

Bashkia Shkodër  
Biblioteka «Marin Barleti»

# Gegnia

*E përkohshme kulturore-artistike*

5 -2018  
Vjeti III i botimit,  
Shkodër

**Gegnia**

E përkohshme kulturore-artistike

5 -2018

Vjeti III i botimit,  
Shkodër

**Redaksia:**

Gjovalin Çuni, Arben Prendi, Ermira Alija,

**Redaktor gjuhësor:** Erzen Koperaj

**Botohet nën kujdesin e bashkisë Shkodër dhe  
bibliotekës “Marin Barleti”**

**ISSN: 2519-73-91**

**Adresa e redaksisë:** Biblioteka “Marin Barleti”, Shkodër

**E-mail:** [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)  
[info@bibliotekashkoder.com](mailto:info@bibliotekashkoder.com)

**Shënim:** *Pikëpamjet e artikullshkruesave nuk shprehin  
detyrimisht qëndrimin e redaksisë.*

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

▪ <b>Editorial</b> ▪ .....	5
Tranzicion, tranzicion! .....	5
▪ <b>Albanologji</b> ▪	
<b>Arshi PIPA</b> <i>Mitologjia e Shqipnisë</i> .....	10
<b>Maksim GJINAJ</b> <i>Një shekull i shtypit shqiptar në bibliografinë e periodikut</i> .....	14
▪ <b>Histori&amp;arkeologji</b> ▪	
<b>Anelmo SPAHIJA</b> <i>Evolucioni i mendimit dhe i veprimtarisë politike të Lidhjes së Prizrenit</i> .....	21
<b>Agron LUKA</b> <i>“Afrodita e skodrinonit” - statujëza më e re ndër hyjneshat e bukurisë</i> .....	39
<b>Zamir TAFILICA</b> <i>Tradita muzeore në Shkodër</i> .....	64
▪ <b>Trashëgimi kulturore</b> ▪	
<b>Ledio XHOXHI</b> <i>Shqiptarët dhe trashëgimia kulturore shpirtërore e tyre</i> .....	87
▪ <b>Filateli</b> ▪	
<b>Lorenc KAÇULINI</b> <i>Historia e filatelisë në Shkodër</i> .....	96
▪ <b>Personalitete</b> ▪ .....	103
<b>Ali LLUKAÇI</b> .....	103
▪ <b>Letërkëmbim</b> ▪	
<b>Nexhmi BUSHATI</b> <i>Dr. Robert Elsie - Dijetari me zemër të madhe</i> .....	117
▪ <b>Bibliofili</b> ▪	
<b>Sidita HALLUNI</b> <i>Dixhitimi një qasje e re në bibliotekën publike “Marin Barleti”</i> . 120	
▪ <b>Letërsi -art-kulturë</b> ▪	
<b>Skënder TEMALI</b> .....	123
<i>Shoqata e shkrimtarëve të Shkodrës - zë i veçantë në kulturën tonë</i> .....	123
▪ <b>Personazh</b> ▪	
<b>Xhahid BUSHATI</b> <i>Jetë nga jeta e shkrimtarit Skënder Drini</i> .....	127

▪Letërsi▪

<b>Skënder DRINI</b> <i>Testamenti</i> .....	139
<b>GJERGJ FISHTA</b> <i>Lahuta e Malesisë</i> .....	144
<b>Gjergj Jozef KOLA</b> <i>Mrekullia e heshtun e Nanë Terezës</i> .....	172
<b>Primo SHLLAKU</b> <i>Diaspora shqiptare – Kjo jetime me prindë gjallë</i> .....	196

▪Drejtshkrimet e shqipes▪

<i>Ortografija e Gjuhës Shqipe (1964)</i> .....	203
---	-----

▪Editorial ▪

## TRANZICION, TRANZICION!

*-Refleksione mbi aktualitet tona-*

Ajo çka po ndodhë me ne shqiptarët është njëmend dëshpruese. Të ishte gjallë Fishta do t'i shkruente edhe një herë poezinë "Nji gjamë desprimit" e "Surgite, mortui!" (Çohi të dekun!). Qe 27 vjet po e lakojmë fjalën tranzicion pa mujtë me dalë prej saj dhe tue pritë si fakiri copën ngrehim veshët kah Evropa, çka po thotë: *A do të na pranojnë ma në fund në Bashkimin Evropian?! A do të dalim ndonjëherë prej këtij tranzicioni?*

Në fakt kÿ duket se është shansi i fundit i Shqipnisë me u bashkue me familjen evropiane. Nëse nuk ia mbërrimë kësaj dite, askush nuk e din se nga do t'ia mbajë Shqipnia e shqiptarët e shkretë (ata që kanë teprue). Disa ia veshin fajet asaj, Evropës që na rren, disa shohin pak ma thellë, e shohin në brendësinë e zhvillimeve tona shoqënore e politike. Në parim, jena popull i shprehun për përkatësinë evropiane dhe me orientim shpirtnor e kulturor evropian, por sa punojmë për këtë gjâ kjo është realitet tjetër, që don gjykue. Të dalun prej një diktature të prodhueme prej vetë nesh, tash sa vjet rropatena prapë në një kaos të krijuem po prej vetë nesh, në përpjekje të mundimshme me ndërtue një shoqni dhe shtet demokratik.

### **Programi për integrimin evropian, program normal i zhvillimit të një vendi demokratik**

Evropa na ka vendosë një program të qartë përpara. Çdo proces zhvillimi shoqnor, integrim apo bashkim, siç na pëlqen ne me e quejtë, duhet me e pasë një program, përndryshe spontaniteti nuk dihet se ku të çon. Në fakt ky program është rruga e përparimit tonë të gjithanshëm dhe është e natyrshme që duhet me i prë edhe tranzicionit tonë kombëtar drejt një të ardhmeje evropiane. Edhe sikur të mos ishte në skenë ky projekt i integrimit tonë në

rrjedhën e jetës së shoqnisë evropiane, ky program i duhet çdo populli sot me dalë prej errësinës, padijes, kriminalizimit dhe kaosit të gjithmbarshëm.

Është e qartë tashma se përgjegjësinë kryesore për realizimin e këtij programi e ka klasa politike shqiptare (që i ka dalë për zot dhe kinse ka fitue mandatin prej elektoratit), e cila në qoftë se nuk ia del me e përfshi Shqipninë në BE ka dështue përfundimisht. Çmimin e dështimit të politikës e pagoi populli shqiptar edhe gjatë diktaturës komuniste. Të paktën ajo e kishte në programin e saj largimin nga Evropa dhe ndërtimin e socializmit me forcat e veta! Ajo që menduem se do të ishte librimi i këtij populli, klasa politike e mbas viteve të nandëdhjeta, shpejt i lshoi flamujt e idealizmit e shpresës tonë për një Shqipni e jetë demokratike i doli flaka fund e maje...

Lufta e pamoralshme politike për vota që prodhojnë pushtet e shndrroi andrrën për liri, demokraci dhe Evropë, në një banderolë llamarine që t'i merr sytë me shkëlqimin e saj, por nuk vlen për asgjë. Sa herë iu afruem deri diku cakut, doli gjithmonë diçka, që në fakt kishte vlue e fshehun, që na largoi edhe ma larg si atë varkën e vogël në furtunë... Herë pëlçet lufta e ashpër politike, herë vidhen votat, herë shpërthen trafiku i drogës e naltohet korrupsioni, herë varfnia i detyron njerëzit me i hý edhe një herë emigracionit të paligjshëm, e varkën e shkretë ku jena të gjithë na shqiptarët e fshin furtuna...

Misioni i politikës është me i prí shoqnisë drejt rrugës së përparimit të gjithanshëm tue ndjekë modelin e së mirës dhe të drejtës, por nuk ka nevojë me bâ ndonjë studim të veçantë për me pa se sa është realizue ky mision. Flet gjendja vetë, rezultati...

Sigurisht nuk vlen ma krahasimi me të kaluemen, me kohën e diktaturës komuniste. Krahasimi duhet të bahet me gjendjen e vendeve të tjera të Ballkanit dhe në kulm me ato të Evropës Perëndimore. Vetëm ky krahasim mund të na ndriçojë mendjen dhe të na orientojë drejt një të ardhmeje tjetër prej kësaj që është sot në Shqipni.

Përparimi i një shoqnie është matë universalisht në lidhje me raportin që ajo ka me të vërtetën dhe drejtësinë. *A artikulohet e vërteta sot në Shqipni dhe a zbatohet drejtësi?! Na që jetojmë këtu, por edhe ata që vijnë për halle apo punë të vetat, e dimë dhe e provojmë çdo ditë se jo, e vërteta ndryhet në çelësa dhe drejtësia*

manipulohet simbas interesit të atyne që i fshehen drejtësisë për shkak të zullumeve që kanë bâ, dhe të atyne që e kanë për detyrë shtetnore por edhe morale për me dhanë drejtësi tue zbatue ligjet e shtetit e të shoqnisë. Nga ana tjetër ai që i mbahet të vërtetës dhe drejtësisë është i rrezikuem për shkak të degradimit të raportit të kompromentuem të shoqnisë dhe institucioneve të saj me të vërtetën dhe drejtësinë.

### **Marrëdhania me të vërtetën dhe drejtësinë përcakton kahun e zhvillimit shoqënor**

A është artikulue e vërteta dhe është vendosë në vendin e saj drejtësia? Jo! Klasa politike aktuale e ka mashtruar popullin e vet me andrrën e bukur për lirinë, demokracinë dhe Evropën sa herë ka ardhë rendi për me u paraqitë te kutia e votimit. Fatkeqësisht shteti i ashtuquejtun demokratik nuk qe në gjendje me dhanë kurrfarë drejtësie as për viktimat e regjimit komunist, të gjallë e të vdekun, të shumtëve nuk u dihen as vorret ende sot.

Përgjatë këtij tranzicioni drejtësinë e ka bâ shpesh rodi i ma të fortëve e i ma të pasunve, që nuk dihet si janë bâ të tillë, dhe i vjegzave politike të lidhuna me ata. Popullit të shkretë i janë premtue qindra mijra vende pune, rroga ma të mira, banesa e rrugë ma të mira, shkolla e arsimtarë ma të mirë, spitale e mjekë ma të mirë, rend e siguri për jetën, drejtësi e barazi para ligjit, e cili është rezultati? Në raport me kohën e gjatë është e qartë se rezultati nuk është ai që duhet. Sigurisht, në qoftë se krahasimi bahet vetëm me regjimin komunist, Shqipnia ka përparue, sepse ai regjim ka qenë vetë ferri mbi tokë.

Shpresojnë njerëzit sot tek i ashtuquejtuni gjykim i Vettingut në Drejtësi, që mundet me kenë një shkëndijë e drejtësisë së mungueme, por që kërkon jetën e një brezi njerëzor me u realizue siç duhet. Flasim për demokraci dhe ajo shpesh mungon, sepse institucionet që e mbrojnë dhe e sigurojnë, nuk janë të tilla, pra demokrate, pa dashtë me i dhanë ndonji definicion tjetër. Një pjesë e mirë e popullsisë janë largue dhe vijojnë të largohen prej vendit në kërkim të një jete ma të mirë, të një shkolle ma të mirë, të një mjekësie ma të mirë, të një infrastrukture ma të mirë etj., që në vendin e tyne nuk u krijue në gjithë këto vite të tranzicionit. Si pasojë e këtij tranzicioni sot kena edhe në numër tkurrje të popullsisë. Ikanakët e rinj, mes vujtjeve të shumta, tuj përdorë "çdo gjâ, çka i vjen përduersh", vijojnë t'i shtohen përsëri pjesës

që ikën me kohë. Papunësia e të rinjve u bâ plagë e pashërueshme e këtij tranzicioni.

*Me kë luftuem gjatë këtij tranzicioni? Ma shumë se me veten tonë, me askënd. Palët politike që alternuen pushtetin, ndanë njerëzit në miq dhe armiq, me ne ose me ata, me zotnimin e të mirave që sjell pushteti, tuj e lanë me u rropatë në përditësi palën tjetër. Në të gjitha rastet viktimat e përhershme âsht populli, i quejtun si për tallje, edhe sovran. Sovran, po ç' sovran i shkreti?! Sovrani zgërlaqun prej të vetëve.*

### **Përparimi mendor e shpirtnor matet edhe prej cilësisë së arsimit dhe kulturës**

Përparimi i një shoqënie âsht matë universalisht me cilësinë e arsimit, të kulturës, apo po të doni edhe me cilësinë e artit dhe të letërsisë së një kombi. Mbas plagëve të thella morale, sociale e institucionale me folë për arsim, kulturë e letërsi do të ishte luks e mendjemadhësi. Megjithatë na kena shembullin e një lexuesi dhe një kulture të mbijetueme në rrjedhë të shekujve, prandaj nuk e quejmë për të madhe, se edhe përgjatë këtij tranzicioni arsimit shqiptar iu nënshtrua eksperimenteve nga ma të ndryshmet, që ma shumë sollën dame se dobí. Secila qeveri ia nisi eksperimentimeve nga zero, tue prodhue ma shumë propagandë e hutim sesa rezultate konkrete. Ndryshimi i shpeshtë i të ashtuquejtunave reforma në këtë fushë veçsa e bani edhe ma komplekse situatën, tue çue në konfuzion të shpeshtë arsimin parauniversitar por edhe atë universitar, rezultat i të cilit doli i ashtuquejtuni "analfabetizmi funksional" i cili prodhoi masivizëm diplomimi por vetëm në letër. Përpjekja për me afrue sistemin tonë arsimor me atë evropian rezultoi një shartim mekanik dhe një kopje e zbehtë e tij.

Ndërkohë kultura shqiptare e tranzicionit u dominue prej realizmit socialist në formë e në përmbajtje. Në televizionet tona gëlojnë përditë filmat dhe narrativa e realizmit socialist që vijnë me propagandën e tyne ditë e natë, kur regjimi komunist përshkruhet si regjimi ma i mirë në botë dhe shqiptarët tue ndërtue kala në brigjet e Adriatikut, tue marrë në thep të pushkës botën borgjezo-revizioniste. Ndërsa propaganda e kinemasë së kuqe mbush ekranet e televizorëve dixhitalë, ma së paku pa asnjë shenjë skjaruese për të moshën e re, askujt nuk i skuqet faqja, që kinemaja, letërsia e kultura e tranzicionit lëngon dhe ka



pak mbështetje nga shteti me arsyetimin se ajo është ma shumë aktivitet privat i artistave për të cilën shteti dhe shoqnia nuk ka pse të shpenzojë

...Kur diskutohet apo studiohet letërsia e realizmit socialist na del gjithmonë moderne dhe postmoderne. Botohen e ribotohen kryeveprat e realizmit socialist, jo rrallë me fondet e shtetit, tue iu servirë publikut si kryevepra të letërsisë moderne, ndërkohë që për letërsinë tjetër shteti nuk shpenzon asnjë qindarkë: *Sa autorë të ndaluem, vepra e të cilëve mbeti në dorëshkrim janë botue me ndihmën e shtetit demokratik shqiptar?* Nuk dimë ndonjë shembull domethanës. Sa pensione të posaçme e tituj pompozë iu dhanë krijuesve të realizmit socialist, e sa atyne që vepra u mbeti në dorëshkrim apo që jeta u shkoi në birucat e burgjeve të Shqipnisë?! Kultura shqiptare nga një kulturë e izolueme në kohën e diktaturës, në raport me kulturën e huej, gati-gati po bahet një kulturë e izolueme edhe në raport me vetë veten përveçse me botën. Letërsia dhe literatura shqip nuk po qarkullon mjaftueshëm as brenda përbrenda shqiptarëve. Lexuesi në Shqipëri nuk është në komunikim me letërsinë që krijohet në Kosovë, në Maqedoni apo në Malin e Zi e anasjelltas për mos me pretendue për letërsinë që krijohet në diasporën shqiptare të shpërndame nëpër botë. Shkrimtari, krijuesi dhe artisti shqiptar gjendet i rrethuem prej indiferencës totale të shtetit dhe shoqnisë ku jeton.

### **Tranzicion dhe konfuzion!**

... Ky tranzicion, simbas shenjave që ka, fatkeqësisht do jetë vazhdimisht i tillë: tranzicion, dhe shoqënia jonë një shoqni në tranzicion të përjetshëm.

*A kena dështue si shoqni në këtë periudhë tranzicioni?*

Secili mundet me e bâ këtë pyetje e me i dhanë përgjigje simbas rradakes së vet...

Në këtë cak ku jena askush nuk mundet me dhanë një afat kohor për fundin e tij të shumëpritun. Lajmi i mirë është se: fundi i tranzicionit dhe fillimi i një të ardhmeje të re, do të jetë futja e Shqipnisë në Bashkimin Evropian, dhe lajmi i keq: nëse nuk do të hyjmë kurrë ose koha do të jetë aq e gjatë sa të udhëtonim drejt Marsit, nuk do të mjaftojë as jeta e brezit që sot është njëzet vjeç. Në rastin e dytë, ky shkrim do të lexohet mbas njëqind e sa vjetësh si një mesazh i dëshpruem në një shishe që dallga e oqeanit e ka nxjerrë në sterenë e tranzicionit...

**Arshi PIPA\*****MITOLOGJIA E SHQIPNISË**

(Përktheu nga frëngjishtja: *Ndriçim Mlika*)

Mitologjia shqiptare nuk përban akoma objektin e ndonji monografie, por kjo temë ka kenë trajtue në shumë ese, artikuj të gjuhësisë, folklorit e të etnologjisë. Mundena me thanë se kjo mitologji asht e tipit pagan ballkanik. Fetë monoteiste që i janë mbivendosun, katolike në Veri, ortodokse në Jug dhe islamike në krejt vendin, s'kanë muejt me e prekë natyrën e saj. Historia e shqiptarëve, që shkon deri te shtegtimet e para indoevropiane në Ballkan, asht një varg pushtimesh të popujve që i rrethojnë, romakët përgjatë Antikitetit, grekë e italianë në Mesjetë, turqit në fillim të Kohës Moderne. Duhet me e e pritë pra, që mitologjia shqiptare me kenë aq sinkretike. Mundena me folë për shtresa të hueja që i sillen boshtit të një konstanteje që identifikohet lehtë: kultit të gjenisë e të racës.

Hyjnitë e kësaj mitologjie janë, gati të tana, pagane. Aty ka shtojzavalle (*nuset e malit*, fjalë për fjalë "nimfat e malit"), najada (*gërzheta*), por edhe vitore e zana. Aty ka edhe gjiganda damtorë (*baloz, katalla*), po ashtu edhe shkurtabiqa që zbaviten tue gërگا njerzit (*thopç*). Takojmë, gjithashtu, ujkun e prrallave (*karkanxholin*) dhe një variant të gishtos (*kacamicrin*). Ka edhe plot përbindsha (*gogola, kuçedra, lubç*). Metamorfozat ndodhin shpesh, burri kthehet në drë, në buf, grueja në bukël, në kukuvajkë apo turtulleshë. Hyjnitë e shpisë munden me pasë trajtë njerzore (*nana e votrës*), ose shtazore (*vitorja*, një lloj gjarpnit). Sakrifikohen kafshë (tjeraherë gra) në teme ndërtesash, ushtrohet magji (përshebull, për me e bâ të keqen të pamujtun). Ka kangë yshtjet e të tjera për me bâ me ra shi. Gjuhet përkundër hanës së eklipsueme për me ju shtî frikën ujqve që e kanë mësyë. Sendet magjike, si: pasqyrat, hajmalitë apo unazat, losin një rol të madh.

\*)Tit. origj.: *Dictionnaire des Mythologie .Sous la direction de Yves Bonnefoy A-J. Flammarion , Paris 1981, f.5 ( Zeri ALBANIE (Mythologie de l). A.P.*

Besohet te *syni i keq* e te andrrat paralajmëruese. Besohet te fuqitë e spikatuna të gurëve e të barnave. Por besohet ma tepër te ato të heronjve.

Kulti i heronjve, i dëshmuem përgjatë një traditet kombtare të pasqyrueme si në epopetë popullore ashtu edhe në të drejtën zakonore, ruen veçansitë e tij mitike në disa pjesë të izolueme të Shqipnisë së Veriut. Të mbrojtuna prej maleve të thepisuna, banorët e tyne kanë mujtë me iu rezistue kolonizimeve romake e sllave e, bile, kanë mujtë me ruejtë njëfarë autonomiet gjatë sundimit turk. Këto barij të Veriut, në pjesën ma të madhe katolikë, vazhdojnë me u thirrë me emnat Uk, Dash, Shpend, Sokol; ata adhurojnë zjermin (me e shkapërcye asht tabu), betohen “Pasha Qiell e pasha Dhé”, vajtojnë të vdekunit tue gërdhishtë ftyrën simbas një ritualit që ka mbetë prej një kërcimi mistik, besojnë në shpirtnat e vendit, në frymë, në demonë, magjistarë ose vampirë. Totemizmi e animizmi përzihen me mite klasike e legjenda mesjetare. Uliksi e Perseu kanë të barazvlershmit e tyne. Polifemi shqiptar thirret *katallâ* në kujtim të mizorive të mercenarëve katallanë të shekullit XIV. *Zana*, mbrojtësja e herojve, asht edhe etimologjikisht, e afërme me Dianën (perëndesha romake shoqnohet nga një sutë, kurse kafsha e hyjnisë shqiptare asht një kaproll i egër), ndërsa prej funksioneve të saj ajo duket si zana sllave, vila. Vetë emni i shtojzavalleve asht një rast sinkretizmit pagano-kristian, “Shtoji, Zo(t), vallet”, don me thanë fjalë për fjalë: “Shumoji o Zot, vallet e tyne”.

Shumë prej këtyne besimeve pagane janë të përbashkëta me ma se një popull ballkanik, kurse të tjerat janë me origjinë latine ose, ndoshta, keltike. Por, në çka mitologjia shqiptare paraqet një fizionomi të vetën, trajtë tipike?

Kjo mitologji nuk ka perëndi. Hyjnitë janë dytësore e nuk kanë emna të përvetshëm, ose ma mirë me thanë emni i tyne asht krejt përgjithësues. Betohen për qiell e për tokë, i luten Diellit e Hanës. Por këto nuk janë veçse personifikime të elementeve ose të fenomeneve fizike, jo të personave. Ndër elementa, toka asht mbizotnuesja. Atributi sipëror i herojve ose heroinave asht “burri i dheut”, “e bukura e dheut”. Betimi në gur asht solemn (Gjeçov § 534). Kush betohet përmbi gur, ka me u bâ si guri bâ me e dhunue betimin (*zanat* kanë fuqinë për me pa se kë me bâ gur). Gjejmë grumbuj gurësh (*murana*), aty ku ndokush asht vra

nga hakmarrja (Çabej 360), edhe hidhen gurë për me lehtësue lodhjen (*me lanë pritesën*).

Nji tjetër prej trajtave tipike të kësaj mitologjie asht mungesa e botës përtej vorrit. Qielli nuk ka asgja qiellore dhe ferri nuk duket askund. Besimi tek fantazmat (*kukuthi, lugati, vurrkollaku*) asht i përhapun. Por fantazma asht një shpirt i bezdisun që toka nuk e ka pranue për shkak të ndonji pengu të randë. Ky shpirt asht një hije, ose një fantazëm me njëfarë mbështjelle trupore ku ka mbetë ndopak landë (mundet me ngritë pesha).

Mitologjia shqiptare, me zana e demonë, por pa perëndi e eskatologji, ku edhe vetë koncepti për shpirtin asht pastërtisht negativ, asht pra tanësisht tokësore. Ajo sillet përreth bipolaritetit etik të së mirës e të keqes. Në një krah kena një përbindësh, hidër (*kulshedër, kuçedër apo mamadragë*), që duket si me kenë një gjarpën me tetë krena i cili than ujin e helmatis ajrin. Në krahun tjetër, asht heroi mitik që përballet me të në shpellën e saj dhe e vret. Në Jug, ku pushteti i sulltanit i zen vendin atij të perandorit bizantin, ky kampion asht shpeshherë fisnik (djali i mbretit), kurse në Veri asht një djalë i popullit i lindun drague. Burri-drague ka flatra nën krahë e mundet me fluturue. Kjo të sjell ndër mend mitin e Herkulit që lufton kundër Hidrës, i cili paraprin atë të shën Gjergjit që vret draguen. Shën Gjergji asht shumë popullor në Shqipni e festa e tij koinçidon me ardhjen e pranverës. "Gjergj" asht edhe emni i heroit që çliron vendin e tij nga një "përbindsh i zi i dalun prej detit" në atë që asht ndoshta ma e bukura rapsodi shqiptare (K,K 5). Në mitologjinë shqiptare, ku asht për me u përmendë cikli i rapsodive të Veriut, naltësohet një kuptim i jetës heroike thellësisht etnik. Herojtë kryesorë të këtij cikli, Muji e Halili, kanë emna myslimanë, të huajtun prej kangëve epike boshnjake, prej ku asht marrë edhe metrika e tyne (rapsoditë janë të këndueme nën tingujt e lahutës). Por këto elementa të huej nuk e prekin thelbin autokton të këtyne kangëve mitike. Muji asht një barí që zanat e malit, në shkëmbim të një shërbimi që ju ka bâ, i kanë dhanë një forcë mbinjzore: ai mundet me zhgulë me gjithë rrâjë lisat (KK 7). Nji tjetër rapsodi ia vesh këtë forcë talentit të tij si gjuetar: ai mbërrin me kapë tri dhitë me brina arit, në të cilat asht mshehë fuqia e zanavet (KK 1). Muji masakron armiqtë e tij, sllavët, por jo pa e pësue edhe vetë. Nji rapsodi e paraqet të plagosun randë, të shoqnuem prej shpirtit të tij mbrojtës, orës, midis një gjarpnit që përkujdeset për

të e një ujkut që i ruen (KK 23). Kur ai vdes, armiku vjen për me e provokue te vorri. Ai zgjohet e i thërret ndihmë, përmes një zogut, të vëllait (KK 32). Muji kthehet në jetë. Një ditë ai provon në dorë forcën e plumbit të armëve me barut. Kur e shef dorën e zhbiruemë, e kupton që koha e tij ka kalue. Ai fshihet atëherë nën tokë si Edipi në Kolonë për me pritë aty me durim kthimin e kohëve heroike (KK parathënie).

Vico e sheh historinë e njerzimit si një proces ciklik që përshkohet ndër tri faza: teologjike, heroike e humane. Mentaliteti mitik shqiptar mjegullohet tek e para për me u pëlqye kaq shumë me të dytën, sa mos me muejt me dalë ma prej aty. Muji nuk asht i vetmi përfaqësues i këtij mentaliteti. Një tjetër shembull asht ai i vetë heroit kombëtar, Gjergj Kastriotit, të thirrur Skanderbeg (1404-1468). Humanisti shqiptar Marin Barleti që ka shkruar historinë e parë romantike të heroit (rreth 1510), kallëzon që e ama pa andërr se kishte me lindë një drague, trupi i të cilit mbulonte tanë Shqipninë, e goja e tij përpinte turqit. Populli e ka zhdrivillue këtë mit, tue e ba Skanderbegun një titan që mundet me mbërthye “pesëdhete persona” e me mustaqe “katër pllambë të gjata”. Ai hidhte kundër armiqve që e rrethojshin shkrepa “të mëdhaj sa një shpi”, ndalonte me një “shtjelm” ujnat e lumit për mos me lanë me kalue turqit. Ai asht i paprekshëm, tue kenë “i lindun me këmishë”. Kali i tij fluturon shkrep mbë shkrep tue lanë ndër ta, kur kalon, gjurmët e potkojve, që shifen edhe sot. Gjithashtu kur Skanderbegu vdes, populli e zhvarros për me bënë hajmalí me kockat e tij (sca 113, 116, 113, 24, 25, 127, 206).

Bibliografi: HAHN. J.G. VON, *Albanesische studien* 1-3, Iena, 1854; *Griechische und Albanische Marchen* I-II, Leipzig, 1864. PEDERSEN, HOLGER, *Zur Albanesischen Volkskunde*, Copenhagen, 1898, LAMBERTZ, MAXIMILIAN, *Albanische Marchen und andere Texte zur albanischen kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen*, Berlin-Leipzig, 1923, *Visaret e Kombit II, Këngë kreshnikësh e legenda*, (B. Palaj, D. Kurti), Tirana 1937 (shkurt. KK). GJEÇOV, SHITJEFEN, *Codice di Lek Dukagjini ossia diritto consuetudinario delle montagne d'Albania* (përkth. P. Dodaj), Romë, 1941. ÇABEJ, EQREM. “Albanische Volkskunde” in *Sudost-Forschungen* XXV (1966); 333-87 (përmban një listë gati komplete të hyjnive e përbindshave). *Tregime dhe këngë popullore për Skënderbeun* (Q. Haxhihasani, Z. Sako) Tirana, 1967 (shkurt Sca).

**Maksim GJINAJ**

## **NJË SHEKULL I SHTYPIT SHQIPTAR NË BIBLIOGRAFINË E PERIODIKUT**

Informacioni mbi veprimtarinë dhe krijimtarinë publicistike të pranishme në shtypin e përditshëm e periodik shqip, mbart dhe dinamikisht merr vlera me kalimin e viteve e dekadave. Mbështetja mbi trashëgiminë publicistike është e vlefshme si për njohjen e zhvillimeve nëpërmjet fakteve e dukurive, ashtu edhe për vlerësimet e tyre nga bashkëkohësit dhe brezat.

Me institucionalizimin e veprimtarisë bibliografike pranë Bibliotekës Kombëtare, nisi edhe hartimi i bibliografisë së shtypit të përditshëm e retrospektiv shqip.

Kronologjia e përgatitjes së bibliografive:

1961- Ky vit shënon fillimin e përgatitjes së bibliografisë të shtypit periodik të përditshëm e më pas atij retrospektiv. Bibliografia e periodikut pati tituj të ndryshëm; sot titullohet *Bibliografia Kombëtare e Republikës së Shqipërisë – Artikuj të periodikut shqiptar*, botim mujor. Nga 25-30 organe kombëtare dhe lokale që janë përpunuar para viteve '90, sot i nënshtrohen proceseve bibliografike, rreth 160 titujve në vit.

Krahas përgatitjes dhe botimit të bibliografisë së periodikut të përditshëm, më 1970, Biblioteka Kombëtare filloi punën për përgatitjen e bibliografive retrospektive të artikujve të periodikut. Janë botuar *Bibliografitë e shtypit* për vitet 1944-1960 dhe ato për vitet 1939-1944.

Shtypi shqiptar i botuar brenda dhe jashtë Shqipërisë “Periudha e pavarësisë 1912 (28 nëntor) deri më 1939 (7 prill)” prezantohet në *Bibliografinë e artikujve të periodikut shqiptar* duke filluar nga viti 1984. U desh një punë prej disa dekadash dhe sot, me përfundimin e Bibliografisë së artikujve të periodikut shqiptar të vitit 1938-7 prill 1939, njoftojmë se Biblioteka Kombëtare, përmes Sektorit të Bibliografisë, mbulon me Bibliografinë e artikujve të shtypit shekullin e parë të shtetit shqiptar, prej 1912-ës dhe në vijim.

Është punë e realizuar me përkushtim nga dhjetra bibliografë, një pjesë e të cilëve nuk rrojnë më. E gjithë kjo veprimtari u realizua dhe vijon të realizohet sot prej një numri modest bibliografësh, duke kryer paralelisht edhe veprimtari të tjera bibliografike të përditshëm dhe retrospektive.

Secila bibliografi, mujore apo vjetore, të përditshëm apo retrospektive, është ndërtuar sipas skemave të caktuara të klasifikimit bibliografik, me rreth 150 kapituj e rubrika, ku materiali është regjistruar në mënyrë të organizuar, sipas përmbajtjes që përfaqëson çdo artikull.

Bibliografitë janë të pajisura me aparat ndihmës (tregues apo indekse) për të lehtësuar përdorimin e tyre.

**Bibliografia e shtypit periodik të përditshëm** e cila hartohet çdo muaj, bazohet kryesisht në përzgjedhjen e materialit të botuar në revistat dhe gazetat përkatëse. Sipas kriterëve të përcaktuara, artikujt që klasifikohen në kapituj me temë historike, juridike, letrare, studimore etj., regjistrohen të gjitha pa seleksionim. Artikujt e tematikave apo niveleve informuese apo me përmbajtje thjesht të përditshëm përzgjidhen gjithmonë duke iu nënshtruar gjykimit të shërbimit ndaj trashëgimisë historike e kulturore.

Organe të specializuara të kuadrit të shkencave albanologjike si *Buletini i Institutit të Shkencave të viteve '50*, *Studimet historike* dhe ato *filologjike* që datojnë nga viti 1964 dhe vijojnë edhe sot, Buletinet e Universitetit të Shkodrës dhe të institucioneve të tjera shkencore e arsimore, organet e *Kulturës Popullore*, arkeologjisë, monumenteve të kulturës e kështu me radhë, të cilat skedohen përmes veprimtarisë bibliografike, klasifikohen e indeksohen sipas treguesve të pranishëm në bibliografitë korrente të shtypit, janë lehtësisht të përdorshme nga studiuesit dhe albanologët si dhe lexuesi masiv.

Një pjesë e bibliografisë të përditshëm, 15 vite, është regjistruar në bazën e të dhënave të katalogut të kompjuterizuar, ku, ndryshe nga katalogu tradicional me skeda manuale, informacioni për njësi bibliografike paraqitet sipas një formati standard, qëllimi i të cilit është t'i pjesëtojë elementët e katalogimit, duke i organizuar në mënyrë të tillë që të kuptohen dhe manipulohen nga kompjuteri.

**Bibliografia retrospektive** e shtypit periodik shqiptar të viteve 1913-1944 sjell informacion mbi një jetë e veprimtari që njihet jo

drejtpërdrejt. Po japim disa të dhëna përmbajtjesore e statistikore: Shtypi shqiptar lindi dhe u zhvillua në luftë për pavarësinë e Shqipërisë, për tërësinë tokësore, si edhe për të drejtat dhe liritë politike shtetërore e kombëtare. Zhvillimi i tij ecën paralel me zhvillimet politike, ekonomike, kulturore e arsimore të shoqërisë dhe shtetit shqiptar. Me shpalljen e pavarësisë, epiqendra e shtypit shqiptar, ashtu si edhe e gjithë jeta shoqërore e kulturore, si edhe veprimtaria politike u zhvendos nga diaspora në Shqipëri. Edhe shtypi ndryshoi rrënjësisht gjeografinë e botimit, nga jashtë Shqipërisë brenda saj. Shkodra, Vlora, Korça dhe Durrësi, më vonë Elbasani, Tirana, Gjirokastra etj. u bënë qendra, ku lindën dhe përparuan disa organe (gazeta e revista), pa ndërprerë botimin në organet ekzistuese shqipe të diasporës. Dukshëm, shtypi fokusohet më për së afërmi në dinamikën e ngjarjeve, aspiratat, opinionin e brendshëm, pa shmangur atë të gazetarisë së diasporës, e cila ishte disi më larg ngjarjeve të brendshme, por më pranë qarqeve, ku zhvilloheshin ngjarjet e politikës e diplomacisë botërore.

Për arsyet e njohura historike e politike, shtypi shqiptar lindi dhe u zhvillua në vende që ishin në një nivel më të lartë zhvillimi se Shqipëria. Atje shtypi, si edhe gazetarët dhe publicistët u ushqyen me përvojën e gazetarisë evropiane e ballkanike. Intelektualë dhe personalitete politike e publike, të arsimuar e me influencë në veprimtarinë shtetërore e administrative, sociale e kulturore, letrare e publicistike dhanë kontribut të drejtpërdrejtë në shtypin shqiptar brenda dhe jashtë vendit. Shpesh ata u bënë pjesëmarrës aktivë në zhvillimet politike, mbetën autorë dhe aktorë saj, me reputacion dinamik, me ngjitje e zbritje sipas veprimtarisë, por edhe sipas ngjitje-zbritjeve dhe ndryshimeve politike e historike përgjatë shekullit të shtetit shqiptar. Kjo dinamikë e pasqyruar në shtypin shqiptar është e regjistruar nga bibliografia retrospektive e shtypit periodik.

Në total nga organet e botuara për herë të parë dhe ato të trashëguara vit pas viti, janë përshkruar bibliografikisht **1507 koleksione vjetore ndërmjet viteve 1912-1944**. Në këtë kuptim një revistë apo gazetë, formon aq koleksione vjetore, sa numri i viteve që është botuar dhe përshkruar. Me një shembull më të thjeshtë, gazeta *Dielli* e cila u botua çdo vit, për periudhën 1912 - 1944, në kuadrin e bibliografisë retrospektive formon 33 koleksione.



Ndërsa numri i saktë i titujve të organeve që u botuan në vitet 1912 - 1944, pavarësisht nga kohëzgjatja e tyre, është 546 tituj. Nga i gjithë ky shtyp i botuar mes viteve 1912 (28 nëntor) deri në fund të nëntorit 1944, janë vjelë saktësisht 192235 skeda apo njësi bibliografike, që përbëjnë kryeartikuj, artikuj redaksionalë, artikuj polemikë, artikuj të tematikave nga më të ndryshmet, njoftime e raportime (sipas rëndësisë së informacionit që sjellin edhe njoftime të shkurtra në paragrafë të veçantë), krijime letrare në prozë, poezi apo pjesë teatrale. Edhe fotografitë dhe ilustrimet artistike janë bërë objekt i përshkrimit bibliografik. Hartat, tabelat statistikore, listat, madje edhe reklamat kryesisht vendase, janë edhe ato të pranishme në këto bibliografi.

Botimet bibliografike të shtypit retrospektiv mbulojnë periodicitet vjetor duke përshkruar lëndën e çdo organi brenda vitit. Organizimi i brendshëm për bibliografinë e çdo viti është bërë mbi bazën e një skeme të klasifikimit bibliografik, e cila në përgjithësi mbulon dhe organizon materialin e përshkruar në krejt tematikën që përmbajnë koleksionet e shtypit. Për çdo bibliografi vjetore janë çelur edhe rubrika të veçanta, që bazuar në ngjarje madhore të vitit, sigurisht të trajtuara në shtyp, ruajnë të veçantën, që shpreh fizionominë e atij viti. Rubrika të veçanta, të cilat janë të përkohshme, sa zgjat ngjarja madhore dhe jehona përkatëse, janë hapur çdo vit apo disa vite, duke organizuar në to informacionin i cili fokusohet mbi këto ngjarje, ka material të bollshëm dhe jep e ndihmon në plotësimin e fizionomisë së vitit, ashtu si ndihmon edhe përdoruesit e botimeve bibliografike për gjetjen e informacionit përkatës në kompleksitetin e tij.

Një vështrim mbi veprimtarinë bibliografike mbi shtypin periodik të shekullit të shtetit shqiptar të pavarur, padyshim, tërthorazi, është edhe një vështrim mbi zhvillimet kryesore të historisë së Shqipërisë, e parë ngushtë me raportet mes historisë së shtypit dhe informacionit të organizuar bibliografik mbi të.

Çdo bibliografi për shtypin, mbart vlera përfaqësuese si burim historik për një periudhë historike, aspekt historik të veçantë, njëkohësisht, parë në tërësinë e saj, e gjithë kolana e bibliografisë së shtypit 100-vjeçar, në të gjithë kapitujt dhe rubrikat në të cilat është organizuar, është edhe vetë një burim i mirëfilltë historik. Më thjesht: në çdo vëllim bibliografik është i pranishëm edhe kapitulli mbi historinë, si edhe rubrika të veçanta mbi historinë e

shtetit dhe të së drejtës, arsimit dhe kulturës, historisë së letërsisë etj. Por, me kalimin e viteve, e gjithë bibliografia kthehet ne histori / burim historik përfaqësuar nga çdo zë i veçantë bibliografik, apo në tërësinë e saj.

### **Fakti që përshkruan, njësia bibliografike është një e dhënë historike në fushën përkatëse**

Nga viti 1961 e në vijim bibliografia e shtypit është të përditshëm dhe ecën paralelisht me zhvillimin e ngjarjeve, duke i regjistruar ato menjëherë mbas zhvillimit të tyre, me një vlerësim sipas perceptimit aktual, të padistancuar në kohë. Bibliografi ka mbajtur ndaj tyre, në vlerësimin e peshës së artikujve apo krijimtarisë, veç klasifikimit të saktësuar tipologjik edhe opinionin e përditshëm, receptimin të përditshëm politik apo social.

Për shtypin e 50 viteve të para të shtetit shqiptar, kur veprimtaria bibliografike është e karakterit retrospektiv, qëndrimi dhe perceptimi ndaj ngjarjeve dhe veprimtarisë së autorëve dhe personaliteteve është i distancuar në kohë, kur historia apo raportet e shoqërisë me to kanë lënë vulën e tyre, apo mbahen qëndrime dinamike që, sidoqoftë, kanë ndikime edhe mbi gjykimin për to; edhe qëndrimi i bibliografit është më i varur nga definicionet e qëndrimet e historisë, analizës, kritikës etj. ndaj tyre.

Në botimet bibliografike transmetohen informacione të adresuara për ngjarje e dukuri te cilat nuk do të ishin të njohura, argumentuara plotësisht apo trajtuara në kompleksin e tyre historik e analitik vetëm nëpërmjet dokumentacionit arkivor. Versione të ngjarjeve apo dukurive, opinionet, komentet, "ngjarjet e vogla" plotësojnë tablonë e atyre të mëdhave në tërë zhvillimin e tyre kronologjik dhe hapësinor, receptimin e tyre.

Në këtë bibliografi është regjistruar për çdo vit i tërë kuadri ligjor i kohës, por edhe rruga e kaluar për vendosjen e tij, debatet parlamentare apo lokale, programet, veprimet dhe qëndrimet e partive, organizatave, shoqatave, apo forcave të ndryshme, por edhe mendimin dhe këndshikimin e personaliteteve apo subjekteve. Brenda dhe në trojet amtare e diasporë, të interesuara apo të lidhura me shumë fije me to.

E njëjta gjë, sipas subjektit apo formave specifike përkatëse, vlen edhe për historinë e kulturës, letrave, arsimit, fesë, për ekonominë dhe gjithë fushat e jetës.

Me idetë që përhapën dhe mbrojtën, gazetatat dhe revistat jo vetëm pasqyruan ngjarjet dhe situatën në vend, bënë të njohura opinione dhe mendime, prezantuan zhvillimet politike, ekonomike e sociale në vijimësi dhe situata të veçanta, por patën rol të rëndësishëm edhe në përpunimin dhe pasurimin e mendimit politik e social të shoqërisë. Shtypi, duke qenë zëri i kohës, zëdhënës dhe kritik e analizues i një shoqërie, është njëherazi edhe paralajmërues i pritshmërive politike e shoqërore. Përmes kronikave, artikujve, analizave dhe polemikave pasqyrohen realitete historike dhe përjetimi i tyre nga individit dhe shoqëria, forcat politike dhe grupet e ndryshme sociale e nivelet e ndryshme arsimore e kulturore, mjediset e ndryshme lokale, krahinore e më tej. Vlerësimet dhe qëndrimet e gazetarëve dhe publicistëve janë njëkohësisht edhe pikëpamje dhe ide të elitës, e cila ishte edhe vetëkrijuese, hartuese dhe ndriçuese e shoqërisë nëpërmjet shtypit si pjesë e saj. E njëjta elitë mori përsipër të krijojë dhe zhvillojë politikën, kulturën, por edhe mendimin mbi zhvillimet e kohës dhe të pritshmet edhe përmes botimeve e shtypit.

Rriten vlerat albanologjike të bibliografive të përditshëm dhe retrospektive të shtypit edhe përmes zbërthimit dhe përshkrimit bibliografik të revistave të specializuara shkencore të kësaj natyre, si dhe atyre arsimore, juridike, ekonomike, letrare etj. me vlera të spikatura albanologjike. Revistat e mirënjohura edhe për informacionet dhe studimet e dokumentet me vlera të mirëfillta albanologjike *Dituria, Hylli i Dritës, Leka* etj. rrisin më tej rëndësinë e informacionit që përmban bibliografia retrospektive.

Së bashku me këto organe, edhe revista të mirëfillta albanologjike janë të përpunuara nga bibliografia retrospektive *Studi albanesi*, drejtuar nga profesorët e shquar Roberto Almagià, Matteo Bartoli, Amedeo Giannini dhe Gennaro Maria Monti, publikuar nga Seksioni shqiptar i Institutit për Europën Lindore të Romës, në vitet 1931-1936. Revista përmban studime me vlera për shkencat albanologjike, veçanërisht arkeologjinë dhe historinë e lashtë dhe mesjetare të Shqipërisë.

**ALBANIA (SHQIPËRIA)** - "Revistë për arkeologji, histori, art dhe shkencë të aplikuara në Shqipëri dhe në Ballkanet" e drejtuar nga arkeologu e historiani francez Leon Rey me 6 vëllime të botuara mes viteve 1925-1939, më tej vlerat e botimeve bibliografike.

Zbërthimi dhe përshkrimi bibliografik i shtypit retrospektiv shqiptar ende vijon. Po pritet realizimi i përshkrimit dhe botimit të bibliografisë për vitet 1848-1912, që nga periudhat më të ndritura të historisë së kombit shqiptar, të Rilindjes Kombëtare gjatë së cilës u hodhën bazat ideologjike, politike, kulturore e sociale që synonin çlirimin e vendit dhe themelimin e shtetit kombëtar shqiptar.

**Anelmo SPAHIJA**

## **EVOLUCIONI I MENDIMIT DHE I VEPRIMTARISË POLITIKE TË LIDHJES SË PRIZRENIT**

### **Hyrje**

Lidhja e Prizrenit dhe aktiviteti i saj i gjerë politik, diplomatik e ushtarak shënojnë një kthesë të rëndësishme në historinë e lëvizjes kombëtare shqiptare, pasi për herë të parë faktori dhe çështja shqiptare u shndërruan në faktor me rëndësi jo vetëm rajonal ballkanik, por edhe evropian. Refuzimi i Lidhjes për të njohur vendimet e Traktatit të Shën Stefanit e të Kongresit të Berlinit dhe lufta e realizuar për mbrojtjen e kufijve “nacionalë” (pra territoret e banuara nga shqiptarë), krijoi probleme jo vetëm për sundimtarët ballkanikë, por edhe për diplomatët evropianë, veprimtaria e të cilëve e bazuar tek parimet e “raison d’etat”, në ekuilibrin e forcave e në realpolitikë, e për të cilët përcaktimi i politikave ndërkombëtare mbi bazën e parimit të vetëvendosjes kombëtare, në mos një herezi, përbënte një kërcënim për sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në këtë prizëm, dalja e faktorit shqiptar si një faktor i pavarur me aspiratat dhe karakterin e vet unik përbënte një risi e, po ashtu, një politizim, e pse jo një masivizim të mëtejshëm të çështjes nacionale, e cila para vitit 1878 trajtohej dhe zhvillohej, siç e paraqet Nathalie Clayer, vetëm në rrethet e ngushta të “veprimtarëve të shqiptarizmit” apo të albanologëve të huaj.

Megjithëkëtë karakterin e plotë nacional dhe qëndimin unik në favor të çështjes kombëtare Lidhja e Prizrenit e mori duke kaluar në disa faza e po kështu edhe në disa përplasje të fraksioneve brenda saj, që përfaqësonin në një farë mënyre jo vetëm qëndrime të ndryshme politike, por edhe pozita të ndryshme sociale. Mund të përcaktojmë tre faza në të cilat evoluoi mendimi politik shqiptar në këtë periudhë. Në fazën e parë, që përfshin peridhën që nga nënshkrimi i Traktatit të Shën Stefanit e deri në Rezolutën e Dibrës (1 nëntor 1878), kemi dominimin e elementit konservator,

gjë që vihet re sidomos në ligjërimin zyrtar të saj, ku pasqyrohet një ndërthurje herë e plotë e herë e nënkuptuar e identitetit nacional me identitetet e tjera krahinore, fetare etj; kjo sidomos në degët e lidhjes në veri të vendit. Faza e dytë, përfshin periudhën 1879-1880, pra që nga përpjekjet për shtrirjen e autoritetit vetëqeverisës të Lidhjes e deri me rënien e Ulqinit. Kjo mund të cilësohet si faza e përplasjes mes fraksionit nacional me atë konservator të moderuar. Ndërsa faza e fundit shënon periudhën që nga rënia e Ulqinit e deri në shpërberjen e plotë të Lidhjes. Kjo fazë shënon triumfin e fraksionit radikal nationalist, gjë që vihet re në vetë veprimtarinë e Lidhjes, që merr tashmë kompetencat e një qeverie kombëtare dhe arrin deri në përballjen e drejtpërdrejtë me trupat osmane të Dervish Pashës.

### 1. Faktori shqiptar përballë rrezikut të copëtimit

Periudha maj-qershor 1878 karakterizohet nga një aktivitet i dendur politik dhe diplomatik që shpërfaqet nga njëra anë përmes notave të protestave të dërguara përfaqësive të Fuqive të Mëdha të mbledhura në Berlin dhe nga ana tjetër nga tërësia e vendimeve që dolën nga Kuvendi i mbledhur në Prizren, më 10 qershor. Në protestat dërguar përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha u mëshohet në veçanti dy aspekteve: që popullsia vendase është tërësisht e ndryshme nga sllavët dhe evidentimit të sjelljes barbare ndaj popullsisë civile, ku listohen vrasjet, grabitjet, keqtrajtimet e ndryshme etj. Megjithatë, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se këto nota protestash (së paku pjesa më e madhe e tyre) kanë ndonjë karakter të qartë kombëtarist. Pjesa më e madhe e tyre, pasi trajtojnë dy aspektet e mësipërme, theksojnë se popullsia vendase dëshiron të jetë nënshetase e sulltanit dhe nuk bëjnë fjalë për ndonjë kërkesë apo projekt për autonomi apo vilajet autonom (duke qenë se parimi i nacionalitetit është i lidhur me territorialitetin, sipas Hobsbaum). Përjashtim bëjnë vetëm dy memorandume: i pari i dërguar në maj 1878 sulltanit nga paria e Prizrenit, që pasi mohon çdo qëllim të tyre për t'u shkëputur nga Perandoria, i kërkohet që për zhvillimin e përparimin e vendit *“mund të arrihet veçse në kushte të caktuara, domethënë vetëm me anë të respektimit të tërësisë së të gjithë territorit tonë, me formimin e të gjithë Shqipërisë si një provincë e vetme, nën drejtimin e një guvernatori të*

*përgjithshëm të emëruar nga Porta e Lartë...<sup>\*)</sup>*. Memorandumi tjetër është shkruar në gjuhën italiane dhe është botuar në Trieste më 13 qershor 1878<sup>\*\*</sup>). Ai i drejtohet lordit Bekonsfilld (kryeministrit britanik Disraeli), përfaqësues britanik në Kongresin e Berlinit. Ky memorandum, i cili thuhet se është shkruar nga një grup patriotësh nga Shkodra, shpërfaq në mënyrë të plotë dhe të drejtpërdrejtë ideologjinë nacionale në fazën e saj më të zhvilluar. Që në rreshtat e parë theksohet kundërvënia me Perandorinë Osmane. Përballë shtypjes së Perandorisë shqiptarët kanë arritur të kenë një shkallë të caktuar pavarësie “*që nga brigjet e Bunës, deri te portat e Janinës*”, duke arritur të zhvillojnë e të ruajnë një karakter unik “*si një bërthamë homogjene dhe kompakte si për nga njësia e tipit, ashtu edhe për nga identiteti i kombësisë*”<sup>\*\*\*</sup>). Po ashtu theksohet ndryshimi dhe kundërvënia me elementin sllav dhe grek. I gjithë memorandum i përshkohet nga ideja e një historie të përbashkët të shqiptarëve me heronj dhe figura historike të përbashkëta<sup>\*\*\*\*</sup>). Një nga elementet më themelore të memorandumit është analiza e marrëdhënieve ndërkombëtare që bëjnë autorët. Synohet që të bindet Britania e Madhe se krijimi i një Shqipërie autonome është pikërisht në interesin e saj. Përmenden interesat e Austrisë e cila synon ta shndërrojë Adriatikun në një liqen austriak. Rëndësi i kushtohet pasqyrimin të politikës ruse në Ballkan, e cila përbente rivalin kryesor të Britanisë në Ballkan e në Lindje. Prandaj, “*nga ana politike duhet pasur parasysh se vetëm Shqipëria është destinuar të jetë mburoja e krijuar nga natyra kundër dyndjes sllave ...*”<sup>\*\*\*\*\*</sup>). Element tjetër i rëndësishëm është ndarja e identitetit kombëtar nga ai fetar, pra fetë e ndryshme nuk pengojnë në bashkimin apo solidaritetin nacional mes shqiptarëve. Parimet e paraqitura në këtë memorandum përfaqësojnë shtyllat e nacionalizmit shqiptar deri në shpalljen e pavarësisë.

Megjithatë, konfiguracioni i brendshëm politik i vendit mbizotërohej nga klasat sunduese të përbëra nga bejlerë, çifligarë, ulema, nëpunës të shtetit osman etj, që e kishin të vështirë të

\*) ASH e RPSSH, Akte të Rindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, Tiranë, 1978, fq. 19-20

\*\*\*) Arkivi i Muzeut Historik Shkodër, F. Arkivi i Vjenës, D. 1878-1879, fl. 1-13

\*\*\*\*) Po aty, fl. 1

\*\*\*\*\*) Për Anderson dhe Hobsbawm historia dhe origjina e përbashkët përbëjnë elementet primare për formimin e “komuniteteve imagjinare”.

\*\*\*\*\*) AMH..., fl. 7

konceptonin parimet moderne të nacionalitetit të shkëputura nga osmanizmi dhe feja. Ky mbizotërim dhe ndikim i tyre vihet re në disa dokumente zyrtare. Së pari, në memorandumun e dërguar nga Prizreni përfaqësuesve të mbledhur në Berlin, vihet re ndjenja e respektit dhe përvuljes para Portës së Lartë: “... ndonëse ajo e detyruar me forcë dhe **për të parandaluar gjakderdhjen nënshkroi Traktatin e Shën Stefanit**”<sup>\*)</sup>. Një frymë të tillë e vëmë re edhe në memorandumun e popullsisë së trevave veriperëndimore: “nën presionin që i bëri Rusia **shtetit të lartë osman**, madhëria e tij, **padishahu ynë** u detyrua të na lëshojë nën sundimin e malazezëve barbarë, të cilët prej katër shekujsh janë armiq të tanë”<sup>\*\*)</sup>. Ndërkohë tek memorandumu i popullsisë të Pejës, Gjakovës, Gucisë dhe Içtovës vihet re një konfuzion mes idesë së kombësisë dhe asaj të fesë: “Vendi në të cilin banojmë që në kohët e lashta quhet vendi i shqiptarëve, vendi i gegëve dhe përderisa **të gjithë jemi shqiptarë, ndonëse tek ne një në dhjetë banorë është i krishterë**, përse duhet... ”<sup>\*\*\*)</sup>. Së fundi, mbizotërimi i rrymës konservatore u shfaq më së miri në vendimet që dolën nga Kuvendi i Prizrenit të përmbledhura tek Kararnameja (Akti i vendimeve)<sup>\*\*\*\*)</sup> dhe Talimati (vendime për organizimin e ushtrisë dhe administratës). Këto dokumente vendosin në plan të parë dy detyra kryesore: mbrojtjen e vendit dhe krijimin e një administrate që do të shërbente për shtrirjen e autoritetit të Komitetit Qendror të Lidhjes dhe për krijimin dhe grumbullimin e forcave të armatosura sipas çdo kazaje. Megjithatë pikërisht tek këto dy dokumente zyrtare të Lidhjes vihet re dominimi i elementit konservator. Që në nenin e parë bëhen të qarta qëllimet e lidhjes që janë mbrojtja e integritetit të vendit dhe kundërshtimi i çdo qeverie “përveç asaj të Portës së Lartë”. Një frymë e tillë vazhdon edhe në nenin 2: “qëllimi ynë më i lartë është **të mbrojmë të drejtat perandorake të personit të papërgjegjshëm të madhërisë së tij, sulltanit**”<sup>\*\*\*\*\*)</sup>. Në

\*) ASH e RPSSH, Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1878-1912), Tiranë, 1978/ Qeveria osmane u detyrua të nënshkruante Traktatin e Shën Stefanit jo për të ndaluar gjakderdhjen, por për të mënjeluar pasoja edhe më të rënda nga përparimi i shpejtë i ushtrive ruse drejt Stambollit.

\*\*\*) Po aty, fq. 30/ memorandum i 15 qershorit 1878

\*\*\*\*) Po aty, fq. 14/ memorandum i 10 majit 1878

\*\*\*\*\*) Arkivi i Muzeut Historik Shkodër, F. Arkivi i Vjenës, D. 1878-1879, fl. 195-198/ Relacion i konsullit a-h në Shkodër, Lëpë dërguar kontit Andrashi në Vjenë

\*\*\*\*\*) Po aty, fl. 195



nenin 4 theksohet se lidhja do të mbrojë edhe jetën, nderin e pasurinë e jomyslimanëve “*në përputhje me ligjet e shenjta të besimit (shariatit)*”<sup>\*)</sup>. Në nenin 16 shpallet se Lidhja përfaqëson përveç Shqipërisë Veriore dhe Epirit, edhe Bosnjën, e cila do të kalonte nën administrimin e Austro-Hungarisë. Së fundi, ai që shkëputet dhe e tradhëton kauzën e Lidhjes, “*do të vështrohet si dezertues prej islamit dhe do të mallkohet e përbuzet nga ana jonë*”<sup>\*\*)</sup>. Gjithashtu në programin dërguar përfaqësuesve të Shkodrës theksohet: “*Mbasi e gjithë Shqipëria Veriore e besëlidhur me Bosnjën për të shpëtuar atdheun*”<sup>\*\*\*)</sup>. Në fakt në listën e 47 nënshkruesve të këtyre dokumenteve nuk rezulton ndonjë përfaqësues i Bosnjës. Megjithatë, përmendjen e Bosnjës e gjejmë vetëm në këto shpallje të para. Shtrirja e aktivitetit dhe autoritetit të Prizrenit, siç u pa më vonë, përfshiu kryesisht territoret e brendshme të Shqipërisë. Kjo bëri të mundur që Lidhja të merrte më tej një karakter qartësisht nacional shqiptar, që u evidentua në kërkesat për vilajet unik autonom dhe autonomi administrative.

*Aktiviteti politiko-diplomatik i Komitetit të Janinës.*

Një rol të rëndësishëm në këtë periudhë luajti elita politike e Toskërisë, e cila që në maj 1877 për t’iu përgjigjur situatës së luftës ruso-turke krijoi komitetin e Janinës, me në krye Abdyl Frashërin, deputet i Janinës në parlamentin e ri osman dhe një nga ideologët, diplomatët dhe organizatorët më të rëndësishëm të lëvizjes kombëtare. Në kushtet kur mendohej se Perandoria Osmane do të përzihet nga Ballkani nga ushtritë ruse, Komiteti i Janinës filloi përpjekjet për organizimin e një kryengritjeje shqiptare anti-osmane, me qëllim që pas luftës Fuqitë e Mëdha ta njihnin formimin e një shteti të pavarur shqiptar, i cili do të shërbente si një barrierë dhe faktor ekuilibri ndaj ekspansionit rus dhe aleatëve të tij. Si fuqi ballkanike më e interesuar drejtpërdrejt në këtë aspekt shihej Greqia, duke qenë se ajo nuk ishte përfshirë drejtpërdrejt në luftën ruso-turke e për rrjedhojë opinioni publik dhe qeveria greke po bindeshin gjithnjë e më shumë se me qëndrimin asnjans të Greqisë, Thrakës e Maqedonia rrezikoheshin të përfshiheshin në kufijtë e Bullgarisë e të Rumelisë që do të krijoheshin sipas planit carist. Në këto rrethana, qeveria greke e

\*) Po aty, fl. 196

\*\*\*) Po aty, fl. 198

\*\*\*\*) Po aty, fq. 55/ Prizren, 2 korrik 1878

mirëpriti propozimin e Komitetit të Janinës për një aleancë me faktorin shqiptar. Në bisedimet që filluan në korrik 1877, Abdyl Frashëri, pasi argumentonte interesat e të dyja palëve për një luftë të përbashkët kundër Perandorisë Osmane dhe pansllavizmit rus, propozonte që shqiptarët ta nisnin kryengritjen çlirimtare anti-osmane, e cila do pasohej me shpalljen e pavarësisë. Nga ana tjetër shqiptarët zotoheshin ta ndihmonin ushtrinë greke që t'i pushtonte pa vështirësi Thesalinë dhe Maqedoninë (kjo pasi në krye të garnizoneve osmane në këto territore ishin oficerë shqiptarë) në këmbim të njohjes së pavarësisë shqiptare nga Athina. Megjithatë bisedimet greko-shqiptare përfunduan në dhjetor pa sukses, pasi Athina këmbëngulte në pretendimet e saj mbi Epirin dhe Shqipërinë e Jugut<sup>\*)</sup>. Megjithatë ajo çfarë është e rëndësishme të evidentohet, është gatishmëria e faktorit shqiptar për të shfrytëzuar rrethanat ndërkombëtare e për të filluar kryengritjen e cila do të përfundonte me shpalljen e pavarësisë. Marrëdhëniet me shtetin grek u përkeqësuan, duke filluar nga shkurti 1878 kur bandat e "vullnetarëve" grekë filluan veprimet e armatosura në Shqipërinë e Jugut, gjë që detyroi faktorin shqiptar që, së bashku me trupat osmane që vinin nga Janina, t'i jepnin fund përpjekjeve greke. Pas konferencës së Berlinit dhe shpalljes së protokollit nr.13 i cili përcakonte caktimin e kufirit turko-grek sipas vijës Kalamas-Selemvria, pas bisedimeve dy-palëshe kemi përsëri mobilizimin politik e diplomatik të Lidhjes së Toskërisë për mbrojtjen e territoreve shqiptare. Nga ana tjetër, duke parë ndryshimet në situatën ndërkombëtare faktori shqiptar u shmang nga aspiratat e mëparshme për pavarësi dhe vendosi si qëllim formimin e vilajetit shqiptar autonom. Protesta e faktorit shqiptar u shpall drejtpërdrejt në korrik 1878, e botuar në faqet e gazetës "Terxhuani Shark", ku theksohej se, edhe nëse qeveria osmane pranon t'i dorëzojë Greqisë këto krahina, popullsia shqiptare do të tregohet e gatshme të bëjë qëndresë deri sa të shuhet e gjitha, me qëllim që të mbrojtë të drejtat e veta. Në memorandumun që iu dërgua qeverisë osmane, paraqiteshin tre kërkesa kryesore: së pari, t'i jepet rëndësi përdorimit dhe zhvillimit të gjuhës shqipe, me qëllim që të sigurohet **ekzistenca**

\*) Filip Liço, Mbi çështjen e aleancës shqiptaro-greke në vitet 1877-1881 në: ASH e RPSSH, Konferencakombëtare e studimeve mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit II, Tiranë, 1979, fq. 120-123

**kombëtare**; së dyti, të bashkohen të gjithë shqiptarët në një njësi administrative të vetme; reformat e nevojshme të zbatohen në Shqipëri para çdo vendi tjetër. Vihet re kështu, në aktivitetin e Lidhjes së Jugut ekzistenca e një tendence të qartë kombëtariste, e formuar jo vetëm në aspektin politiko-administrativ, por edhe në atë kulturor. Në këtë mënyrë mund të evidentojmë qëndrime dhe mendime më të avancuara në aspektin kombëtar të Lidhjes së Jugut dhe Komitetit të Janinës, të cilat do të ndikonin në të ardhmen në forcimin e pozitave nacionaliste në brendësi të Lidhjes së Prizrenit.

## **2. Prirjet për autonomi dhe shfaqja e kontradiktave të brendshme**

Pas ngjarjeve të Gjakovës, të cilat përfunduan me përplasjen e popullsisë vendase me autoritetet osmane dhe vrasjen e Maxharr pashës e Abdulla pashë Drenit, vihet re një radikalizim i mëtejshëm në veprimet dhe qëndrimet politike të Lidhjes së Prizrenit. Në fakt përpjekjet për vendosjen e një organizimi të brendshëm fillojnë që me shpalljen e Kararnamesë e të Talimatit. Veprimtaria kryesore që kërkohet prej përfaqësuesve është grumbullimi dhe organizmi i trupave të armatosura në secilën kaza. Një pikë kthese shënohet pikërisht në Kuvendin e Dibrës (1 nëntor 1878). Ndikimin vendimtar në këtë kuvend e pati pikërisht Abdyl Frashëri, i cili kishte lidhje të ngushta me Komitetin shqiptar të Stambollit dhe veprimtarët e tjerë të diasporës. Në këtë kuvend ai arriti të imponojë qëndrimin e tij mbi formimin e një njësie të gjerë administrative dhe autonome shqiptare, duke tërhequr pas vetes dhe rrymën e të moderuarve që përfaqësohej nga Iljaz pashë Dibra. Akti kryesor i Kuvendit të Dibrës ishte Rezoluta (e hartuar nga Abdyl Frashëri) që iu dërgua qeverisë së Portës së Lartë.

Rezoluta fillonte me paraqitjen e rreziqeve të copëtimit e të asimilimit kulturor nga të cilat kërcënoheshin shqiptarët. Prandaj për të larguar këto rreziqe dhe për të siguruar të ardhmen e vendit kërkohet formimi i një vilajeti shqiptar, në të cilin të gjithë nëpunësit duhet së paku të dinin gjuhën shqipe. Rolin kryesor në këtë vilajet autonom shqiptar do ta luante kuvendi i përgjithshëm, i cili do të merrte vendim për zbatimin e reformave të domosdoshme për zhvillimin e vendit. Rezoluta përfshinte edhe kërkesa me karakter kulturor për zhvillimin e arsimit dhe

gjuhës shqipe<sup>\*)</sup>. Ajo paraqiste ngjashmëri të plotë me kërkesat e paraqitura nga Komiteti i Stambollit një muaj më parë në gazetën "Terxhuman-i Shark"

Viti 1879 shënon një fazë të rëndësishme në luftën e faktorit shqiptar në kundërvënien ndaj pretendimeve greke në Epir e po ashtu edhe në mbrojtjen e Plavës dhe Gucisë përballë ushtrive malazeze. Njëkohësisht me aktivitetin ushtarak, në planin e brendshëm rritet kundërvënia ndaj autoriteteve osmane që shprehet në refuzimin e vilajeteve të Shkodrës e të Kosovës për të paguar taksa e për të dhënë nizamë për Portën e Lartë. Një kundërvënie e tillë ndaj autoritetit qëndror u zhvillua paralelisht me rritjen e kompetencave administrative të degëve të Komitetit të Prizrenit. Në mars 1879, në të gjithë vilajetin filloi agjitacioni ndërmjet qytetarëve me kërkesën për krijimin e gjykatave të pavarura nga pushteti qëndror. Në maj, Zija Prishtina, anëtar i Komitetit të Stambollit i paraqiste Portës së Lartë petitionin e popullsisë së sanxhakut të Prishtinës, ku ndër të tjera kërkohej formimi i gjykatave shqiptare dhe largimi i ushtrisë turke nga Kosova. Prandaj, përballë presionit të faktorit shqiptar, sulltani u detyrua të lejonte formimin e gjykatave shqiptare në të gjithë vilajetin e Kosovës, të cilat do të vepronin krahas atyre osmane. Më tej Komiteti Kombëtar i Lidhjes do ta shtrinte kërkesën e vetëqeverisjes jo vetëm në institucionet gjyqësore, por në mbarë administratën shtetërore të vilajetit. Përballë refuzimit të Portës për të suprimuar gjykatat osmane, Lidhja e Prizrenit shpalli bojkotimin e tyre dhe ftoi popullsinë që t'i drejtohej vetëm gjykatave shqiptare, që ishin nën influencën e Komitetit të Lidhjes<sup>\*\*)</sup>.

Një moment të rëndësishëm në përplasjen e mendimeve rreth konceptit të vetëqeverisjes në Shqipëri, përfaqësoi Kuvendi i mbajtur në Prizren, më 3 tetor 1879. Përveç çështjeve që lidheshin me aspektet e luftës kundër Malit të Zi në Plavë e Guci, u diskutua edhe çështja e vetëqeverisjes. Për herë të parë në këtë kuvend dalin në pah dy koncepte të ndryshme mbi vetëqeverisjen e Shqipërisë. Përfaqësuesit e rrymës radikale shfaqën mendimin që këtë herë Lidhja duhet të kërkonte jo si një vit më parë në Rezolutën e Dibrës një "vilajet shqiptar",

\*) ASH e RPSSH..., fq.65-66/ Rezoluta e Dibrës

\*\*\*) ASHSH... fq. 189

por një “principatë shqiptare” apo një “republikë shqiptare” me kryeqytet Manastirin, nën **suzeranitetin** e sulltanit. Kjo nënkuptonte një autoritet formal të Portës dhe përbënte hallkën për shkëputje të plotë nga Perandoria. Megjithatë delegatët e krahut të moderuar, që në këtë moment përbënin shumicën, në një gjendje të tillë kur kërcënimi malazez ishte në plan të parë, kundërshtuan që të ashpërsoheshin më tej marrëdhëniet me Portën. Prandaj, u vendos që si çështje kryesore që do të trajtonte rezoluta të vazhdonte të ishte kërkesa për “vilajet shqiptar”. Rëndësia politike e këtij kuvendi është se në krye të Komitetit të Lidhjes nuk do të ishte më sheh Mustafa Tetova, përfaqësues i krahut konservator, por u zgjodh Ymer Prizreni, përkrahës i krahut radikal të lëvizjes kombëtare\*).

Muajt e parë të vitit 1880 u karakterizuan përsëri nga një valë trazirash që shpërthyen në Kosovë, si pasojë e shpalljes së të ashtuquajturave “ligje organike” të shpalluara nga qeveria e Stambollit. Ata përmbanin një tërësi reformash me karakter centralizues që do të zbatoheshin në secilin vilajet, ndërkohë që shmangej çdo referim ndaj vetëqeverisjes shqiptare. Në shkurt, gjatë një fushate osmane për pagimin e taksave, nisi rebelimi i fshatarëve në afërsi të Prizrenit. Ndërkohë garnizoni osman arrestoi 6 udhëheqës të Lidhjes. Atëherë kryengritësit sulmuan Prizrenin, hynë brenda në qytet dhe, pasi çliruan të burgosurit, ia dorëzuan pushtetin Komitetit të Lidhjes. Garnizoni u detyrua të qëndronte i mbyllur në kala. Sulme të tilla ndodhën edhe në sanxhaqet fqinje të Prishtinës e të Pejës, ku pushteti kaloi gjithashtu në duart e Lidhjes. Zhvillime të ngjashme ndodhën edhe në vilajetin e Manastirit, ku sipas njoftimeve që vinin nga valiu i Manastirit dhe mytesarifi i Dibrës, në kazanë e Elbasanit Dega e Lidhjes ushtronte mbledhjen e taksave dhe organizimin e forcave të rendit, gjë që shkaktonte shqetësim për kryeministrin Hajredin pasha\*\*).

Një hap të rëndësishëm në avancimin e përpjekjeve për vetëqeverisje e autonomi shënon Kuvendi i Komitetit Ndërkrahinor të Shkodrës, i cili u mblodh më 9 prill 1880 për të diskutuar mbi përgatitjet ushtarake për mbrojtjen e Hotit dhe Grudës. Pas dy ditë punimesh Kuvendi miratoi një rezolutë

\*) Po aty, fq. 190-191

\*\*\*) ASHSH..., fq. 192-193

me të cilën kërkohej nga sulltani që të largonte ushtritë turke nga Shqipëria dhe t'u njohte autonominë administrative mbarë viseve shqiptare të bashkuara në një vilajet të vetëm. Ky vendim u përsërit me ceremoni të veçantë në mitingun popullor që u zhvillua në Shkodër, më 19 prill, me rastin e nisjes së vullnetarëve të parë për në Tuz. Në fillim të majit Komiteti Ndërkrahinor i Lidhjes e ktheu gazetën qeveritare turqisht të vilajetit, me emrin "Shkodra", në një gazetë shqip dhe në një organ të tij. Edhe tek memorandumit që po ky Komitet u dërgoi konsujve të Fuqive të Mëdha vihet re një avancimim i mëtejshëm në konceptimin e kombësisë e në njëfarë mënyre në nacionalizimin e Lidhjes. Në këtë memorandum artikulohej qartë të drejtat kombëtare dhe karakteri i qartë shqiptar i krahinave të Hotit e të Grudës, të cilat theksohet se janë pjesë e "**tërësisë territoriale**" shqiptare: "*kombi nuk mund të përmbahet më pa e bërë të sigurt tërësinë e vet territoriale kombëtare*". Populli shqiptar paraqitet i bashkuar në qëndrimet e tij: "*Ndjenja, frika se mos humbet kombësia që kur u mor vesh lajmi i zi i lëshimit të trojeve të Hotit të të Grudës, të gjithë popujt e Shqipërisë me një unanimitet si kurrë ndonjëherë vendosën të pranojnë më mirë vdekjen... sesa t'i lëshojnë edhe një pëllëmbë tokë qeverisë malazeze*"<sup>\*)</sup>. Së fundi, u kërkohej konsujve që të respektohen të drejtat e shqiptarëve ashtu si edhe popujve të tjerë.

Kundërvënia mes qëndrimeve të ndryshme të moderuara dhe radikale rreth aktivitetit të Lidhjes në aspektin e qeverisjes, pra në qëllimet e saj të fundme, mori trajtën e plotë në Kuvendet e Gjirokastrës e të Dibrës. Kuvendi i Gjirokastrës u mbledh më 23 korrik 1880, në periudhën kur u zhvillonte veprimtarinë e saj Konferenca e Berlinit. Në këtë kuvend, ku morën pjesë kryesisht përfaqësues nga krahinat e Jugut, por edhe disa përfaqësues të Veriut rolin kryesor e luajti përsëri Abdyl Frashëri. Kuvendi u mbledh në kushtet kur në Berlin diskutohej mbi krijimin e një komisioni për caktimin e kufirit turko-grek përgjatë Epirit. Për herë të parë në Kuvendin e Gjirokastrës u ngrit çështja e formimit të një qeverie të përkohshme shqiptare, në qoftë se Porta pranonte t'i "dhuronte" Greqisë teritore shqiptare. Qeveria e përkohshme do të zëvendësonte nëpunësit turq me ata shqiptarë, si dhe do të administronte të ardhurat shtetërore. Marrëdhëniet mes Shqipërisë autonome dhe Perandorisë Osmane do të kufizoheshin

\*) ASH e RPS..., fq. 100-101

vetëm me emërimin e një guvernatori të përgjithshëm si dhe do të merrte një tribut vjetor.

Në Kuvendin e Dibrës (20-24 tetor 1880), përveç çështjes së mbrojtjes së Ulqinit, u diskutua edhe për dy çështje të tjera: atë të vilajetit autonom dhe të formimit të qeverisë së përkohshme. Për çështjen e parë, atë të mbrojtjes së Ulqinit ranë dakort me shumicë dërrmuese të pjesëmarrësve, ndërkohë që për dy çështjet e tjera pati divergjenca të theksuara. Divergjencat e shfaqura mes dy rrymave politike vihen re në dy rezolutat që dolën nga ky kuvend. Rezoluta e parë, që ishte e ndërtuar sipas platformës së Kuvendit të Gjirokastrës, në të cilën kërkohet krijimi i vilajetit të Shqipërisë me autonomi të gjerë, arriti të marrë 120 vota. Ndërsa rezoluta tjetër e paraqitur nga rryma e të moderuarve (150 vota) propozonte formimin e një Elajeti të Shqipërisë, pa i shkrirë vilajetet ekzistuese, në të cilat do të zbatoheshin reformat e parashikuara.

Me daljen në pah gjithnjë e më tepër të karakterit autonomist e nacionalist të Lidhjes, ndryshoi edhe qëndrimi që mbanin konsujt e Fuqive të Mëdha ndaj saj. Në fillimet e organizimit të saj, në vitet 1878-1879 në raportet e konsujve austro-hungarezë, Lidhja e Prizrenit paraqitet si një organizim me karakter islamist dhe lokalist. Ndërkohë, sidomos pas luftës për mbrojtjen e Hotit dhe të Grudës, pas rritjes së rolit administrativ-ushtarak që filluan të ushtronin degët e Lidhjes në territore të caktuara, e sidomos pas kuvendeve të Gjirokastrës e të Dibrës, në raportet e tyre vlerësohet karakteri i plotë shqiptar që merr Lidhja e Prizrenit. Në gusht 1880, konsulli austro-hungarez i Prevezës, pasi raportonte në Vjenë mbi vendimet e Gjirokastrës vlerësoi: *“Shqiptarët dëshirojnë t’i japin kështu Evropës një dëshmi të fuqisë së tyre morale dhe të fitojnë dhe të fitojnë të drejtën e ekzistencës së tyre si komb.”* Në raportin e konsullit Lipih në Shkodër paraqitet situata e rrymave politike që u shfaqën në Kuvendin e Dibrës, që ai i cilëson si *“parti e Lidhjes”* dhe *“parti qeveritare”*. Sipas tij, në *“partinë”* e parë bënë pjesë Ali Pashë Gucia, Esad Pasha nga Tetova dhe Iljaz Pashë Dibra, ndërsa e dyta përfaqësohet nga Hasan Pasha, Abdullah Pasha e Sadik Pasha nga Dibra dhe Xhemal Pasha nga Mati\*).

### **3. Ashpërsimi i marrëdhënieve me Portën dhe triumfi i “radikalëve”**

\* ) Arkivi i Muzeut Historik Shkodër, F. Arkivi i Vjenës, D. 1880, fl. 188/ 20 nëntor 1880, relacion i konsullit austro-hungarez Lipih

Me rritjen e organizimit politik dhe veprimtarinë e vendosur ushtarake të Lidhjes së Prizrenit, në pranverën e vitit 1880 tek funksionarët dhe qarqet drejtuese të Portës së Lartë vihet re një përpjekje për t'iu përgjigjur në një farë mënyre kërkesave të Lidhjes. Kjo bëhej me qëllim që të paqesoheshin shqiptarët, në mënyrë që të mënjanohesh një përplasje e mëtejshme me Lidhjen. Në dokumentet osmane të periudhës maj-qershor, në relacionet e komisionit të funksionarëve të lartë të vilajeteve shqiptare e po ashtu në relacionet e Këshillit të Ministrave në Stamboll, paraqiten përpjekje dhe diskutime për t'u bërë lëshime shqiptarëve dhe kërkesave të formuluar në kuvendet e Lidhjes. Në këto relacione, pasi jepen informacione të përgjithshme rreth Shqipërisë dhe shqiptarëve, paraqiten qartë kërkesat për vetëqeverisje, si *"kërkesa të shqiptarëve"*. Këshilli i ministrave madje vendosi me shumicë votash që të formohej një vilajet i përbashkët, duke bashkuar katër vilajetet e mëparshme, që megjithatë nuk do të merrte emrin e Shqipërisë, por do të quhej *"Vilajet i Rumelisë"*, në krye të të cilit Porta do të emëronte Ahmet Ejup pashën<sup>\*)</sup>. Ndërkaq, çështja e organizimit të brendshëm të këtij vilajeti u la e hapur për bisedime të mëtejshme. Në këtë mënyrë mendohej se do t'i jepej fund *"trazirave"* të shkaktuara nga e ashtuquajtura *"propagandë tunduese që Lidhja e Prizrenit ka bërë qysh më parë, me qëllim që Shqipëria të marrë pamjen e një shteti autonom..."*<sup>\*\*)</sup>. Por formimi i vilajetit do të shoqërohej edhe me vendosjen e rendit në këto provinca, që vihet re me kërkesën për dërgimin e një force të armatosur e gjithashtu me dobësimin dhe shpërbërjen e Lidhjes. Kjo vihet re sidomos në telegramin e valiut të Manastirit dërguar Kryeministrit. Aty hidhet ideja që vali i thërrasë në Manastir disa përfaqësues të Shqipërisë së mesme dhe jugore, me qëllim që të nxisë përçarje në degët e Lidhjes e po ashtu *"të ledhatohet me favore popullsisia"*<sup>\*\*\*)</sup>. Së fundi, kërkohet që të dërgohen rreth dymbëdhjetë batalione që do të përqëndrohen fillimisht në Manastir e më pas do të lëvizin drejt Veriut. Propozime të tilla vinin edhe nga funksionarët e vilajetit të Kosovës, të cilët po ashtu kërkonin ardhjen e një force ushtarake për të vendosur

\*) ASHSH, Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet osmane, Kombinati Poligrafik, Tiranë 1978, fq. 78-79/ 30 maj 1878, relacion i kryeministrit dërguar pallatit.

\*\*) *Lidhja...*, fq.

\*\*\*) Po aty, fq. 109/ 13 gusht 1880, telegram dërguar kryeministrit nga vali i Manastirit.



rendin në Kosovë.

Qëndrimi i qeverisë së Portës së Lartë do të ndryshojë dhe do të ashpërsohet sidomos pas kërcënimit të Fuqive të Mëdha për një demonstratë navale e madje edhe një zbarkim në Izmir, në qoftë se Ulqini nuk i dorëzohet Malit të Zi. Kështu, në një relacion të shtatorit, të ministrit të Punëve Botërore paraqitet rrezikshmëria e lartë që përfaqësonte për Portën kjo ndërhyrje e mëtejshme e Fuqive të Mëdha e prandaj duhet të dorëzohej menjëherë Ulqini, duke refuzuar çdo lloj lëshimi ndaj Lidhjes: *“Qeveria duhet ta konsiderojë të domosdoshme që të ndëshkojë të gjithë ata që do të bëheshin shkak për ndërhyrje të jashtme, rreziqet e së cilës dihen mirë...”*<sup>\*)</sup>. Në një plan të tillë duhet parë fushata ushtarake ndëshkuese që marshalli osman Dervish Pasha ndërmori për dorëzimin e Ulqinit, ndëshkimin e kryengritësve dhe shpërbërjen e të gjitha degëve dhe organeve të Lidhjes në Vilajetin e Shkodrës. Në fundin e dhjetorit 1880, Dervish pasha hartoi planin ushtarak për shpërbërjen e plotë të Lidhjes përmes forcës ushtarake. Në relacionin që i dërgonte Abdyl Hamitit mbi fushatën ndëshkuese në vilajetin e Shkodrës vinte në dukje pikërisht faktin e kontrollit të administratës deri në ato çaste nga organet e Lidhjes: *“U shpëtua administrata e cila për disa kohë pati kaluar në duart e Lidhjes...”*<sup>\*\*\*)</sup>. Por më poshtë ai vinte në dukje se *“idea e bashkimit dhe kryengritjes është ende e gjallë në anët e Prizrenit, Pejës, Gjakovës, Dibrës e Matit”* e prandaj *“të futen forca të mjaftueshme ushtarake në ato krahina të Gegërisë që ende ushqejnë idenë e Lidhjes ose që ëndërrojnë autonominë”*<sup>\*\*\*\*\*)</sup>. Gjithashtu, marshalli turk, dënonte idenë e gabuar që kishin pasur disa funksionarë osmanë për ta përdorur Lidhjen për qëllimet e Portës së Lartë: *“Ata që mendonin e prisnin që Lidhja e Shqipërisë t’i sillte dobi Perandorisë, duke parë ngjarjet pikëlluese që njerëzit e Lidhjes shkaktuan njëra pas tjetrës, e kuptuan se mendimi dhe supozimi i tyre kishte qenë i gabuar”*<sup>\*\*\*\*\*)</sup>.

Këto qëndrime dhe veprime nga ana e qeverisë osmane patën pasojat e tyre edhe në radikalizimin e veprimtarisë së Lidhjes së Prizrenit. Vendosmëria e patundur e Portës për të dorëzuar

\*) Lidhja..., fq. 131, Stamboll, 15 shtator 1878, Relacion i ministrit të punëve botwrore, Hasan Fehmi.

\*\*) Lidhja..., fq. 146/ Shkodër, 27 dhjetor 1880. Relacion i Dervish Pashës dërguar sulltan Abyl Hamiti II.

\*\*\*) Po aty, fq. 146

\*\*\*\*\*) Po aty, fq. 143

Ulqinin e për të shpërbërë përfundimisht çdo organ të Lidhjes, nxiti për pasojë mbizotërimin e elementit radikal në gjirin e kësaj të fundit, element me prirje të theksuara autonomiste e nacionaliste. Këta riorganizuan Komitetin Kombëtar të Lidhjes, qëllimi i të cilit do të ishte përhapja e kryengritjes anti-osmane dhe mbledhja e Kuvendit të Përgjithshëm të Lidhjes nga i cili do të formohej qeveria e përkohshme. Në krye të Komitetit u vendosën Ymer Prizreni, Abdyl Frashëri, Sulejman Vokshi, Ali Ibra etj. Për rrjedhojë në të gjithë vilajetin e Kosovës u nxit popullsia vendase për të dëbuar funksionarët dhe nëpunësit osmanë e po ashtu edhe ata shqiptarë që u përkisnin rrymave të moderuara e sulltaniste dhe që kishin refuzuar të ngrinin krye kundër qeverisë. Qëllimin e Kuvendit të Jashtëzakonshëm të Lidhjes që u mbajt në dhjetor do ta shprehte vetë Abdyl Frashëri : *“Le të mendojmë e të punojmë për vete e të mos këtë asnjë ndryshim mes toskëve dhe gegëve. Të jemi të gjithë shqiptarë e të formojmë një Shqipëri të bashkuar”*<sup>\*)</sup>. Kuvendi shpalli Komitetin e Lidhjes si qeveri të përkohshme, ku kryetar do të qëndronte Ymer Prizreni; Abdyl Frashëri do të kontrollonte punët e jashtme, ndërsa Sulejman Vokshi veprimtarinë dhe organizimin ushtarak. Në janar, forcat e armatosura të Lidhjes përparuan drejt Mitrovicës, Prishtinës e Shkupit, ku u dëbuan e u neutralizuan nëpunësit e qeverisë osmane. Qeveria e përkohshme arriti ta shtrinte autoritetin e saj në katër nga pesë sanxhaqet e vilajetit të Kosovës (me përjashtim të Novi Pazarit). Ndërkohë në Dibër u neutralizuan kundërshimet e elementëve sulltanistë, si Sadik pashë Hoxholli, i cili u kishte bërë thirrje trupave osmane të Manastirit për ndërhyrje. Vetë Abdyl Frashëri u vendos në selinë e prefekturës, ku njëkohësisht u dëbua mytesarifi turk. Kudo në territoret ku ushtronte autoritetin qeveria e përkohshme filluan arrestimet dhe presionet edhe ndaj asaj pjese të parive lokale që nuk pranonin autoritetin e saj. Kjo pasqyrohet dhe në dokumentet osmane të shkurtit 1881. Nga prefektura e Shkupit vinin njoftime mbi ankesat e shehut Salih efendiu, të cilin e kishin detyruar të jepte mbështetje për Lidhje nën kërcënimin se do t'i digjnin shtëpinë. Vihej në dukje se *“këto Komitete të Lidhjes nuk po i njohin aspak autoritetet qeveritare dhe Perandorinë, por veprojnë sipas udhëzimeve*

\*) ASHSH..., fq. 217

*që marrin nga Lidhja e Prizrenit*<sup>\*)</sup>). E tensionuar paraqitej edhe situata në Dibër, ku njoftohej se repartet ushtarake të Lidhjes po përgatiteshin të sulmonin depon e municioneve e të rrëmbenin armët. Përsa i përket ushtrimit të aktivitetit vetëqeverisës nga organet e Lidhjes në Prizren, konsulli Lipih raportonte në mars se Lidhja kishte vënë dorë edhe mbi gjykatat, ku në krye ishte vendosur një qytetar i Prizrenit, taksat që mblihdeshin nga popullsia përfundonin në buxhetin e Lidhjes, ndërkohë që vihet në dukje se *“sigurimi publik tani është shumë më në rregull se ç’ ishte në kohën kur administratën e drejtronin funksionarët e sulltanit”*. Duhet të vihet në dukje se vetë konsulli Lipih do të ndryshonte qëndim ndaj Lidhjes, pasi më parë e konsideronte thjesht si vegël të qeverisë osmane. Përfaqësuesit e Lidhjes, madje në ditët e para të prillit 1881 do t’i dërgojnë një memorandum ambasadës austro-hungareze në Stamboll, ku përshkruhet veprimtaria dhe karakteri i Lidhjes së Prizrenit në mbrojtje të territoreve shqiptare e po ashtu edhe në qëllimet dhe kërkesat e saj. Së pari, bëhet e qartë se Shqipëria është një komb evropian e prandaj lipset që të jetë pjesë e qytetërimit dhe përparimit evropian. Së dyti, të krijohet një vilajet i vetëm, si pasojë e bashkimit të katër vilajeteve e të mbajë emrin Shqipëri. Së fundmi, bëhet e qartë se këto kërkesa nuk kanë domosdoshmërisht karakter separatist, por që edhe me realizimin e tyre do të njihet sundimi i Portës së Lartë. Në pjesën tjetër theksohen kërkesat e vetëqeverisjes e të vilajetit për autonominë, që Lidhja i ka paraqitur që me formimin e saj, *“vetëm se të gjitha shkuan kot”*. Gjithashtu, protestohet edhe ndaj nëpunësve osmanë, të cilët *“pengojnë plotësimin e dëshirave tona dhe një popull që është duke u përpjekur vetëm për mirëqënien e atdheut dhe lulëzimin e tij, vihet në një shkallë të barabartë me rebelët”*<sup>\*\*</sup>). Së fundi, shprehet vendosmëria për t’i rezistuar sulmit të ushtrisë osmane të drejtuar drejt Prizrenit nga marshalli turk Dervish Pasha.

## **Përfundime**

Me ekspeditën osmane të drejtuar nga Dervish Pasha në prill 1881, pas shtypjes së rezistencës në Slivovë e në Caralevë,

\*) Lidhja..., fq. 172/ Shkup, 19 shkurt 1881, relacion i Prefekturës së Shkupit dërguar Vilajetit të Kosovës.

\*\*\*) ASH e RPS..., fq. 120

mori fund veprimtaria dhe ekzistenca e Lidhjes së Prizrenit. Megjithatë, kjo lidhje pati një rëndësi të veçantë për lëvizjen nacionale dhe karakterin e zhvillimit të saj të ardhshëm. Së pari, rëndësia e saj qëndron në krijimin e një fronti të përbashkët mes përfaqësuesve të ndryshëm të katër vilajeteve (megjithë pikëpamjet e tyre të shumëllojshme) në mbrojtjen e territoreve në skajet veriore e jugore të vendit përballë ofensivës së shteteve fqinje. Së dyti, Lidhja, megjithë problematikat e saj të brendshme (shumëllojshmërinë e pikëpamjeve dhe shtresave që e përbënin\*), arriti të bënte hapa të rëndësishëm në drejtim të vetëqeverisjes duke vendosur nën kontroll pushtetet administrative, gjyqësore e ushtarake në territoret ku kishte influencë. Së treti, Lidhja e Prizrenit arriti të krijojë një konfrontim real, ku mbizotëronte karakteri kombëtar kundër Portës së Lartë (ndryshe nga kryengritjet e mëparshme me karakter lokal e rajonal që ishin kryesisht të drejtuara kundër Tanzimatit). Ky konfrontim nisi që me ngjarjet e Gjakovës e arriti kulmin në nëntor 1880 e prill 1881, si dhe me formimin e qeverisë së përkohshme. Së fundmi, Lidhja e ndihmuar edhe nga komitetet nacionaliste të diasporës bëri të mundur dhe nxiti ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare. Para vitit 1878, çështja shqiptare kishte më tepër karakter kulturor e romantik, pasi trajtohej kryesisht në shkrimet e albanologëve e të disa veprimtarëve të pakët të shqiptarizmit. Me kundërshtimin e vendimeve të Fuqive të Mëdha e sidomos me aktivitetin e saj diplomatik, mund të themi se Lidhja bëri të mundur daljen në pah të çështjes shqiptare si problem politik, si çështje me karakter evropian.

Megjithatë nuk mund të themi se vija politike e Lidhjes ishte një dhe e vetme e pandryshueshme. Siç e pamë më lart, në fillimet e veta, në muajt e parë të formimit të saj, kishte një paqartësi dhe konfuzion ideologjik, ku shqiptarizmi përzihej me identitete krahinore e fetare, për shkak të një varg faktorësh të karakterit kulturor e shoqëror. Pas ngjarjes së Gjakovës dhe Kuvendit të Dibrës (tetor 1878) kemi konsolidimin e dy rrymave. Konservatorët e moderuar, të cilët duke e konceptuar

---

\*) Nga pikëpamja shoqërore aty përfaqësoheshin jo vetëm çifligarë e klerikë, por edhe bajraktarë, përfaqësues të esnafëve, si dhe, në numër mjaft të vogël edhe përfaqësues të klasave të reja të mesme. Pikërisht ndër këto të fundit Natalie Clayër vendos vëllezërit Frashëri.

shqiptarizmin të lidhur me osmanizmin, nuk pranonin më tepër se një ndarje administrative të re, bashkim të katër vilajeteve në një të vetëm me një guvernator osman në krye. Ndërkohë grupi tjetër, që mund ta quajmë si radikal-nacionalist, ku spikaste figura e Abdyl Frashërit, kërkonte jo vetëm një vilajet shqiptar, por edhe dhënien atij gjithnjë e më tepër të karakteristikave të një shteti autonom, ku guvernatori turk të kishte vetëm autoritet formal e pushteti real të mbetej në duart e elitës politike vendase. Nga ana tjetër, veprimtaria politike e këtij grupimi, që synon t'i japë Lidhjes një karakter të qartë kombëtar, shkon gjithnjë e më tepër në konfrontim me qeverinë e Stambollit. Përballja e dy rrymave arrin kulmin me Kuvendin e Dibrës (tetor 1880), ku secila palë i dërgon Portës nga një rezolutë të veçantë. Së fundi, me rënien e Ulqinit dhe ashpërsimin e marrëdhënieve me Portën e Lartë kemi triumfin e krahut radikal, ku me formimin e qeverisë së përkohshme, me mobilizimin e ushtrisë e administratës së saj kundër Portës, Lidhja e Prizrenit merr qartazi karakter anti-osman dhe kombëtar.

Faktori primar që nxitë në një farë mënyre radikalizimin e Lidhjes së Prizrenit dhe daljen në pah të karakterit nacional, ishte në radhë të parë vetë situata ndërkombëtare e krijuar pas luftës ruso-turke (1877-1878) dhe ajo e gjysmës së dytë të shek. XIX. Vendimet e Fuqive të Mëdha dhe këmbëngulja e vazhdueshme për çedime territoriale në Veri (fillimish Plavë e Guci, pastaj Hot e Grudë e në fund Ulqin), si dhe vendosja në pikëpyetje e kufirit turko-grek në Konferencën e Berlinit, nxitën si kundërpeshë një reagim gjithnjë e më të vendosur të elitës politike vendase. Gjithashtu, në një plan më të gjerë, dobësimi i Perandorisë Osmane, shndërrimi i saj përfundimisht në "të sëmurin e Evropës" e bënë të qartë nevojën për daljen në pah të elementit shqiptar si faktor që përfaqësonte një interes kombëtar më vete. Nuk mund të harrojmë se vetë shek. XIX është shekull i nacionalizmave, shekull ku ideologjia nacionale dhe nacional-revolucionare njeh një përhapje të gjerë, jo vetëm mbarevropiane, por edhe mbarëballkanike, për një varg arsyes. Në këtë aspekt, duke iu përgjigjur një sërë faktorësh të brendshëm e të jashtëm të cituar më lart, ajo pati ndikimin e vet, megjithëse pak të vonuar, edhe tek elita politike në katër vilajetet perëndimore të Perandorisë Osmane.

Së dyti, ishin vetë qëndrimet e Portës së Lartë që ndikuan në

veprimtarinë e Lidhjes së Prizrenit. Fillimisht, qeveria osmane nuk iu kundëvu drejtpërdrejt aktivitetit të saj, madje edhe pas vrasjes së Ali Pashë Maxharrit në Gjakovë. Kjo për arsye se synonte ta përdorte për të mos lejuar marrjen e territoreve të saj kufitare nga Mali i Zi. Porta e Lartë nuk ndërmori asnjë veprim të drejtpërdrejt apo të dhunshëm as ndaj shtrirjes së aktivitetit vetëqeverisës të Komitetit Qendror dhe degëve të Lidhjes. Siç e pamë më lart, në pranverën e vitit 1880, qeveria osmane pranoi në parim për një vilajet të bashkuar me në krye një guvernator osman, megjithëse kjo formulë nuk i përgjigjej tërësisht kërkesave të krahut nationalist. Mirëpo, qëndrimi i osmanëve u ashpërsua në fundin e këtij viti pas ultimatimit të Fuqive të Mëdha për dorëzimin e Ulqinit. Në kushte të tilla të presionit të përshkallëzuar ndërkombëtar, Porta nuk mund të lejonte më tej asnjë kundërshtim nga pala shqiptare. Kështu ekspedita e Dervish Pashës në vilajetin e Shkodrës për shtypjen e çdo rezistence për dorëzimin e Ulqinit, i thelloi edhe më tej divergjencat, duke nxitur kështu një reagim të drejtpërdrejtë nga ana e Lidhjes së Prizrenit, që arrin kulmin me shpalljen e qeverisë së përkohshme. Së treti, një rol të rëndësishëm luajti Komiteti i Stambollit, i krijuar në dhjetor 1877, ku merrnin pjesë disa anëtarë të Lidhjes, si: Abdyl Frashëri, Ymer Prizreni, Iljaz Dibra etj. si dhe figura të tjera, si: Sami Frashëri, Pashko Vasa, Jani Vreto etj, të cilët me veprën e tyre publicistike, diplomatike e kulturore në favor të zhvillimit dhe propagandimit të idesë kombëtare, patën ndikim të rëndësishëm edhe në veprimtarinë e Lidhjes. Ky komitet ishte i pari që ngriti çështjen e vilajetit autonom dhe drejtoi negociatat diplomatike me qeverinë greke për shpërthimin e kryengritjes shqiptare, përpjekje që dështuan për arsyet që u renditën më lart. Gjithashtu, do të ishte pikërisht artikulli i botuar në gazetën "Texhumani Shak" botuar nga Sami Frashëri, tek i cili do të bazoheshin kërkesat e shpallura në Rezolutën e Dibrës (1 nëntor 1878).

## Agron LUKA

## “AFRODITA E SKODRINONIT” - STATUJËZA MË E RE NDËR HYJNESHAT E BUKURISË

*Kulti i Afroditës në Skodrinon në mijëvjeçarin I p.e.r. në monedha, në terrakota dhe në statujëza bronzi simbas mitologjisë në variantin pellazgjik homerik. Zbulohet rastësisht një statujëzë bronzi, vepër e artit të periudhës ilire-helenistike e krahasueshme me modelet me forma të shkollave dhe punishteve të Tanagrës, Korintit, Athinës, të shek IV-III p.e.r. Mund të jetë derdhur në Skodrinon në kohën e Gentit apo edhe më përpara.*

**I. “Afrodita e Skodrinonit” nudo, vajza virgjëreshë me pëllumb mbi kokë, Praksiteliana e statujëzave të derdhura në bronz.**

Në një ditë fillim qershori 2017, kur në qytetin tonë dalin qershitë e para dhe kur ajri ta mbush gjoksin me aromën e blinit, si një “dhuratë e rënë prej qiellit”, më erdhi një statujëzë bronzi (shënim: terminologjia jonë nuk i ka fiksuar mirë termat diminutive me bazë statujën, prandaj ne përdorëm termin statujëzë). Mbase e pastrova disi, sepse kishte baltë të ngjitur, e pikasa menjëherë: Afrodita!

Tashti vini re rëndësinë e rastësisë dhe të koincidencës, se jo më kot thonë në Shkodër: “Atë që s’ta sjell motmoti, ta sjell momenti”! “Relikti” ynë, simbas të dhënave që munda të mbledh, pretendohet se ishte gjetur rastësisht nën dhé nga një punëtor, gjatë një gërmimi për themele ndërtimesh e lokalesh, nga ato që mbarë e mbrapsht, me/ose pa leje, janë bërë gargull, atje ku ka qenë Skodrinoni në antikitet, në pjesën e peripolisit fushor. Siç duket, shtresa prej balte e ka ruajtur në gjendje relativisht të mirë, megjithëse ka një shtresë oksidimi të konsiderueshme. Sapo e sheh, menjëherë “të pushon syri”, me këtë Afroditë, vajzë virgjëreshë.

Rreth temës në fjalë, para shumë vjetësh, kisha shkruar për një zbulim nënujor të një ekspedite evropiane në ishujt e Egjeut, të cilët kishin zbuluar në një anije romake të mbytur, ndër shumë objekte të plaçkitura, edhe “një nimfë-nereide që del nga thellësitë e detit, një Afroditë Anadiomena”... ( A. Luka, “Shkodra Loce në

2500 vjetorin e jetës qytetare”, bot. në gaz., Shkodra, 16 dhjetor 1999, f. 9, ku kam riprodhuar edhe dy monedha argjendi me Afroditën me pëllumb në kokë; “Perëndesha e Urtësisë, Kukuvajka Athina që vjen nga Shirgji i Bunës”, bot. në gaz., Shkodra, 9 gusht 2001, f. 3)

Diçka sinjalizuese mbi prezencën e kultit dhe të objekteve terrakota e figurinave mikroterrakota të Afroditës në qytetin tonë e kam botuar vjet në librin tim. (ΣΚΟΔΡΙΝΩΝ, bot. 2016, f. 531 etj.)

Në facebook, pak muaj më parë kam postuar disa terrakota e ndonjë mini-statujëzë bronzi të gjetur në Shkodër, në një diskutim me prof. F. Stamatini, restauratorin dhe ekspertin autoritet të Muzeut Historik Kombëtar.

Këtë kuriozitetin e ri të statujëzës së Afroditës, unë e lajmërova në “Festën e 50-vjetorit të Maturës të gjimnazit Jordan Misja” (1967), dhe u premtova maturantëve tashmë 68-vjeçarë botimin e një studimi të plotë, kushtuar bukurisë rinore me rastin e anëtarësimit të Shqipërisë në Unionin Evropian.

Në entuziazmin dhe impresionin e parë, këtë statujëzë për nga bukuria dhe ndoshta nga unikaliteti si ekzemplar (hë për hë një hipotezë), e kam pagëzuar: “*Afrodita e Skodrinon-it nudo, vajza virgjëreshë me pëllumb mbi kokë, Praksiteliana e statujëzave të derdhura në bronz*”... (Shih riprodhimin fotografik dhe trajtimin në paragrafin përkatës)

Në hipotezat e punës, unë mendoj se:

1) Kjo statujëzë, ndër të gjitha simotrat e saj, përfaqëson Afroditën më të re!

2) Ka mundësi që edhe fondimi i kësaj Afroditë në bronz të jetë bërë në Shkodër, përderisa edhe monedhat e bronzit dhe ato të argjendit priteshin dhe kishin markën dhe vulën shkodrane. (Polibi, XXVIII, XXIX; Livi, XLIII, 19, XLIV, 23, 27, 29, 30, 31, XLV, 26, 43)

3) Ndoshta modeli i saj është unik, krahasuar me të tjerat.

Meqenëse me dekada kisha mbledhur “si bleta nektarin”, një fond të vogël modest me monedha dhe statujëza me Afroditë, vendosa t’i përfshij të gjitha në një shkrim-studim më të veçantë.

II. Dy variantet e mëdha të gadishullit tonë të prejardhjes mitologjike të Afroditës.

1. Afrodia Anadiomena: “Etaloni i bukurisë femërore”, që krijohet nga fara hyjnore e Uranit dhe shkuma ujore e Detit Egje, Nimfa që del nga Deti



*Egje:*

2. Afrodita Pandemia: "Bija e Dionës nereide pellazge dhe e Zeus Kronidit", në një shpellë nënujore në Detin Egje

Mitologjia e lashtë e gadishullit tonë, e cila përmban kontribute të përbashkëta të të gjithë fiseve e popullsive, u mblodh, u përpunua dhe u regjistrua e shkruar nga grekët antikë dhe po ashtu u kodifikua edhe si një fe politeiste, me kryezot Zeus Kronidin (Homeri, Herodoti etj; Hesiodi, "Teogonia" etj.).

Kjo Teogonia, si me thanë, Bibla e Vjetër e Gadishullit Evropa, e hapte siparin e prezantimit me Kaosin Qiellor, ku hapësira qiellore ishte tymnajë e errësirë... Pastaj, kishte një Zanafillë/Fillesë, ku gjithçka që do të "parashutohej" dhe instalohet mbi Tokë nga hyjnitë qiellore, do ta kishte pikë-bazimin në truallin e gadishullit tonë. Me këtë konceptim edhe vetë gjeo-strategjia dhe raca e bardhë evropoide, ishin të privilegjuar e të përzgjedhur nga vetë hyjnitë. Në skenën e teatrit tonë gadishullor, do të luanin "gjigandët" me Kronin e Rean (vëlla e motër dhe burrë e grua), pastaj Zeusi dhe Hera (edhe këta vëlla e motër dhe burrë e grua) ..., këtu do të kishim edhe Përmbytjen/Diluvion dhe njerëzit e parë që shpëtuan me "Arkë-n", si Deukalioni e Pirra, të cilët "*për nantë ditë e nantë net u endën nëpër tallazet e detit*", derisa zbarkuan në Epir. Në Epir kishte qenë edhe tempulli i vjetër i Zeusit Pellazgjik, madje, edhe të vdekurve që shkonin në Hades, rruga nënujore u kalonte përmes lumit e liqenit Akeront, në Epir.

Do të ishte padrejtësi e madhe, po të thuhej se i gjithë prodhimi dhe kontributi antik gadishullor, ka qenë eskluziviteti i fiseve dhe i etnosit grek-helen, sepse padyshim aty kanë kontribute dhe përfshihen, pellazgët, thrakët, ilirët, dardanët, epirotët, maqedonët, dako-mizët etj, d.m.th. të gjithë fise-popujt e gadishullit dhe një periferi edhe më e gjerë. Kështu mundemi të konstatojmë se artistët e gadishullit tonë, dora-dorës arritën t'i rafigurojnë të gjitha perëndeshat e perënditë e formacionit olimpik, filluar nga Kroni, Zeusi e me radhë. Nëse fillimisht shihen kopje imitime të arteve asiro-babilonase, persiane etj, tani do ta kemi pamjen dalluese e tipike të racës evropoide (shih ilustrimin në fig.1).

Kulti i një hyjneshe si symbol, kampionia e bukurisë femërore, dashurisë, rinisë, seksualitetit, fertilitetit dhe e një serie epitetesh dhe hiresh të lakmuara me zjarr, si nga hyjnorët e pavdekshëm, ashtu edhe nga tokësorët e vdekshëm, mendohet se, para pellazgo-

grekëve, ishte lëvruar ndër popujt e civilizimet e Orientit, diçka më dallueshëm tek fenikasit detarë. Fenikasit, siç mendohet e kishin eksploruar jo vetëm Mesdheun, por mbase ishin shtyrë edhe përtej "Shyllave të Melkartit", siç e quajtnë ata ngushticën e Gjibraltarit. Ndër kultet më të hershme, hetohen si statueta terrakote e bronzi ai i hyjneshës Astarte, në hapësirën e Lindjes së Mesme dhe i hyjneshës Anat tek fenikasit, disa kulte të ngjashme ndër egjiptianët etj. Duke qenë kronologji më të hershme (rreth shek IX p.e.r.), vetëkuptohet se edhe arti shprehës i tyre, mbetet arkaik (shih grup fotot nr. 2).

Por, ja ku arrin të konkurojë edhe gadishulli ynë evropoid, i cili i përvetëson dhe i adopton si të vetat, disa nga këto ish mitologjitë fenikase: eksploratori Melkart zëvendësohet nga Herakliu, Shtyllat e Melkartit bëhen "Shtyllat e Herakliut"; si babai i Afroditës, do të bëhet Zeusi, kurse si mamaja do të bëhet Diona, bija e oqeanidës Dorida dhe e Nereut, Plakut të Detit. Nën konceptimin e një race e uniteti të bardhë, mitologjia e gadishullit tonë do ta trajtojë edhe Afroditën: si kult simbol dhe etalon të kësaj race dhe artistët e gadishullit tonë do t'ia arrinin të shprehnin edhe atë shkallën e bukurisë dhe realitetit, mbi bazën-kopjimin e modeleve njerëzore.

Nisur nga pozita kryefemërore e Afroditës dhe nga përhapja e kultit dhe objekteve të saj, mbase mund të mendohej që gadishulli mund të ishte quajtur edhe si Afroditë. Por nuk ndodhi kështu. Nga e gjithë galeria e vashave të bukura, prë e syrit, epsheve dhe shfrimeve të Zeusit, do të ishte Evropa, bija e Agenor Feniksit, që na dha bijtë meshkuj të racës gadishullore, ishte ajo që u përzgjedh fillimisht si emërtimi i gadishullit tonë, emërtim që pastaj u përhap si kontinental. Siç e shohim kjo Afroditë fenikase është konkuruar nga një tjetër fenikase, nga Evropa e mbiquajtur në folklorin tonë edhe si Feniçka. (Iliada, K. XIV, v. 393-394)

Afrodita shquhej për dashurinë pasionante, për magnetin thithës, afshet dhe eksitimet që u shkaktonte hyjnorëve dhe tokësorëve, shquhej si lakmitare e madhe për veshje luksore e dhurata, por dinte të ishte edhe një mama e rrallë për të mbrojtur pjellën e saj, kur ata kërcënoheshin, si në ato rastet kur ndonjë bishë e egër kërkon t'i hajë këlyshët e vegjël.

Afrodita bukuroshe, por edhe xheloze, ambicioze dhe kërkuese në maksimum, fillimisht ndezi një luftë të pashembullt midis ishujve egjeanë për origjinën e saj. Pak më vonë do të shpërthente edhe gara, me një konkurrencë po aq të pashembullt në histori, midis ishujve e

qyteteve greke dhe vetë mjeshtrave skulptorë: kush e kishte statujën e saj më të bukur, me veshje qiellore transparente, me mëndafsh apo edhe nudo fare, kush e kishte më të jashtëzakonshëm tempullin e Afroditës, festimet për nderimin dhe adhurimin e saj etj.

Ne e kemi trajtuar këtë temë, vetëm me një paraqitje sipërfaqësore dhe nuk i kemi hyrë në qelizë se sa thellë shtrihet kjo garë - konkurrencë, kjo "sëmundje epidemi ngjitëse". E sigurtë duket se kulti i Afroditës, me tempuj dhe objekte, ishte përhapur jo vetëm në Helladë, por edhe në të gjithë gadishullin tonë, në gadishullin Anatolik, në gadishullin Italik, si edhe në të gjithë pellgun mesdhetar, "*ku qytetet koloni tregtare helene kuaknin si bretkocat rreth një pellgu*", simbas shprehjes së Aristotelit.

Kultet e statujëzave prej terrakote të shkollës së Tangrës, Korintit, Athinës etj, janë evidentuar edhe në vendin tone, edhe në Rumani etj. dhe mbi këto kemi botuar (ΣΚΟΔΡΙΝΩΝ, f. 540; Shih, Elena Barladeanu - Zavatin, "Noi descoperiri in necropolele Callatiene", për zbulimet arkeologjike të viteve 70-ta, nxjerrë nga interneti).

Për ta shprehur këtë ish realitet e këto specifika dhe këtë "podium nderi për Afroditën hiperbukuroshe" edhe me "gjuhën qiellore", besoj se do të mjaftonte "pohimi me gojë" i vetë Zeusit:

*"Ty bukuroshe e madhërishme Qipride, lufta s'të ka hije...  
ti vetëm merru me punë dashurie".*

(Iliada, K. V, v. 521-526)

Ndërsa "Hera mashtruesja", për ta joshur e rifituar Zeusin, vëllain e njëkohësisht burrin e saj, u detyrua botërisht ta ulte veten si servile dhe t'ia lypte hua huret, afshin e ëmbël, vetitë eksituese etj. Afroditës dhe vetëm mbasi e ka siguruar këtë "hua", ka arritur një nga bashkimet seksuale më ekzemplare me Zeusin:

*Më jep hua o Afroditë lakminë dhe dashurinë, me t'cilat  
Zotat e Olimpët dhe njerëzit ti i pushton" ... (Iliada, K. XIV, v. 240-242)*

*Prit, Herë, një çikë, ke kohë të vesh në shtëpi të Oqeanit,*

*Eja të biem në shtrat bashkë të kënaqemi,*

*Pse aq sa ti asnjë hyjneshë, as grua njerëzore*

*Kurrë s'ma pushtoi me afsh të tillë mua shpirtin,*

*kaq nuk i lakmova as gruas së Iksionit...*

*as vashës Evropë të Feniks shpirtmadhit,*

*që Radamantin dhe Minosin bëri...*

*madje as ty, pse kurrë për ty nuk ndjeva*

*kaq dashuri si sot dhe afsh të ëmbël...*

(*Iliada*, K XIV, v, 365-442)

Në mitologjinë tonë të lashtë gadishullore, e cila njëkohësisht ishte edhe shprehje e fazave të ndryshme të politeizmit, dallohen kryesisht dy variante për prejardhjen e hyjneshës Afroditë/ Ἀφροδίτη:

**Varianti i parë** që i referohet kryesisht Hesiodit në Teogonia, e paraqet Afroditën Anadiomena, si një bashkim i materies biologjike, spermës hyjnore të testikujve të Uranit të tredhur dhe i materies ujore me shkumën e Detit Egje. Ky konceptim, natyrisht edhe i rregulluar i shkollave antike greke, synon të paraqesë idetë hipoteza njerëzore se gjallesat gjysëm tokësore e gjysëmhyjnore e kishin prejardhjen e parë nga deti. Bukuroshja e Detit dhe e Dheut, na prezantohet si një guackë që e hap siparin me një skenë madhështore egjeane (Shih grup fig. 3).

Këtë Afroditë superbukuroshe do ta lakmojë edhe Aresi, perëndia e luftës, edhe Hermesi; kjo Afroditë do të martohet edhe me Hefest Çalamanin, Farkëtarin. Ky i fundit, i ndezur nga një xheloz i tërbuar, do ta zërë Afroditën në flagrancë me Aresin lakuriq duke kryer aktin seksual dhe do t'i mbështjellë të dy me një rretë merimange të fuqishme. Në prani të vetë Zeusit, Poseidonit dhe një serie hyjnorësh të lartë zhvillohet një lloj komedie gjyqësore, ku Poseidoni detyrohet të hyjë si dorëzënës.

Këto këngë komike, zbavitëse, ironike, por edhe eksituese, këndoheshin në ishullin e Korfuzit, të thuash në zemrën e teritoreve tona, nga lahutari zyrtar i pallatit të Alkinout, Demodoku:

*Duke kënduar me lahutë zu plaku  
t' tregonte dashurinë që e kish zanë  
Aresin për Afroditën kurorë-artë  
dhe takimin e parë, edhe të fshehtë  
mu te shtëpia e Hefestit, sa dhurata  
ajo mori, mbasi ia dhunoi shtratin  
zotit të zjarrit ...*

*Zeus o Atë...*

*Sa turp e faqe e zezë! Pse jam i çalë  
po më shnderon kjo Afërdita e Zeusit...*

(*Homeri, "Odiseja", K., VIII, v., 312-430*)

Por, a mund të ndodhte ky "krijim i Afroditës", si një kontakt direkt, si një hyrje në reaksion fiziko - kimik i spermës/farës së testikujve të tredhur të Uranit, me shkumën e ujit të kripur të Detit Egje?! A mund të krijohej jeta nga kjo "supë përzierjeje organike e inorganike" e

tollovitur në tallazet?! Jeta ka filluar me një femër?! Ç'të ishte këtu një ish variant i lashtë mitologjik femëror i matriarkatit, edhe më i lashtë se Adam/Ademi mashkullor tradicionalist?! Nga femra e parë doli mashkulli apo nga mashkulli i parë doli femra, apo të dy kanë dalë nga një ish hemafrodit?! Nga mitologjia e dimë se vetë Zeusi mashkullor e kishte aftësinë të pillte nga koka (Athinanë), kishte aftësinë ta rriste një embrion me jetë si një shartesë (pemësh) në kofshë (Semelën), por ishte edhe si hemafrodit, pa folur pastaj se ishte edhe një çikë pederast "modern"!

Dhe këtu nuk po ndalemi të trajtojmë se si ishin çensuruar pothuajse krejtësisht ish metamorfizimet dhe bashkimet që imitonin seksin e fuqishëm të specieve shtazore, ku Zeusi shndërrohej edhe në dem, shqiponjë, delfin, gjarpër, etj, madje edhe si materie amorfe, si: ar, shi dhe arrinte t'i mbarste ato femra, të cilave ua kishte vënë syrin dhe idenë në kohën e epshit.

Në Biblën e Vjetër, kur besimi monoteist kishte filluar të përparonte, mund të konstatohen ende gjurmë të këtij ish-politeizmi edhe në hapësira të tjera tokësore. Fakti që këto pasazhe kanë shpëtuar, duhet interpretuar si një inerci, më në fund edhe si pakujdesi e çensurimeve dhe redaktim-rregullimeve të mëvonshme. Një nga rastet më skandaloze e paradoksale ishte ky që po citoj: *"Kur njerëzit filluan të shtohen e të përhapen mbi tokë dhe u lindën vajza, bijtë e Hyjit, kur i panë bijat e njerëzve se ishin të bukura, zunë t'i marrin për gra të gjitha ato që u pëlqenin. ... Në atë kohë – po edhe më vonë – kishte mbi tokë viganë, kur bijtë e Hyjit lidhnin martesë me bijat e njerëzve dhe ato u lindnin fëmijë: këta janë kreshnikët e kohëve të lashta, njerëz të përmendur".* (Bibla e Vjetër, bot. shqip 1994, Zanafilla, "Bijtë e Hyjit dhe bijat e njerëzve", 6, 1-4)

Padyshim kjo "orgjia kolektive hyjnore ndaj femrave tokësore", na çonte në kohën dhe moralin e zotave të politeizmit. Mjaft të kujtojmë këtu mitologjitë e femrave të bukura tokësore Isidës në Egjipt që u bashkua me Ammonin, Jonës, Evropës etj, që u lakmuan dhe u bashkuan me Zeusin etj.

Këto çështje, gjurmë të bashkimeve seksuale të qiellorëve me tokësorët, sidomos monoteizmi kristian dhe ai islam u kujdesën t'i pastronin dhe t'i zhduknin si të paqena asnjëherë.

**Varianti i dytë** i cili prezantohet direkt nga Homeri, e paraqet Afroditën, si bijën e Zeusit Pellazgjik me nimfë-nereidën Dione. Kjo ishte njëra nga bijat e Plakut të Detit, Nerreut dhe Doridës,

që banonin në një shpellë nën ujore të ishujve të Egjeut jonik, atje ku ujrata e kripura bashkoheshin me ujrata e pastra të pijshme të rrjedhave nëntokësore (Iliada, bot. shqip 1979, Kënga V etj).

Ky variant quhet Afrodita Pandemia, domethënë kemi një Afroditë më popullore, më të përbashkët, më njerëzore, ndoshta, sepse hyjnesha kërkon të shkrihet më shumë me njerëzit, një ide që më vonë do ta shohim edhe te Jezusi. Në të vërtetë, po t'i shikosh hollë-hollë, në të dy variantet, Afrodita mbetet me një origjinë nga deti. Ne do të anonim nga mendimi i disa ekspertëve se ky varianti homerik rezulton se ishte më i përhapuri në gadishullin tonë. Por, ndryshimi tashti është i dukshëm: mjaft të përmendim faktin se Afrodita është bija e vetë Zeusit me Dionën, bijën e Nereut.

Mund të konstatohet se ish mitologjia e lashtë fenikase tashmë ishte përvetësuar e përshtatur nga protoevropoidët. Në skenën egjeane ka hyrë Dorida, mamaja e Dionës. Kjo Doridë udhëton – noton në det e hipur mbi një hippocamp me kokë demi dhe bisht gjarpër-dragoi të gjatë, çka na kujton edhe demin Zeus që rrëmben Evropën fenikase, por na kujton edhe hippocampin me kokë kali që është Poseidoni! Dionën çuditërisht e gjejmë në monedhat e Epirit, bashkë me Zeusin, ku çuditërisht Zeusin e gjejmë edhe të metamorfizuar si dem! Të kujtojmë këtu se emrin e Epidamn e kanë lidhur etimologjikisht me dem dhe se vetë Poseidoni ishte hyu mbrojtës i ilirëve, madje edhe i vetë Epidamn – Dyrrahut.

Ndonjë autor italian shkruan edhe për një kult specifik si “Afrodita Adriatike” dhe ndër bazat më të forta të përhapjes radhit Durrësin, i cili pret monedha edhe bronzi e argjendi me Afroditën. Një shtresë, ndoshta shumë e hershme e kultit mitologjik thotë se, fillimisht Afrodita ishte dashuruar me dajën e saj, me Nereidin, birin e Nereut “Hyut Plakut të Detit” dhe kjo shtresë për ne shkon e krahasueshme me legjendën mitologjike të Ishullit të Feakisë/Korfuzit, kur Areteja e bukur dashurohet dhe martohet me xhaxhain e saj, me basileusin Alkino.

Siç e dimë nga mitologjia, ky, Hyu i Detit, Nereu, banonte bashkë me 50 bijat e tij oqeanide e Nereida banonte në një shpellë detare në një nga ishujt e egjeut jonik. Ish ky Plak Deti që ia tregoi eksploratorit detar Herakliut, “rrugën detare për në Fundin e Botës në Perëndim të Shtyllat e Herakliut”... Të kujtojmë se po ky Herakli ka ardhur në Epidamn e Dyrrah, “ka pyetur nimfat lumore për rrugën detare në fund të Botës në Perëndim”, por edhe “për rrugën për në fund të

Botës në mjegull të veriut” ... Dhe sigurisht këtu nuk kemi ndërmend të zgjatemi pafund nëpër rrjetat e merimangave të mitologjisë.

Mitologët kanë radhitur edhe një listë emërore se me sa hyjni mashkullore e me sa njerëz mashkullorë ishte dashuruar ose bashkuar seksualisht Afroditë.

Këtë Afroditë ndër sa e sa fatlumë e dashuron dhe bashkohet me të seksualisht *“në mal të Idës plot me burime, pyje dhe orë e zana”*, çobani i ri dardan, Ankizi. Dhe kështu, *Afroditë lindi Ene Dardanidin e Trojës, djalin që me shpirt e deshi* (Iliada, bot. shqip 1979, K V, v. 300 - 301; v. 376 - 385; v. 460 - 465 etj.)

Vetë Fati, pastaj Poseidoni kryesisht dhe disa nga perënditë e tjera e pranuan lutjen dhe dëshirën e Afroditës dhe ia mbushën mendjen Zeusit, që fara, fisi e populli i Ene Ankiziadit Dardanidit, vetë prejardhja e parë prej Dardanit, të mos shuheshin krejtësisht nga faqja e dheut, por të shtegtonin, të shtoheshin e shumëheshin në vende të tjera. Citoj:

*“Unë e kam për mburrje*

*Që jam biri i Ankiz shpirtmadhit,*

*E nëna ime është zonja Afroditë...*

*E, në daç të dish për fisin tim të ndritur*

*çfarë nami ka, këtë e di mirë gjithë bota!*

*Zeusi, që vrenjt e kthiell, së pari lindi*

*Prijësin Dardan, që themeloi Dardanien...*

*pastaj Dardani bëri Eriktonin,*

*mbret pasanik si askush mbi faqe t’ dheut,*

*për të kullosnin ndër luadhe e kneta*

*plot tri mijë pela që për mëza mburreshin...*

*E shkroi edhe Fati, që Eneu t’i shpëtojë vdekjes,*

*mos t’i shuhet fara e zhduket emri fisit të Dardanit,*

*që me shpirt Zeusi e deshi mbi të gjith djemat...*

*Fuqia e Eneut do të sundojë mbi teukrët*

*e djalë mbas djali do sundojë në të ardhmen.*

(Iliada, bot. shqip, 1979, K. XX, v. 250 -289; v. 366-373 etj.)

Siç e shohim edhe Afroditë ka një mision dhe vepër si Evropa: shton dhe shumon racën e bardhë. Por, ka të ngjarë që ky variant, na çon më thellë në një ish hegjemoni trojano-dardane, kur edhe mitologjia sillej në këtë funksion si epiqendër. A thua kishte një mitologji me një fillim bote me prejardhje Dardanide, si një mitologji me këtë Mama? Ishin akeji-helenët ata që e shprishën dhe e ngatërruan

lëmshin, lesh e li?!

Eneu, “biri i Ankizit dhe Afroditës”, niset në misionin dhe shtegtimin “e parathanë” dhe ndër më të parët me një vizitë nderoi Buthrotin, Trojëzën e Vogël me mure e porta, me Pergamin dhe barinjët e tij, atje ku Andromaka qe degdisur nga fati i parathënë, i parashkruar. Ishte ky Buthroti – Butrinti ynë një imitim i ish Trojës së Madhe në Dardanele. Më pas do të kishte edhe imitime të tjera.

Prindi im, Gjovalin Luka, në ato kuriozitetet e pasionet e tij hulumtuese, e kishte shënuar këtë Parathënie – Profeci, të nxjerrë nga një botim italisht i Iliadës dhe më vonë ma kishte lënë ndër amanetet e mundshme këtë trajtim-hipotezë. (*Omero, Iliade, Traduzione di Vincenzo Monti, Milano, 1934, Libro VI, v. 585-600, f120*)

Unë po i sjell ato vargje simbas përkthimit shqip për lexuesit:

*“Pse mirë ma ndien zemra*

*do vijë një ditë dhe Ilioni i Shenjtë do shuhet...*

*Por unë nuk ndiej aq hidhërim për teukër,*

*as për Hekubën, as për mbret Priamin,*

*as për vëllezër, që burrnisht në pluhur*

*do bien të vrarë nga duart e gjakshme armike,*

*sa ndiej për ty, kur një ake i ngjeshur*

*me parzmaq tunxhi, ty me sy t’ përлотur,*

*do të rrëmbejë mizori lirinë tënde.*

*Ndoshta në Arg nën urdhra të një zonje*

*për të do bësh në avolimend pëlhurë,*

*do mbushësh ujë në gurrat e Meseidës*

*ja Hiperisë me detyrim nga halli...”*

*(Iliada, K. VI, v 449-562)*

Gjovalini e nënkuptonte këtë Meseidën me Gurra, pak a shumë rrotull fshatit Mesopotami (mes dy lumenjve gr.) ose dikund te burimet e Malit të Gjerë, ndërsa vetë këtë Hiperi-në e shikonte si Epiri, pra në Butrint, ku edhe realisht-mitologjikisht Andromaka vjen dhe përfundon. Fantazi apo e qëlluar “si qorri shenjës”, gjithsesi Buthroti/Butrini aty është nuk ka luajtur vendit.

Ndërkaq nuk po e mbyllim pa shënuar edhe këtë njoftim: “*Enea bashkë me ushtarët trojanë...arriti në Dodonë, me qëllim që të kërkonin mendimin e perëndisë (orakullit); këtu gjetën ata trojanë që kishin ikur bashkë me Helenin. Si morën përgjigjen hyjnore mbi punën e kolonisë, i dhuruan Zotit/Zeusit bashkë me dhuratat e tjera trojane edhe kratere bakri, disa nga të cilat ndodhen akoma me mbishkrime shumë të vjetra, që*



*tregojnë emrat e dhuruesve; ... Ardhjen e trojanëve në Buthrot e tregon edhe një kodër e quajtur Troja, të cilën ata e përdorën për të ngritur lëmin. Prej Buthrotit, duke ndjekur anën e detit ata arritën deri tek porti që atëhere quhej Anhisi e që sot ka një emër më të paqartë; prej këtej, pasi ndërtuan faltoren për nder të Afroditës, çanë detin Jon ... Thonë se Enea i ardhur nga Mollosia në Itali ndërtoi bashkë me Odhisen qytetin, të cilin e quajnë Romë me emrin e njëres prej Iliadave...*"

*(Dionisi i Halikarnasit, "Antiquitatum Romanorum", Lib. II, 51 e 72)*

Siç shihet në Sarandë e në gjithë Mollosinë nderohej me mirënjohje Afrodita që me lutjet e saj ndaj Zeusit dhe Poseidonit e kishte shpëtuar birin e saj Eneun dhe farën e vjetër pellazgo-dardane...

III. Modelet e Afroditës, etalone të bukurisë femërore të shkollave-punishteve në Greqi dhe në të gjithë gadishullin tonë.

Nuk ka dyshim se në memorizimin dhe përhapjen e kultit të Afroditës, vendi i nderit dhe i hapësit të skenës i takon Homerit me dy poemat Iliada dhe Odiseja. Ka të ngjarë që dikur Afroditën e derdhnin edhe në statujëza ari, por më pas, me rënien e politeizmit, erdhi edhe rrënimi.

Ironiku dhe mosbesuesi Lukian, rreth një mijë vjet më vonë nga Homeri, e kishte fiksuar ngritjen dhe pastaj edhe dekadencën, rënien e këtij kulti kështu:

*"Afrodita – Atëherë, o Hermes, vërmë edhe mua në rreshtin e parë, se jam prej ari.*

*Hermesi – Jo, s'je, o Afroditë, me sa mund të vërej unë. Në qoftë se s'më janë zënë sytë krejt, ti më duket se ke qenë skalitur prej mermeri të bardhë Pentelikoni dhe më pas, kur u bërë Afroditë, të dhanë në duart e knidasve – kështu e pa të udhës Praksiteli.*

*Afrodita – Po unë të nxjerr edhe një dëshmitar që është i denjë të besohet – Homeri, që nga kënga e parë e deri tek e fundit më quan kudo "e arta Afroditë".*

*Hermesi – Vërtet, po Homeri thoshte edhe për Apolonin se është i pasur në ar. Por tani ti do ta shohësh të rrijë diku mes zvegjitëve – cubat ia kanë hequr kurorën dhe ia kanë vjedhur çelësat e kitarës. Prandaj edhe ti gëzohu që s'po të vënë të rrish në kuvend me tetët".*

*(Lukiani, "Vepra të Zgjedhura", përkthim shqip 1979, "Zeusi aktor tragjik", f.90)*

Ironia e apogjeut homerik, ishte kaq e hollë, sa rreth 18 shekuj më vonë një Lukiani nga Shkodra, iu desh ta verifikonte Lukianin nga Samosta, nëse vërtetë Homeri e kishte përmendur vazhdimisht në të gjitha këngët e Iliadës, nga I-XXIV, atë epitelin "e arta Afroditë"?

Dhe rezultonte se, nuk e kishte përmendur në të gjitha. Afroditë mungonte te Kënga I, përmendej te Kënga II, te Kënga III “dhuntitë e zonjës Afroditë”, te Kënga IV “Afroditë buzëqeshura”, përmendej gjerësisht te Kënga V e “Madhërishmja Afroditë”, zhdukej si lumë shkretëtire nga Kënga VI e deri te XIII; del përsëri te Kënga XIV, zhduket... ridel te Kënga XX dhe mbyllet perdja e saj. A thua kishte patur ndonjë variante homerike të tillë, “me të artën Afroditë”, si ajo që e përmend Lukiani në shek II?! Tallej Lukiani, apo redaktorët helenikë që nga koha e Pisistratit e kishin krasitur këtë Afroditomaninë?!

Gjithsesi, dekadencia e politeizmit kishte filluar kur “kurorat e arta”, jo vetëm të Apollonit, Afroditës, por edhe të vetë Zeusit, kishin filluar t’i lehtësonin nga pak ose t’i vidhnin...

Vetë Olimpi, simbas Lukianit, kishte hyrë në dietë mishi dhe furnizohej me regjim me tallona. Madje edhe ky racionim ishte falë zbritjes poshtë të Panit, Hyut ilir të grigjave dhe kullotave, me kope e me vllazni. Vetë Zeusit në Kuvend, për një çikë mish e flije më shumë, i duhej t’i servilosej e të dëgjonte “leksionet, kapardisjet” e Panit nga poltrona e parë, që qelbej era sqap...

Njëra nga shkollat dhe njëkohësisht edhe një punishte e madhe e prodhimit në seri të mini statujave dhe statujave, sidomos të femrave të bukura hyjnore e tokësore, do të bëhej qyteza afër Athinës që quhej Tanagra ose Graena. Mikrostatuettet e prodhuara në fillim dallohen për një kohë dhe art arkaik. Më vonë dora-dorës, veçanërisht edhe me futjen e formave shtampë, arti gjithnjë e më shumë do të përsosej në bukuri, duke i futur brenda edhe mendimin e ndjenjat shprehëse. Në një fazë më të evoluar u kalua edhe në statuja e statujëza me derdhje metalesh, si bakër, bronz e plumb. Thuhet se Praksiteli, në shek IV p.e.r., mbi bazën e modeleve të terrakotave e statuettave më të vogla, kishte realizuar në mermer së paku dy Afroditë të famshme me një art gati-gati të paarritshëm. Njihen sot, Afroditë e Knidos (e Praksitelit, shek IV p.e.r.), Afroditë e Milos (e Aleksandrit të Antiokisë), Afroditë e Rodit, Afroditë e Kiterës, Afroditë e Qipros, Afroditë e Pafos etj. Grupe skulpturale në mermer me prezencën e Afroditës, kishte realizuar edhe Fidia etj. (shih grup fotot 4)

Disa nga qytetet dhe ishujt e Greqisë rivalizonin njëri me tjetrin se kush e kishte statujën e Afroditës më të bukur, më të kushtueshme, po ashtu edhe tempujt më të kushtueshëm të saj, ndërsa mes

ishujve ishte ndezur një konkurrencë mbi vendin ku kishte lindur ekzaktësisht Afroditë? Ky kult ishte kthyer më shumë se ekonomi tregu për prodhimin e terrakotave, statuetave, statujave, për riprodhimin në monedha etj. Knidosi, për shembull preu edhe monedha me paraqitjen e statujës së Afroditës. Dhe nuk mbaron me kaq: tempujt e kultit të Afroditës ishin kthyer edhe në një ekonomi gjigande fitimprurëse prostitucioni. Ky “prostitucion dhe korrupsion” i shoqëruar me dhurata të shumta, siç e cituam, supozohej se kishte filluar së pari në qiell dhe pastaj ishte “kopjuar - importuar” edhe në tokë. Në të vërtetë ishte e kundërta. F. Engelsi kishte shkruar: *“Të jepej gruaja për të holla ishte në fillim një akt fetar; kjo bëhej në tempullin e perendshës së dashurisë dhe paratë në krye shkonin në thesarin e tempullit. Hijerodulet e Anaitit në Armeni, të Afroditës në Korint dhe kërcimtarët fetare të tempujve në Indi, të ashtuquajturat bajadera, kanë qenë prostitutat e para. T’u jepeshin burrave në fillim ishte një detyrë për çdo grua, më vonë kjo praktikohet vetëm nga këto priftëresha, që zëvendësonin të gjitha të tjerat. Tek popujt e tjerë heterizmi e ka origjinën e tij në lirinë seksuale, që kishin vajzat para martesës dhe si rrjedhim është një mbeturinë e martesës me grupe...”* (“Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit”, *Vepra të Zgjedhura*, bot. 1958, f. 211)

Në të gjithë Greqinë, sidomos në Athinë dhe në Korint, festohej një ditë e Afroditës e cila stimulohej edhe me përdorimin e afrodisiakëve dhe degjeneronte në skena orgjie seksuale kolektive, ku shumë pasanikë shprehnin “adhurimin e veçantë”, duke bërë seks direkt me priftëreshat e bukura të tempujve të Afroditës, duke shpenzuar me këtë rast shuma dhe dhurata marramendëse. Kjo modë, shpejt iu ngjiti të gjithë gadishullit.

Sigurisht lexuesi e ka të qartë tani se ato që ndodhnin në tokë, ishin pasqyruar si një shëmbëllim virtual edhe në orgjitë qiellore.

Ilustrime të tilla për llojet e ndryshme të martesave dhe evolucionin e moralit ne i kemi gjetur edhe në fiset ilire.

*“... Në Iliri ka gra të tilla që ruajnë dhentë ose shkojnë për dru, ose gatuajnë, ose ruajnë kasollen. Sa për ruajtjen e fëmijëve them se duhet të bëjnë njësoj si mëndeshat, ashtu edhe mëmat... Siç kam dëgjuar, atëhere kur ti ndodheshe tek Liburnët, ke parë gra të martuara, të ngarkuara me dru dhe në të njëjtën kohë mbanin në duar kush një, kush dy fëmijë, sikur donin të tregonin se lehonat tona, të cilat dergjen ditë të tëra, janë të dobëta dhe për t’u përbuzur...Po, në Iliri ndodh diçka tjetër: shpesh një grua shtatzënë, kur i vjen për të pjellë, largohet pak nga vendi i punës së vajzave dhe pasi*

*lirohet nga fëmija, e sjell, thujse nuk e lindi, por e gjeti. Gjithashtu edhe vajzave që atje i quajnë virgjëresha, zakoni nuk ua ndalon, që para martesës të shkojnë me atë që duan, të enden vetëm dhe të kenë fëmijë..."* (M. Terentii Varronis, *De Re Rustica*, Lib. II, 7-10; "Ilirët dhe Iliria te autorët antikë:, bot. 1965, f. 79; *Krahaso me Herodoti, Historiae, Lib. V, 1; 12 -17 etj*)

*Liburnët gratë i kanë të përbashkëta dhe fëmijët i ushqejnë bashkërisht deri në moshën 5 vjeç; pastaj në vitin e gjashtë i mbledhin gjithë fëmijët dhe shquajnë ngjasimet që kanë me burrat dhe secilin ia dorëzojnë babait të vet; secili baba që nga koha që merr fëmijën e quan si djalin e tij. (Nikolla i Damaskut, "Jeta e Çezarit August", 17, 14)*

#### **IV. Kult i virgjëreshë Afroditës në Shqipëri dhe në Skodrinon/Shkodra**

Sipas tekstit "Historia e Shqipërisë", disa zbulimeve arkeologjike dhe një kontributi personal të arkeologut prof. dr. N. Ceka, kult i Afroditës dhe i objekteve të saj është evidentuar dhe hetuar edhe në territorin e Republikës së Shqipërisë. Më të spikatura nga trajtimet dhe botimet e prof. Cekës janë dy terrakota: njëra e gjetur në Selcën e Poshtme dhe tjetra në Margëlliç të Mallakastrës. Kjo Afroditë e Margëlliçit krahasohet qartazi me modelet e prodhuara nga shkollat dhe punishtet greke (*Ilirët, bot. 2001, f. 91 dhe f. 111*).

Profesor Dhimitër Pilika, nga puna e tij me dekada, i kushtoi një sintezë me tre faqe hyjneshës pellazge Afërditë, bijës së Zeusit dhe Dionës, ku citon variantin homerik. Krahas një terrakote të shek IV p.e.r., të gjetur në gërmimet arkeologjike 1872-1075 në Dodona, sjell gjetje në monedha, rreshton një listë të tempujve në territorin e vendit tonë, ku përmend edhe një tempull në Skodra. Ai nënvizon: "Një studiuues evropian i lashtësisë, për intensitetin dhe dëndësinë e nderimit të Hyjneshës së Bukurisë dhe Dashurisë, i ka cilësuar trojet albane, "Vend i kushtuar kultit të Afërditës. Emri i hyjneshës sikurse edhe i yllit përkatës, ka gjetur shpjegim etimologjik vetëm përmes shqipes: Afër - ditë = ylli që duket edhe në agim, pra afër ditës" (Dhimitri Pilika, "Pellazgët, origjina jonë e mohuar", bot. 2005, kap. XXXII, Afërdita, f. 252-254)

Në Amantia, kohët e fundit është evidentuar një ish tempull i Afroditës dhe mendohet se është gjetur edhe një formë për prodhimin e terrakotave të Afroditës. Në zonën e Liqeneve të Belshit mendohet se ka ekzistuar një festim masiv kolektiv i kultit të Afroditës, me hedhjen e figurinave prej terrakote në liqene etj. Por, ka të ngjarë që Apollonia dhe Durrësi të jenë edhe stacione të fuqishme të përhapjes së kultit të Afroditës, pa përjashtuar këtu idenë e ekzistencës së ndonjë kultit të

ngjajshëm vendas. Edhe në Kosovë ka raportime se është gjetur një kokë guri e Afroditës.

Është për të ardhur keq që Enciklopedia online shqiptare ndodhet në një gjendje të mjerueshme përsa i përket informacionit, sidomos të paraqitjes me ilustrimet fotografike etj, të artefakteve! Edhe kur këto postohen të ilustruara me foto me ngyra etj, redaktorët tanë çuditërisht as nuk e marrin mundimin t'i pasqyrojnë, as edhe pjesërisht, por i çensurojnë komplet! A thua se jemi në kohën e inkuizicioneve mesjetare, apo edhe të një regresi injorant kundra objekteve idhujtariste!

Atëhere, rastësisht ka mbërritur kulti i Afroditës në Shkodër? Si mund të shpjegohet që ka dalë një Afroditë, vajzë virgjëreshë me pëllumb mbi kokë?!

Tashti të paraqesim fondin modest privat që ne kemi mbledhur nga monedhat dhe statuetat:

a) Monedhë bronzi me përqindje të lartë bakri. Nga njëra anë ka kokën bukuroshe të Afroditës me kurorë dhe nga ana tjetër mendohet se ka dy mini statujta, ku njëra është Afroditë. Paraqitja fotografike është mjaft e vështirë, kërkon teknika speciale dixhitale etj. (fig. 8)

b) Dy monedha argjendi që paraqesin kokën e Afroditës me pëllumb. Nga ana tjetër një luan që i ka kërcyer mbi shpinë një dreri brilopatë. Mendohet se si këto monedha ka prerë edhe Durrësi (fig 9)

c) Monedhë argjendi e Lidhjes Epirote. Nga njëra anë paraqet Zeusin dhe Dionën, mamaja e Afroditës dhe nga ana tjetër Zeusin e metamorfizuar si Demi i Epirit (fig. 10).

d) Ndër statuetat prej terrakote ne kemi një kokë të Afroditës, e cila mendohet se ka qenë pjesë e një statuate me trup të plotë ose në formë busti. Koha e ka dëmtuar disi. Se cilës kohë i përket, bazuar edhe mbi teknikën e formës me boshllëk përbrenda, mendojmë se duhet të shprehen specialistët. Mendimi ynë është që i përket kohës helenistike (fig. 12).

e) Një fragment koke e fytyre terrakotë statuetë (?), apo ndonjë pjesë e një ene balte, paraqet fytyrën e mrekullueshme të Afroditës dhe ka një cilësi të lartë pjekjeje (fig.13).

f) Kokë bronzi me përqindje të lartë bakri, statujëzë e Afroditës me kurorë dhe me vathë. Ka përmasat 55x34 mm, peshon 250 gr. (fig. 14)

g) Statujëza "Afrodita e Skodrinonit". Ka përmasat 157x53 mm,

peshon 380 gr. (fig. 15)

Ne kemi raportuar dhe botuar për gjetjen në Shkodër të një terrakote arkaike, me motivin e mamasë me fëmijë për gjiri dhe kemi botuar me shpenzimet tona një libër të plotë, për të cilin "dijelerët" e Bashkisë dhe Prefekturës Shkodër, nuk begenisën të vinin as në Promovim (fig. 16)

Ikonoklastia dhe të gjitha llojet e tjera kanë qenë dukuri e fenomene edhe në hapësirën kristiane, por me fillimin e Rilindjes, u shënua një kthesë, ndërsa ne ramë në errësirën e gjysmë hënës. Me një Urdhëresë të posaçme të Sulltan Mehmetit II Fatihut, më 1479, me rastin e pushtimit, Shkodra "u pastrua" nga kultura tradicionale e saj dhe kjo është edhe një nga arsytet që objektet arkeologjike rezultojnë të asgjesuara, të shkatërruara, të hallakatura. (Në Kur'an-i, përkujtohet dhe përforcohet "Urdhëresa e Dytë", e kohës së Musait, kundra statujave në ajete të posaçme, duke kaluar në një ikonoklasti, statujoklasti ekstreme, kundra objekteve të klasifikuara si idhujtare. El Arafë, ajeti 138, 139, 140; El Enbija, 57, etj.)

Fatkeqësisht, ky shkatërrim i artefakteve dhe i gjithë zonave arkeologjike, ca për inerci e injorancë, ca për pakujdesi të pafalshme ose dreqi e di se për çfarë zekthi pickues e ngacmues, ka vazhduar përgjatë gjithë shek XX dhe po vazhdon edhe sot e gjithë ditën në shek XXI! Le të përmendim vetëm faktin që një delfin triton basoreliev, simboli i Poseidonit, i skalitur në një gur të madh, i konstatuar nën ujërat e Drinazës, mezi ka vetëm një foto bardh e zi e jo vetëm që nuk u filmua, por edhe u dënua duke i hedhur qindra tonaleta gurë e çakull përsipër! Ashtu edhe e gjithë Zona Arkeologjike, Gropa Stratigrafike dhe e gjithë zona e kodrave dhe e buzë lumenjve u zu me ndërtime! (Dhe askush nuk e ka trajtuar se, përveç rrënimëve, edhe sa vlera u shitën në Malin e Zi, Gjermani e Greqi... se objektet nuk ishin të sigurta as në vetë Muzeun Historik të Qytetit...)

Ka ardhur koha që këto pak vlera që kanë mbetur, të zmadhohen nga skulptorët tanë mjeshtra dhe të vendosen në vendet më të spikatura të qytetit (shih edhe statuetën "Dama antike Skodrinane", fig. 17)

Kush nuk do ta dëshironte ta shihte këtë Afroditë, apo "Damën antike Skodrinane me kyliks e ojnohe vëne mjalti", të zmadhuar dhe të vendosur në një nga sheshet më të dukshme të qytetit tonë?! Kush nuk do të dëshironte që një statujë gjigande e mamasë së

Skodrinonit, njëra nga mamatë më të lashta dhe më të justifikuara tokësore, me fëmijë për gjiu, të vendosej në një majë të Taraboshit?! Do të guxoja bile të thosha “se statuja e Faties me fëmijën për gjiu ia kalon në lashtësi edhe asaj dardanes së Trojës me Afroditën me Eneun për gjirit”! Por, kur “të dhjet dreqi në kuletë” dhe “kur ligjin e bën Maliqi”, duhet me mbyllë edhe gojën, se këta trumëhasur të quajnë edhe të marrë ...

Kur në Malin e Taraboshit shkruhej ENVER – P. P. SH, askush nuk guxonte ta quante të marrë personin dhe marrëzi idiote idenë, për tërë atë investim e vepër heraklidiane me gurë mali, vetëm për kultin e shfrenuar të individit Enver ... madje edhe vetë autori i këtyre radhëve ka qenë si gjimnazist në atë aksion me detyrim – përcaktim! Dihet se sa zi u hoq të zhdukej ky mbishkrim.

Por t’i ngresh këtë statujë “Mamasë me fëmijë”, simbolit të identitetit dhe ekzistencës së qytetit tonë, kësaj Troje të koinçiduar, legjendës së fisit, racës tonë evropoide, legjendës së vetë Rozafatit, kush do të guxonte ta përgojë e kundërshtojë?!

Le të shpresojmë se brezat e ardhshëm të qytetit tonë do të jenë më me fat dhe këto do të realizohen.

Ilustrimi grafik i studimit:



1. Pikturë në qeramikë, kyliks i shek VI p.e.r., Zeusi me mjekër dhe me shqiponjë, imitim i artit persian; Gdhendje në gur, Zeusi në fron me shqiponjë; Monedhë bronzi e gjetur në Shkodër, “Zeusi Diell, që vran e kthiell”, ka gjurmë zjarri. Koleksion personal. Zeusi bust, punim i skulptorit shkodran Ferid Kola, viti 2016.



2. Statuetë bronzi e hyjneshës së bukurisë Anat dhe terrakotë e hyjneshës Astarte .



In Pompeii before 79 AD. Venus on a sea shell painted on a wall.

3. Krijimi i Afroditës Anadiomena, simbas variantit të Teogonisë së Hesiodit, si një qenie që del nga guacka, sipas një pikturë vazo helene; Pikturë murale në Pompei;





4. Basorelievo, Dorida me pishtar etj, e hipur mbi një hipokamp me kokë demi dhe bisht qenieje ujore; Pikturë murale, Poseidoni hipokamp me kokë kali, në Durrës.




A.



B.



C.



D.

5. A. Statujat prej mermeri Afrodita e Knidos e Praksitelit nudo; Afrodita e Milos e Aleksandrit të Antiokisë, gjysëm e veshur.

B. Modele të terrakotave helene.

C. Afrodita e Rodosit dhe Afrodita me pëllumb, terrakota statueta.

D. Statueta derdhje në bronz, modele helene. Shihni edhe Afroditën me mollë në dorë.



6. Terrakotë, Afrodita mama me Eneun Ankiziadin Dardanidin për gju.




7. Afrodita e Selcës së Poshtme, terrakotë; Afrodita e Margëllicit, terrakotë e krahasuar me modelet helene; Kore, terrakotë.



8. Monedhë bakri, 'Koka e Afroditës me kurorë, e gjetur në Shkodër.

*Koleksion personal. Monedhë e krahasueshme me prerjet greke me kokën e Afroditës dhe me bletë.*



9. Monedhë argjendi, diametri ~ 20 mm. Ana e përparme, "Afrodita me kurorë dhe pëllumb"; ana tjetër, "luan që i ka kërcyer mbi shpinë dhe po e kafshon në qafë një dre bri lopatë". Ka prerje të Durrësit, por kjo mund të jetë edhe prerje e Skodrinonit. (?) Koleksion personal.



10. Monedhë argjendi e Lidhjes Epirote. Ana e përparme, "Zeusi dhe Dione", babai dhe mamaja e Afroditës, "me kurora mbi kokë"; ana tjetër, shkruan ΑΠΕΙΡΩΤΑΝ, paraqet Zeusin e Epirit pellazgjik të metamorfizuar si dem dhe e lauruar me gjethe lisi. Koleksion personal.



11. Kokë e Afroditës, e dëmtuar, pjesë e thyer e një statuate (?) Gjetur në Shkodër. Koleksion personal.



12. Koka e Afroditës, terrakotë e pjekur me cilësi të lartë, pjesë e një ene (?). Gjetur në Shkodër. Koleksion personal.




13. "Kokë e Afroditës me kurorë", gjetur në Shkodër, derdhje në bronz. Koleksion personal.







14. Statujëza "Afrodita e Skodrinonit me pëllumb mbi kokë", foto në përmasën origjinale 156 x 53 mm. Koleksion personal.



15. Terrakotë arkaike, "Fatia me të birin", e gjetur në Shkodër, 114 x 53 mm. Koleksion personal.



16. "Dama antike skodriane", statuetë bronzi e gjetur në fshatin Gur i Zi, Shkodër. Ndodhet në Muzeun e Luçit.

## Zamir TAFILICA

### TRADITA MUZEORE NË SHKODËR

**Hyrje.** Termi *muze* rrjedh prej greqishtes së vjetër *mouseion*, vend i shenjtë për Muzat, bija të Zeusit e kujdestare të arteve e të shkencave, të mbrojtura nga Apolloni. Muzeu është një institucion që disponon një bashkësi artefaktesh (objektsh), publike ose private, e lidhur me një ose më shumë sektorë të kulturës, të artit, të shkencës e të teknikës. Statuti i Këshillit Internacional të Muzeumeve (International Council of Museums) e përcakton "*një institucion i përhershëm, jo me qëllim fitimi, në shërbim të shoqërisë e të zhvillimit të saj. Është i hapur për publikun e përfshin kërkime që sjellin dëshmitë materiale e jo materiale të njerzimit e të mjedisit të tij; i pronëson, i konservon, i komunikon e, mbi të gjitha, i ekspozon për studim, për edukim e për kënaqësi*". Muzeu i Aleksandrisë i ngritur në periudhën helenistike, qe muzeu i parë i historisë. Sot ka një numër shumë të madh muzesh, përsa i takon tipologjisë: të arteve figurative, të artizanatit, të arkeologjisë, të antropologjisë, të etnologjisë, të historisë, të shkencave e teknologjisë, të natyrës etj. Brenda këtyre tipologjive, ekzistojnë shumë muze të specialiteteve më të ngushta: të arteve moderne, të historisë lokale, të aviacionit, të agrikulturës, të gjeologjisë etj. Koleksionet e një muzeu shpesh janë të regjistruar e të kataloguar, duke i lejuar vizitorit të njohë datimin, prejardhjen, teknikën e punimit, autorin, funksionin etj. të artefaktit.

Muzeologjia është një disiplinë që, sëbashku me muzeografinë merret me muzetë. Përdorimi i dy termave, edhe në mjedisin shkencor e profesional, nuk është uniform. Kuptimi dhe roli që përpiqet t'i atribuohet njërit o tjetrit term ndryshon në kontekste të ndryshme. Muzeologjia është një disiplinë e re: ka lindur më 1955, duke u shkëputur prej muzeografisë së strukturuar qysh prej shekullit 18, që bazohej para së gjithash mbi idetë e teoricienëve gjermanë. Të dy disiplinat i drejtohen studimit të muzeut nga dy kënde të ndryshme: muzeologjia merret me institucionin e muzeut nga pikëpamja teorike -historike dhe është pra e interesuar në kërkimin e kuptimeve dhe në esencën e muzeut; muzeografia, përkundrazi, është e lidhur më ngushtësisht me fushën operative-



arkitekture, e kështu, futet në studimin analitik-përshkrues<sup>\*)</sup>. Sikurse dihet, muzeu si institucion ka lindur mbi bazën e një tradite të hershme të koleksionizmit të objekteve të vjetra me vlera artistike e kurioze. Megjithë varfërinë dhe prapambetjen e përgjithëshme në masën e popullit tonë, në qytete të ndryshme të Shqipërisë, si në Shkodër, Krujë, Tiranë, Elbasan, Berat, Vlorë, Korçë, etj. ka ekzistuar prej kohësh kjo traditë e vyer e koleksionimit. Kryesisht familjet e pasura si dhe njerëzit e kulturuar mblidhnin, ekspozonin dhe trashëgonin koleksione të ndryshme e të çmuara të importit apo të punuara në vend, si stoli e sende prej ari e argjendi, servise porcelanesh, kostume tradicionale, armë të ndryshme të zbukuruara. Kështu mund të përmendim koleksionet e familjes Toptani (Tiranë), të familjes Vlora (Vlorë), të familjes Curani (Shkodër). Por historia e lindjes dhe zhvillimit të muzeumeve në Shqipëri është e lidhur ngusht me zbulimet arkeologjike të kryera nga misionet arkeologjike franceze e italiane që pas Kongresit të Lushnjës.

Duke u bazuar në një monografi të T. Selenicës, mësojmë se “*Qeveria shqiptare, duke marrë parasysht se vendi ynë në gjirin e tij përmban thesare të paçmuara të vjetërsinave historike, më 1922 ngrehu dhe një Muze Kombëtar këtu në Tiranë dhe për rregullimin e tij, solli profesorë me famë, si Dr. Karl Patsh, i cili në pak kohë e pasuroi muzenë nacionale me vepra historike të gjetura aty-këtu dhe sidomos me ato që u gjetën në Durrës. Vendet që janë bërë gërmime arkeologjike deri më sot, janë Durrësi, Pojani e Feniku. Objektet e gjetura atje do të begatojnë Muzeumin Kombëtar, i cili, kur të pasurohet me të gjitha këto vjetërsina, do të jetë një nga muzeumet më me rëndësi të botës.*”<sup>\*\*)</sup>

Po nga ky burim informohemi se “*Arkeologu francez L. Rei përshëndet iniciativën e z. Ahmed Dakliut, Kryetar Bashkie në Durrës, që diji të trajtojë një koleksion të randsishëm qeramikash që u mblodhën gjatë punimeve të sipërprmenduna tash disa vjet për ndërtimin e kanaleve të reja. Mbas vitit 1924, kur Misioni francez filloi hulumtimet ma të para në Apoloni, pasi kryhej çdo rend punimesh, i ngarkuemi i Misionit përbate një inventar vjetërsinash të mblidhuna. Këta u barshin në Bashkinë e Fierit. Arkët që përmbajshin sendet, renditeshin brenda një saloni të katit përdhës, ndërsa truporet e mermerta ngreheshin dosido për mur. Disa kapitela, copa arkitektonike, disa relieva, epitafe e shumë mbishkrime shtriheshin mbarë e mbrapsht mbi tokë. ...Bashkia e Vlonës, nën veprimin e kryetarit të saj, z.*

\*) Wikipedia, zëri “Museum”

\*\*) T. Selenica, *Shqipëria më 1927*, Tiranë, 1928. f.CLIX

*Asllani, qysh në verë të vitit 1936 muer pronësimin mbi shpinë e atdhetarit I. K. Vlorës, qi gjindet mbi limà, pak metra larg vendit të zbarkimit...Me 8 tetuer 1936 qe inaugurue (aty) muzeu arkeologjik e historik, në prani të shumë delegatëve të qeverisë shqiptare e të z. Luigj Mercier-it, ministër i Francës.Në dy salonet e katit përdhes janë vu truporet që stolisin stoa-n e Apolonisë, basorelievin, kapitelat, mbishkrimet. Sallat e katit të parë qenë caktuar vetëm për enë, figurina, trupore e objekte bronzi, të ndara sipas epokave....<sup>(\*)</sup>.*

*Pas luftës II bot., me themelimin e institutit të studimeve albanologjike, merren masa për ngritjen e disa muzeve në Tiranë e në qytetet e tjera të vendit, duke filluar nga Shkodra. Puna nisi me grumbullimin e objekteve muzeale, kryesisht atyre arkeologjike, të shpërngarë në vende të ndryshme e që i kishin shpëtuar grabitjeve. Si rrjedhim edhe i ekspeditave arkeologjike në Durrës e Pojan, më 7 nëntor 1948 u hap Muzeumi Arkeologjik-Etnografik. Muze të tjera iu shtuan më pas Tiranës si kushtuar Luftës Nacional-çlirimtare, Muzeu Lenin –Stalin (1957), ai i Shkencave të Natyrës.Gjatë viteve në vazhdim u ngrit nëpër krahina e qytete të ndryshëm të vendit një rrjet shumë i gjërë muzesh e shtëpishë muze, me profile të ndryshme, që u kushtoheshin ngjarjeve, patriotëve, heronjve të luftës etj. Më 9 korrik të 1953 hapet në Tiranë ekspozita e re arkeologjike-etnografike, sipas modelit të muzeumeve të Bashkimit Sovjetik<sup>\*\*</sup>.*

*Në “Buletini i Muzeumeve” të ministrisë se Arsimit dhe Kulturës të vitit 1965 është publikuar një rregullore e muzeve lokalë. Në dispozitat e përgjithëshme të të cilës thuhet: “Muzeumi lokal është një institucion shtetëror, shkencor dhe kulturor-arësimor, është vendi kryesor i ruajtjes së koleksioneve të monumenteve të luajtëshme të kulturës së krahinës. Në këtë rregullore shihet qartë qëllimi dhe strukturimi ideologjik e politik i këtij institucioni: “Muzeumi ka për qëllim edukimin komunist të punonjësve, rritjen e patriotizmit të masave dhe mobilizimin e tyre për plotësimin e detyrave ekonomiko-politike dhe për zgjidhjen e problemeve praktike të ndërtimit socialist të vendit”<sup>\*\*\*</sup>.*

*Sipas kësaj rregulloreje, Ministria përcaktonte edhe strukturën e muzeve lokale me skemën e sektorëve përkatës që ishin: 1-Sektori i natyrës (gjeologji, botanikë, zoologji), 2- Sektori i historisë dhe i*

<sup>\*</sup>) Adhami S., Muzeologjia shqiptare, Tiranë, 2002; Rei L., Një problem arkeologjik e Muzeu i Vlorës, H. Dritës, 1939, f. 466

<sup>\*\*</sup>) Adhami S., Zhvillimi i Muzeumeve në Shqipëri, Buletini i Muzeumeve, nr.1, Tiranë, 1964, f.38

<sup>\*\*\*</sup>) Buletini i Muzeumeve, Dokumenta dhe materiale, nr.2, Tiranë, 1965, f.44

etnografisë (prej kohës së lashtë deri më 1939), 3- Sektori i Luftës Nacional-Çlirimtare, 4- Sektori i periudhës së demokracisë popullore (prej çlirimit deri në ditët tona). Jashtë kësaj strukture, nëse ka koleksione të mjaftueshme, mund të krijohen në muze edhe dhoma të veçanta për pikturë, muzikë, letërsi etj.

Fillimi i viteve '90 solli ndryshimin e sistemit politik në Shqipëri, nga diktatura në demokraci, që patjetër do të reflektonin edhe në përmbajtjen dhe strukturën muzeale të vendit, duke iu përshtatur realitetit të ri ekonomik e politik. Ky kalim i menjëhershëm nga sistemi i centralizuar i shtetit ideologjik e të mbyllur në atë të hapur e të decentralizuar të ekonomisë së tregut pati për pasojë dëmtimin e rëndë të rrjetit muzeal të mëparshëm dhe mjaft humbje për kulturën tonë materiale. Por edhe më pas, gjatë viteve që ndoqën tranzicionin, fusha e kulturës në përgjithësi, e ajo muzeale veçanërisht nuk përbënte prioritet në reformat e ndërmarra nga shteti.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të Kushtetutës më 04.05.2005 miratoi ligjin "për Muzetë" në dispozitat e përgjithshme të të cilit thuhet: *"Ky ligj përcakton rregullat bazë për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe klasifikimit të muzeve në Republikën e Shqipërisë si dhe organet përgjegjëse për mbikqyrjen e veprimtarive të tyre në shërbim të shoqërisë, me qëllim ekspozimin, ruajtjen dhe administrimin e objekteve muzeale, pjesë të pasurisë së trashëgimisë kulturore kombëtare".* Qëllimi i këtij ligji, - thuhet më tej - është ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore muzeore kombëtare. Në zbatim të këtij ligji, termi "Muze" ka kuptimin e institucionit të ruajtjes së kujtesës, të ngjarjeve e dëshmimeve të shkruara e materiale të njeriut dhe të zhvillimit të shoqërisë, që ndërmerr kërkime, administron, ruan dhe ekspozon pasuritë muzeore, për qëllime studimi, edukuese dhe argëtuese, në shërbim e i hapur ndaj publikut." Vitet që pasuan kuadrin e ri ligjor filloi ringritja dhe riorganizimi i disa muzeve tashmë mbi një bazë të re konceptuale të përafrueshme me modelet perëndimore, si më përmbajtje ashtu edhe në formë. Në kuadrin e integritimeve rajonale erdhi gjithnjë duke u shtuar bashkëpunimi me institucione simotra e organizata të tjera nga vende të ndryshme të Europës e të rajonit tonë. Kështu u hapën disa muze të mbyllura më parë, por edhe në muzetë që qëndruan pësuan ndryshime sidomos në konservimin e objekteve muzeale, skedimin e dixhitalizimin e tyre sipas standarteve europiane. Gjithashtu u shtuan shumë format bashkëkohore të promovimit të vlerave të trashëgimisë kulturore.

Ngritja e Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurisë Kulturore (QKIPK) ka ndikuar pozitivisht në mbrojtjen, administrimin dhe promovimin e vlerave muzeale kombëtare.

Muzetë gjithnjë e më shumë po integrohen në ekonominë e tregut, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në rritjen e turizmit në përgjithësi e të atij kulturor në veçanti.

## Kreu I

### Fillesat muzeore në qytetin e Shkodrës

**Koleksionet private :** Në kronikat e shtypin të Shkodrës të vitit 1918 shkruhet për hapjen e një ekspozite antikuaresh me nismën e Përlimtares (Bashkisë) dhe hidhet ideja e një Muzeu kombëtar, duke shpresuar tek qytetarët që disponojnë vlera muzeale dhe tek inteligjenca e qytetit. Nën titullin “Ekspozicion jetikësh (kupto sende, objekte përdorimi) në Përlimtare të Shkoders” shkruhet: *“...Përlimtares së Shkoders i erdh një mendim fort i bukur, me çilë një ekspozicion sendesh jetike ase të vjetra, qi të munden me u gjetë ndermjet t’gjytetasve të Shkodrës. Ekspozicioni ka me kenë gati per neser-19 të k.m. Na, qi kemi pasë rasë me e pa at ekspozicjon, me vu n’oroë sendet e mënyrën e bukur me të cillen janë rreshtue, munden me thanë per sugure, se ekspozicjoni ka me kenë pëlqye prej gjithkuj. Ka sende mrend përnjimend shumë t’interesantshme e qi, muzejtë e Europës kishin me i pague shtrejt fort., per me i ba të vetat. Aty ka petka të punueme për bukuri- mjaft me thanë vesha e Bibë Pashës, armë të vjetra të ngrime e të prarueme, enë sermit e arit të punueme me mjeshtri të madhe: Sidomos bijnë m’ sy një legen i vjetër e fort i kushtueshem i Prenk Pashës e dy çinija sermit të një zotnis tjetër Shkodret, qi dikuer kishin pasë kenë të sarajit t’Abdyl Hamidit; piktura të vjetra, një dorshkrim arabisht i hershem me vinjete e minjature, e mandej ka do rafta krejt t’intarsjuem me zadef, zarfa filxhanash të punuem për bukuri, saxhade, halija etj. etj. Kto sende t’kushtueshme në vedvedi, të rreshtueme ashtu s’bashkut, me mjeshtri, bajnë për njimend një përshtypje fort të kandshme. Prandaj kishte me u dishrue prej të gjith shqyptarëoet të meçëm qi ky ekspozicion të shifet prej sa më shumë qytetasoet e jo vetëm për qëllim bamirësijet...por qi t’mësohet syni i popullit me u kn dell në të pam të ktyne sendevet e kshtu të njallet në të dishiri qi me pa sa ma parë në Shqypni një Muzeum Kombtar. Për krah të një komisjonit letrar tash, në kohë lufte, për t’mledhunit e visarit komtar nder shkrime, kangë e prralla,*

*kishte me ndejë fort mirë edhe një muzeum për të rujtun të visarit komtar ndër sende jetike arit, sermit etj., prej të cilavetshifet historija e shpirti i popullit t'onë. Por për me u ndërtue ndoj send në popull, kishte me u dashtë qi populli vetë t'a kuptojë nevojën e atij send, pse kshtu bahet ma mirë e rrron ma shum. Na kande me shpnesue se zotnit e inteligencja e Shkoders kan me i marrë në kujdes kto dy qëllime të naltueshme t'ekspozicionit të Perlintares së Shkoders e se prandaj me shumicë kan me shkue me e pa"\*)*.

Në traditën qytetare koleksionimi ka rrënjë të thella që tresin në mjegullat e kohës. Organet e shtypit në Shkodër që herët, por sidomos i viteve '20-30 të periudhës mbretërore tërhiqte vëmendjen e institucioneve të shtetit dhe sensibilizonte shoqërinë për rëndësinë e "vjetërsinave" (objekteve muzeale) dhe nevojën e ngritjes së muzeve. Në një artikull të botuar në revistën LEKA të vitit 1933 lexojmë: "Muzejt shqiptarë duhet që të mbledhin direkt prej popullit visarin e vet edhe ta zbulojnë me anë të puntorvet të ditunis, me përhap të njoftunt mbi popull të vet, edhe me ruejt, me edukue edhe me perfekcionue kulturen e vet shpijake. Koha e kalueme etnike e shqiptarvet formon pjesën e bazës së kërkimeve etnologe të popujtoet tjerë në Gadishullin Ballkanik. Nga kta, përparimi i muzejtoet shqyptarë ka me kenë pa dyshim me randsi të madhe shkencore, jo vetun per shqyptarë e kufitarë të tyre, por edhe per mbarë boten e kulturueme." Po nga shtypi mësojmë se ky pasion erdhi vazhdimisht duke u rritur dhe numri i koleksionistëve dhe larmia e përmbajtjes së koleksioneve në periudhën mbretërore arriti nivelin më të lartë. Një vend të veçantë zinin filatelistët, të cilët qenë dhe shumë aktivë në ekspozita e konkurse ndërkombëtare, duke fituar edhe çmime. Kështu p.sh.: në ekspozitën filatelike ndërkombëtare të Vjenës të vitit 1933, Zef Prendushi fitoi medaljen e argjendtë për një koleksion të pullave të Shqipnisë\*\*).

## **Muzetë e Kishës Katolike:**

**1. Muzeu i Kolegjit "Saverian":** Etënt Jezuitë të Provincës së Venetos që u vendosën në Shkodër nga mesi i shek.19 dhe themeluan Kolegjin Saverian që herët filluan të interesoheshin për historinë e Shqipërisë. Ishte Padër Karlo Vasiliko qe i pari që nisi të gjurmonte nëpër arkivat e huaja dokumenta mbi Shqipërinë dhe të koleksiononte materiale të shumta nga terreni shqiptar. Këto dokumenta e koleksione shërbyen si bazë e një biblioteke dhe e një muzeu të mëvonshëm me prioritet arkeologjinë dhe numizmatikën(1882) në shërbim

\*) Gazeta "Posta e Shqypnis", n, 44. Shkodër, dt.18.5.1918, f.4

\*\*) Revista "LEKA", Kronikë, nr.8, Shkodër. 1933,, f. 179, f. 269

kryesisht të nxënësve të atij Kolegji\*).

Më 1924 arkeologu italian Luigji Ugolini, që pati rastin ta vizitojë këtë “Muze Historik-geologjik të Etënve Jezuitë” e përshkruan me këto fjalë:” Këto Etën, duke qenë të pasionuar pas çdo forme të kulturës, kanë ekspozuar në sallat e Kolegjit gjithshka që është gjetur prej tyre në tokën shqiptare e që vlen për t’u konservuar. Dhe kështu kanë mbledhur ekzemplarë të faunës e të florës shqiptare, përveç një numri të madh fosilesh e mineralesh. Nuk mungon gjithashtu ajo, e cila më ka lënë mbresa më shumë, - koleksioni arkeologjik”. Ndërmjet objekteve arkeologjike Ugolini merr në analizë disa prej atyre më të rëndësishmit: Një figurinë prej kocke që paraqet një Eros me duar pas shpine të ardhur nga Durrësi; një figurinë prej terrakote po prej Durrësi; një seri e madhe objektesh të ardhura nga varreza e Komanit, të cilat ai i analizon një për një, etj. Në këtë sektor bënte pjesë edhe një koleksion numizmatik prej rreth 1000 monedhash, të cilat qenë ekspozuar të klasifikuara në greke, romake, bizantine, serbe, veneciane, të Balshajve, të qyteteve shqiptare të mesjetës, etj. Ndër më interesantet ishin 33 monedha autonome të këtyre të fundit.

Muzeu kishte edhe objekte etnografike të traditës shqiptare të punuara në dru, tekstile etj. si dhe plot objekte të të ardhura nga vende e kultura të huaja\*\*).

**2. Muzeu i Franceskanëve:** Sikurse del nga burimet e kohës, Shtjefën Gjeçovi filloi t’i vizitonte t’i gjurmonte monumentet arkeologjike që në vitin 1902 (Laç, Troshan, Koman, Shtoj, etj.). Kështu ai krijoi për herë të parë koleksionin e tij me gjetje arkeologjike gjatë qëndrimit të tij për 8 vjet (1907-1915) në fshatin e Gomsiqes, ku shërbeu si famullitar. Ai mundi të zbulonte me duart e tij e të mblidhte një koleksion të çmuar objektesh arkeologjike, të cilin e ruante me kujdes e dashuri të madhe në qelën e vet, duke habitur vizitorët. Njëri prej tyre shkruante: *“Në katin e sipërm të banesës së tij, përmbi një tryezë të madhe ishin shtruar një tok vjetersinash të zbuluara e të mblledhura një nga një me një fatbardhësi të rrallë dhe me një shije të mbaruar nga vetë dora e Gjeçovit”*. Në vitet ’20 të shekullit të kaluar, në Romë u hap një ekspozitë arkeologjike, ku u dërgua edhe koleksioni i Gjeçovit.


\*) Cordignano F., Valentini G., Saggio di un Regesto Storico dell’Albania, Scutari, 1939, f. 3

\*\*) Ugolini L., Albania antica, v.I, Romë, 1927, f.17; Bushati H., Shkodra dhe Motet, II, Shkodër, 1999, f.105

Delegati i Gjermanisë, duke parë këtë koleksion, tha: *“Me këto vjetërsira Gjermania mund të paguajë një kësht të madh të borxheve të luftës”*. Në koleksionin e tij kishte çekanë prej guri të kohës neolitike, sëpata bronzi të tipeve “shqiptaro-dalmate” e “shkodrane”, përkrenare ilire, armë e sëpata prej hekuri, të periudhës romake, monedha, enë qeramike etj. Gjata kohës së qëndrimit të tij në Troshan të Lezhës, ai dërgoi për botim shkrimin *“Një argtim arkeologjik”*, në të cilin trajton rëndësinë e shkencës arkeologjike (vjetërsorës, siç e quante ai) metodat e gërmimit e të studimit si dhe kujdesin që duhet treguar nga shoqëria dhe shteti për monumentet e gjetjet arkeologjike. Ai e vlerësonte arkeologjinë si mjet i pazëvendësueshëm për të zbuluar historinë e lashtë të shqiptarëve e të atdheut të tyre. Gjeçovi theksonte se visari ynë, historia jonë gjendet e mbuluar nën dhe, se mbi këtë visar mbështetet jeta e kombit; një komb që s’ka histori të vetën, konsiderohet i vdekur. Që këndej ai shtron detyrën e zbulimit e të studimit të kësaj historie nga vetë shqiptarët. Ai u mëson bashkëatdhetarëve të vet mënyrën e nxjerrjes në dritë, të mbledhjes e të ruajtjes së objekteve arkeologjike, duke theksuar se jo vetëm sendet e arta e të argjendta, por edhe ato prej hekuri ose bakri kanë vlerë historike, bile nganjëherë vlerë edhe më të madhe. *“Të mos i hedhim tej ato sende që nuk na e mbushin mendjen, - shkruan Gjeçovi, - vetëm nga fakti se ato janë prej hekuri apo bakri...”*. Sh. Gjeçovi ngre me të madhe problemin e mbrojtjes së vlerave arkeologjike nga grabitja në masë që filloi t’u bëhet atyre nga të huajt. Ai shkruan më tej: *“Çe sekam fillue me shijue kët degë, sa të argtueshme aq e ma të çmueshme, zemra më ka pasë lengue kah shifshë se shiteshin për çmime aq të poshtra visare kombëtare”*.

Arkeologu italian L.Ugolini e çmon shumë kontributin e Sh. Gjeçovit si për gjurmimin në terren të monumenteve arkeologjike, ashtu edhe për sistemimin e ekspozimin me kujdes e shije në banesën ku jetonte e studjonte. Në veprën e tij, Albania Antica, ai jep këtë konsideratë: *“Koleksioni i Padër Shtjefnit, megjithëse nuk është shumë i madh në numër, ai është shumë i rëndësishëm, qoftë për cilësinë e objekteve që ruan, qoftë sepse në shumë raste, këto përbëjnë shembujt e vetëm të këtij lloji që kam parë e së fundi, qoftë se sigurisht ato vijnë nga terreni shqiptar”*. Në vazhdim autori bën përshkrimin analitik shkencor, objekt për objekt, duke dhënë edhe konkluzionet e tij rreth funksionit, datimit e kulturës, të cilës i përkasin. Me shumë vlerë për prehistorinë janë litikët e sëpatat e tipit shkodrane prej bakri. Po ashtu disa vazo prej qeramike të periudhës helenistike e

asaj romake. Ndërmjet objekteve ka një numër të konsiderueshëm që i përkasin kulturës arbërore (kultura e Komanit), si vegla pune e armë prej hekuri (sëpata, shigjeta etj, stoli prej bronzi, argjendi e qelqi, fibula, byzilykë, vathë, varëse, unaza, gjerdanë etj.)<sup>\*)</sup>.



*At Sh. Gjeçov – muzeograf Padër Gj. Fishta në muzeun franceskan*

### **Muzetë shtetëror**

**1. Muzeu Popullor:** Përprojekta e parë për ngritjen e Muzeut të rrethit të Shkodrës filloi më 11 nëntor të vitit 1947, në shtëpinë e Beb Muzhanit, një shtëpi e shtetëzuar me vlera të veçanta arkitekturore dhe etnografike. Ajo nisi me depozitimin aty të një pjese të fondeve muzeale të Kuvendit Jezuit dhe atij Françeskan të Shkodrës, të sekuestruara nga regjimi komunist i asaj kohe (pjesa kryesore e objekteve muzeale u dërgua në Tiranë për Muzeun Arkeologjik-Etnografik). Objektet e këtyre fondeve (rreth 700 objekte) iu besuan qytetarit Cin Suma, i ngarkuar si përgjegjës i këtij fondi, i cili u pasurua edhe me objekte të tjera të koleksioneve private, gjithashtu të sekuestruara disa familjeve qytetare.

Disa muaj më vonë, pikërisht në gusht të 1948-ës, fondi u transferua në një tjetër ndërtesë karakteristike në qendër të qytetit, në atë të anglezit Paget ngjitur me kullën e Sahatit, duke i kaluar gjithë inventaret në ngarkim të punonjësit Ndoc Gashi.

<sup>\*)</sup> Mata R., Shtjefën Gjeçov, jeta dhe veprat, Tiranë, 1982, f.61; Ugolini L., Albania antica, v.I, Romë, 1927, f.17; Ugolini L., Albania antica, v.I, Romë, 1927, f.17





*Shtëpia e Muzhanëve*



*Shtëpia e "inglizit Paget"*


Për konsolidimin e mëtejshëm të këtij institucioni, më 20 gusht të vitit 1948 me vendim të pushtetit lokal, ngrihet një komision i përbërë prej nëntë vetësh, ndër të cilët: Avdullah Gjeçaj (kryetar), Ndoc Gashi (nënkryetar), Muhamet Uruçi, Hamid Beqja, Vladimir Jani, Petrit Velaj, Feti Bilali, Lec Fishta e Haki Llazani (anëtarë). Mbledhja e parë e mbajtur me procesverbal i përket datës 11 shkurt të vitit 1949 me prezencën e komisionit, ku përcaktohet rregullorja e Muzeut dhe bashkëpuntorët e tij. Si specialistë të fushës së muzeografisë (kustodë) u thirrën studjuesit e njohur shkodranë, Marin Sirdani dhe Ndoc Kamësi (për aspektin arkeologjik e historik), Gjush Sheldija, Bajram Tellalli e Jakup Sokoli (për aspektin etnografik e atë folklorik). Ata do të merreshin me sistemimin e fondeve, regjistrimin e objekteve dhe alestimin e sallave ekspozuese. Me datën 18 mars 1949 u caktua Drejtori i parë i Muzeut, Gjush Sheldija, i cili pas disa ditësh mori në dorëzim inventarin fizik të Muzeut nga përgjegjësi i deriatëhershëm Ndoc Gashi.

Në Arkivin e Muzeu ruhet ende procesverbali i dorëzimit, i përbërë prej 16 fletësh, në listat e së cilës përfshihen 2764 objekte muzeale të të gjitha llojeve.

Me masat organizative që mori komisioni i mësipërm, Muzeu u hap në lokale ri (shtëpia e Lordit Paget), pikërisht më 4 prill të vitit 1949. Kjo mund të merret si datë e themelimit të Muzeut, si institucion kulturor publik. Ai do të përbëhej nga salla e arkeologjisë, salla e etnografisë dhe salla e shkencave të natyrës.

Në vitin e parë të ekzistencës së tij, Muzeu u vizitua nga rreth 9000 vizitorë, nxënës shkollash, banorë të Shkodrës dhe vizitorë nga i gjithë vendi. Pak kohë më vonë Muzeu u pasurua edhe me sektorin e pinakotekës, e cila përmbante vepra të piktorëve shkodranë e

të huaj dhe atë të luftës Nacional-Çlirimtare. Duke filluar nga kjo kohë fondet muzeale erdhën gjithnjë duke u rritur, qoftë përmes dhurimeve, qoftë përmes blerjeve, qoftë përmes gjetjeve të rastit gjatë punimeve të ndryshme nëntoksore e më pas gërmimeve arkeologjike.





**Viti 1949 - Proccs-verbal dorëzimi  
Liste dhurimeshProjekt-buxheti**

Megjithë punën e bërë kishte ende plot boshllëqe në pasqyrimin e vazhdimësisë historike përmes ekspozateve. Sektori i historisë përfaqësohej vetëm përmes objekteve arkeologjike që përfshinin periudhën ilire helenistike e romake, ndërsa periudha e mesjetës, ajo e Rilindjes kombëtare, e Pavarësisë dhe e shtetit shqiptar deri më 1939 nuk pasqyrohej. Kështu, paraqitej nevoja e domosdoshme e një rikonstruksioni të përgjithshëm të Muzeut, i cili përfundoi më 8 nëntor të vitit 1953. Këtij rikonstruksioni i shërbeu eksperiencia sovjetike, si në konceptim, ashtu edhe në mënyrën e alestitimit të objekteve

muzeale. Përveç plotësimi të boshllëqeve të mësipërme, u shtuan edhe komponentë të tjerë nga pasuritë natyrore lokale, si mineralogjia, flora e fauna etj. Një aspekt tjetër, që u plotësua përmes ekspozateve, ishte edhe ai i ndërtimit socialist, me prodhimet bujqësore, industriale e artizanale nga qyteti e rrethi i Shkodrës. Kështu pas kësaj ndërhyrjeje Muzeu popullor ka këtë skemë: 1-Sektori i natyrës, 2-Sektori i historisë, 3- Sektori i etnografisë, 4- Sektori i “demokracisë popullore”, 5- Sektori i pinakotekës.

Në dokumentat e kohës gjejmë këtë përshkrim: *“Ekspozita e Muzeut Popullor të Shkodrës fillon me sallën e hymjes. Këtu paraqitet në mes harta e Shqipnisë në relief dhe përposhtë sajë saksu me lule, që pa dashtë, të bajnë me i kujtue fjalët e mikut më të shtrejtë të popullit tonë “Shqipnia do të bahet një kopsht i lulzuem”.* Anash portës janë: Maketi i kalasë së Shkodrës “Rozafat” që simbolizon të kaluemen e lavdishme të qytetit të Shkodrës dhe maketi i Uzinës së Fermentimit “Vasil Shanto”, që paraqet të sotmen e shkëlqyeshme socialiste...” Në vitin 1962, me rastin e 50 vjetorit të pavarësisë kombëtare, Muzeu përgatiti një ekspozitë të vecantë, kushtuar asaj ngjarjeje, e cila shërbeu si bazë për pasurimin e mëtejshëm të Muzeut për këtë periudhë të rëndësishme historike\*).



### *Relacion mbi punën e bërë dhe nevojat*

\*) Arkivi i Muzeut Historik të Shkodrës, Dosja “Historiku i Muzeve të Shkodrës, dok. Nr.10-24; Llazari V., Muzeu Popullor, Shkodra 61 (almanak), Shkodër, 1961, f.252



*Ekspozite muzeore (viti 1949)*

Në vitin 1971 Muzeu i nënshtrohet një rikonstruktimi të përgjithshëm në formë e në përmbajtje. Tashmë Muzeu ndryshon karakterin e tij nga muze natyror-historik në muze të mirëfilltë historik. Fond i objekteve natyrore që prezantonin vlerat e Qarkut të Shkodrës në fushën e mineralogjisë, të florës e të faunës i kalojnë I.L. Pedagogjik (sot Universiteti L. Gurakuqi), duke i dhënë një frymëmarrje më të gjërë sektorëve të tjerë. Muzeu tashmë përbëhet prej këtyre sektorëve:

*1. Sektori i Arkeologjisë. 2. Sektori i Historisë 3. Sektori i etnografisë.*

Sektori i Arkeologjisë tashmë është pasuruar me objekte të tjera që vijnë kryesisht nga gërmimet e Gajtanit, të Shtojit, të Kalldrunit etj. si dhe nga gjetje të tjera të rastit nga punime bujqësore, mbrojtëse etj. Ekspozita permanente vendoset në një sallë të madhe të katit përdhës. Përzgjedhja e artefakteve, sistemimi, datimi e përshkrimi i tyre si dhe tekstet, hartat, skicat etj. realizohen me punën e kujdesshme të personelit të muzeut e me kontributin e drejtpërdrejtë të arkeologut të shquar të Qendrës Arkeologjike të Tiranës, Prof. Frano Prendit, si specialist i fushës. Ekspozita fillonte me epokën e Neolitit dhe vazhdonte me periudhën e metaleve, atë helenistike-romake, mesjetën e hershme e atë të mesme. Ndërsa për alestimin e tyre në një formë të re dhe më të përshtatëshme qoftë për objektin ashtu edhe për vizitorin punuan dekoratorët F. Ashiku e P. Bedeni.

Muzeu Popullor i qytetit të Shkodrës ka arritur përgjatë këtyre viteve të tërheqë një numër të konsiderueshëm bashkëpunëtorësh të fushave të ndryshme të trashëgimisë kulturore. Kjo ka sjellë disa rezultate të mira edhe në fushën e promovimit të kësaj trashëgimie tek njerëzit. Janë organizuar veprimtari të mirëfillta komemorativë, hulumtuese e botuese, si data përkujtimore, simpoziume, konferenca shkencore etj. Duke filluar nga viti 1970, Muzeu arriti të botojë revistën e vet periodike nën titullin "Kumtari", (katër numëra me studime nga fusha e arkeologjisë, etnografisë, historisë,

memorialistikës, filatelistë, artit etj.)

Gjatë viteve '70 e në vazhdim, sipas urdhërave e porosive që vinib nga lart, Muzeu Popullor i Shkodrës, me punonjësit e vet, ka ndihmuar në mënyrë efektive në ngritjen e një rrjeti të gjërë muzesh të vegjël nëpër ndërmarrjet e shkollat e qytetit si dhe nëpër fshatra. Në përgjithësi ato ishin muze modeste, por, ndërmjet tyre, sidomos ato të qëndrave të zonave rurale e të disa fshatrave, ishin me të vërtetë mjaft dinjitoz, veçanërisht për vlerave muzeale arkeologjike e etnografike që kishin arritur të grumbullonin e të ekspozonin. Kështu duhet përmendur muzeu i arsimit në qytetin e Shkodrës, Muzeu i Shkollës së Mesme "29 Nëntori", Muzeu i fshatrave të Bërdicës, Mjedës, Dedajve, Drishtit, Koplikut etj.

Në vitin 1979, mbi bazën e një dokumentacioni të pasur dokumentar bëhet riorganizimi i periudhës së Rilindjes kombëtare në Muzeun Popullor të Shkodrës, i cili merr një pamje të re e bëhet më e pasur në një përmbajtje. Një punë e mirë bëhet nga bashkëpunatori Luigj Franja për sistemimin e skedimin e arkivit dokumentar.

Gjatë viteve '80 Muzeu kryen një veprimtari intensive promociionale përmes ekspozitave të përkohshme, takimeve përkujtimore e botimit të broshurave me tematika të ndryshme, gjithnjë në përgjigje të urdhërave, udhëzimeve e porosive që vinin nga organet eprorë.

Megjithëse personeli i Muzeut kishte një numër shumë të kufizuar të personelit, arriti të afronte pranë vetes bashkëpunëtorë të shumtë të pasionuar, që kontribuan shumë në gjallërimin e jetëskulturore-promovuese të këtij institucioni. Gjatë këtyre viteve u organizuan takime përkujtimore e konferenca shkencore kushtuar ngjarjeve e personaliteteve të ndryshme të historisë e kulturës lokale e kombëtare, por gjithnjë nën kontekstin e politikave kulturore e propagandistike të regjimit<sup>\*)</sup>.

**2.Shtëpia - muze e "Tre Heronjve":** Në vitin 1950 në shtëpinë e Jordan Misjes, ku ai bashkë me dy shokët e tij, Perlat Rexhepi e Branko Kadia, pas një rezistence heroike, qenë vrarë nga fashistët italianë, u ngrit shtëpia-muze e quajtur "e tre Heronjve". Kjo shtëpi përdhese, e restauruar pas dëgjies që kishte pësuar, qe mobiluar e përshtatur në interierin e saj. Në vitin 1957 shtëpia-muze ristrukturohet e pasurohet më tej. Një vend të rëndësishëm në hapësirat ekspozuese zinin pikturat

\*) Arkivi i Muzeut Historik të Shkodrës, Dosja "Historiku i Muzeve të Shkodrës, dok. Nr.10-24; Llazarri V., Muzeu Popullor, Shkodra 61 (almanak), Shkodër, 1961

e heroit Jordan Misja. Në eksterieret ekspozohen armë e municione të kohës, fotografi, dokumenta, relikte etj. që krijojnë atmosferën e atij episodi të rezistencës antifashiste. Shtëpia-muze vjen e riorganizohet e pasurohet për herë të dytë në vitin 1987, ku vendoset dhe maketi i shtëpisë së shkatërruar menjëherë pas ngjarjes, ndërsa sistemohet oborri i banesës, në të cilin vendosen bustet e tre heronjve, vepër e skulptorit F. Kola\*).

**3. Shtëpia-muze e Migjenit:** Në vitin 1961 në qytetin e Shkodrës u përurua Shtëpia-muze kushtuar jetës dhe veprimtarisë krijuese të poetit të shquar, Millosh Gjergj Nikollës (Migjeni). Ajo u ngrit në një shtëpi dykateshe, në qendër të qytetit, fare pranë banesës përdhese ku pati lindur Poeti, por që ishte prishur më 1940 për zgjerim rruge.

Me grumbullimin dhe sistemimin e materialeve u muar një komision i posaçëm specialistësh. Për pasurimin e përmbajtjes së muzeut një kontribut të vyer dhanë miqtë e shokët e Poetit, me kujtime, dorëshkrime, fotografi e korespondencë autentike. Natyrisht reликтet më të shtrenjta i solli motra e Poetit, Ollga dhe Skënder Luarasi.

Aty ruheshin relikte të përdorura nga Migjeni. Fotografi të shumta paraqesin Poetin në shkollën fillore, në Manastir, mësues në Vrakë e në Pukë, në Shkodër. Ruheshin gjithashtu dhe dorëshkrimet e tij. Më 1974 fondit iu shtuan edhe objekte të tjera muzeale, ndër të cilat dhe disa relikte të dhuruara nga motra tjetër e tij, Jovanka. Më 1988 shtëpia i është nënshtruar një rikonstruktimi të plotë. Një cikël grafikash të autorit P. Mele që pasqyronin veprimtarinë poetike të Migjenit. Gjithashtu në një nga sallat ekspozuese, përveç krijimeve të Poetit qenë afishuan një seri monografish e krijimesh të autorëve të ndryshëm rreth tij.

I gjithë materiali i ekspozuar dhe ai i ruajtur në fondin e depozituar ishte i inventarizuar dhe për secilin objekt muzeal që krijuar një kartelë e posaçme. Përveç "librit të përshtypjeve", Shtëpia-muze regjistron e një regjistër të veçantë grupet e vizitorëve me këto shënime: nr.renduer, emri i shkollës, ndërmarrjes a institucionit, vendi nga vjen, nr.i pjestarëve, firma e udhëheqësit të grupit. Një tjetër regjistër i ngjashëm për delegacionet e grupet e vizitorëve të huaj\*\*).

\*) Po aty.

\*\*) Dizdari R., Në Shtëpinë-muze të Migjenit, Shkodër, Buletini i Muzeumeve, nr.1, 1964, f.50



**4. Shtëpia- muze e Luigj Gurakuqit:** Vendimi për ngritjen e Shtëpisë – muze kushtuar atdhetarit Luigj Gurakuqi (Hero i Popullit) u muar më 1963, kurse përrurimi i tij u bë më 19 shkurt të vitit pasardhës. Gjatë gjithë procesit për ngritjen e Muzeut u aktivizua, përveç stafit, një numër i madh bashkëpunorësh, duke u ndarë në grupe pune me detyra të caktuara, sipas një platforme të ngritur më parë.

Muzeu u ngrit në shtëpinë ku lindi e jetoi ky personalitet i historisë e i kulturës sonë kombëtare kombëtare. Kjo shtëpi tipike shkodrane e mesit të shek.XIX ruante gjithashtu vlera të spikatura etnografike. Nga të afërm të Heroit u siguruan disa relikte e mobilje personale e të familjes. Krahas këtyre u ekspozua edhe epitafi i varrit të tij i sjellë nga Italia sëbashku me eshtrat e Heroit më 1957. Qytetari Gjon Kamësi, i njohur i Heroit, dhuroi shumë objekte personale që lidhen kryesisht me çastet e fundit të jetës së L. Gurakuqit. Personeli i Muzeut popullor dhe bashkëpunëtorët e tij arritën të siguronin plot materiale autentike e fotokopje që pasqyronin veprimtarinë e gjërë poliedrike të këtij atdhetari të shquar, si politikan, shtetar, mësues, krijues-poet etj.

Grupi i piktorëve, i përbërë nga Vladimir Jani, Gaspër Zojzi, Franc Ashiku e Valentin Kakarriqi realizuan alestimin e objekteve muzeale, duke i përshtatur me mjediset dhe objektet etnografike të banesës. Në dhomën e madhe (oda e miqve) u montua një oxhak i vjetër 150 vjeçar, i marrë nga shtëpia e Sumejve, pas prishjes së kësaj të fundit.

Muzeu kushtuar Heroit të popullit, L. Gurakuqi u vendos në dy dhoma, kurse dhoma e madhe e kuzhina u trajtuan në pikëpamje etnografike. Gjatë vitit të parë të qenies së tij Muzeu u vizitua nga një numër i madh vizitorësh (rreth 9 000 vetë, grupe e individë).

Në vitin 1973 u bë rikonstruksioni i parë i Shtëpisë-muze, punimet e të cilit i drejtoi punonjësi i Muzeut, studjuesi K. Ulqini. Përveç ndërtesës u bë një risistemim e pasurim i materialeve dokumentare. Një seri restaurimesh të pjesshme iu bënë banesës nga Atelieja e Monumenteve të Kulturës, duke filluar nga viti 1982 e në vazhdim. U bënë njëkohësisht ndryshime edhe në përmbajtjen e sistemimin e objekteve në interiere. Gjatë periudhës 1976 - 1988 muzeu është vizituar nga rreth 36 000 vizitorë\*).

**5. Fototeka “Marubi”:** Fototeka “Marubi” më e vjetra dhe më e pasura në vendin tonë por jo vetëm, zë fill në shtator të vitit 1970, kur Gegë Marubi mori iniciativën e i fali shtetit të gjithë negativat e

\*) Arkivi i MHSH, po aty.

ruajtura për më se një shekull nga studioja e familjes. Kjo inisiativë u përqaftua menjëherë edhe nga fotografë të tjerë shkodranë, si familja Pici, Jakova, Rraboshta e Nënshati. Materiali arkivor, i përbërë prej negativash në xham e në celuloid (filma) me vlera të jashtëzakonëshme, por dhe tepër delikat për sa i takon ruajtjes, u vendos në katin e dytë të një ndërtese katërkatëshe të shtetëzuar, të stilit italian të viteve '30, në qendër të qytetit të Shkodrës.

Menjëherë pas kalimit në pronësi të shtetit, u caktue dhe personeli që do të punonte pranë këtij arkivi fotografik, si për regjistrimin e sistemimin e fondeve ashtu edhe për shfrytëzimin e tyre në shumë plane të kërkimit shkencor, të edukimit me traditat. Në krye të punëve u emrua vetë mjeshtri Gegë Marubi i mbështetur nga një staf prej tre punonjësish: një arkivist (Semilha Osmani) dhe një fotograf-laborant (Muhamet Boriçi), më vonë edhe dy punonjëse të tjera, Fanko dhe J.Pici. Fototeka do të ishte nën vartësinë administrative të Muzeut popullor të Rrethit të Shkodrës. Para këtyre punonjësve arkivistë dilte si një detyrë e rëndësishme ngritja e këtij institucioni të ri mbi baza sa më shkencore të konservimit e restaurimit të negativëve si dhe shërbimit ndaj hulumtuesve, institucioneve dhe klientëve të tjerë. Për këtë qëllim u përgatitën raftet e përshtatëshme prej druri për sallën e fondeve dhe laboratorin me të gjitha paisjet teknike e preparatet e nevojshme për zhvillim-stampimin në bardh e zi të fotove të riprodhuara. Menjëherë filloi dhe procesi i inventarizimit të plotë në regjistra të rinj e paralelisht edhe evidentimi i shumë negativave, duke shfrytëzuar përvojën profesionale dhe njohjen e thellë të mjeshtrit të moshuar G. Marubit mbi qytetin e qytetarët e Shkodrës e të vendit. Më pas nisi dhe skedimi shkencor i tyre, një punë e mundimshme dhe e shtrirë në kohë, por që u arrit të realizohej në një shkallë të kënaqshme. Një kontribut të rëndësishëm dhanë gjatë atyre viteve dhe punonjës të tjerë të Muzeut popullor, nga i cili varej Fototeka si dhe specialistë të tjerë të jashtëm, veçanërisht në evidentimin e imazheve të panjohur dhe në procesin e skedimit shkencor. Ndërmjet tyre duhet përmendur etnografi shkodran, Prof. Dr. Kahreman Ulqini, i cili, si njohës i mirë i historisë dhe kulturës kombëtare ka dhënë një ndihmesë të vyer në evidentimin e e përmbajtjes së shumë negativave të vjetër dhe ngritjen e skedarit. Albumi "Gjurmë të historisë kombëtare në Fototekën e Shkodrës" përgatitur prej tij e botuar më 1982, është vepra më e arrirë e publikuar deri më sot mbi këtë arkivë.



Fondi, Mbrojtje Nr. 29, 857 Nr. origjinali Nr. i rubrikës	Kuba e ngjarjes Vendi i ngjarjes Origjinali ose riprodhimi Indeks
Titulli	
Tafa Boger	
Përpiluar nga: <i>J. Ohmani</i> Dt. 28.10.1986	

### Kartelë foto-negativi

Krahas fondeve të negativave fototeka disponon edhe plot fotoaparate, aksesore e paisje të tjera të studios "Marubi" e të studiove të tjera, të cilat ndiqnin hap pas hapi evolucionin e këtij arti magjik, një bazë e mirë për ngritjen e një muzeu të fotografisë. Kjo fototekë me karakter kombëtar si për nga përmbajtja ashtu edhe si shtrirje gjeografike, u vu në shërbim jo vetëm të studiuesve të fushave të ndryshme si historianëve, etnologëve, arkitektëve, urbanistëve, artistëve etj. Duke filluar nga viti 1858 me imazhet e para në xham me përmasat 30 x 40 cm. të realizuara në natyrë e më pas në studio (1885-1890), Pjetri e mbas tij dy vëllezërit Matija e Keli (Kodheli), fiksuan evenimente e personalitete të shumtë të rilindjes sonë kombëtare. Pas shpalljes së pavarësisë mjeshtri dhe atdhetari i shquar Kel Marubi vazhdoi përjetësimin e ngjarjeve e personazheve historikë, por tashmë, studio të tjera fotografike shfaqen njëra pas tjetrës, duke ecur në rrugën e mjeshtërve të parë, por secili me profilin e vet, ato të Shan Picit e Dedë Jakovës, e mbas tyre Rraboshta e Angjelin Nënshati. Përveç vlerave të mirëfillta historike kombëtare e lokale, imazhet e këtij arkivi kanë fiksuar arkitekturën, urbanistikën, kostumerinë tradicionale, pejsazhe e fenomene natyrore nga krahina e Shkodrës por edhe nga vise të tjera shqiptare. Fondet e Fototekës Marubi, përveç dimensionit kombëtar, kanë dhe një dimension rajonal, pasi aty ruhen me mijëra negativa të personaliteteve historikë të Europës e vendeve të rajonit si ministra, konsuj, gjeneralë e persona të tjerë të rëndësishëm. Një aspekt tjetër është ai i artit, i cili përfaqësohet nga një numër i madh imazhesh artistike që pasqyrojnë natyrën e mrekullueshme shqiptare, veçanërisht atë të alpeve të veriut<sup>\*)</sup>.

**6. Muzeu Ateist.** Në vitin 1973, në kuadër të luftës absurde, antihumane e antikombëtare "kundër besimeve fetare", në shtëpinë e shtetëzuar të familjes Doberdaku, përbri sheshit qëndror (Piacës) që

\*) Arkivi i MHSH.

hapur ky muze, unikal në llojin e vet. Në ballë të hollit që vendosur një citat i K. Marksit: "Feja është opium për popullin". Në dy katet e kësaj ndërtese të madhe, ku binin menjëherë në sy citatet e shumta të klasikëve marksistë dhe të E. Hoxhës, ishin ekspozuar objekte të shumta të sekuestruara nga institucionet e kultit (kishat e xhamitë) si dhe nga shtëpitë e qytetarëve. Nëpër stendat e varura në faqet e mureve dhe nëpër vitrina druri të mbuluara me xham objektet ishin renditur sipas një platforme të caktuar, në përshtatje me qëllimet e Partisë-shtet për të diskredituar klerin dhe rolin e tij "reaksionar", "antihuman" e "antikombëtar". Një pjesë e materialeve të ekspozuara ishin fotokopje dokumentash e fotografish që kompromentonin klerikët e të tyre besimeve, si bashkëpunëtorë të pushtesve e armiqve të tjerë të Shqipërisë. Fotografi procesesh gjyqësore, ku klerikët ishin të lidhur me grupe armiqësore brenda e jashtë vendit. Një grup tjetër objektivash ishin ikona e skulptura shenjtore, që përdorshin për të mashtruar besimtarët. Përveç këtyre ishin ekspozuar armë, municione e materiale të tjera konspirative gjoja të përdorura nga klerikët për qëllime kriminale. Pastaj një kategori tjetër objektivash ishin veshjet ceremoniale të klerikëve, kupa e sende të tjera të sakramentit, ruzaret (tespihet), kryqet, nuskat, hajmalitë si dhe libra të ndryshëm fetarë (Bibla e Ungjille, Kurane, libra me predikime, revista fetare që shërbenin në për shtëpitë e besimtarëve apo institucionet fetare)\*).

### **7. Shtëpia - muze e Degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit**

Me rastin e 100 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit, në vitin 1977 fillon puna për ngritjen e Shtëpisë-muze të Degës së L.SH. P. për Shkodrën. Ajo u vendos të ngrihej në shtëpinë e Pashko Vasës. Kjo ndërtesë e tipit të shtëpisë shkodrane që restauruar paraprakisht nga Atelieja e Monumenteve të Kulturës të Rrethit.

Në bazë të platformës së miratuar nga Organet eprore të Partisë e të Shtetit në rreth, ngritjes së Muzeut i parapriu një hulumtim i nevojshëm intensiv në një seri arkivash qëndrore e lokale dhe një konsultim i vazhdueshëm me institucione të specializuara e specialistë të fushës së historisë në kryeqytet e në Shkodër. Kështu u sigurua një material i pasur dokumentar si memorandum, protesta, letra, telegrame, peticione e fotografi. Gjithashtu u siguruan disa relikte që lidhen me personalitete të ndryshme të Shkodrës, protagonist të atyre ngjarjeve historike, sikurse ishin Pashko Vasa, Isuf Sokoli, Ali Pashë Gucia, Daut Boriçi, Filip Çeka etj,

\*) Po aty.

Interieret e Shtëpisë muze u plotësuan edhe me disa orendi e paisje tradicionale si dhe një koleksion armësh të kohës.

Dhanë kontributin e tyre Pjetër Hasi, Mithat Dibra, Njazi Vadahi, Luigj Franja etj., të cilët konsultuan një dokumentacion të pasur arkivor, kurse alestimi u krye nga ndërmarrja e Dekorit, nën drejtimin e mjeshtri të talentuar, Pjerin Bedeni. Inaugurimi i Shtëpisë – muze u bë më datë 16 qershor 1977, në kuadrin e 100 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit<sup>\*)</sup>.

### **8. Ekspozita Kombëtare e Kulturës Popullore**

Në viti 1981 filloi puna për ngritjen e një ekspozite kombëtare permanente me karakter etnografik. Ajo u ngrit në qendër të qytetit, në rrugën e “Pjacës” të shpallur “Monument kulture” (sot rruga “K. Indromeno”), në mjediset e një seri dyqanesh, në të dy anët e kësaj shëtitoreje të sapo restauruar. Ekspozitës i parapriu një seri ekspeditash në terren, në të gjitha krahinat e vendit. Objektet e shumta të traditës si dhe prodhimet artizanale të ndërmarrjeve artistike të qyteteve të ndryshme u ekspozuan në katër “pavione” (salla të mëdha) : Pavioni i Gurit, i Drurit, i Tekstileve dhe i Metaleve. Për secilin pavion u caktua një punonjës përgjegjës – shpjegues. Përveç punës së madhe të personelit të muzeut, tashmë i rritur edhe me katër punonjës të tjerë, që u angazhuan totalisht gjatë gjithë procesit, një ndihmesë të çmuar dhanë edhe Muzetë e tjerë të vendit si dhe disa specialist nga institucionet shkencore e kulturore të Kryeqytetit. Alestimi edhe kësaj here iu besua Ateliesë së Dekorit të Shkodrës, e cila e kreu me shumë sukses. Ekspozita u përrua në tetor të atij viti.

Ekspozita pati një rikostruktim në vitin 1986 (Ekspozita II Kombëtare e Kulturës Popullore), përmes së cilës ajo u pasurua më tej me objekte të reja dhe një konceptim të ri të mënyrës së alestimit të ekspozateve, të sistemit të ndricimit etj. Rreth kësaj ekspozite u botua edhe një guidë bilingue<sup>\*\*)</sup>.

### **9. Shtëpia-muze e Ndre Mjedës**

Më 22 nëntor të 1982, me rastin e 70 vjetorit të Pavarësisë, pas një pune të palodhur të personelit të Muzeut Popullor në bashkëpunim edhe me bashkëpunorë të tjerë e specialistë, u përrua Shtëpia-muze e Ndre Mjedës, në fshatin Kukël, pikërisht në banesën modeste ku ai kishte shërbyer, jetuar e punuar për shumë vite. Banesa kishte

\*) Arkivi i MHSH.

\*\*\*) Po aty.

nevojë për ndërhyrje restaurues. Në qendër të hyrjes ishte vendosur busti i Poetit. Me shumë mund u arrit të siguroheshin disa orendi, dokumente, foto e relikte që lidheshin me jetën e veprimtarinë e këtij poeti, studiuesi e atdhetari të madh\*).

### **10. Shtëpia-muze e “Qarkorit të Partisë”**

Në vitin 1984 rrjetit muzeal të qytetit të Shkodrës i shtohet edhe një tjetër objekt, me funksion propagandistik, Shtëpia-muze e Qarkorit (degës) të Shkodrës e Partisë Komuniste Shqiptare (Partia e Punës e Shqipërisë). Ky objekt u ngrit në shtëpinë e qytetarit Qamil Gavoçi, një ndërtesë e thjeshtë përdhese e restauruar, në të cilën më 1941 qe themeluar Organizata e Partisë Komuniste e Shkodrës. Materiali dokumentar e fotografik u përgatit nga Mithat Dibra e Paulin Peroja, Kahreman Ulqini, Seit Bushati etj. duke u mbështetur në kërkimet paraprake pranë Arkivave të ndryshme në Tiranë (Arkivi i K.Q. të PPSH, Arkivit të Shtetit) e në Shkodër (Arkivi i Muzeut). Krahas dokumentave (trakte, komunikata, korespondenca) e fotografive që lidheshin me veprimtarinë e kësaj organizate, qenë ekspozuar edhe relikte, ditare, armë, paisje për punë konspirative si shaptilografë, makina shkrimi, etj. Për alestimin punuan piktorët Danish Jukniu e Franc Ashiku në bashkëpunim me Atelienë e Dekorit pranë ndërmarrjes së Riparim-Shërbimeve. Muzeu, sipas porosive të dhëna, duhej të sintetizonte luftën dhe përpjekjet e Organizatës së Partisë Komuniste të Qarkut të Shkodrës, për drejtimin e popullit në luftën për çlirim. Gjatë vitit 1986 këtë shtëpi-muze e vizituan rreth 6000 vetë, nxënës shkollash, grupe punonjësish dhe grupe të huaja marksiste-leniniste. Gjatë viteve 1987-1988 këtu bëheshin pritje nga udhëheqësit lokalë të Partisë e të Shtetit me rastin e 5 Majit, ditës së Dëshmorëve partizanë. Në këtë periudhë ky muze ka shërbyer edhe për zhvillimin e orëve të mësimit të lëndës së marksizëm-leninizmit të shkollave të mesme\*\*).

### **11. Muzeu i Kështjellës**

Më 24 nëntor të vitit 1987 përurohet Muzeu i kështjellës “Rozafa”. Ky muze u ngrit në ndërtesën e “kapitenerisë”, në oborrin e tretë të kësaj kështjelle. Vetë lokali, ndërtesë impozante e shek. 15 përbën një monument mjaft interesant e të përshtatshëm për një muze të karakterit historik. Punës për ngritjen e muzeut i parapriu restaurimi i ndërtesës monumentale, sidomos në interierin e saj,

\*) Arkivi i MHSH.

\*\*) Po aty.

duke e përshtatur për këtë destinacion. Në ngritjen e tij përveç stafit të Muzeut popullor, punuan me përkushtim e fantazi edhe piktorë e specialistë të tjerë si Franc Ashiku, Shaban Bilali, Zef Çuni, Zef Temali, Primo Shllaku etj. Në pasurimin e fondit me objekte arkeologjike një ndihmë të pakursyer dha Bërthama Arkeologjike e Shkodrës. Veprat artistike u punuan nga autorë shkodranë si Danish Jukniu, Ismail Lulani, Ferit Kola, Hashim Kruja, Skender Kraja, Sadik Spahia etj. Maketi i kështjellës me qytetin e vjetër u punua nga mjeshtri i talentuar Shaban Bilali, punimet në dru prej mjeshtrit Zef Temali, hartat, skicat, tekstet në relief nga Pjerin Bedeni, punimet në hekur të rrahur e punime të tjera të brendëshme janë vepër e Ateliesë së Monumenteve të Kulturës, ndërsa në gjetjen e negativeve e stampimin e fotografive, riprodhimin e dokumenteve kontriboi fotografi Muhamet Boriçi.

Në hollin e Muzeut, në ballë është ekspozuar skena heroike e gruas së murosur me fëmijën në gjoks, altoreliev në allçi i skulptorit S. Kraja dhe një fragment i zgjedhur prej legjendës së murimit. Simbolika plotësohet dhe me një shqiponjë dykrenare të kompozuar me një seri heshtash luftarake mesjetare. Në katin përdhes janë ekspozuar artefaktet arkeologjike të zbuluara në gërmimet arkeologjike ose të gjetura rastësisht në hapsirën e kalasë ose poshtë, në territorin e qytetit të vjetër. Ato janë renditur sipas parimit kronologjik-tematik dhe përfshin harkun kohor nga prehistoria në periudhën moderne. Artefaktet e secilës periudhë shoqërohen me harta, citate, skica betejash etj. Ekspozitën e bën edhe më tërheqëse vendosja e busteve të tre të mbretërve ilirë, të punuara në gur si dhe portretet e Balshajve në bakër.

Salla e katit përqëndrohet në historinë e Mesjetës dhe atë moderne, të futura në një kontekst mjaft të gjetur etnografik. Në qendër është vendosur një maketi i madh i qytetit të vjetër me kalanë, Pazarin e vjetër, skelën lumore etj. Edhe këtu, si në katin përdhes, janë paraqitur harta e skica betejash, armë të kohës, makete anijesh tregtare. Vend të posacëm zenë rrethimi i Shkodrës i vitit 1474 dhe ai i vitit 1478-79 dhe periudha e sundimit të vezirëve Bushatlinj. Ekspozita mbyllet me fotografinë e madhe historike të ngritjes së flamurit të pavarësisë në Kala në mars të 1914-ës para popullit të Shkodrës e të malësive përreth. Gjysëm-kati i dytë është tepër interesant me fasadën transparente të trajtuar me hekur të rrahur, nga ku soditet lirisht salla e katit të mëposhtëm. Në mes të hapësirës qëndron një tryezë e

madhe po prej hekuri të rrahur me mozaik motivesh tradicionale, e rrethuar me karrige të rënda të të njëjtit stil punimi. Gjatë viteve në vazhdim muzeu erdhi duke u pasuruar me objekte të tjera muzeale. Kohët e fundit edhe në këtë Muze kanë ndodhur ndryshime, si në përmbajtje, duke u shtuar numri i objekteve të ekspozuara, koleksione armësh mesjetare, numizmatike, orendish të periudhës moderne etj. ashtu edhe në formë, ku vitrinat e më parëshme prej druri janë zëvendësuar me vitrina e panele prej hekuri e xhami. Ka ndërruar gjithashtu edhe sistemi i ndriçimit të sallave.

*( vijon në numrin e ardhshëm)*

**Ledio XHOXHI\***)

## **SHQIPTARËT DHE TRASHËGIMIA KULTURORE SHPIRTËRORE E TYRE**

### **Abstrakt**

*Shqipëria ratifikoi Konventën e UNESCO-s “Për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Trashëgimisë Shpirtërore” në vitin 2006 dhe që në atë kohë janë rritur në mënyrë domethënëse përpjekjet e gjithë autorëve publikë e privatë për t’i ruajtur e mbrojtur vlerat e trashëgimisë shpirtërore të krijuar nga shqiptarët ndër shekuj. Këto vlera, unike dhe të shumëllojshme për nga mënyra e krijimit, përçimit dhe realizimit të tyre, përbëjnë një nga shtyllat e identitetit kulturor të shqiptarëve, si pjesë e identitetit mbarëevropian e botëror. Gjithë Trashëgimia Shpirtërore Kulturore, me një larmi e pasuri të fillë, ka të bëjë me vitalitetin e këtij kombi që ka krijuar vlera të pakrahasueshme me asnjë tjetër.*

**Fjalë kyçe:** *Trashëgimi Shpirtërore, Identiteti Kulturor, Folklori shqiptar, Festival Folklorik, Letërsi Popullore.*

### **ALBANIANS AND THEIR SPIRITUAL CULTURAL HERITAGE**

### **Abstract**

*Albania ratified the UNESCO’s Convention “On the Protection of Spiritual Heritage” in 2006. Since then, there are significantly increasing the efforts of all public and private authors to preserve and protect the spiritual heritage values created by Albanians through centuries. These unique and diverse values from of the way of creation, transmission and their performances constitute one of the columns of the Albanian cultural identity, as part of the world-wide identity. The Spiritual Cultural Heritage, with a variety of such assets, has to do with the vitality of the nation that has created incomparable value to any other.*

**Key words:** *Spiritual Heritage, Cultural Identity, Albanian Folk, Folk Festival, Popular Literature.*

---

\*) \*Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Koleksioneve, Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë

## STUDIMI

Midis tipologjive kryesore të trashëgimisë shpirtërore shqiptare përfshihen këngët dhe vallet, meloditë dhe ritet e ndryshme, proza dhe poezia popullore, shfaqjet dhe lojërat popullore, si dhe aksesoret e nevojshëm për praktikimin e tyre, doket dhe zakonet etj. Ndër zakonet e shqiptarëve janë vëllamëria, miqësia, hakmarrja, mikpritja, konceptet për të bukurën dhe të shëmtuarën, për familjen patriarkale, për nderin, besën, apo për kombësinë e fenë.

Proza popullore përfshin lloje të ndryshme folklorike, si: përrallat, legjendat, anekdotat, tregimi, fjalët e urta dhe gjëgjëzat. Por edhe brendapërbrenda secilit prej këtyre llojeve ka përbërës të shumtë. Konkretisht, përrallat mund të jenë fantastike, aventurore, humoristike apo fabula. Po të shkohej më tej, edhe çdo nëndarje e sjellë më lart ka një shumësi motivesh. Mund të përmend motivin e shndërrimit njeri-kafshë. Në këtë mënyrë skemat klasifikuese janë edhe për llojet e tjera të prozës popullore shqiptare.

Poezia popullore, në përbërje të këngëve apo të valleve të kënduara, është e natyrës epike<sup>\*)</sup>, lirike<sup>\*\*)</sup> dhe epiko-lirike apo liriko-epike, në varësi të mbizotërimit të epizmit apo të lirismit. Krijimet epike përbëhen nga këngët e kreshnikëve dhe këngët historike, ndërsa krijimet lirike janë këngë të lindjes dhe të djepit, të dasmës, vajet, këngët e dashurisë, kurbetit, etj. Brendapërbrenda të gjitha këtyre llojeve të lirikës popullore shqiptare ka skema klasifikuese<sup>\*\*\*)</sup>.

Të dhënat nga gërmimet arkeologjike na tregojnë për zhvillimin kulturor e artistik që kishin arritur stërgjiyshërit tanë rreth 3000 vjet më parë. Në këtë zhvillim mund të përfshijmë edhe muzikën për shkak të dëshmimeve të vyera nga teatrot apo amfiteatrot, nga arenat e argëtimeve si dhe një sërë gjetjesh të tjera arkeologjike, si, skulpturat më pamje vallëtarësh apo banketesh të ndryshme<sup>\*\*\*\*)</sup>. Straboni, p.sh., në veprën e tij "Gjeografia" thotë për dardanët se *nuk e lënë muzikën mënjane, por përkundrazi përdorin gjithmonë fyej e vegla me korda.*<sup>\*\*\*\*\*)</sup>

\*) Njëra ndër tri gjinitë kryesore të krijimtarisë letrare që paraqet në formë tregimi, në vargje ose në prozë anë të ndryshme të jetës shoqërore. Shih: *Fjalori i Gjjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006, fq. 248.

\*\*\*) Gjini e letërsisë artistike e cila përfshin veprat që shprehin në vargje ndjenjat, shqetësimet, dëshirat e përjetimet e poetit. Shih: *Fjalori i Gjjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006, fq. 561.

\*\*\*\*) *Fjalori Enciklopedik Shqiptar-Vëll. 1*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, "Kristalina-KH", 2008, fq. 704.

\*\*\*\*\*) Ramadan Sokoli & Pirro Misto, *Veglat muzikore të popullit shqiptar*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1991, fq. 23.

\*\*\*\*\*) *Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë, "Toena", 2002, fq. 155.



Lidhur me instrumentet popullore duhet thënë se ka lloje të ndryshme që përfshihen në instrumentet idiofone, membranofone, aerofone dhe kordeofone. Në gjininë e veglave idiofone hyjnë mjetet kumbuese që nxjerin tinguj nga vibracionet e trupit të tyre të ngurtë nëpërmjet përplasjes, fërkimit, tundjes ose gërryerjes. Në to përfshihen: gurët, troka, çanga, cinglat, raketakja, tingëzat apo lugët.<sup>\*)</sup> Veglat e gjinisë membranofone janë ato që nxjerin tinguj nga vibracionet e membranave të tendosura shkaktuar prej ngacnimit nëpërmjet frymës (fyllzani) ose nëpërmjet goditjeve me duar (qypi, darja) ose me rryp (tullumbaci), ose me shkop e shufër (lodrëtia), si dhe nëpërmjet tundjeve (poçi) ose nëpërmjet fërkimit të lëkurës me diçka<sup>\*\*</sup>). Në gjininë e veglave aerofone hyjnë veglat që nxjerin tinguj nëpërmjet vibracioneve të frymës. Ndërsa tek veglat kordeofone hyjnë ato vegla të cilat nxjerin tinguj nga vibracionet e kordave të ngritura<sup>\*\*\*</sup>). Ndër to mund të përmendim çiftelinë, lahutën etj.

Folklori shqiptar paraqitet i pasur dhe i larmishëm. Shqiptarët, ndonëse jetojnë në një hapësirë gjeografike të kufizuar, kanë trashëguar nga të parët e tyre larmi stileshe, mënyrash të të kënduarit e instrumente muzikore. Midis kësaj larmie gjejmë muzikë që këndohet (vokale), muzikë që vetëm luhet me instrumente (instrumentale) dhe muzikë që vjen nga dy format e mësipërme (vokale-instrumentale). Muzika popullore shqiptare mund të ndahet në katër dialekte muzikore themelore; dialekti gegë, toskë, lab dhe qytetar.<sup>\*\*\*\*</sup>)

Iso-polifonia popullore shqiptare qëndron në tipologjinë e të kënduarit të një apo disa zërave të ndryshëm solistikë, mbi një shtrat isoje, të kënduar nga një grup këngëtarësh. Këngët polifonike mund të jenë 2, 3 dhe 4 zërëshe, vokale, instrumentale dhe koreografike.<sup>\*\*\*\*\*</sup>)

Iso-polifonia shqiptare përfaqëson një vlerë shumë të rëndësishme të trashëgimisë shpirtërore shqiptare. Kaq e vërtetë është kjo, sa që kjo vlerë është përfshirë dhe në listën e “Kryeveprave të Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore”, më 25 nëntor 2005, të cilat mbrohen nga UNESCO-ja.<sup>\*\*\*\*\*</sup>)

\*) Ramadan Sokoli, *Gjurmë folklorike*, Tiranë, “Naim Frashëri”, 1981, fq. 254-261.


\*\*) Po aty, fq. 270-277.

\*\*\*) Po aty, fq. 322.

\*\*\*\*\*) *Fjalori Enciklopedik Shqiptar-Vëll. 2*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, “Kristalina-KH”, 2008, fq. 1794.

\*\*\*\*\*) Spiro Shituni, *Tipare origjinale të polifonisë labe*, 1983, “*Kultura popullore*”, nr. 2, Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, fq.77-78.

\*\*\*\*\*\*) *Fjalori Enciklopedik Shqiptar-Vëll. 3*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, “Kristalina-KH”, 2009, fq. 2061.



***Dëshmia e dhënë nga UNESCO më 25 nëntor 2005  
(Arkivi i Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë)***

Midis krijimeve folklorike të kënduara në mënyrë homofonike (një zë) mund të përmend përsëri këngët e kreshnikëve. Edhe ky lloj krijimi përfaqëson një tipologji të trashëgimisë shpirtërore shqiptare. Eposi i kreshnikëve ka të bëjë me një cikël këngësh legjendare, përgjithësisht të shoqëruara në të kënduar me lahutë, në qendër të të cilit janë dy vëllezërit Muji e Halili me çetën e tyre në luftime të vazhdueshme me dyndjet e sllavëve, duke lartësuar trimërinë e malësorëve ndër shekuj, bëmat e tyre heroike etj.<sup>\*)</sup>

Vallëzimi popullor është ajo pjesë e kulturës popullore shqiptare e cila shprehet përmes kërcimit, i kuptuar si lëvizje, plastikë e gjest. Përcaktimi në përgjithësi i valles kryhet mbi bazën e plastikës koreografike, e cila ka të bëjë me lëvizjet e këmbëve, veprimet e trupit, pozicionet e duarve dhe qëndrimet e kokës. Me këtë "gjuhë" të veçantë, vallëzimi popullor shpreh një përmbajtje të caktuar, mendime e ndjenja të ndryshme. Vallëzimi popullor shqiptar ekziston në dy lloje formacionesh koreografike: valle masive dhe kërcime solistike. Vallet popullore janë të zhdërvjellta dhe shprehin veçori të karakterit, të psikologjisë e të botëkuptimit të valltarit shqiptar.

<sup>\*)</sup> Spiro Shituni, *Shprehje e gjallësisë së Eposit Heroik Legjendar*, 1987, "Kultura popullore", nr. 1, Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, fq.77-78.

Vallet popullore shqiptare janë të shumta, të pasura e të larmishme. Vallëzimi popullor shqiptar ka si dukuri tipike të vetën trihapëshin e dyzuar ose siç quhet ndryshe asimetrikun. Quhet në këtë mënyrë pasi kemi të bëjmë me gjashtë hapa, nga të cilat katër hapa bëhen djathtas e dy majtas. Këtë lloj trihapëshi e gjejmë edhe në popuj të tjerë, por ndër shqiptarë ka origjinalitetin e vet, lidhur me mënyrën e ekzekutimit në hapa të barabartë, me muzikën shoqëruese, poezinë që e shoqëron me tipare kombëtare.<sup>\*)</sup>

Festivalet folklorike janë veprimtari masive të organizuara të lëvizjes folklorike. Organizimi i tyre është parë si një nga rrugët efikase që ka shërbyer për popullarizimin dhe përhapjen sa më të gjerë të krijimtarisë folklorike. Në Shqipëri, festivalet folklorike janë zhvilluar në nivele dhe në përmasa të ndryshme, në bazë fshati, zone, qarku, për të arritur deri tek organizimi më i lartë, që janë festivalet folklorike kombëtare.

Organizimi i festivaleve folklorike zë fill në vitin 1947. Ndër vite pati dhe festivale të tjera, në përmasa të gjera, por mund të bëhet fjalë për organizime sistematike të këtyre lloj festivaleve që nga viti 1968, kur u vendos që një herë në pesë vjet do të zhvillohej Festivali Folklorik Kombëtar. Meqënëse vendi ku do të zhvillohej ky festival ishte përcaktuar në kështjellën e Gjirokastrës, edhe vetë ky festival mori emrin Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës.<sup>\*\*)</sup>

Organizimi i Festivaleve Folklorike Kombëtare vazhdoi edhe pas vendosjes së pluralizmit në Shqipëri, mbi bazën e Statutit të F.F.K.-së, me konkurimin e grupeve folklorike, përfaqësuese të qarqeve të vendit. Për të arritur deri këtu është parë e nevojshme që të organizohen çdo vit veprimtari të organizuara folklorike, siç janë festivalet folklorike tipologjike kombëtare, të tilla, si ai i valles popullore burimore, i iso-polifonisë, i këngës popullore qytetare, i sazeve dhe i rapsodëve dhe instrumentistëve popullorë<sup>\*\*\*)</sup>. Krahas tyre, janë mbështetur edhe festivale të tjera të natyrës rajonale, me

\*) Ramazan Bogdani, *Për Strukturën e vallëzimit popullor shqiptar*, 1987, "Kultura popullore", nr. 2, Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, fq. 77.

\*\*) Engjëll Serjani, *Gjirokastrë, starton festivali i parë Folklorik në shkallë rrethi*, <http://www.gazeta-shqip.com/lajme/2015/01/26/gjirokaster-starton-festivali-pare-folklorik-ne-shkalle-rrethi/>, (parë më 24.08.2016);

Shih edhe: <http://www.libohovaonline.com/historia-e-festivalit-folklorik-te-gjirokastrës/>, (parë më 24.08.2016);

Shih edhe: <http://historia-ime.com/2015/05/15/foto-festivali-folklorik-kombetar-ne-gjirokaster/>, (parë më 24.08.2016).

\*\*\*) <http://www.folklor.gov.al/?cat=18>, (parë më 24.08.2016)

një përfaqësim të gjerë. Të gjitha këto veprimtari paraprake janë parë si një rrugë e efektshme për të përzgjedhur sa më shumë vlera folklorike, interpretues dhe ekzekutues sa më virtuoze, në shërbim të Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës.



*Festivali Folklorik Kombëtar, 1978  
(Arkivi i Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë)*

Një nga aspektet më interesante të trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar e përbëjnë veshjet popullore të cilat në krahasim me numrin e popullsisë dhe sipërfaqen e territorit të banuar prej tyre, janë të pasura e të larmishme. Madje, edhe një fshat i vetëm kishte veshjen e tij. Veshjet popullore shquhen jo vetëm për larminë e tyre, por edhe për bukurinë dhe vlerat artistike që ato përmbajnë. Ndërkohë ato na japin informacione të gjithanëshme për proceset e zhvillimit kulturor të banorëve të krahinave të ndryshme ashtu si dhe për zhvillimin ekonomik, historik, shoqëror e kulturor të tyre.<sup>\*)</sup> Veshje të veçanta përmbajnë elemente të atillë të cilët sjellin mesazhe qytetërimesh mjaft të hershme.

Mjeshtëria e të endurit është ndër më të hershmet në mjeshtëritë e shumta të popullit shqiptar. Për lashtësinë e saj në territoret shqiptare flasin zbulimet arkeologjike. Gjurmë janë ndeshur në vendbanimin prehistorik të Maliqit (Korçë), të cilat i përkasin Epokës së Gurit të Ri (7000-3700 vjet para Kr.), ku midis gjetjeve të shumta bëjnë pjesë edhe pesha vegjesh.<sup>\*\*)</sup> Tradicionalisht punëdoret e ndryshme

\*) *Fjalori Enciklopedik Shqiptar-Vëll. 3*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, "Kristalina-KH", 2009, fq. 2878.

\*\*\*) Muzafer Korkuti, *Qytetërimi neolitik dhe eneolitik në Shqipëri*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, "Kristalina HK", 2010, fq. 106.

të grave shqiptare kanë luajtur rol të rëndësishëm në ekonominë e familjes. Me prodhimet e këtij lloji visheshin anëtarët e familjes dhe pajiseshin mjediset e banesave dhe pajisjet e vendit të fjetjes<sup>\*)</sup>. Ndër më të spikaturat mes tyre ishin llojet e pëlhurave prej leshi, ato prej liri, prej pambuku e prej mëndafshi etj.<sup>\*\*)</sup> Një pjesë e tyre përbënin krijime të vërteta artistike. Të tilla ishin pëlhurat e përdorura për veshjet ceremoniale (këmishë, përparëse, mbulesë koke), llojet e shtrojeve e mbuloje si: qilima, sixhade, velenxa etj. Pëlhurat e mëndafshta e ato të pambukta i kishin bërë të njohura endëset shqiptare përtej kufijve të vendit. Mjaft të pasur me vlera artistike paraqiten edhe llojet e qëndisjeve të realizuara nga gratë fshatare dhe ato qytetare për të zbukuruar mjedisin e banesës por edhe pjesët e veshjeve popullore të krahinave të ndryshme<sup>\*\*\*)</sup>. Midis tyre, mjaft të njohura u bënë gratë e krahinës së Zadrimës, Fushë-Krujës, Shpatit, Myzeqesë, Elbasanit, Vlorës, Beratit, Gjirokastrës etj.

Tradita e mjeshtërisë së argjandarisë artistike në trevat e banuar nga shqiptarët, është mjaft e lashtë. Këtë fakt e dëshmojnë gjetjet arkeologjike të cilat datojnë që nga Periudha e Bronzit (3100-1050 vjet para Kr.). Përgjatë shekujve, kjo mjeshtëri e quajtur me të drejtë "fisnike", u favorizua edhe për shkak të prezencës me shumicë të lëndës së parë. Dokumente të shumta dëshmojnë praninë e minierave të argjendit, sidomos në trevat e Kosovës. Në mënyrë të veçantë ushtrimi i kësaj mjeshtrie mori vrull të madh pas shek. XVIII e sidomos përgjatë shek. XIX<sup>\*\*\*\*)</sup>. Qendrat më të njohura për zhvillimin e argjandarisë u bënë qytetet: Shkodër, Berat, Elbasan, Prizren e Pejë (Kosovë); si dhe qyteti i Janinës (Çamëri). Argjendarët shqiptarë kishin një repertor shumë të pasur i cili përfshinte objekte kulti për zbukurimin e mjediseve të banesës, stoli të ndryshme për gra e burra, armë dhe aksesoret e tyre etj. Teknikat më të përparuara kanë qenë ato "me derdhje", "me kokrriza", "me gdhendje", "me rrahje", "me filigran" etj.<sup>\*\*\*\*\*)</sup>

\*) Afërdita Onuzi, *Besime e rite rreth mjeshtërisë së endjes*, 1997, *Kultura Popullore*, nr. 1,2, Akademia e Shkencave e RSH, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, fq. 49.

\*\*\*) Andromaqi Gjergji, *Vendi i veshjeve shqiptare në kontestin ballkanik*, 1998, *Kultura Popullore*, nr. 1,2, Akademia e Shkencave e RSH, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, fq. 49.

\*\*\*\*\*) Ikbal Bihiku, *Motive të qëndisura në veshjet popullore*, 1983, *Kultura Popullore*, nr. 1, Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, fq. 74.

\*\*\*\*\*) *Fjalori Enciklopedik Shqiptar-Vëllimi 1*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, "Kristalina-KH", 2008, fq. 95.

\*\*\*\*\*) Po aty, fq. 95-96.

Eposi popullor ka qenë një nga traditat artistike mbi të cilën është mbështetur zhvillimi i prozës shqiptare. Me pasurinë e ideve dhe me forcën artistike të fjalës shqipe, eposi heroik dhe legjendar përbën një truall të pasur, një përvojë të pashtershme, që ushqen zhvillimin e prozës dhe të mbarë letërsisë. Balada popullore shqiptare, lashtësia dhe evolucioni i saj, motivet me brendi të thellë emocionale, figurat e shumta e të pasura, fantazia e krijimit artistik janë pasqyrë e historisë, e jetës shpirtërore plot drama e tragjedi, plot heroizëm të popullit shqiptar, janë dëshmi e një talenti të madh krijues.

Letërsia popullore, në mënyrë të veçantë këngët popullore, formojnë urën e kapërcimit midis së kaluarës dhe së tashmes, midis letërsisë së vjetër e asaj të re, sepse pikërisht nga letërsia popullore në përgjithësi, dhe nga këngët popullore në veçanti, nxorën frymëzimin shumë krijime të tyre më të mira shkrimtarët e parë të letërsisë së vjetër dhe sidomos ata të periudhës së Rilindjes e asaj të Pavarësisë. Folklori ka dhënë një ndihmesë të veçantë në veprimtarinë e përgjithshme të poetëve të Rilindjes në poezi, në dramë, në fabulistikë dhe në gjuhën e tyre.

**BIBLIORGAFIA**

- Afërdita Onuzi, *Poçeria popullore në Shqipëri*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1988.
- Alfred Uçi, *Mitologjia, folklori dhe letërsia*, 1982.
- *Fjalori Enciklopedik Shqiptar-Vëll. 1*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008.
- *Fjalori Enciklopedik Shqiptar-Vëll. 2*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008.
- *Fjalori Enciklopedik Shqiptar-Vëll. 3*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2009.
- *Fjalor i Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2006.
- Hysen Koçillari, *Trashëgimia shpirtërore e Devollit, (vështrim studimor dhe përmbledhje folklorike)*, balada, ninulla, këngë, 2014.
- *Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002.
- *Kultura popullore*, Akademia e Shkencave e RPSSH, nr. 1, 1983.
- *Kultura popullore*, Akademia e Shkencave e RPSSH, nr. 2, 1983.
- *Kultura popullore*, Akademia e Shkencave e RPSSH, nr. 1, 1984.
- *Kultura popullore*, Akademia e Shkencave e RPSSH, nr. 2, 1984.
- *Kultura popullore*, Akademia e Shkencave e RPSSH, nr. 1, 1985.
- *Kultura popullore*, Akademia e Shkencave e RPSSH, nr. 1, 1986.
- *Kultura popullore*, Akademia e Shkencave e RPSSH, nr. 2, 1986.
- *Kultura popullore*, Akademia e Shkencave e RPSSH, nr. 1, 1987.
- *Kultura popullore*, Akademia e Shkencave e RPSSH, nr. 2, 1987.
- *Kultura popullore*, Akademia e Shkencave e RSH, nr. 1-2, 1996.
- *Kultura popullore*, Akademia e Shkencave e RSH, nr. 1-2, 1997.
- *Kultura popullore*, Akademia e Shkencave e RSH, nr. 1-2, 1998.
- Mark Milani, *Jeta dhe zakonet e Shqiptarëve*, 1995.
- Muzafer Korkuti, *Qytetërimi neolitik dhe eneolitik në Shqipëri*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2010.
- Naxhi Kasoruho, *Gjirokastra e këngës*, 2004.
- Ramadan Sokoli, *Gjurmë folklorike*, 1981.
- Ramadan Sokoli & Pirro Misto, *Veglat muzikore të popullit shqiptar*, Instituti i Kulturës Popullore, 1991.
- Timo Mërkuri, *Madhëria e saj, kënga iso-polifonike*, 2007.
- Vasil S. Tole, *Muzika dhe letërsia*, 1997.
- Vasil S. Tole, *Sazet, muzika me saze e Shqipërisë së Jugut*, 1998.
- Vasil S. Tole, *Folklori muzikor, iso polifonia dhe monodia*, 2007.

**Lorenc KAÇULINI**

## **HISTORIA E FILATELISË NË SHKODËR**

Në historinë e filatelistë shqiptare, Shkodra është ndër qytetet që ka një vend të merituem. Filatelisti më i hershëm që njihet deri më sot, është shkodrani Ndoc Xhuxha (Gjinaj) atdhetar dhe rilindas i shquem dhe më vonë Prengë Bibë Doda, Princ i mirditasve. Ky i fundit me pasionin për filatelinë, arriti me shtypë pullën e parë shqiptare lokale në vjetin 1883. Ndoc Xhuxha që bashkëpunoi me patriotin Pashko Vasa për formimin e Alfabetit të Gjuhës Shqipe, ishte edhe filatelist dhe numismat i apasionuem. Në vjetin 1883, ai mori pjesë në një ekspozitë numismatike në Vatikan me një koleksion monedhash ari. Kjo që pjesëmarrja e parë e një shqiptari me monedha në botën e jashtme. Familja Gjinaj vazhdoi traditën e saj filatelike me të birin Kolën, por përse i përket koleksionit filatelik të familjes, kështu u plaçkit prej forcave malazeze gjatë Luftës së Parë Ballkanike dhe u sekuestrue prej tyre, kur hynë për herë të dytë në Shkodër, më 27 Qershor 1915.

Shqyrtimi dhe analiza historike e zhvillimit të lëvizjes filatelike në Shqipëri, nxjerr në pah se ky zhvillim ka kaluar në disa periudha.

*A - Periudha e parë përfshin zhvillimin e filatelistë shqiptare në vjetët 1912-1925.*

Mbas shpalljes së Pavarësisë më 1912, qeveria e Ismail Qemalit, e prime prej synimit me konsoliduar më tej shtetin e ri shqiptar, ndonëse në kushte të vështira, mori masa për hedhjen e hapave të parë të Postës Shqiptare. Në kuadrin e këtyre masave, ishte edhe nxjerrja e pullës, Vulës të parë shqiptare më 1913.

Në një fotografi të fondit "Marubi" paraqitet filatelisti i vjetër Mark Mosi, i veshun me kostum kombëtar shkodran, së bashku me një fëmijë, tuj shikuar disa albume pullash, ku sipas tyre, kuptohet se kjo fotografi i përket vjetit 1915.

Si personaliteti më i shquem i filatelistë, në periudhën që flasim e më vonë, që Zef Prendushi. Ai mori pjesë në veprimtari ndërkombëtare të filatelistë, në shumë ekspozita filatelike, kryesisht me koleksione të Shqipërisë, si në Gjermani, Austri, Itali etj., ku edhe u nderue me 9 medalje, prej të cilave disa ishin të arta, njëkohësisht fitoi edhe shumë



diploma. Ai u bâ një autoritet në ekspozitat e pullave shqiptare të vjetëve të para, sidomos për emisionet e qeverisë të Ismail Qemalit. Vula e tij si ekspert, me inicialet Z. P, që në të tana rrethet filatelike, mbrenda dhe jashtë Shqipënisë. Ka patun edhe filatelistë të tjerë, si: Ferdinand Çoba, Tush Kakarriqi, Gjon Temali etj.

Në mars të vjetit 1913, si pasojë e vendimit të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, Fuqitë e Huaja u larguen prej Shkodre dhe administrata e qytetit kaloi në duart e Komisionit Ushtarak Ndërkombëtar. Në muajin korrik 1913, filloi punën edhe administrata postare e qytetit, tuj vue në qarkullim pullat e misionit të tretë të Qeverisë së Vlonës e tuj aplikue një vulë datare me shkrimin shqip SHKODËR-SHQIPËNIE.

Më 7 Mars 1914, Princi Wied u shpall Mbret i Shqipënisë dhe këtë ngjarje filatelia shkodrane e përkujtoi tuj vulosun serinë e Skënderbeut të Madh prej 6 vlerash me një vulë të re, më datë 6.3.1914 dhe me ngjyrë ari.

Më 22 Prill 1913, Shkodra iu dorëzue pushtuesve malazezë dhe mâ pas, si rrjedhim i situatës së favorshme që u krijue, më 19 Mars 1914, forcat ushtarake ndërkombëtare i zbrapsën trupat pushtuese tuj e çlirue Shkodrën prej tyne. Në këtë ditë populli i Shkodrës u mbýll në Kështjellë të Rozafës, ku u ngrit Flamuri Kombëtar kuq e zi, që valoi për herë të parë mbas 500- vjetësh mbi Kalanë Rozafat. Gjatë kësaj periudhe hidhen një varg emisionesh lokale. Midis tyne spikasin emisioni i 19 Marsit 1915, që u emetue me rastin e përvjetorit të parë të ngritjes së Flamurit Kombëtar në Kalanë e Shkodrës.

Përveç series të Skënderbeut me vulë ari, kena atë me një pullë 1 GROSH/25 Q, me mbishtypjen "SHKODER 1919" në formë gjysëm rrethore.

Lidhun me emisionin e 19 Marsit 1915, nisma për i takon administratës postare të Shkodrës dhe drejtorit të saj Sadik Tirana. Vula prej druni u punue në Itali dhe mbishkrimi që u vendos mbi pulla dhe karta postare, të thjeshta e me përgjigje, ishte 19 MARS. 1914 - KUJT. I NGRITJES FLAM. KOMBËTAR NE FONTESË-SHKODRE i vendosun në katër rreshta në një pjerrësi që shkon afër diagonales, nga e majta poshtë në të djathtë sipër. Mbishtypja u vendos edhe në pullat e emisionit "Taksë".

Komisioni përbahej nga 4 vetë, mes të cilëve edhe Luigj Gurakuqi, i cili merrej me filateli dhe kishte një koleksion të pasun me pulla shqiptare. Ky komision filloi punën më 18 mars 1915, në orën 8

paradite dhe vazhdoi deri në orën 13.00. Mbasi sasia e planifikueme nuk u mbishtyp tansisht, puna rifilloi të nesërmen më 19 mars, në orën 8.30 të mbramjes dhe vijoi deri në mesnatë. U punue edhe në datën 20 mars, prej orës 9.00 të mbramjes e deri në orën 11.00, kohë që përfundoi gjithë mbishtypja. Gjatë tri ditëve, kur nuk punohej, vula mbyllej në kasafortën e postës në prani të tânë anëtarëve të komisionit. Interesant është fakti se, mbasi përfundoi mbishtypja, në prani të tânë anëtarëve, vula u prish dhe u bâ e papërdorshme. Vula sot gjendet në Muzeun e P.T.T.-së, pa asnjë ndryshim nga gjendja që pësoi, më 21 mars të vitit 1915.

Për këtë emisjon shërben serija me 6 vlera e Skënderbeut të madh me vlera të reja në para e grosh. Serija ka 7 vlera mbasi pulla 5 është me dy mbishtypje, një e kuqe dhe tjetra e zezë. Në 5 vlerat e tjera mbishtypja u bâ në ngjyrë të kuqe.

Emisioni u vu në qarkullim, më 15 mars 1915. Në këtë ditë u shitën seri të plota, pulla me copë e karta postare. Të nesërmen, në datë 20 mars, u shitën pulla për përdorim postar.

Pullat e emisionit "Taskë" nuk u vunë menjëherë në përdorim. Serija prej 3 vlerash me mbivendosje të një T të madhe me ngjyrë të kuqe dhe të zezë, doli në qarkullim në sportelin e shërbimit postar në muajin maj 1915.

Mbishtypja e këtij emisioni, pulla, karta postare dhe pulla takës, me ngjyrë të kuqe dhe të zezë, paraqet një variacion të larmishëm tuj u spostue brenda sipërfaqes së pullës në të gjitha drejtimet. Ka ekzemplarë të rrallë me mbishtypje kokë poshtë në të trija variantet. Administrata e Postës së Shkodrës, disa seri të këtij emisioni i vulosi në shërbimin postar me vulën e ditës së parë të emetimit. Vula qe metalike, rrethore me diameter 34 mm., ku në mes, në të dyja anët ka një shmangie nga rrumbullakësia që ia japin të dalat e katërkandëshit, ku shkruhet me shifra "19 - 3 - 1915". Në harkimin e poshtëm të rrethit unazor asht vendosë "SHQIPËNIË" dhe në pjesën e sipërme "Zyra postare SHKODËR".

Vula tjetër, që hyni në përdorim në mesin e prillit 1915, qe unazore në diametrin e së cilës asht vendi i datës; diametri i saj asht 37 mm., në fushën unazore ka mbishkrimin Shkodër - Shqypnie (SCUTARI - ALBANIE), e cila paraqitet vetë në pullat përkujtimore të taksës dhe në botimin e dytë të zakonshëm të pullave të Skënderbeut. Vula, me të gjitha karakteristikat e saj, e padëmtume dhe në gjendje të mirë, ruhet në Muzeun e Postës.

Me ripushtimin e Shkodrës nga ushtritë malazeze në fund të Qershorit 1915, edhe Posta Kombëtare në Shkodër pushoi së funksionuemi. Atje u vendos administrata malazeze, që futi në qarkullim serinë e pullave të vitit 1913, me portretin e Car Nikollës dhe një vulë datare me shkrimet në cirilike SKADAR dhe SCUTARI. Zhvillimet e mëtejshme luftarake sollën fitoren e Austro-Hungarisë mbi Malin e Zi dhe Serbinë. Si rezultat i kësaj, nga Shkodra ikën malazezët dhe në janar 1916 ajo u pushtue nga forcat Austro-Hungaraze. Si rrjedhojë në Shkodër u vendos një administratë tjetër e huej tuj fut në qarkullim pulla të Austro-Hungarisë të viteve 1915-dhe 1917/18, si dhe një vulë të re datare me shkrime në gjermanisht “Knd KFELDPOST” dhe emnin SCUTARI (SHKODRA).

Me mbarimin e Luftës së Parë Botërore, më datën 25 dhjetor 1918 u mbajt Kongresi i Durrësit, nga ku doli një qeveri Kombëtare. Edhe Drejtoria e Postave në Shkodër rifilloi punën, tuj pasë si drejtor Sadik Tiranën, i cili vazhdoi ritmet rinovuese në filatelinë shkodrane.

Nga stoku i pullave fiskale të Austro-Hungarisë që gjendeshin në zyrat e financës së Shkodrës, u formuen 6 vlera të reja tuj u mbishtypun: “POSTA E SHKODRËS – SHQYPNIS”. Këto u ndanë në këtë mënyrë:

1. Emisioni i 15 janarit 1919, i mbivulosun me datën në karaktere latine me gërma romake me një vulë dore druri e pergatitun nga mjeshtri shkodran Zef Dajçi. Numrat romakë me drejtimin nga e majta poshtë në të djathtë sipër. Mbishtypja u ba me ngjyrë të kuqe për të tana vlerat, me përjashtim të vlerës 10 qind që u mbishtyp me ngjyrë blu. Ky emision u vù në shitje vetëm për një ditë prej 15 janari 1919 deri të nesërmen në mesditë.

2. Emisioni i dytë 16 janar 1919 qarkulloi për gati 1 muaj deri 15 shkurt 1919 dhe u mbivulos në të majtë, e cila në pjesën e sipërme ka një yll me gjashtë cepa të rrethuem me imazhe shkëndijash. Vula e dorës për realizimin e mbishtypjes u përgatit prej druri nga mjeshtri Zef Dajçi. Edhe këtu pesë vlerat u mbishtypën në ngjyrë të kuqe dhe vetëm vlera 10 Qind u mbishtyp me ngjyrë blu. Gjysma e serive (4000 copë) e ka pullën 25 QIND me tipin e shqiponjës me dy kalë me siluetë të ngushtë e të gjatë, kurse gjysma tjetër me tipin e shqiponjës me siluetë të gjanë e të shkurtër.

3. Emisioni i tretë qarkulloi tuj fillue nga 7 marsi i vitit 1919. Mbishtypja e serisë u realizue me një vulë bakri, ku ishte gdhendur një lloj tjetër komete po me yll me gjashtë cepa, por këtë herë pa shkëndija dhe me kahje nga e djathta. Ngjyra e mbishtypjes ishte vjollcë. Mbas mbishtypjes, vula e dorës prej bakri u prish. Krahas këtyre, u prodhua

dhe një emision tjetër me pulla taksë. Kjo seri kishte vetëm katër vlera në dallim nga emisionet e sipërpërmenduna që kishin secili nga gjashtë vlera. Mbishtypja u ba në ngjyrë vjollcë nëpërmjet një vule druri, ku vulëgdhendësi Zef Dajçi kishte skalitë fjalën *TAXË*, ku gërma *T* ishte ma e madhe se të tjerat dhe asht e vendosun vertikalisht. Tri gërmat e tjera janë ma të vogla dhe janë vendosun diagonalisht. Seritë u nxorën në shitje më 10 shkurt 1919. Edhe ky emision shquhet për variacione gabimesh. Bamja e vulave të papërdorshme u krye në prani të komisionit; ruhen në arkivin e Drejtorisë së Postës.

Gjatë muajit mars 1919, Posta e Shkodrës emetoi edhe një pullë të emisionit të dhjetorit të vjetit 1913 me portretin e Skënderbeut, me vlerë 25 Qint, e mbishtypun me tekstin "SHKODER" 1919, në formë gjysmërrethi dhe me vlerë 1 Grosh. Mbishtypja u realizua në ngjyrë vjollcë. Ky emision u prodhua për shkak të mungesës së pullave për me përballu nevojën në rritje për afrankimin postar. Po kështu gjatë vjetit 1919, në zyrën postare të Shkodrës, u vunë në përdorim dy vula datare të tjera "SHKODRE-SHQYPNIE", më e madhja, dhe tjetra ma e vogël "Shkodre-Scutari".

Në vitin 1920 administrimi i Shkodrës iu besue një garnizoni ndërleat, nën komandën e gjeneralit francez B. Forton, që qe dashamirës i filatelistë dhe ndihmoi në emëtimin e dy serive të fundit të Shkodrës.

Më 16 shkurt 1920 u emëtue një seri prej 9 vlerash, nga stoku i vitit 1914, të paemëtue me portretin e princ Wiedit. U mbishtyp n'vlera të reja si dhe një shqiponjë dykrenare me fjalën Shkodra, poshtë në gjysmëharkun në ngjyrë blu, kafe, jeshile dhe të zeza. Mbishtypja të kujton emisionin e tretë të Qeverisë se Vlorës të vitit 1913.

Emisioni i fundit i Shkodrës është ai që quhet "Skënderbeu i vogël", që u porositi në Paris nga gjenerali De Forton, porse nuk u vùe në qarkullim, mbasi poshtë mban fjalën Shkodër dhe për faktin se prej 11 marsit 1920, Shkodra filloi me b' pjesë në Shtetin Shqiptar. Këto pulla u mbishtypën me një buri poste dhe me një kordele me fjalën "Besa". Gjenden të paqarkullueme dhe pa dhambë në seri komplete prej 6 vlerash. Këtu merr fund një nga periudhat e lavdishme të filatelistë shqiptare, ajo e historisë postare të Shkodrës, në vitet 1913 - 1922, për me vijue më tej.

- A. Prej vjetit 1923 deri më 1925, që përfshihet në periudhën e parë të filaterisë, kemi misionin e zakonshëm me 7 vlera "Qytete dhe ndërtime", ku në pullën me vlerë 50 qint, është kështjella Rozafat. Seria u përdor me mbishtypje të ndryshme deri në vitin 1925, me mbishtypjen e pjerrët "Republika Shqiptare".

- B. Periudha e dytë përfshin zhvillimin e filatelistë në vitet e sundimit të Ahmet Zogut. Gjatë mbretnimit u shtypën 15 emisione, disa edhe me mbishtypje, shumë pak, dhe gjatë kësaj periudhe ka emisione me peisazhe shqiptare, ngjarje të rëndësishme, kryesisht me portretin e Zogut. Gjithsesi tematikat mbeten të cinguleme.

- C. Periudha e tretë përfshin pushtimet nga Italia dhe Gjermania. Nga 7 prilli 1939 deri më 8 shtator 1943, kur Italia fashiste kapitulloi, u emëtuen prej saj në Shqipëri rreth 8 seri pullash, me kostume kombëtare, pamje të ndryshme, si dhe ato me portretin e Viktor Emanuelit, mbretit të Italisë.

Pushtimi gjerman, që zgjati prej shtatorit 1943 deri 29 nëntor 1944, pati kryesisht ato seri të periudhës italiane me mbishtypjen "14 shtator 1943", si dhe serinë e refugjatëve të luftës me shtatë pulla. Pra, kjenë dy seri gjithsej. Gjithashtu dolën në qarkullim edhe një sasi zarfash, kartë letër, kartë postare të thjeshta e me përgjigje, ku disa ishin me pamje të ndryshme prej vendi, ku mes tyre dallojmë pamjet e kështjellës Rozafa dhe të Urës së Mesit. Zarfat kjenë me portretin e mbretit Viktor Emanuelit e u përdorën gjatë pushtimit gjerman, por me mbishtypjen e "14 shtatorit 1943".

- D. Periudha e katërt është ajo mbas Çlirimit. Filatelia pati një zhvillim të madh, e pasun me tematika nga më të ndryshmet, tuj përfshi edhe ato me karakter politik.

Në prill të vjetit 1947, në qytetin e Shkodrës, një grup filatelistësh themeluan "Klubin Filatelik", që ma vonë u quejt "Rrethi Filatelik" dhe së fundmi, në vitin 1992, u quejt "Shoqata e Filatelistëve të Shkodrës". Ky ishte i pari rreth filatelik i krijuem në vendin tonë me pjesëmarrjen e moshave të vjetra dhe më të reja. U hartue rregullorja e kësaj shoqate si dhe u miratue statuti, si dhe u dha edhe leja nga organet kompetente. Klubi Filatelik i Shkodrës punoi sipas një programi të pasun me rregulla dhe debate, tuj arritë rezultate konkrete në përgatitjen dhe hapjen e shumë ekspozitave filatelike, si dhe botimin e zarfave përkujtimorë dhe të Ditës së Parë. Ekspozita e parë filatelike u hap më 28 shtator, të vitit 1947. Figurat e shqueme të filatelistë shkodrane: Luigj Kromiqi, Idriz Fishta, Kolë Gjinaj, Selim Karakaqi, Pashko Saraqi etj., me materialet e tyre bënë të mundun përrurimin e kësaj ekspozite që tërhoqi vëmendjen e qytetarëve të shumtë shkodranë, që i përgëzuen nismëtarët e kësaj veprimtarie. Përveç kësaj, në vitet në vijim, u hapën edhe 18 ekspozita të tjera, ku janë ekspozue pulla postare shqiptare dhe të shteteve të tjera.

Klubi Filatelik i Shkodrës nxori 10 lloje zarfash të ilustruem mbrenda

një periudhe të shkurtë kohore prej një viti e 9 muejsh, prej 27 Shtatorit të vjetit 1958 deri më 5 Maj të vjetit 1960. Zarfat specialë (F.D.C) dolën për datat historike, si me rastin e Miqësisë Shqiptaro-Sovjetike dhe hapjes së Ekspozitës së Dytë Filatelike në qytetin tonë, që mban datat 27-9 deri 6-X-1958; zarfat me emisionin e pullave të Spartakiadës së Parë Kombëtare 1959. Zarfi i katërt u vù në qarkullim me emisionin e pullave të 15-Vjetorit të Çlirimit të Atdheut. Zarfi i pestë ishte me rastin e Deklaratës së Përbotshme për të Drejtat e Njeriut. Zarfi gjashtë që është edhe zarfi parë i plotë me të gjitha kërkesat e zarfit të ilustruem, qe për 8 marsin e vitit 1960. Zarfi tjetër me rastin e 40- vjetorit të Kongresit të Lushnjës (1920-1960).

Zarfi i tetë i kushtohet 80-vjetorit të lindjes të artistit të madh Aleksandër Moisiu. Zarfi i nëntë i kushtohet V. I. Leninit me rastin e 90- vjetorit të lindjes dhe zarfi i fundit doli me rastin e 80-vjetorit të themelimit të Shoqnisë së Shkronjave Shqipe, tuj mbyllë aktivitetin e rrethit tonë filatelik për emetimin e zarfave postare.

Muzeu historik Shkodër organizoi katër Seminare Ndërkombëtare "Shkodra në Shekuj" (1992-2000), ku një vend të veçantë patën edhe trajtesat për filatelinë.

Në këto sesione filatelistat shkodranë me përvojë, si: Idriz Fishta, Kol Gjinaj, Gjush Tarragjati, Pashko Saraçi, Mark Pali, Angjelin Zojzi etj, punuen tema me vlerë për lëvizjen filatelike shqiptare.

Në përfundim të historisë filatelike në Shkodër, duhet me nënvizue se qytetit të Shkodrës iu kushtuen shumë seri me përmbajtje panoramike, monumentare apo edhe tematike, si trajtesat etnografike me kostume kombëtare etj.

## Personalitete



### ALI LLUKAÇI

*Ali Llukaçi u lind më 19 Mars 1932, në qytetin e Shkodrës. I ati, Hamza Llukaçi, ishte një mësues i nderuem, që Ernest Koliqi, me të drejtë në fletët e revistës së tij, »Shejzat”, e shënjonte si një ndër personalitetet që dha një ndihmesë të madhe në zhvillimin e arsimit kombëtar. Qysh në vogëli u shquë si nxanës i shkëlqyeshëm. Në rini gjatë kohës që studionte në Liceun e Shkodrës, (Gjimnazi) përqafoi idealet nacionaliste e antikomuniste tuj marrë pjesë në organizatën “Përpyjekja Shqiptare», që ishte sýmbol i qëndresës antikomuniste të studentëve e profesorëve të Gjinnazit, kundër sistemit diktatorial komunist që po vendosej në Shqipni. Organizata u drejtue nga Bardhosh Dani, Et’hem Bakalli e mâ vonë Ahmet Bushati. Krahas Ali Llukaçit, pjestarë të tjerë të organizatës ishin edhe të rinjtë antikomunist, si: Et’hem Bakalli, Viktor Luka, Çiljeta Simoni, Gjon M. Ndoj, Rrok Jubani, Njazi Uruçi, Mërgim Dani, e sa të tjerë bij e bija të Shkodrës. Aktiviteti i týne, shtypja dhe shpërndamja e trakteve; shkruemja e parullave kundër regjimit komunist u bâ në ilegalitet të plotë. Zbulimi i organizatës prej organeve të Sigurimit të Shtetit, u pasue me ndëshkime të rânda. Bardhosh Dani, Mark Caca e Brahim Derguti u dënuen me vdekje, të tjerët rrahën, u arrestuen e u burgosën. Meqë rreziku për jetën ishte i pranishëm në çdo*

moment, me një grup të rinjsh, pjestarë të kësaj organizate, si: Zef Hila, Lec Vasia etj., u arratis në Jugosllavi.

Atje, ai filloi studimet e nalta në Universitetin e Beogradit, në degën Inxhinieri Ndërtimi. Ndërsa vijonte studimet, autoritet jugosllave, për pikpamjet e tija nacionaliste e antikomuniste, e burgosën në burgun e Gracanicës, ku iu nënshtrua rrahjeve e torturave përgjatë 9- muajve. Me t'u lirue nga burgu, bashkë me të tjerë të rinj, emigranta politikë, mbasi harton një letër të fshehtë dërgue O.K.B-së, në të cilën pasqyrohen keqtrajtimet në burgjet politike të Jugosllavisë, largohet për në Itali. Fati e deshti me u takue me Ernest Koliqin, që e ndihmoi së tepërmi me rifillue studimet e nalta në Romë, në degën Inxhinieri Elektronike. Në këtë degë ai mbaron po me rezultate të nalta edhe Doktoraturën për Telekomunikacion. Përgatitja e naltë shkencore, i hapi rrugën drejt SH.B.A.-ve. Me referencën e profesorëve të tij filloi me punue në kërkime shkencore, në Bell Laboratories. Rezultatet kërkimore në fushën e Cardiac Pacemakers, jo vetëm i dhanë një emën të mirë, por i mundësuen punësimin në Departamentin e Mbrojtjes të SH.B.A.-ve, në Bordin Elektronik të Nëndetësve (Submarines), pranë shoqënisë së njoftun "General Electric". Aftësitë në fushën shkencore bënë që ai të ishte në krye të grupeve kërkimore, inxhinjerash shumë të zotë. Në të tana momentet e jetës edhe atëherë kur ai ishte bënë një personalitet shkencor, me krenari, asnjëherë nuk e mohoi, përkundrazi, gjithnjë e në çdo ambient e paraqitte vedin shqiptar. Tanë jeta e tij u shoqnue me mall të jashtëzakonshëm për Atdhën, për prindët, vëllaznit, motrat, miqtë e shokët që ishin në Shqipni. Mbeti deri në fund të jetës shqiptar, e vetëm shqiptar. Në vjetin 1994, kur erdhi për të parën herë në Shqipni, pata fatin e nderin me e takue dhe bisedue me atë, në shtëpinë e mikut tem, Selami Llukaçi. Ali Llukaçi ndërroi jetë, më 17 Janar 2018, në Syracuse, NY.

Gjovalin Çuni

(Mâ poshtë, me qëllimin e mirë të njohjes së një personaliteti të rëndësishëm në fushën e shkencave; një biri dhe qytetari të Shkodrës, jo i njoftun aq, dhe si duhet, po botojmë, me lejen e familjarëve të tij, letrën e plotë që Dr. Ali Llukaçi i dërgon familjes, miqve dhe shokëve, menjëherë sapo kishte rënë regjimi komunist në Shqipëni)

**“S.K.S.K.S. – SA KAM SHPIRT KAM SHPRESE”**

**PREJ DHENAVET TE HUEJA**

Ndër toka të hueja për shqiptarët e mjerë nuk ka festime. Aty, ata qeshen vetëm në kllapí. Mendja tyne mbetet gjithmonë në Shqipni



ku sod po vuejnë. Çamët ju nënshtruen fatit të zi. N'Ulqin e në Tivar, në Plavë e në Guci, e në Kosovë e në Metohi, halá buk e gjak po han shqiptari. Mbrenda e jashtë kufijvet të Shqipnisë së coptueme ata vriten e vuajnë sikurse jo në vend tjetër të botës."Zot, pse na lëshove doret. Sa larg jam prej Shqipnisë e prap sa afër e jam. Jam në Breg të Ranës (në liqe të Shkodrës) e jam në breg të Kirit e të Drinit. Jam në kalanë Rozafat të Shkodrës, pranë murit ku kullon tamel prej gjoksit të nuses së re, që sikur e thotë gojëdhâna, u vorrue për së gjalli. Jam në Xhami të Kuqe e në Xhami të Bardhë e në teqe të Bektashijve të Shkodres e në Kishë të Madhe e në kishë të Thethit, te kaskada ku uji then qafen. Jam në akulloret e Pletkës së Madhe e Pletkës së Vogël, në majë të bjeshkës që bora shekullore nuk shkrihet as në zhegun e gushtit. Jam në Shkodër të rrethume prej Maranajt e Taraboshit si një amfiteatër madhështor, por ku sod jetohet drama mizore e klikës së kuqe ku nuk ka spektatorë porse ku edhe pleqt e fëmijtë janë viktima reale. Jam në Tiranë e jam në Gjakovë e jam në Mitrovicë. Jam në katër qoshet e Evropës, në Romë e në Stamboll, në Paris e në Zyrih e në sa qytete të tjera e në katër anët e Amerikës. Kudo e marr Shqipninë me vedi, Shqipninë që njoj e prap nuk e njoj.

Si fëmi mora rrugën e gërbetit. Më kujtohet kur, me Babushin prej Janinet, burrë plak me flokë të bardha, kalova kufirin që copton Shqipninë. Të dy kjame me lot ndër faqe, kur dolme në Gjakovë. Unë kjava për prindët, vllaznit e motrat. Ai kjau për fëmitë, nipat e mbesat. Kosova nuk âsht ndryshej prej Çamërisë që e lashë kur isha halá i ri, tha Babushi. Të dy kjame për Shqipninë e mjerë, për miqtë e për shokët.

Sa herë shkova, vetëm, në breg të oqeanit, në Cliff Walk, në Rhode Island, ku jetova për disa vite. Shpesh pushojmë në një shkamb të naltë me shikjue kah vendi ku linda, ku vdiqa disa herë e prap jetoj. Andrroj Shqipninë me një mall që nuk shuhet kurrë. Edhe arbneshët kanë bâ të njahten gjâ për qinda vjetsh prej bregut t'Adriatikut e halá vazhdojnë. Valët e mëdha përplaseshin me zhurmë e me vrull kundër shkambit që ka qenë aty për qinda vjetsh. Unë jam shumë nalt për to. Valët kthehen mbrapsht, të thyeme marrin shumë gurë me vedi. Unë mbetem aty, shikjoj larg këndeje e qaj. Jam në tokë të huej e jam në një Shqipni të vogël e jam në një Shqipni të madhe (Shqipni të plotë).

Disa herë fluturova përmbi Shqipni, nalt shumë nalt në qiell, përmbi grumbuj resh të bardha si lamsha mëndafshi e mendova. Aty poshtë

janë njerzit e mí. Aty poshtë është Nana e jeme e dashtun me zemër të thyeme e me zemër të mbushun, tue ju lutë Zotit për mue. Aty është Baba plak, aty janë vllaznit e motrat e miqtë e shokët. Disa kanë vdekë e disa janë të vdekun të gjallë. Jetojnë me një shpresë që nuk vdes e që mbetet gjithmonë e re. Aty është Vehibja e shtangueme dhe Qazimi i shkretë, prindënit e Bardhoshit në qoftë se janë halá gjallë, që më deshtën aq fort e që zemra më pikon gjak për to. Edhe ato i luten Zotit për mue. Aty janë motrat e Bardhoshit, Pertefi e Drita e Bixhani, e sa e sa të tjera. Pyes e pyesim: "Kur Zoti do përgjigjet?" Prej dritares së vogël n'anë të majtë nuk shof kurrigjâ tjetër, veçse rë të bardha, por mendoj çka lashë atje poshtë. Sipër, përmbi rë është drita e madhe që të merr sytë. Aty poshtë të gjith janë në terr, ata që mizorisht sundojnë e ata që të pa përkulun qëndrojnë mizoritë që historija nuk i njofti deri tash. Më kujtohet xhamija e vjetër e Drishtit, me mindare të thyeme. Me mend jam tue ju ngjite malit në rrugët zig-zage të kambësorëvet. Ndjeki kryqat e drunit, vue aty për me pushue. Këto kryqe të përkulun, janë gjithmonë pranë një prronit, me ujë si akull. Edhe unë jam i lodhun prej udhëtimit, djersë e ftoftët ma mbulon ballin. Sa do të dishrojshe edhe unë me pushue aty, me u ulë e me pi atë ujë me buzët e mija të thame prej mallit për vendin t'em. E kaloj qiellin shqiptar e fluturoj përmbi vende të hueja, por prap me mend e me shpirt jam në Shqipni.

Prap jam tue ngjitë asaj rrugës terthore ndër pyejet e Dugagjinit ku shof gra me buljera në shpindë, malcore të reja e të veja me fëmijë jetima për doret. Aty ku rreth votrës dikur burrat kuvendojshin e lahuta me një tel i këndonte zemrës për Mujin e Halilin dhe herojt e lashtë, banesat tash janë të shkrueme. Tash, as lahuta, as çiftelija, as fyelli e as zumbarja nuk digjohen mâ. Aty ku i zoti i shtëpisë, tue i hapë derën mikut i thotë "mirë se të ka pru e djathta e Zotit", pa pvele se prej kah po vjen, sa ke me ndeje e kur a por ku do të shkojsh; aty bujarija nuk do të ishte ndryshej për Zotin vete. Aty Prelë Alija e të tjerët më thirrën Shkodrani i vogël. Ky kje emni jem për to. Edhe aty tesh, malcorët si kudo tjetër janë të vramë ose janë ndër burgje ose janë në mal me pushkë në dorë. Në shi e në borë ata flejnë në shkamb, aty ku i nxen nata.

Prap kthehem në Shkodër. Më kujtohet shpija ku linda e u rrita. Me kujtohet shpija ku i thashë babës lamtumirë, për mos me u pa mâ; ku i thaçë nanës me lot ndër sy, lamtumirë Loke, e vllazënvet e motravet halá fëmi.

Edhe unë isha fëmi e prap mbeta fëmi jetim, larg prej vendit që u rrita, larg prej njerzvet të mij të dashtun.

Halá udhëtoj nëpër vende të huaja pa paqe në zemër. Kam gjithçka e nuk kam kurrëgjâ. Zbres prej aeroplanit, por prap si shumë të tjerë mbetem një udhëtar pa cak, pa destinacion.

Kam kenë deri tash i detyruem si shumë të tjerë me e pa vendin t'ëm vetëm n'andërr. Një e drejtë që m'âsht dhanë prej Zotit me kenë mohue prej shqiptarëvet sovjetikë. Ne na âsht mohue e drejta me jetue të lirë, na âsht mohue e drejta me jetue në vend t'onë, na âsht mohue e drejta me jetue si shqiptarë. Turp e faqe e zezë për ata që e shkaktuen.

Sa herë më kujtohet fëminija.

Me kujtohet shkolla e Perashit. Isha në klasat e para ku me dy shokë e me tri shoqe, në një mbasdreke të bukur pranveret shkueme me shetitë ndër kodrat e Draçinit. Pamja e qytetit âsht shumë e bukur prej atyne kodravet. T'ulun n'atë barë të njomë sikurse na vete, ishim të dejun me ndjenja të pa-fajshme që porsa kishin fillue me marrë formë. Murmurojshim si fëmitë që por sa fillojnë me folë. Murmurojshin fjalë që nuk kanë kuptim. Kishim turp me i shikjue vajzat ndër sy e më thanë çka dishrojshim me thanë. Na u merrte goja. Vajzat me shumë naze e sy të mekun nuk na vunë faj, nuk u qeshën me ne. Ato e kuptuen se ishim halá të vegjël e që kishim kohë me mësue. U bame vone, na nxuni nata. Për ngut zbritme prej kodravet tue ngâ. Pse kaq vonë më pveti nana, e pse i ke faqet kaq të kuqe, a ke zjermi e ku ke kenë deri tash? Fillova me folë shumë. Shumë e mâ shumë kur u kthye baba. Nuk deshta me e lanë nanën me folë, me u zgjatë me pyetjet e saja. Në shkollë fjala doli shpejt. Të gjithë shokët e shoqet filluen me folë për sherrin tonë të pafajshëm. Mendoja a thu atyne iu kujtohet. A thua ata janë halá gjallë, a por jam prap vetëm që jetoj me keto kujtime?

Fëminija jonë kaloi shumë shpejt. Anmiqtë e vendit na grabitën fëmininë. Na u rritme si stinat pa pranverë.

Shkolla u mbyll për ne, porse u mbush me ushtarë të huej. I hueji e kishte zaptue vendin t'onë e lufta per çlirim shpërtheu në çdo qytet e në çdo katund, ndër male e ndër fusha. Kangët e lirisë e zani i pushkëvet ndigjohesh ditë e natë. Shumë shqiptarë u vranë tue luftue. Tash një pasjon i ri u ngjall ndër zemrat t'ona. Harruem se ishim fëmi. Menduem e vepruem si të rritun kurdo që na u dha rasti. Filluem me lujte me pushkë në vend që me shkue në shkollë. Në një nga shtëpijat e Perashit me mure të naltë, si kështjella në

vetvehte, në një ditë të bukur vjeshtet, u mblodhën disa intelektualë të rij shkodranë. Me vullnet e me shpresë u mblodhën për me folë për të ardhmen e Shqipnisë, me kenë që zaptuesi i huej kishte ditët e numërueme. Këta të rij, shumë prej tyne studenta n'universitete të jashtme, erdhën një ka një. I zoti i shtëpisë më tha me vështrve e me e lajmue nëse do të shifshe ndonji të dyshimtë që do të sillej n'afërsi. Me një thupër të gjatë në dorë u ula në një gurë, pranë një shtyllë elektriku.

Vështrojshe rrugën e i bijshe guralecavet, herë me thupër e herë me kambë.

Pështyejshe n'erë pa prâ, jo se kishe nevojë porse për me shprehë një farë arrogance fëminore, shenj rrebelimit e shenjë entuziazmit të shtrydhun. Ndëjta për disa orë nën atë shtyllë drunit, ku gotat e dritës i pata thye me lastik kështu që luftetaret për liri të mos shifeshin kur ndroreshin vend natën. Në fund këto të rij dolën tue u qeshe, dukeshin të gëzuem. Të gjithë me përshëndetën, disa më fërkuen flokët; nuk njofta asnjënin. Jam i bindun që shumë prej tyne u vranë e u burgosën kur gjoja lirija erdhi. Ndër ato shtëpijat e Perashit me pullaze tjegullash u mshoh edhe nana e Ramiz Alisë sepse ndiqej prej fashistavet. Po n'ato shtëpija tash shoh shumë nana me degërmija të bardha në krye po ashtu si nana e Ramizit. Tash ato kjajnë për djelmte e tyne të vetëm që u vranë apo u burgosën, sepse edhe një herë e çuen zanin për liri, për atë liri që Ramizi premtoi kot. Kur i hueji e la vendin, na thanë që lirija erdhi. Sa mashtrim tragjik. Na thanë që Shqipnija u lirue. Jo, jo, Shqipnija nuk u lirue. Shqipnija u coptue e u robnue si kurr përpara.

Periudha ma e kobshme që njëf historija e kombit, filloi për vendin t'onë.

Kosovarët u prune me kamiona mbas kamionash e u vranë pa mëshirë prej shkjevët të pa shpirtë; në bregun e liqenit te Shkodrës e deri në Trieshte (qytet Ilir, dikur me emën shqip Tri-heshte).

Qeverija shqiptare i tradhtoi, i dorëzoi. Turp e faqe e zezë. E kështu-e quejtuna hakmarrje popullore filloi. Po prej cilit popull, për ke me u hakmarrë, me ke me u hakmarrë, për çka me u hakmarrë? Pashë tue pushkatue shqiptarët përpara Bashkisë. Ishin me duer të lidhuna kur ranë për dhë e u lanë aty të shtriem në mes të rrugës. Kërkojshin ujë përpara se me vdekë, ia mbushën gojën me dhë. Të vdekun, u pështyen prej burravet trima të qeverisë se re. Turp e faqe e zezë. Me u hakmarrë me njerëze të pafajshëm, që për fat të

keq kishin lindë shqiptarë e dojshin Shqipninë. Me u hakmarrë për me i sherbye serbit e malazetit, me i shërbye Titos.

Tash ishte student në lyce të Shkodërs. Kjesht student i dalluem ndër mësimet, por landa ma e bukur që mësohesh në këtë shkollë ishte Shqipnija. Mësoheshe prej mesuesavet të lirisë. Shumë prej mesuesavet u burgosën. Të gjithë këta kjenë turturue e disa kjenë vra, porse nxanësat e tyne i ndoqën e qëndrimi për liri vazhdoi.

Shumë e gjatë do t'ishte lista e atyne studentavet të "Perpjekjes Shqiptare". Ah, si tingllonte kur përshëndetshim njeni tjetrin me "E jona". A ju kujtohet?

Kjo ishte një URRRA, për vendin e për të gjithë luftëtarët e lirisë. Sa e gjatë është lista, lista e profesoravet e lista e studentavet. Sa shumë do të kisha me thanë.

Më kujtohet palestra famë-keqe, ku u thirrshim për me u lajmue për studentat që u përjashtuen prej rinisë. Po kush prej studentavet kishte kërkue me marrë pjesë në organizatën e rinisë së tyne? U thirrme për me na lajmue për studentat që u përjashtuen prej shkollës për arsye politike. Po kush kishte të drejte me jua mohue nxansavet shkollimin në lyceun e shtetit? Ky nuk ishte lyce privat, nuk ishte lyceu i partisë, nuk ishte lyceu i sigurimit. Fatkeqësisht u bâ lyceu i zaptuem prej pa-dijes, prej kuqalashavet që nuk kishin asnjë cilësi morale apo qytetare.

Më kujtohen konviktorët, grup banditësh, pleh që për çdo mëngjes të rreshtuem e me hapa ushtarake, vijshin në shkollë tue këndue internacionalen e kuqe "*internacionale do të jetë bota e jonë*". Tatalushat e kuq e quejshin vedin të përparuem. Ju dukesh punë e madhe me mohue vendin e vet.

Kënduen për Titon në fillim. Të njëjtit kënduen për Stalinin ma vonë. Ky materjal i importuem (konviktoret) e i organizuem prej sigurimit filloi me rrahë studentat vendas që çuen zanin kundër tradhëtisë e zaptimit të ri. Nuk ishte e papritun me pa shkopinj tue fishkullue e gurët tue u hjedhë prej studentavet të kuq, kundra studentavet të vendit. Sa guxim për ata trima të çartun, të paguem prej sigurimit famë-keq. Po të shikojnë fëtyrat e tyne në pasqyrën e së kaluemes mendoni çka do t'ju thojnë fëmijvet....?

Rrnoftë partija, rrnoftë Stalini, rrnoftë Bashkimi Sovjetik, rrnoftë Enveri, bërtiste ky grup.

Rrnoftë Shqipnija, rrnofshin dëshmorët e lirisë, përgjigjeshin të tjerët.

Makina e zezë e sigurimit priste për ata që bërtitshin rroftë Shqipnija. Të tjerët shpërbleheshin me darka të majme e të pafund. Shpërbleheshin me mbramje gazmimi, ndërsa populli nuk kishte bukë me hangër. Nanavet tona ju binte të fikët tue pritë në rreshta përpara dyqanevet të shtetit për me ble një kilogram gjuhca me ushqye familjet. Me ushqye ata që e mbajshin barkun me dorë. Drejtori i shkollës, arsimtari i frigës e i terrorit, karikaturë e çoroditun edhe ky ishte i importuem si konviktorët, edhe ky mistrec i sigurimit. Gjeta një ditë Ndojën, shërbëtorin plak tue kja mbas sallës së vizatimit. Me zâ të marrun, e tue i fshî lotët më tha, më vjen keq, nuk mundem me bâ gjâ tjetër veçse me kja. Për përpjekjen e të gjithvet ky lyce mbeti symbol i qëndresës.

Lyceu i Shkodrës mbeti qendër kulturet, pse studentat u edukuen me librat e ndaluem, që qeverija kishte dhanë urdhën me i djegë, me djegë dituninë.

Më kujtohet kur u thirrme në palestere të lyceut për me pa Enver Hoxhën. U muer vesht që krejt rruga, prej Tiranet deri në Shkodër ishte e ruejtun në të dy anët prej ushtrisë së tij. Në Shkodër, ndër rrugët që do të kalonte, në çdo dritare kishte ushtarë të armatosun. Përpara se të hyjshim në palestër na kontrolluen që të mos kishim pushkë. Shumë prej studentavet u arrestuen. I ashtu-quejtuni udhëheqës i popullit kishte frigë prej popullit vetë. Kishte frigë prej pleqvet, kishte frigë prej fëmijvet. Ai kishte frigë prej gjakut të derdhun prej dëshmorëve të lirisë. Frigohej prej shokvet të vet, kishte frigë prej hijes së vet. Shokët e tij kishin frigë prej njeni-tjetrit. Enveri e klika e tij vazhduen me vra, me burgosë e me torturue sepse nuk i kishin lanë vedit shteg tjetër. Sa i munduen shqiptarët ndër kampet e punës. Më kujtohen fjalët e një shokut me fëtyrë të zbetë si limoni, prej vujejtjevet të burgut. Më këshilloi me vra vedin përpara se me u dorëzue. Më tha që e kishte lutë Zotin shumë herë me vdekë tek sa ishte i vjerrun prej kambëvet e ndër tortura të tjera t'importueme prej Mosket e prej Siberisë.

Prenka, plak mirditas, më tregoi se kur ishte në mal, kuqalashët ia plagosën Kolecin, djalin e vetëm. Koleci, më tha Prenka, nuk mujt me u çue mâ në kambët e veta, merrte frymë me vështirësi. Ishte dimën i ftoftë e unë nuk mujsha me luejtë Kolecin vendit. Ai m'u lut, vazhdoi Prenka, Babë, n'emën të Zotit, mos më len gjallë në dorë të tyne. Porsa Koleci e ktheu kryet n'anë tjetër i rashë tri herë me pushkë. Nuk kam mujtë me e vorrosë. Me disa gurë vuna një kryq

pranë tij. M'u banë duert me gjak kur e preka për herë të fundit. Vazhdova rrugën vetëm, atë rrugë që e filluem bashkë me Kolecin. Ishte djali jem i vetëm, përsëriti Prenka, e kam dashtë fort. Mjekra i dridhej në sa më tregonte porse nuk i delshin lot. Sytë e tij të gropuem i ishin tha përgjithmonë. Prenka nuk kishte shkollë porse kishte burrnin. Nuk dinte si me firmue por të jepte fjalën. E ndamë me të kafshatën e bukës.

Koleci ishte djalë i vetëm, sikurse Bardhoshi e Marku e Brahimin. Koleci është një dëshmorë pa emën e pa vorr, sikurse janë luftëtarët e Postribës. Kush e harron Postribën. Trupat e të vramvet shifeshin kudo, në Shkodër, te Ura e Mesit e te Kalaja e Drishtit. Vendi ndryshon, pamja mbetet e njajtë.

Sa dëshmorvet nuk ju dihet as emni as vorri. Çdo qytet e çdo katund i Shqipnisë do të flasë një ditë për dëshmorët e vet.

Kujtime të bukura të fëminisë, dishprime, për vuajtjet e papërshtueshme të popullit e malli për vendin t'ëm nuk më ndahen porse edhe shpresa për një t'adhshme shumë të bukur për atdheun t'onë asht gjithmonë me mue. Faraonvet që ngrihen piramidat me djersën e gjakut e sllavëve ju erdhi fundi në sa piramidat halá qëndrojnë. Piramidat nuk janë shprehje e madhnisë së Faraonvet porse shprehin fuqinë e sllavëve. Mumjet e Faraonvet janë vetëm shenjë dobësijet e historija e klikës së kuqe është e njajtë. Zemra jeme që i ka arsyet e veta më thotë se unë nuk jam tue andërrue një andërr. Atdhetarët e Rilindjes Shqiptare patën si moto "S.K.S.K.S" (Sa kam shpirt, kam shpresë). Kjo shpresë na bani të fortë, kjo shpresë na mbajti gjallë. Do të vijë një ditë kur flamuri pa shpatë e pa yllë do të valojë i lirë, i lirë sikurse vendi vetë. Jo aj flamur që iu përket vetëm disavet porse flamuri i të gjithëve. Jo flamuri që ndan, porse flamuri që na bashkon, flamuri që i bashkon të gjithë shqiptarët, kudo që të jenë. Të gjithë për një e një për të gjithë. Flamuri i vjetër që nuk plaket kurrë.

Të bashkuem të gjithë kena vetem një Zot, Zotin e muslimanëve e Zotin e të Krishterëve e Zotin e Atheistave që kanë një fe të veçantë. Kena vetëm një Zot, Zotin të cilit i lutena shqip e Zotin të cilit e mohojmë shqip. Ky është Zoti jonë, Zoti i të gjithë shqiptarëve. Æsht Zoti që vendosi Shqipninë aty ku gjindet edhe sod e ku i qëndroi stuhinavet të shekujvet. Æsht Zoti që na krijoi, jo Zoti që krijojmë se kena nevojë për të. Nuk ka Zot që ndanë, por ky asht Zoti i shqiptarëve e që i don e i bashkon shqiptarët.

Tash kjo ditë po vjen.

Enveri vdiq, Bashkimi Sovjetik u asgjësue prej për mbrenda e herojt e idhujt e të kuqvet nuk do të përmenden më, veçse për të këqijat e mizoritë që shkaktuen.

Vjetin e kaluem një mik i jemi më telefoni, e më tha që gjendja në Shqipni po ndryshohet. Një prej qeverisë shqiptare kishte thanë që vendi jonë do të demokratizohesh. Porse, kishte shtue, ka me marrë kohë sepse gjoja demokracija nuk është me traditën shqiptare. Po ky zotni i randë a don me thanë që kuqalashet e zbatuen komunizmin me aq përdhuní, sepse ishte në traditën shqiptare? Prijsat t'onë të lashtë kanë kenë të zgjedhun prej popullit e i shërbyen popullit, pa përdor fjalën demokraci. Shqiptarët i kanë pasë ligjet e veta popullore kur shumë të tjerë ishin barbarë. Prijsat t'onë të lashtë si të gjithë pjestarët e tjerë të komunitetit, pa dallim i bindeshin ligjevet të vendit. Ata prijsa flitshin pak, flitshin me zâ të ulët, e mbajshin kryet poshtë, porse shikojshin gjithmonë ndër sy, miqtë e anmiqtë e tyne. Ata flitshin e lejshin me folë. Fjala demokraci është një fjalë e huej, fjalë e importueme e shumë e keq-përdorueme në kohët e fundit. Sidokjotë traditat t'ona kanë kenë popullore. Kanë kenë prej popullit e për popullin.

Mandej, më tha ky miku se është hapë fjala që qeverija Shqiptare don me ba një falje (amnisti) të përgjithshme.

Sa mir i thashë, se ishte fort në marak që kuqalashat nuk do të mi falin fajet. Po çfarë fajesh kush ka me më falë? Turp e faqe e zezë. Fajtorët e kuq duhet të kërkojnë falje haptazi viktimavet të panumërta. Jo me trillue arsye për fajet e bame, jo me luejtë me falë, jo me kja me lot krokodilash, porse me u pendue. Me u pendue – mea culpa, mea culpa, mea culpa -. Me fal është virtyt e burmi, është në traditën Shqiptare, porse të kuqët nuk kanë ke me fal e për çka me falë, ata kanë vetëm me kërkue të falun.

Të kuqët nuk do të jenë mësuesat t'onë, ne nuk kena nevojë për bojna e aq ma pak për gjak-derdhje. E kaluemja e vendit e përgjakun që fushat e malet e lumejt e liqëjtë e Shqipërisë e dishmojnë i përket kuqalashavet e vetëm atyne e aty duhet të ndalet. Ajo aty do të përfundojë. E ardhmja asht e të gjithve të lirë e të bashkuem për të gjithë. Për ndryshe na nuk kena me pasë një të ardhme. Me marrë hak është në traditën t'onë porse nuk është në traditën tonë me ndye pushkën. Burri shqiptar t'a falë gjakun, burri shqiptar nuk e mundon anmikun. Si burra e për këto tradita, dëshmorët e lirisë dhanë jetën e dëshmorët janë mësuesat t'onë.



Tash kjo ditë po vjen. Qeveria e sodshme po i bjen mohit të kaluemes së saj. Qielli shqiptar nuk do të jetë ma i mbushun me yje të kuq që djegin, porse do të jetë i ndriçuem prej yjevet të panumërt që plot me dritë xixillojnë n'errësinën e natës së gjatë, që po trashigojmë. Porse pesha e randë i ngarkohet të tijvet. Ata që dikur ishin fëmij tash s'janë, apo po plaken. Të rijtë janë shpresa e të ardhshmes, të rijtë do t'a caktojnë me pasë a por mos me pasë një Shqipni, një Shqipni të lirë e të përparueme. Si ata do t'a caktojnë do të bahet. Shof shenja të mira kur lexoj gazetata e sodshme shqiptare. Shof ndër shkrimet e reja një koshiencë kombëtare të pamohueshme e pregatitje premtuese. Æsht shumë e vështire, ka shumë punë me bâ. Vendet e hueja që i shikojmë me lakmi janë ashtu sepse punuen e punojnë halá pa prâ. Përndryshe na kena ma shumë begati e traditat shqiptare janë plot me virtyte të pakrahasueshme. Bota e jashtme po na shikjon me sytë e hapun. Përfaqsesat t'onë, mbrenda apo jashtë kufijvet duhet të jenë të pajisun me dituni, me krenari për kombësi e me vet-besim të plotë për punën, jo sharlatana e jo ushujza, t'ushqyeme, me gjakun e popullit.

Bota e sodshme æsht një botë krejt e re e me shumë të paprituna; ajo i ka hallet e veta. Kurrkush nuk do të na ndihmojë po nuk e ndihmuem vetveten. Shumë të huej janë gjithmonë gadi me na dhanë plumba e konop pa pare, po qe se vazhdojme me luftue njeni tjetrin. Këtë gja historia e kohëvet të fundit na e mëson me insistim. Bota e jashtme do të na nderojë nëqoftëse të bashkuem me një qëllim të kjartë do t'i vehena punës. Me punue per vetveten e për vendin t'onë, jo për me pasunue të huejt e qeveritarët e imponuem.

Le t'a fillojmë punën, nuk kena kohë me humbë. Le të ndigojmë ç' do shqiptar që ka diçka me thanë, porse mos të flasim shumë. Mos të flasim pa dijte, mos të flasim vetëm për me folë. Të gjithë munden me e ndihmue vendin, Shqipnija sod ka nevojë për të gjithë. Nana e mirë nuk i lëshon doret fëmijtë e këqij, iu ngrehë vetëm veshin e iu mëson me durim se si me i prue nder emnit. Shqipnija nuk æsht ndryshej e nuk ban përjashtim. Përfaqsesat e vendit nuk duhet të jenë të vetë-vendosun. Flamurtarët e ri duhet të jenë të zgjedhun lirisht prej popullit e të kenë vetëm një qëllim, me i shërbye vendit edhe me vetmohim në qoftëse e kërkon rasti. Kryeplaku le të jetë kryeplak. Kena shumë shembulla të bukra prej të kaluemes.

Nuk æsht nevoja me kenë i qendrës, i të majtës a por i të djathtës; me kenë liberal apor konservator. Ky lloj karakterizimit vetëm na ndanë pa asnji të mirë. Le t'a mbajmë derën krejt hapun për dituni,

porse nuk është nevoja për ne me ndjek moden. Çdo gja që shndritë nuk është diamant. Le të përvetsojmë vetëm atë që na pershtatet, jo atë që është në kundërshtim me moralin e karakterin shqiptar. Teshat e hueja nuk na rrinë mirë në shtat. Le të mësojmë e të përparojmë, porse le të mbesim shqiptarë dhe vetëm shqiptarë, burra të ndershëm e të fjalës, burra të besës.

Sod jena shumë të vorfën, sepse klika e kuqe e la popullin si jetim në mes të rrugës, pa tasha, pa bukë, pa ilaçe. Fushat t'ona sod janë plot ferra. Nuk është punë e lehtë, por është punë krejt e bashme nëqoftëse vendosim kështu. Mos me bëmë punën me vullnetarët e detyruem ose me të burgosurit e torturuem, porse me shqiptarët e vendosun që të bashkuem çohen në kambë edhe një herë. Me bëmë Shqipninë pjestarë të denjë t'Europës, e të kulturës së saj. Mos të humbim sikurse ka humbë Maqedonia. O sod ose kurr më, nuk do të na nepet rasti përsëri. Përndryshe nuk kena me pasë me ke me i kja hallet, bota do të tallet me ne e Zoti do t'i mbyll veshët. As lahutës, as fyllit nuk ka me iu ndie zani më e gjuha shqipe në këto raste do të mbetete gjuhë kurjozitetit për linguistat e ardhshëm. Po qe se të gjithë shqiptarët, të bashkuem thrrasin rrnoftë Shqipnija, në të njëjtën kohë Tomorri e Jerovica do të ushtojnë e krejt bota do të dridhet.

Merre vedin, pra e t'u priftë e mbara o udhëtar i rrugës së gjatë. Zoti kjoftë me ty, Zoti kjoftë me ne. "S.K.S.K.S.- SA KAM SHPIRT KAM SHPRESE".

Po i shkruaj këto rreshta sepse motra jeme Myzejeni më tha me i shkruaj, Myzejeni që vdiq pa pritmas, tue m'a thye zemrën.

Po i shkruaj këto rreshta për babën që pat shumë besim në mue.

Po i shkruaj këto rreshta për nanën, Loken t'eme të dashtun që të lexoje edhe një herë pse un jam ndër vende të huaja, gati për një gjysë shekullit.

Po i shkruaj këto rreshta për të rihtë që ju uroj me zemër të gjitha të mirat, për të rihtë që të dijnë se çka ngjau me ne.

Po i shkruaj këto rreshta si detyrë ndaj deshmorëvet të lirisë të të gjitha kohënavet, dëshmorëvet me emën e atyne pa emën, ndaj atyne me një vorr e ndaj atyne që nuk iu dihet vorri, tue mendue që heshtja e tyne do te jetë forca e jonë, për një Shqipni të lirë të plote e të përparueme.

Po i shkruaj këto rreshta tue iu lut Zotit edhe për fajtorët.

Po i shkruaj këto rreshta për ata shokë që i njof e ata që nuk i njof porse që qëllimi na bashkon. Po i shkruaj këto rreshta për mallin t'em për Shqipni e fëmininë t'onë, shumë, shumë, të shkurtë.

N.Y.-Janar 1992. Firma (Ali Llukaçi)





**Nexhmi BUSHATI**

**DR. ROBERT ELSIE - DIJETARI ME ZEMËR TË  
MADHE**

*Në kujtim të një takimi të paharrueshëm*

18 maj 2016. Takova rastësisht një dashamirës, i cili më vuri në dijeni të një sihariqi sa të papritur, aq ngazëllues: në një sallë të Muzeut Kombëtar të Fotografisë “Marubi”, Dr.Elsie, personalisht, do të prezantonte 100 fotografi të panjohura të Edith Durhamit, të bëra në tokën shqiptare. U befasoja me të drejtë, sepse nuk kisha patur rastin për një informim të mëparshëm, sado të vogël. Një takim të tillë fatlum as që do ta mendoja deri në atë çast. Më poshtë do të shpjegoj arsyet e këtij interesimi tim të veçantë për këtë takim të papritur.

Studiuesi Hamdi Bushati, që në vitet '50 të shekullit të kaluar, kishte përfunduar monografinë e tij “Bushatllinjte”, në dorëshkrim. Në listën e autorëve të konsultuar e të cituar bën pjesë dhe kronisti osman Evlija Çelebi me veprën e tij “Sejihatnamesi”, përkthyer në shqip nga Sali Vuçiterni, nën titullin: “Shqipnija para dy shekujsh”, botim i vitit 1930. Ishte ky përkthim që autori H. Bushati do ta kontestonte ndër shtatë pasazhet ku bëhej fjalë për vizitën e Çelebiut te sundimtari i Shkodrës. Konkretisht, kontestimi përqendrohej te togfjalëshat “ {sipas H.B}: i biri i Jusuf Beut, Mehmet Pasha”, në origjinal: “... Jusuf-Bej-Zade Mehmet Pasha”, ndërsa {sipas S.V}: “...Mehmet Pasha i Jusuf BEGOLLIT” ose “ ...i djalit të Jusuf BEGOLLIT”. Kuptohet që përkthyesi ka rënë viktimë e llagapit BEGOLLI në kurriz të togfjalëshit i biri i Jusuf Beut”. Autorë seriozë e me autoritet (Fr. Babinger, E. Armao, S. Frashëri) nuk ranë në gabimin gjuhësor dhe t’u shkante mendja te llagapi “BEGOLLI”, kur po interpretonin shprehjet “Jusuf Bejogllu” dhe “Jusuf Bejzade” si “ i biri i Jusuf Beut” e jo “ i biri i Jusuf Begollit”. Vetë Çelebiu s’ lë vend për mëdyshje, përdërisa përdor fjalën “zade” për “ i biri”. Kontestimi i autorit Bushati ishte në dobi të një të vërtete historike duke evituar që një “lajthitje gjuhësore” mund të bëhej shkak për

argumentime të pasakta shkencore. Duke shmangur këtë lajthitje gjuhësore, i bëhet një shërbim së vërtetës historike që praninë e Begollajve në Shkodër si sundimtarë provizorë e dokumenton vetëm një shekull më vonë. Tek Çelebiu, autori Bushati gjente një tjetër dëshmi bindëse për gjenealogjinë e sundimtarëve Bushatllinj. Lexuesit mund t'i tingëllojë një largim nga tema sqarimi i mësipërm, por kjo ishte e domosdoshme për të motivuar lidhjen time me dijetarin e nderuar. Pika e kontaktit ishte pikërisht përkthimi që vetë Elsie i kishte bërë veprës së cituar të Çelebiut nga osmanishtja në anglisht e pastaj në shqip.

Janë dy email-et e bashkangjitur që sqarojnë se interpretimi i bërë nga Dr. Elsie përputhej plotësisht me atë të H. Bushatit: një distancë kohore prej 6-7 dekadash .

Komunikimi mes nesh nisi që në vitin 2015, përmes internetit. Një pengesë serioze paraqiste vështirësia për t'i vënë në dispozicion librin "["Bushatllinjët" të H. Bushatit](#)". Kuptohet se përse takimi ynë i asaj mbrëmjeje të 18 majit paraqiste për mua një kënaqësi të dyfishtë. Është me të vërtetë një privilegj të takohet një personalitet i atij kalibri, i cili të mahnit me thjeshtësinë e tij e njëheri me çiltërsinë karakteristike të një njeriu me zemër të madhe. Të hynte në zemër menjëherë dhe njeriu ndihej i shpenguar në bisedë, sikur të kishim njohje të vjetër. Të befasonte disponibiliteti i tij i jashtëzakonshëm për të të përmbushur çdo kërkesë, në një kohë që ai kishte aq shumë projekte për të realizuar. E kujt ia merrte mendja se pas disa muajsh shuarja e parakohshme do ta shkëpuste fizikisht nga miqtë e dashamirët e shumtë të tij, si dhe nga përmbushja e atyre shërbimeve që do t'i sillte shkencës në përgjithësi dhe kulturës sonë në veçanti.

Kuptohet që kujtimi i tij, ashtu si për tërë ata që e njohën e bashkëpunuan, pa përjashtuar qoftë dhe tërë bashkatdhetarët tanë, nuk do të shlyhet lehtë. Për mua do të mbeten të shtrenjta çastet që e njoha, ashtu si dhe çdo relikte (email-et) e shkëmbyer, libri i dhuruar dhe fotografitë e takimit që na lidhën së bashku.





**Sidita HALLUNI**

## **DIXHITIMI NJË QASJE E RE NË BIBLIOTEKËN PUBLIKE “MARIN BARLETI”**

Qasja informative bashkëkohore, pjesë e pandashme e bibliotekave në epokën dixhitale, shtrirja e Internetit, këtij rrjeti kompiuterik gjigand, në mbarë botën, nuk ka se si të mos të ndjehet edhe në institucionin tonë, tradicionalisht i njohur si “fole” konservatore e kujtesës dhe e trashëgimisë, dhe tani si qendër “fleksibël” informacioni.

Zhvillimi marramendës i teknologjive të informacionit, në mënyrë të natyrshme na udhëheq drejt një kuptimi të ri të rolit të bibliotekave në shoqërinë moderne.

Në mjedisin dixhital situata na paraqitet disi e ndërlikuar. Nga njëra anë, interneti lejon mundësira të pafundme qasjeje në burime të ndryshme informacioni me ose pa pagesë, nga ana tjetër, bibliotekat, si institucione sociale, duhet ta garantojnë këtë qasje në mënyrë të barabartë për të gjithë, duke marrë në konsideratë edhe kërkesat e përdoruesve.

Bibliotekat janë faktor thelbësor për zhvillimin e paqes dhe vlerave njerzore. Ato hapin një univers dijeje dhe informacioni, duke lidhur kulturat përtej kufijve gjeografik e social.

Biblioteka dixhitale është pjesë përbërëse e shërbimeve të bibliotekës që aplikon teknologji të reja për të siguruar qasje në koleksionet dixhitale, në mënyrë të shpejtë dhe ekonomike për një komunitet ose grup të caktuar komuniteti.

Duke parë fillimet e zhvillimeve të teknologjisë të asaj kohe, pra është fjala për vitin 2010, u krijua një projekt-ide që të fillohej dhe të bëhej një shërbim ndihme për lexuesit dhe studiuesit e ndryshëm, në përpjekje për të bërë të konsultueshme një pjesë të arkivit të bibliotekës sonë. Ishim të parët dhe kishim vështirësi. Biblioteka Kombëtare kishte dixhitalizuar vetëm hartat.

Në atë periudhë dixhitalizim u quajt thjesht krijimi i një materiali PDF. Mungonte eksperiencia dhe njohuritë e duhura për procesin e



dixhitalizimit. Në këtë periudhë biblioteka publike "Marin Barleti", Shkodër ka skanuar, dhe kthyer në PDF një pjesë të konsiderueshme të koleksionit të "Hyllit të Dritës", por fatkeqësisht duke mos ndjekur teknikat e duhura. E gjitha kjo punë u ripërsërit pas një viti me të njëjtin staf, dhe me të njëjtat pajisje të thjeshta duke perfeksionuar teknikat dhe metodat e punës.

Pas një pune këmbëngulëse dhe pas kapërcimit të një sërë vështirësish mund të themi se ia kemi arritur qëllimit. Kemi arritur tani t'i japim lexuesve dhe studiuesve një paketë të plotë librash, një bibliotekë që nuk ishte e lejuar të konsultohet më parë. Kjo bibliotekë në formë dixhitale e arritur të konsultohet në çdo mjedis, e të pajisur me internet rezultoi e sukseshme.

Sot, në bibliotekën dixhitale të bibliotekës "Marin Barleti" mund të shfletosh online revistën "Hylli i Dritës" me rreth 10 mijë faqe, por jo vetëm kjo. Janë një sërë revistash dhe librash të tjera që ndodhen në faqen tonë. Nga këto veçojmë:

"Kultura Islame" dhe "Fryma"; gazeta "Perlindja e Shqipnies", 15 vëllimet "Visaret e Kombit", 2 vëllimet "Shqipënia me 1937", librat e parë në shqip "Meshari 1555", "Pasqyra e të rrfyemit" e Budit, etj ... si dhe trajtesa në gjuhë të huaj si "The struggle for scutari", "Istorici delle cose Venezian", një kolanë me 10 volume, 4 Inkunabula, dorëshkrimi original i At Gjergj Fishtës "Lahuta e Malcies", kalendar etj.

Gjithsej janë 20 mijë faqe online, dhe rreth 15 mijë faqe të pa publikuar ende.

Të gjitha këto për një periudhë shtatë vjeçare 2010-2017.

I gjithë materiali është konvertuar për ëeb, por në fakt nuk gjendet i gjithi i hostuar në ëeb-sit-in e bibliotekës, për arsye të mungesës së një serveri personal.

Ndërsa, tani jemi krenar të kemi ndihmuar sado pak në proces, që mund ta konsiderojmë pjesë të asaj që quhet: "Bibliotekë Dixhitale". Nga ana tjetër, Biblioteka Publike "Marin Barleti" vendosi të bashkëpunojë me Bibliotekën e Universitetit "Luigj Gurakuqi" në krijimin e një ëeb-side të përbashkët "Arkivat Dixhitale Shkodër", dhe këtu ne paraqitemi me 3 (tre) revista dhe 1 (një) gazetë:

"Agimi", "Cirka", "Perpjekja Shqiptare" dhe "Posta e Shqypnies". Gjithsej 3576 faqe, nga Biblioteka "Marin Barleti" në këtë ëeb-side, por nuk janë vetëm këto, ka edhe të tjera materiale që janë në process, ku shpresojmë që së shpejti të shohin dritën e publikimit të tyre.

Që në momentin e dixhitimit dhe deri tani impakti i parë ka qënë i kënaqshëm, klikimet që bëhen në ëeb-in tonë, p.sh: arrijnë deri ne 70 -80 në ditë.

Puna që e kemi filluar para pak viteve, është pasuruar vazhdimisht bazuar në mundësitë e pakta teknologjike që zotërojmë. Në punën tonë më tepër prevalon dëshira për të transformuar punën dhe misionin e bibliotekës, se sa mundësia teknologjike për të ju përgjigjur aktualitetit. E megjithëatë me ato mundësi të pakta teknologjike që kemi ne vijojmë të shpresojmë që edhe në të ardhmen do të kemi një bibliotekë dixhitale më konkurrese dhe ambicioze për lexuesit e studiuesit, që janë të shumtë dhe kërkojnë vazhdimisht pasurimin e kësaj biblioteke me vepra e libra të tjerë të çmueshme që për fat të mirë i disponojmë.

Nga eksperiencia Botërore, por edhe e jona tanimë jemi të bindur që misioni i bibliotekave dixhitale siguron qasje të drejtëpërdrejtë në informacionin dixhital dhe jodixhital; qasje dhe ruajtje e trashëgimisë kulturore dhe shkencore; kthimi i burimeve të paaksesueshme në të aksesueshme; ruajtje dhe promovim i koleksioneve; përdoruesit do të përjetojnë burimin në të njëjtën mënyrë si origjinalin etj.

Me zhvillimin e teknologjisë informative në bibliotekë, mendohet se ka një rënie të interesimit për t'i vizituar bibliotekat tradicionale., *Kundera* ka lënë një lloj testamenti se: "...Askush nuk ka të drejtë të bëjë dixhitimin e librave të tij...", ndërsa, *Umberto Eco* ka thënë se: "...Duhet prekur dhe ndjerë librat ..."

Historia ka treguar që ashtu si televizioni që kurrë nuk mundi të zëvendësojë radion apo aeroplanët trenat, as botimet elektronike nuk do të mund të zëvendësojnë krejtësisht ato të shtypurat.

Prandaj, i gjithë komuniteti i punonjësve të bibliotekave e di që ndryshimet e vijueshme janë karakteristike për kohën në të cilën ne jetojmë.

Mirënjohje të veçantë, edhe për donatorët (ndonëse shumë të pakët), që kanë ndihmuar në paraqitjen e punës së bërë përmes botimit të katalogut :

Sfida të papritura mund të paraqiten në vijueshmëri, por besojmë dhe jemi optimistë, që efektet e punës së kryer nga ne dhe specialistët e bibliotekave në mbarë botën janë afatgjatë dhe duan kohë që të kenë impaktin e duhur. Nuk është edhe aq e lehtë të maten sukseset.

**Skënder TEMALI**

## **SHOQATA E SHKRIMTARËVE TË SHKODRËS - ZË I VEÇANTË NË KULTURËN TONË**

Shoqata e Shkrimtarëve të Shkodrës ka hyrë në vitin e 5-të të jetës së saj. Ajo u themelua më 14 dhjetor 2013, në sallën e madhe të Bibliotekës publike “Marin Barleti”. Erdhi si nevojë e një grupimi të organizuar të letrarëve shkodranë, pas asfiksimit të Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë e për rrjedhojë edhe të degëve të saj në rrethe.

Këto vite në jetën e shoqatës janë fare pak për të bërë histori, por mendoj se një gjurmë të gjithë bashkë, më shumë se individualisht, e lamë në kulturën tonë kolektivisht e në gjallërimin e jetës letrare në Shkodër.

Më së pari u krijua statuti dhe akti i themelimit, ku u konturuan drejtimit kryesore të veprimtarisë dhe u zgjodh kryesia e përbërë nga Skender Temali, Fadil Kraja, Dashamir Cacaj, Ledri Kurti, Mustafa Tukaj, Zija Vukaj e Xhahid Bushati.

Gjatë kësaj periudhe shoqata erdhi duke u zgjeruar me emra të rinj krijuesish dhe sot ajo ka të regjistruar 67 anëtarë, të cilët, kush më shumë e kush më pak kanë kontribuar me vëllime në prozë, poezi, studime, kritikë e përkthime, shpesh duke ecur në një hap me letërsinë shqipe e krijuesit në të gjitha trevat shqipfolëse. Nga themeluesit deri më sot, u ndanë nga jeta disa anëtarë: Skënder Drini, Adil Zeka, Vehbi Fishta e Smajl Alia, emrat e të cilëve do mbeten përjetë të spikatur për kontributin e vyer që dhanë në zhanret që lëvruan.

Pas njohjes zyrtarisht nga Gjykata e Shkallës së I në Tiranë, shoqata fitoi të drejtën të krijonte logon e vulën e saj dhe shumë shpejt, në mënyrë profesionale e si pak shoqata homologe në vend, krijoi në internet portalin e saj të veçantë në Google, në emërtesën [www.shoqataeshkrimtareveshkoder.com](http://www.shoqataeshkrimtareveshkoder.com) ku u pasqyruan të gjithë anëtarët me jetëshkrimet letrare e foto si dhe krijimet e tyre më përfaqësuese

të kohëve të fundit në poezi, prozë, studime, përkthime e kritika. Kjo faqe është vizituar nga dhjetra mijëra vetë, ku më i lexuari rezulton të jetë Albri Brahusa, tregimtar e dramaturg, me 3421 klikues deri në shkurt të 2018. Krijimi i kartave të anëtarësisë me foto të gjithsecilit, me logo e plastifikim, qenë gati të afërta me kartën e identitetit, duke i dhënë edhe një seriozitet këtij organizmi letrar. Me gatishmërinë e anëtarëve u botuan tre volume të antologjisë “Pena e Shkodrës”, me afro 1500 faqe, u organizuan dy manifestime të mëdha letrare, “Pranvera poetike shkodrane” e “Vjeshtë në Shkodër” me të ftuar edhe nga shoqata të tjera homologe nga vendi e shqiptare nga Kosova e Mali i Zi, u shpall çmimi letrar mbarëkombëtar “Skënder Drini” në gjininë e tregimit, që u fitua nga Erion Fiqiret Temali, u organizuan dy konkurse të mëdha poetike dhe shumë nga anëtarët u ftuan e bashkëbiseduan në shkolla të niveleve të ndryshme në qytet e në fshat. Pjesëmarrja e shkrimtarëve të shoqatës në Festivalet letrare të Bibliotekës publike “Marin Barleti” të qytetit në tetorët e kaluar që një tjetër kontribut për afrimin e tyre me lexuesit. Lidhjet e ndërsjellta me shoqata homologe letrare si brenda e jashtë Shqipërisë shërbyen shumë për njohjen e krijimtarisë së njëri-tjetrit e të përcimit të saj tek lexuesi, jo pak i larguar nga konkurimi i internetit. Në gazetën letraro-kulturore “Nacional”, në dy numra radhazi, u përfaqësuan të gjithë poetët e shoqatës. Mjaft shkrimtarë morën pjesë me analiza kritike e krijimtarinë e tyre, kryesisht poetike, në tubime veçanërisht të Kosovës e të Malit të Zi, madje duke marrë edhe çmime, ku meritojnë të përmenden Dimitrov Popoviq, Farida Ramadani, Mimoza Rexhvelaj, Fatbardha Behri (Kaçi), Diana Çelepja, Bledar Tafaj, Zija Vukaj, Skender Temali etj. Ndër sukseset më të spikatura vetiake të anëtarëve të shoqatës brenda këtij 5-vjeçari është fitimi i çmimit të dytë të dramës shqipe në Konkursin Kombëtar nga dramaturgu Mustafa Tukaj, nominimi në Konkursin Kombëtar të letërsisë në pesëshen më të mirë të shkrimtarëve shqiptarë për vitin 2017 të Meritan Spahisë me vëllimin e tij me tregime, përfshirja e poetit Davit Boseta në antologjinë botërore në Kili me një poezi, etj. Risi sollën takimet me shkrimtarët e njohur malazezë Goranoviq e Zyvdija Hoxhiq, që shërbyen për shkëmbime kulturore si dhe pjesëmarrja e një grupi shkrimtarësh shkodranë në takimin e veprimtaritë 3-ditore në shtator të vitit të kaluar në Bjello Polje të Malit të Zi mes shumë poetëve të disa shteteve, që nga Kina në

nderim të një poeti të njohur malazez.

Gjatë kësaj periudhe, kush më shumë e kush më pak, thuajse të gjithë, kontribuan në gjallërimin e jetës së shoqatës me pjesëmarrje e diskutime, por dua të veçoj për analizat e mendimet e pjekura Mjeshtrin e Madh Fadil Krajen e me radhë pastaj Skënder Drinin, Zija Vukën, ish-sekretarin e shoqatës, Dashamir Cacajn, Dimitrov Popoviqin, Ermira Alinë, Ledri Kurtin, Zenepe Dibën, Ermira Ymerajn, Kadri Fikajn, Kadri Ujkajn, Luigj Temalin, por dhe skulptorin e njohur Ferit Kola, i cili edhe pse jo anëtar i shoqatës, e ndoqi atë, duke dhënë edhe mendime të vyer.

Veprimtaria e shoqatës nuk do të ishte kaq intensive, nëse nuk do të kishim mbështetjen maksimale të drejtorit të bibliotekës, Gjovalin Çuni e stafit të tij.

Një falenderim shkon edhe për biznesmenët Gjergj Leqejza e Ketii Bazhdari që e mbështetën shoqatën në mirëfunksionimin e veprimtarisë tona si dhe kontribuesit kryesorë të botimit të tri antologjive "Pena e Shkodrës", shkrimtarët-anëtarë të shoqatës, Rush Dragu e Lulash Palushaj, të cilit, në vitin 2015 nga presidenti i Republikës iu dha titulli "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut" për krijimtarinë e tij të spikatur studimore e letrare, veçanërisht të përshkrimt të Malësisë së Madhe. Për mirëfunksionimin e disa veprimtarive të shoqatës duhet përmendur edhe shkrimtari tjetër shqiptaro-amerikan, autori i disa vëllimeve në poezi e prozë, Shyqyri Mollaj.

Ç'e bën zë të veçantë shoqatën në kulturën tonë? Padyshim analizat e mirëfillta ideoartistike e kritike të veprave të reja të anëtarëve, duke zbuluar vlerat e tyre, qasjet me nivelet bashkëkohore të letërsisë shqipe, pa kufizime nëse ishin apo jo në standardin letrar të gjuhës sonë, pra duke botuar e promovuar edhe në gegnisht. Ftesa që në foltoren e shoqatës të kumtonin e të bashkëbisedonin për problemet e letërsisë bashkëkohore edhe figura të spikatura të letrave shqipe, si Zija Çela-Nderi i Kombit, mjeshtrit e Mëdhenj Moikom Zeqo, Xhevahir Spahiu e Petrit Ruka (siç qe rasti në promovimin e dy librave të poeteshës së re Amina Meshnuni), shkrimtarët e njohur Nasho Jorgaqi, Nikolla Spathari e Demir Gjergji etj. Krijimi në portalin e shoqatës të rubrikës së talenteve të rinj dhe i të gjitha veprimtarive, shoqëruar edhe me foto e video krijonin një atmosferë vlerësuese. Në propogandimin e krijimeve të reja e të veprimtarive promovuese ka shërbyer e po shërben edhe krijimi në facebook i

faqes së shoqatës me emërtesën Shoqata e shkrimtarëve Shkodër. Afrimi në shoqatë i vajzave e grave që një tjetër risi, pasi gjithnjë e më shumë zëri femëror iu bashkua me dinjitet «korit» të të gjithë krijuesve me përvojë e botime dinjitoze.

Gjatë këtyre viteve të jetës së shoqatës pati një “bum” botimesh e promovimesh, ku skalitën edhe më tej individualitetin e tyre liriku Mehmet Gucia (lëvrues edhe i haikut bashkë me Lazër Prekën), Burhan Kurti, publicistët e shkrimtarët Bedri Islami e Prelë Milani, Luan Qalliu, poet e prozator, Freskida Plepi - poeteshë e re, historiani Mithat Dibra, Broz Simoni, Nik Bunjaj, Qazim Çela, Vera Sakaj e Sadetin Limani, Lisandri Kola e Smajl Bala, etj. madje edhe anëtari i shoqatës Ilir Bala me karikaturat e tij fine e përcjellëse mesazhesh bashkëkohore, tashmë të denja për një ekspozitë personale apo album.

Siç ndjehem krenar se qeshë njëri nga bashkëthemeluesit e shoqatës e që për 4 vjet e drejtova atë duke patur në krah shumë bashkëpunëtorë, deri dhe aktoret e teatrit “Migjeni”, Merita Smaja e Rajmonda Marku, jam i vetëdijshëm se si kudo, edhe në të tilla shoqata vullnetare, duhen respektuar statutet e miratuara që në krye të herës, mes të cilave edhe mandati 4 vjeçar i kryetarit. Jam shpresëplot se kryetari i ri i sapozgjedhur, studiuesi, përkthyesi e eseisti i njohur Zija Vukaj do ta çojë më tej veprimtarinë e shoqatës përmes vizionesh të reja që kërkon koha.

**Xhahid BUSHATI**

## **JETË NGA JETA E SHKRIMTARIT SKËNDER DRINI**

*-triptik kujtimesh-*

### **1. Një ditë...**

1.

Shumë njerëz e njohin... Por... ka edhe nga ata që nuk e njohin shkrimtarin Skënder Drini. Nuk mbahet mend që moti, por për dikë nuk ka dhe shumë rëndësi data, viti dhe koha e, kjo s' do të thotë që ai nuk e di, (e mbart si relike në kujtesë): kur dhe si erdhi i biri i prefektit Riza Drini i dashuruar si fanolist, të jetojë në Shkodër...

Në këtë marrëdhënie më shumë se një gjysmë shekulli me këtë qytet Verior, vallë ky qytet e 'shkodranizoi' Skënderin, apo Skënderi e 'shkodranizoi' këtë qytet?.. Apo ende nuk e kanë gjetur emëruesin e përbashkët drejt një etaloni vlerësues, respektues, miqësor e të sinqertë... Apo ende janë në kërkim të njëri-tjetrit... Apo...

Në përfundim: Qyteti Verior e Skënder Drini, kanë secili një profil, një identitet e një gjurmëlënie...

Skënderi ka lindur në Voskopojë (Korçë). Teksa flet për një problem a teksa qesh (dhe rrallë qesh), zëri i tij, tani, më ngjan si një serenatë e harruar korçare por edhe si një jare shkodrane ende e pa mësuar deri në fund. Por... për Shkodrën, për rrënjët, traditat dhe historinë e saj të flet imtësisht dhe me kompetencë, aq sa edhe dituria e ndonjë intelektualit shkodran është i detyruar 't'i hapë udhë...' rrafshit kulturor të eruditit kureshtar Skënder Drini.

Në këtë qytet Verior, e njohin dhe s'e njohin tregimtarin, romancierin, diplomatit dhe analistin Skënder Drini. Në jetën e tij shkrimore, këtij qyteti i ka falur romanin "Vraje tradhtinë", për ta bërë atë të pavdekshëm. Në këtë hulli letrare më shfaqet edhe libri "Tregimet e Veriut". Si simbolikë a diçka më tej, më sjellë pranë zërin e Migjenit me "Novelat e Veriut". Vërtet, në këto libra jetojnë e trazohen kohëra me problematika të ndryshme, me pika të largëta

horizontesh shikimi, por që zbulojnë afri e shtigje takimesh... Kohë shkrimtarësh apo shkrimtarë që kanë fiksuar kohën?.. Në këtë marrëdhënie Koha lëviz, flet dhe në heshtje prapë flet... Në mes tyre, si një zonjë e rëndë, rri Pavdekësia, si një memorialistikë vlere kushtuar njerëzve që u kërrusën dhe u thinjën, nga që i kishin dhënë 'besën' diturisë e kulturologjisë, shkrimtarisë.

2.

Ditët e Skënderit janë aq të zakonshme, të dukshme e të përceptueshme, sa nuk e ke të vështirë t'i rrëfesh. Rrëfimi është i thjeshtë, i natyrshëm e njerëzor për një personazh stoik që kohës i ka bërë sfidë, ndërsa, vetë, koha në këtë "dyluftim" nuk është treguar dhe aq bujare, përkundrazi vende-vende është treguar e pamëshirëshme. Çuditërisht, këtë mungesë të hapësirës në jetën e tij njerëzore nuk e ka ndjerë hapësira e prozës së tij artistike, ku gëlojnë natyrshëm, si: filozofia, poetika, meditimi, simbolika, kontrasti, sugjestionimi, pasuria leksikore dhe fraza e ngjeshur me domethënie e ngarkesë emocionale. Të gjitha këto më sjellin para syve romanin "Korbi", do ta quaja një kod identiteti në opusin romanesk të Skënderit. "Korbi, - siç do të më thoshte Skënderi, shumë vite më parë, gjatë një bisede një ditë, - është një histori e gjatë, një eksperiencë e imja e shumë viteve më përpara, 60 vite a 70 më përpara në Turqi, që unë kam pasur rastin të shoh e të njoh një korb që fliste disa fjalë. Unë kisha elementin e parë, korbin që fliste pak fjalë, por më ka intriguar vite me radhë, por nuk kisha pjekur e kristalizuar filozofinë e veprës. Unë e ndieja që e kisha këtë korb, dhe gjatë viteve filozofia u kristalizua, u qartësua dhe doli romani. Unë nuk besoj që jo të gjithë emigrantët i ka pritur një korb, sepse jo vetëm fati i emigracionit shqiptar, por edhe fati i emigracionit në shkallë botërore ka notat e veta të dhimbshme e të trishtuara dhe, fillon me një hap mjerimi do të thosha unë, dhe ekzistojnë më të fortët, ata që jetojnë dhe mbijetojnë. Duke e shkruar këtë vepër unë kam kujtuar Xhek Londonin, "Dhëmbin e bardhë", romanin e tij. Në kohën kur doli kjo vepër, një pjesë e kritikës tha: pa qenë **qen** Xhek Londoni nuk mund ta shkruante këtë vepër. Edhe gjatë veprës kam menduar shpesh, se pa qenë **korb** nuk mund ta shkruaj këtë vepër." Ditët e Skënderit janë të ngjashme me njëra - tjetrën. Përgjithësisht ka një orar të paradites, kur del nga shtëpia. Ecën në këmbë. Trotuarit. Hapat e tij nuk dëgjohej, aq të butë janë. As nuk trokasin. As nuk



zhurmojnë. As nuk tërheqin vëmendje. Ecën i menduar. Gjithmonë me një vatër letërsie a motiv që rrinë ndezur pandërprerë... Me sy të palëvizshëm, që të vështrojnë pa ia nda e e të përkëdhelin edhe në heshtje. Sy që të flasin për pafajsi. Miqësisht të vë dorën mbi supe. Dorë që nuk të vret. Dorë që të lëmon si një pendë zogu e të fal fluturime. Mbase, ti, nuk e ndjen, por gishtrinjtë e tij po aq sa janë plakur, po aq janë rrudhur, po aq të zverdhur. Me cigaren që ndez cigaren... (Ndoshta kjo është arsyeja që ende nuk ka bërë një tregim kushtuar shkrepes...) I heshtur. Edhe në mbretërinë e kësaj heshtjeje, Skënderi: sa lë gjurmë urtësie aq lë gjurmë hallesh, por... kujdesshëm edhe gjurmë lavdie.

Qëllon gjatë rrugës, shpesh qëllon që një makinë t'i ndalet pranë. Nuk e tremb. E bën të kthejë kokën ngadalë i shoqëruar me një vështrim përhumbers. Janë nga ata miq që e njohin, por janë edhe nga ata miq që s'e njohin. Ka nga ata që e njohin së largu, ashtu siç ka nga ata që nuk e njohin së afërmi. Ia humbasin kohën e rrugës, por ia shpejtojnë kohën e ndenjes për diku... E favorizojnë.

Si çdo ditë, edhe sot, e pret lokali i përditshëm me emrin "Venecia", që është në pronësi të ish boksierit të talentuar Besnik Gjetja. Shpirtzemërgjerësia e tij i fal shkrimtarit Drini në çdo moment ngrohtësi njerëzore. E pret një ndenjese, ku nuk ulet askush. E pret një kafe me shumë kafe në një filxhanjo të zakonshëm. Sjell nëpër mend e përcjell në atë rruftije traditën e kafes shkodrane. Pastaj avazi i zakonshëm, por jo bezdisës, i ndezjes së cigares që s'ka të pushuar e shuar. Pastaj shtëllungat e hirta të tymit, që e mbulojnë si padashur shkrimtarin që më shumë hesht se sa flet, të cilat sikur e degdisin në kohë dhe e risjellin përsëri... Duket sikur i ngjan një personazhi absurd i një kohe absurde. Pastaj çdo gjë fanitet dhe vazhdon biseda me përditshmërinë e saj. Pastaj..., siç i quan ai njerëzit e tij më të shtrenjtë të gdhendur e përjetësuar në tregimin "Testamenti", vijnë në orare të ndryshme: Kali Arab, Dhelpra, Kokëforti Aktiv, Pacuku, I sinqerti, Topi me dhjamë, Daja, Gjenerali... "Dihet, - shkruan shkrimtari, - që këto nuk janë emra të vërtetë, por pseudonime që unë i kam vënë për t'i përkëdhelur dhe llastuar... .. Balzaku i madh, dhe një varg balzakësh më të vegjël se ai, na kanë kujtuar se, atij që merr mundimin e madh për të lënë një testament, i faniten përpara syve portretet e njerëzve që e kanë rrethuar nga afër në jetë." Dhe aty, përkrah tij janë, flasin, frymojnë, heshtin e jetojnë personazhet e tij, që mbartin plot histori

e plot copëza jete të çdoditëshme. Kështu dhe lind një tregim prej tij si një mbresë e çastit. Kështu, disa janë kthyer në personazhe, të tjerë së shpejti do të jenë të tillë. Tani lokali në sytë e botën e shkrimtarit nuk është më lokal, por një muze me objekte-njerëz që për ta flasin testamentet-Jetë përmes lëvrimit të tregimit të shkurtër. Kohët e fundit shkrimtari Skënder Drini pikërisht kësaj gjinie të vështirë po i rreket. Siç duket në rrjedhën letrare ka ende për të thënë, a testamentit ende fjalë për t'i shkruar. Kjo marrëdhënie me këtë gjini që zakonisht shkrimtarit i fal mjeshtëri e zotësi mbetet "një pikë e dobët dhe e vështirë, por jo e pakapërcyeshme" edhe në jetën letrare të Skënder Drinit, se "...duhet të thuash diçka të madhe brenda pak faqeve. Kërkon koncentrat absolut."

Teksa lexon prozën e shkurtër të Skënder Drinit, vetiu të vjen të përmendësh: Çehovin, Turgenievin, Mopasanin, Buxatin, etj. Bën përpjekje të rikujtosh e ta qasësh me një autor shqiptar... Por tipologjia e tregimeve të Skënder Drinit ka tipare dhe veçoritë e tij, të papërsëritshme. Nuk gjen një të krahasuar, ndonëse vatrat poetike që u ngjajnë flakadanëve olimpikë jetojnë edhe periferive. E, duke iu risjellur këtyre tregimeve, nuk e ke të vështirë të dallosh filozofinë e shkrimtarit, skalitjen e personazhit, kompozicionin e kujdesshëm dhe delikat, ndërtimin e frazës me ngjyra poetike, kontrastuese, e me një emocion që të rrëmben falë një kulture të admirueshme. Se, edhe sot e kësaj dite, veçanërisht kur nata i fal qetësinë shkrimtarit, i cili s'mund të jetojë pa të, ai nis dhe shfleton letërsi të huaj... Takimi me prozatorë të mëdhenj të njohur e të panjohur i dhuron, si gjithnjë, planete të reja shkrimtarie dhe jo "...planete të lodhura" - siç do të thoshte diku në një krijim të tij shkrimtari Drini. Nata... për romancierin Skënder Drini!.. Natën punonte dh Kafka. Natën punonte dhe Frederik Rreshpja.

Skënder Drini është një nga ata shkrimtarë me emër të letërsisë shqipe, që panteonit të letrave dhe bashkëkohësve, si testament u ka lënë këto vepra, si: "Tregimet e së shtunës", ndonëse shahu si lojë brenda shpirtit të autorit i ka mbetur si një vegim i largët, por me një marrëdhënie dashurie si në rini; "Shqipja e kreshtave tona" (dy vëllime), "Midis dy kohëve" etj., ku historia ngjan, sikur zëvendëson realitetin ekzistues; ndonëse janë të njohura në jetën e krijuesve ikjet nga realiteti dhe bashkëkohësia, kur ato shtypin jetën dhe botën e shkrimtarit; "Shembja e idhujve", "Kirurgët", "Tanush Martini", "Nata është grua", "Kthim në vetvete", "Njerëzit dhe

deti", "Klass", "Parajsa e gjenive" etj., që s'u kuptuan esencialisht nga kritika jonë letrare, e që realisht këto vepra do t'i dëshironte t'i shkruante e ëndërronte çdo krijues...

3.

... dhe vjen një orë, kur Skënder Drini vështron parreshtur orën. Nxitimthi, do të thosha. Sikur ka ngut, sikur ka ankth, sikur po i ikën koha... Sikur... E vështron përsëri e përsëri... I duhet të ikë. Ikën, jo në vetmi. Njëri nga personazhet me nofkën përkëdhelëse e llastuese vënë enkas nga shkrimtari, e përcjell... Ky është Kokëforti Aktiv. (Shpesh e përcjell dhe Gjenerali.).

Biseda vazhdon, e jeta sjell copëza jete...

I duhet të largohet. Të gjithë e dinë, përse ai largohet. Nuk e pyesin... Në jetën e zakonshme, që duket sikur Skënderit i kanë mbaruar pretendimet, shëtit me të edhe një e fshehtë e çmueshme: dashuria për Karolinën e tij të dashur e të shtrenjtë, dashuri deri në amshim e sakrificë deri në hyznizim. Edhe këtu fjalët janë shumë të pakta... Më shumë heshtja me sigurinë e testamentit të saj është bashkëudhëtare e tij. Heshtja si filozofi e të jetuarit si një tjetër realitet, duke sfiduar provincën e rutinën, mërziçjen e ordinerinë... Kulturologjia i jep forcën e të jetuarit e të ekzistencës, qoftë për të lënë edhe një shenjë mbarësie, të cilën po e lë me madhështinë e talentit të tij. E tillë është rruga e këtij njeriu të vërtetë, që përsëri në heshtje të thotë: "Në mes të librave të mi kam "Origjina e species". Jam i bindur që pas kaq mijëra vjetësh marrëzije, do të mbetet si libër i shenjtë. Dua ta marr me vete, se dua që të jem unë ai që i paraprin kësaj profecie. Ndoshta nuk e di me saktësi se çfarë jam, por nëse dikush më përziën me socialdemokratët nuk mund ta kundërshtoj me shumë forcë, por vetëm mund të them që nuk jam nga këta të sotmit, nuk ngjaj as me Shrederin që ka qenë i suksesshëm, dhe ndoshta kam një qasje vetëm me kohët më të mira të Vili Brandit. E përsëris, nuk duhet që në asnjë mënyrë të lejoni që politika të më bëjë të vetin. Nuk ka shans të ndërrohem në një dekor koket, pa e pasur në gjak koketërinë... Elada e lashtë e kishte kuptuar shumë herët, prandaj, as Leonida i famshëm nuk kishte shans të rrinte me Eskilin. Kur t'u dalë e nevojshme të më mbronin. Kujtoni si u përdor Migjeni dhe si u mënjanua Migjeni..... nuk dua funeral publik, dhe për këtë më është mbushur mendja disa vite përpara, që në atë ditën që vdiq poeti F. R. (Frederik Reshpja, - shënimi im) Bëra të pamundurën

për t'i dhënë një përcjellje publike atij, sepse as atë nuk e donin. Politika? Politika dhe diçka më shumë... .. E çova çështjen shumë lart, dhe më në fund e arrita. F. R. ishte një personazh kontravers, një njeri që kishte bërë çmos për t'i hipur me shkelma jetës së tij të vogël dhe talentit të tij të madh. Shkurt, ishte një poet. Nuk kishte asnjë shans, që ta kuptonin atë ata që kishin në duar nderimin. Nuk mund ta përtyp kurrësesi, si mund të mbetej NDERIMI në duart e tyre. Imagjiloni ç'ngjyrë merr një medalje e shërbyer nga ato duar. Jam i zemëruar, dhe po e teproj... Po, jam shumë i zemëruar se meritojmë diçka më shumë. Nuk besoj që të kem qenë ndonjëherë në jetën time më brilant se në funeralin e F. R. Fola me një dhimbje të madhe dhe me një ankth të madh. Por kur mbarova dhe, i hodha një sy gjindjes së artit dhe të kulturës që ishin të pranishëm, m'u lidh në fyt një nyje si një tumor. Dëshiroj të gabohem, po aty, me ndonjë përjashtim të vogël, kjo vdekje nuk ishte tjetër por një vdekje e radhës. Aty m'u kujtua Hygoi që bërtisterrugëve të Parisit, ndërsa po vdiste Balzaku. A e dinte Franca që po vdiste njeriu më i madh i saj? Unë nuk dua një funeral, po për këto arsye. Nuk dua as një "vdekje të radhës", as një "vdekje jashtë radhe", sepse ne nuk e duam njëri-tjetrin..."

Ditët e Skënderit janë të ngjashme si pika uji. Përgjithësisht ka një orar të paradites, kur del nga shtëpia. (Pasditeve pothuajse nuk del.) Ecën në këmbë. Trotuarit. Hapat e tij nuk dëgjohen, aq të butë janë. As nuk trokasin. As nuk zhurmajnë. As nuk tërheqin vëmendje. Ecën i menduar. Gjithmonë me një vatër letërsie a motiv që rrinë ndezur pandërprerë... Me sy të palëvizshëm, që të vështrojnë pa ia nda e e të përkëdhelin edhe në heshtje...

### 1. Te 'Venecia'... një kafe me Skënder Drinin

Shkodër, 01.01. 2015. Dal nga shtëpia ime në të njëjtën orë që dilte, çdo ditë, nga shtëpia e tij miku im, i paharruari, shkrimtari Skënder Drini. Dhe... 'vizitën' e parë, i kisha vënë vetes si qëllim, do ta bëja në kafe "Venecia", ku artisti Drini fali një pjesë të jetës së tij të çmueshme.

Enjoh mirë atë lokal. Së paku, dy herë në javë, të shtunave e të dielave para dite, aty, isha i pranishëm si klient dhe si mik i shkrimtarit. Është një lokal simpatik, që edhe me heshtjen e tij të fton. Klientët e rregullt e dijnë mirë 'sekretin' e derës së këtij lokali. Dera e tij është shpirti i pronarit, një pronar si Besniku që fal dëlirësi, buzëqeshje e

mirësi. Këtu hyn pa trokitur. Kështu hynte Skënder Drini, kështu hyjmë dhe ne...

Emri që mbart lokali është larg gondolave veneciane. Ndonëse me Venecien këtë lokal e ofron uji i rrëmbyeshëm apo përmbytjet që pëson në mënyrë të beftë ky qytet. Është pranë monumentit të 'Katër Heronjve të Demokracisë'. Përreth gëlon gjelbrimi, që shpesh na mungon a na merr malli për të. Çdo 2 prill kujtohen heronjtë. Mbi mermer u vihen kurora, tufa lulesh e lule, nderohen... I nderojnë para një monumenti... të pa përfunduar ende. Të tilla simbolika në këtë gjendje, nuk mund t'i artikulojnë mesazhet plotësisht.

Rrugës më shoqëron një qiell kujtimesh për ty, miku im!

Dita e parë e këtij viti të ri është e ftohtë. Me një erë idhnake që t'i skuq faqet dhe hundën. Janë të zakonshme për këtë qytet, por jo për ata që nuk janë mësuar t'u skuqet faqja.

Rruga ku po eci, 'frymon' nga kalimtarë të rrallë. Rrugë ku shëtit malli!

Unë vazhdoj të hedh hapin. Rruga është paralel me teatrin "Migjeni". Në skenën e këtij teatri shumë vite më parë u shfaq drama "Rrënjë të hekurta" e Skënder Drinit. E rikujtoj mirë at' dramë. U shfaq në një kohë, kur teatri kishte marrë goditje nga liberalizmi i tepërt. Drama u shfaq. Do të shkonte edhe në një festival teatror. Nuk pati pritshmërinë e duhur. Mendoj se nuk u kuptua as nga regjisori, as nga kritika letrare dhe as nga juria e festivalit në të cilën konkuroi pjesa. Një nga arsyet them që ishte se, nuk njihnin strukturën e ngjyrën ligjërimore të filozofisë së shkrimtarit Skënder Drini. Dramë më vete, kjo. Ndonëse drama rrëfente kulturalisht. Rrëfente një dramë të vërtetë, realiste, poetike, meditative dhe filozofike. Nuk e di pse më shkoi mendja te vdekja e shkrimtarit. Te ajo e atëditëshmja. Homazhet u bënë në bibliotekën "Marin Barleti" (nga ora 12.00 - 13.30). Në atë moment kohe njoha vetëm dy aktore sypërlotur: Merita Smajën dhe Rita Gjekën. Të tjerët mungonin. Ashtu siç mungonin pothuajse pedagogët e katedrës së Letërsisë, ashtu siç mungonin deputetët, por qëndronin hijshëm e mirënjohëse kurorat e deputetes Mimoza Hafizi dhe e Akademisë së Shkencave. Para varrit nuk mungoi e folura e magjishme e krijuesit erudit Moikom Zeqo, si dhe prania e dinjitetshme e studiuesve Jorgo Bullo e Nasho Jorgaqi.

E gjithë rruga ime e mbarsur nga këto kujtime. Sikur nuk u ndje.

Tani ndodhem para lokalit. Para se të vinte stina e ftohtë e dimrit,

kishte plot tavolina në trotuar. E kujtova menjëherë vendin e tavolinën, pozicionin e karrigave, ku qëndronim përballë njëri-tjetrit dhe bisedonim me mikun Drini, atë ditë të shtunë. Ishte e shtuna e fundit. Sapo u ulëm më tha mendueshëm dhe psherëtiu: “Eh, miku im, miku yt është i sëmurë rëndë! Të hënën do të nisem për Tiranë. Koronarja është e vështirë, por do t’ia dal”. “Nuk ka gjë për t’u shqetësuar!” – i thashë. “Pastaj ti shquhesh për trimëri”, - i thashë për së dyti. Qeshi pak dhe thithi cigaren, pa më dhënë përgjigje. Kjo ishte biseda e fundit... Bisedë që kishte si fund heshtjen. E çuditshme, por njerëzore.

E vështrova. E pashë të menduar. Shumë të menduar!.. I kishte rënë hija e mendimit apo... Portreti i tij humbiste herë pas herë në tymin që lëshonte cigarja, që ishte e pandalshme për të. Më bëhej, herë sikur më ikte, e më bëhej sikur e kisha pranë. I them: “Lëre duhanin, o burrë!” Më përgjigjet: “Jo s’ mund ta lë, se me të kam bërë aleancë dhe ‘bashkëjetesë’ plot mistere...” Heshta. Dhimbja mbuloi heshtjen time. Nga dhimbja dhe nga heshtja, ai portret, përsëri, herë më largohej e herë më afrohej, herë më krijonte dhimbje e herë më falte fisnikëri... Nuk fola. Më pas ndërrova bisedë. Folëm për librin që sapo kishte botuar me titull “Testamenti”. Pjesën dërmuese të tregimeve i njihja që më parë se m’i kishte dërguar në kompjuter. T’i lexoja e t’i jepja mendime. Titulli i tregimit tëparë do të ishte homonim i librit të fundit.

Teksa vazhdoja të vështroja portretin e tij, më feksi (siç feks një yll i bukur) ky fragment, i lexuar në këtë tregim: “Në rrugën T., te cepi i Shkollës së Muzikës, është një fakir çigareshitësi. Kur më njohu, më kërkoi t’i reçitoja një poezi, dhe unë i thashë atë që më erdhi ndërmend aty për aty: “Qielli mbi tokë, toka nën qiell, / Nuk shoh as re, nuk shoh as diell...” Ai nuk pranoi kurrësesi të merrte paratë dhe filloi të qante, duke më lënë në një gjendje shumë të vështirë. Ju lutem, ndaluni tek ai dhe i thoni që nuk po iki krejt pa diell...”

E kujtimet për mikun tim krijues vazhdojnë..., por... tragjike... ‘Në një nga dhomat e reanimacionit të spitalit të QSUT-së “Nënë Tereza”, ku dhe heshtja ka fytyrën e vdekjes, në orën 10.00 (paradite), të datës 16 dhjetor 2014, në moshën 79 vjeçare, do të pushonte së rrahuri zemra e shkrimtarit Skënder Drini. Jo shpirti. Ndërroi jetë. Jetë ndërroi... udhëtari i kësaj bote Skënder Drini, si vetë mbiemri i tij, duke vazhduar udhëtimin e tij sa qiellor aq dhe njerëzor. U prefsh në paqe miku im i shtrenjtë!..

Në atë dhomë heshtane, prej më se dy javësh luhej një dramë. Më e egër se varfëria e mosmirënjohja, ndryshkësia provinciale e shfrymjet etiketore të pavlera.

Shkrimtari i rënë në gjendje kome kacafytej me vdekjen, në emër të etjes për liri, për t'i shtuar një frazë poetiko-filozofike më shumë kulturës dhe letrave shqipe. Kacafytej... me"... me dëshirën time më të fundit, më të rëndësishmen dhe më kapitalen: Do t'u përgjërohem të gjithëve që të bëni të pamundurën dhe të mos më lini të vdes". Kështu thoshte shkrimtari Skënder Drini në mbyllje të tregimit "Testamenti". Amanet i një qetësie olimprike, njerëzillëku e fisnikërie, ardhurimi e prometeizmi. "O Jetë!.." - shpesh më thoshte në biseda apo kur e shoqëroja rrugës drejt shtëpisë.

Kujtimet si kujtimet më kthejnë shumë vite më pas. Nga vitet e fëmijërisë më sjellin si dhuratë "Tregimet e së shtunës". Libri i parë i shkrimtarit Skënder Drini. Më këtë libër shkrimtari trokiti në dyert e letërsisë. Për kohën dhe stadin e letërsisë për fëmijë e të rinj, ky libër qe nga më interesantit. Ky libër ma zbukuroi fëmijërinë time. Mbeti në kujtesën e saj. E lexoj përsëri. Më duket sikur takoi autorin e shumëdashur dhe bisedoi me të... Sikur rend drejt botës së tij...

Hyra brenda. 'Venecie-n' e gjeta të mbushur plot me klientë. U drejtova nga tavolina, ku rrinte përherë miku im. Aty gjeta dhe u përshëndeta me Kokëfortin Aktiv, Pacuku-n dhe Dajën. Karriga jote miku im, ishte bosh. U ula. Karrigen tënde kisha pranë. Ndërsa përballë kisha disa nga personazhet e tregimit tënd "Testamenti". I vështroja me vëmendje. Dhe m'u kujtuan këto rreshta nga krijimi yt: "Vendosa të shkruaj testamentin tim. ... Për përmbushjen e vullnetit tim kuptohet që do të angazhohen njerëzit e mi më të shtrenjtë dhe patjetër mes tyre do të jenë edhe Kali Arab, Dhelpra, Kokëforti Aktiv dhe Pacuku."

Kujtimet m'u arratisen, kur në një moment Daja (tani ka ndërruar jetë) tha: "Na mungon Profesori..! (Kështu e thërrisnin të gjithë. Në të rrallë me emër.) Pavarësisht moshës, kulturës, profesionit, shkollës... me të gjithë dinte të bisedonte e nuk mërzhitej... Eh, ç'njeri ishte ai, i çuditshëm!.."

Dhe m'u kujtuan përsëri këto rreshta nga krijimi yt: "Kokëforti Aktiv patjetër që do të japë një kafe në kujtimin tim atje te kafeneja "Venediku", në përvjetorët e mi. Në rastin e Dajës (një tjetër pseudonim ky), duhet të shtojë edhe një fernet Branka. Për shumë kohë, derisa të mërzhitet dhe nuk besoj që kjo të ndodhë shpejt, nuk

do të lejohet askënd në poltronin ku uleshë unë. Kokëforti Aktiv më ka robëruar përgjithnjë vetëm me një buzëqeshje, të hollë, elegante, me një bonhomie universale... Po Pacuku, që është një "hilexhi pa hile", që është edhe një proverb i gjallë lindor, sepse ka lexuar shumë Hafëzin dhe Rumin, përpiqet të më zhgënjejë. Thotë që atë buzëqeshje Kokëforti Aktiv ua dhuron edhe të tjerëve. Nuk e besoj. Po të jetë e vërtetë kjo, do të ishte një katastrofë. Pacuku lëshoi një ditë një tjetër ide lindore. Ai tha që për njerëzit si unë do të preferonte një varr vertikal, si ai i Rumiut në Konja. Më do shumë Pacuku dhe nuk çan kokën për asnjë lloj teprimi..."

Ashtu, të mbledhur rreth asaj tavoline flasim pak e kujtojmë shumë. Kështu nuk bëjmë asgjë tjetër, veçse gdhendim figurën e mikut tonë Skënder Drini. Iku në një orë..., të cilën Karolina nuk e deshi asnjëherë. Ishte ajo orë që e bëri shpesh të mekej, të drithërohej, të mbushej në detin e lotëve, sa herë përmendte emrin e tij përmes dhimbjes së padurueshme. Ishte ajo orë e atij burri model që shpesh ndalte dhe orën e zemrës së Karolinës...

Ashtu, të mbledhur rreth asaj na kaplon heshtja. Nuk e di, a është heshtja monument për shkrimtarin e shquar të letrave shqipe, që u nda 16 ditë më parë apo një testament që Skënderi na la dinjitetshëm. Vetë jeta e tij ishte një libër, testament. Dhe kjo ishte arsyeja që "Testamenti" ishte prijëtar i librit me të njëjtin titull. Një tregim i trishtë, shpesh me kontraste por me rrezatim universal. Universale dhimbja, dinjiteti e papërkulshmëria. Një rrëfim plot dhimbje e tragjizëm i ligjëruar në vetën e parë: për kohën që jetoj fisnikërisht, për njerëzit e tij të shtrenjtë; për raportet me jetën, me letërsinë, me përjetësinë, dashurinë njerëzore... Një rrëfim që koha dhe njerëzit e mirë do ta gdhendin në gjurmë lavdie e nderimi e mosharrese.

Unë u largova nga ajo tavolinë, në atë orë që zakonisht largohej Skënderi. Nuk e di pse m'u dha që ta bëja këtë ritual, sot më 01 janar 2015. Ndoshta se më thirri kujtesa, bota e shkrimtarit, gjurma e tij... Nuk e di... Por ama një gjë di se "Fisnikëria e tij thellësisht ishte ruajtur në çdo qëndrim dhe mendim që shprehte. Një zë kumbues, një timbër përmbajtësor!"\*)

Teksa largohesha, ktheva kokën pas; pashë personazhet që janë miqtë e mi teksa bisedonin dhe karrigën bosh... Jo, në atë karrigë fle

\*) Morina, E.S.: "Jam përpjekur që në veprat e mija të mos tregoj barsoletë" (Intervista e fundit e shkrimtarit Skënder Drini dhënë gazetës "Nacional", (1935 – 2014), 21.12.2014.



një testament. Ndoshta, nuk do të ketë lokal në botë si ky i yni me emrin "Venecia", me vendlindje Shkodrën, që në historikun e saj ka një objekt me vlera të pashlyeshme, të patjetërsueshme: një karrigë-testament!.. Ndoshta dhe monument... Po!..

Teksa largohesha... ca re puplore e të mëndafshhta rendnin drejt perëndimit të diellit të përflakur. Vetiu m' u kujtua pyetje që gazetari E.S. Morina i bëri shkrimtarit:

-Çfarë planesh krijuese keni në tavolinë?

Skënder DRINI: Kam shumë, por nuk e di sa do të ma lejoj shëndeti, por lus zotin që të më japi fuqi të shkoj deri në fund. (Shkodër, 09.11.2013)

### 3.Ora e 'Venecies'...

Skënder Drini e kishte një orë. Ajo quhej 'Ora e Venecies'. Skënder Drini e kishte një orë. Ajo quhej "Ora e Karolinës". Shkrimtari Skënder Drini e kishte një orë. Ajo quhej 'Ora e miqve'.

Kjo orë nuk matej me orën e celularit, as me orën që mbante në dorë, por me orën e shpirtit të tij. E ngritur në kult. Po. Idhull. Po. (Pavarësisht se nuk i pëlqenin idhujt e idhujtarët.)

Te 'Venecia' hyjnë dhe dalin njerëz të moshave të ndryshme, të kulturave të ndryshme. Ardhja e Drinit ishte sa një përjashtim, aq dhe një mikpritje. Shkrimtari me intuitën, intiligjencien dhe mënyrën e rrëfimit shkrihej në këtë multikulturalizëm, që shpesh herë provinca ishte e dukshme me padukshmëritë e saj. Kultura e Drinit e përjashtonte. Absurditetin e provincës e kishte trajtuar dhe analizuar në një cikël shkrimesh të botuara në gazetën "Koha jonë" e në një libër me ese, që nga studiuesit nuk është vënë re.

Skënder Drini ishte një natyrë që të dëgjonte me etje. Të dëgjonte me etjen e një njeriu që është i etur të mësojë edhe nga kultura e jetës së përditshme. Kjo ishte, ndoshta, arsyeja që Skënderi kishte krijuar një "ishull" fansash e pse jo dhe tifozësh, përreth tij. Fansat dhe tifozët, përgjithësisht, vinin herë në klub. Ata, herë pas here, kthenin kryet nga rruga... Nga ajo rrugë ku vinte zakonisht Drini i qetë, njerëzor dhe i mendueshëm.

Mezi prisnin ardhjen e tij. Fillonin bisedat, teoritë, gëlonte filozofia po aq sa edhe teologjia, gëlonin hatërmbetjet, shfaqeshin arsyetimet, konfliktet, shamatat, ngritjet e uljet e zërave nervozë, humori, barsoletat, të qeshurat pafund... Mes kësaj "performance" Drini "jetonte" i qetë, nganjëherë i përhumur, por gjithherë i

vëmendshëm. Qeshte pas pak, me një të qeshur kumbuese tërë finesë.

Rreth këtij “ishulli” me emrin ‘Drini’ mblihdeshin edhe shumë krijues. Vinin te vatra ‘Drini’. Vinin krijues të talentuar e të pa talentuar. Kishte edhe nga ata që nuk bënë asnjë mungesë. Sigurisht, këta të fundit nuk kishin lidhje me letërsinë, por donin domosdoshërisht të ishin të pranishëm si dëgjues e kureshtarë në ‘leksionet kulturologjike’ të Drinit. (Teksa fliste më kujtonte leksionet e Kalvinos me përmasa dimensionale.)

Drini, zakonisht, e pinte kafënë me filxhan të madh. Një kafe me shije turke, që i kishte mbetur nga koha kur kish qenë diplomat në Turqi. E shijonte shumë. Se këtu te ‘Venecia’ ndaj Drinit kishte një përkujdesje deri në imtësi. Sigurisht edhe te kafeja. Kjo fal dorës dhe syrin të padukshëm të Besës dhe shpirtit njerëzor të Urimit.

Orët kalonin, si gjithmonë, pa u ndjerë...

Pastaj vinte ora... Se Skënder Drini e kishte një orë. Ajo quhej ‘Ora e Venecies’. Skënder Drini e kishte një orë. Ajo quhej “Ora e Karolinës”. Shkrimtari Skënder Drini e kishte një orë. Ajo quhej ‘Ora e miqve’.

Largohej duke lënë te ‘Venecia’, mallin...

Malli është kaq i madh për Skënder Drinin sa shumëfishohet çdo orë e çdo ditë, çdo ditë e çdo orë...

Të lutem, shko te ‘Venecia’!.. – më thoshte shpirti...

*Shkodër, janar 2018*

**Skënder DRINI****TESTAMENTI***Tregim*

Vendosa të shkruaj testamentin tim. Kjo, sepse jam mërziur nga kjo jetë, sepse ditët e mia në këtë planet janë nga fundi dhe se atje në Hjuston ka filluar numërimi së prapthi për nisjen e raketës drejt hiçit. Për përmbushjen e vullnetit tim kuptohet që do të angazhohen njerëzit e mi më të shtrenjtë dhe pa tjetër mes tyre do të jenë edhe Kali Arab, Dhelpra, Kokforti Aktiv dhe Pacuku. Dihet që këto nuk janë emra të vërtetë, por pseudonime që unë i kam vënë për t'i përkëdhelur dhe llastuar. Më duhet të shtoj këtu atë mërzinë juridike për të shpjeguar që gjithçka e kam bërë me vullnet të plotë, pa shtysën e askujt dhe me një gjendje mendore të përsosur.

Gjithçka që është në emrin tim, e tundshme dhe e pa tundshme, i kalon bashkëshortes sime. Balzaku i madh dhe një varg Balzakësh më të vegjël se ai na kanë kujtuar, se atij që merr mundimin e madh për të lënë një testament, i faniten përpara syve portretet e njerëzve që e kanë rrethuar nga afër në jetë. Është për t'u çuditur që gruaja ime nuk më del përpara si një portret, por vetëm si ide pengimi. Nuk e kishte pranuar kurrë që unë isha një artist i madh, ashtu siç nuk e kishte pranuar kurrë që tromba mund të ishte një instrument sa i të bardhëve, aq edhe i zezakëve. Por të gjitha veglat me frymë ishin të zezakëve dhe shtonte më tej që edhe meloditë e tyre ishin të zezakëve, nga xhazi dhe nuk e di se deri ku... As që donte t'ia dinte që zezakët kishin fare pak shekuj atje në Amerikë, ku bënin ligjin me veglat e frymës. Asaj i mjaftonte që unë nuk isha zezak për të mos qenë një artist i madh i trombës. Kur thoshin që unë isha një virtuoz i vërtetë në trombë, ajo hidhej sikur ta kishte pickuar diçka dhe thoshte që virtuozët e vërtetë në trombë ishin vetëm zezakët. Unë e doja aq shumë atë, sa isha gati të bëhesha zezak, por as kjo nuk do të më ndihmonte, sepse ajo përnjëherësh do të thoshte që në trombë janë virtuozë kinezët. Ndonjëherë e mallkoja veten që kisha

zgjedhur atë vegël, që sa të lartësonte në skenë me spektatorët, aq të shkaktonte andralla me banorët e pallatit. A mund të stërvitesh në pallat me një xhez? Aq mund të stërvitesh dhe me trombën. Ikja. Gjeja vende bosh, larg veshëve të njerëzve. Më të shumtën e kohës e kaloja në palestrën e gjimnazit, kështu që gruas sime nuk i mungonte qetësia, por diçka tjetër, i mungonin duartrokijet! Ishte tepër e shquar në punën e saj, por nuk kishte pse të duartrokitej një meteorologe. Shumë, shumë mund të merrte ndonjë lavdërim në telefon, por unë kisha vënë re që ajo ishte pothuaj krejtësisht e saktë, kur parashikonte kohë të keqe. Mendoja që veç të dhënave që studionte e ndihmonte deri diku edhe fakti që në familjen tonë nuk mbretëronte ndonjë klimë edhe aq e ngrohtë... Asnjëherë nuk e mora vesh, nëse ai pellgu ku përpëlitej ajo, ishte i mbushur me egoizëm, cmirë, apo kryelartësi ... Nuk do ta marr vesh kurrë ... Po, kur është kështu, mund të ma thotë dikush, pse nuk ia le djalit atë qe ke? Sepse shpresoj që ajo ta kuptojë, që gjithçka që po i lë, vjen nga tromba e artistit që nuk është zezak ... Do t'ju lutesha diçka miqve të mi, që të sillni ndërmend gruan e Tolstoit dhe të mos e lejonin time shoqe të thotë që ishte ajo që më bëri artist të madh...

Kam shumë kostume në raftin e rrobave. Shumicën të veshur një herë dhe të paveshur fare. Nëse do t'i pranonte do t'ia lija me shumë kënaqësi violinistit S. Atij i duhen kostumet, ndërsa për mua i gjithë kostumi nuk është tjetër veçse një kravatë që të shtërngon në fyt. Po ishte e pamundur që unë të hiqja dorë nga kjo mbulesë torturuese, sepse ma kërkonte skena. Jashtë skene unë mjaftohesha me një bluzë në verë dhe me një xhakovento në dimër. Nuk di nga ka ardhur kjo mbulesë e njerëzve të varfër apo dhe të zakonshëm. Duke kujtuar ato veshjet e Kinës së vjetër me mbërtheakat në fyt, besoj të këtë ardhur nga Kina. Po ngado që të ketë ardhur, i ka bërë një shërbim të madh të varfërve dhe sidomos të nguturve. Violinistit S. i duheshin kostumet. Ishte një lloj dalldije, që besonte se përbuzja e femrës fillonte nga veshja e mashkullit. Ishte ndoshta idhujtari më i madh që kam njohur unë, i bukurisë femërore. Ai besonte se bukuria e femrës nuk ishte e tokës dhe se nuk dihej nga mund të kishte ardhur. Kishte një mendim metafizik për të dhe besonte se ajo mund të pulitej dhe të pushonte mbi shpirtra shumë të brishtë që me delikatesën e tyre mund të krahasoheshin vetëm me një drithmë qepallash.

Ai vetëm merr erë, por nuk kafshon, - thoshte e shoqja e tij, - dhe kjo ishte e vërtetë. Ishte një violinist i mirë dhe shumicën e rasteve

ishite spalë në krye të orkestrës, por ai vinte i dyti, vinte pas meje në hierarkinë e vlerave, që kishte vendosur ky qytet. Pavarësisht se përkëdhelem unë, ky ishte një vlerësim i saktë dhe nuk ishte si ato "mirënjohjet" që shpërndan Bashkia. Nuk ishte xheloz dhe nuk mërzhitej që ishte në plan të dytë, por gjithsesi do të them që, megjithatë kishte gjetur një marifet matematik për të kapërcyer vendin e dytë. Ai thoshte: "Ti je njëshi, por unë jam dyshi. Dyshi është më i madh se njëshi ..." Ky njeri do të më mungojë.

Do t'ju lutesha të jeni shumë të vëmendshëm dhe të mos lejoni të më kooptojë ndonjë parti polike, siç ndodh kur ndahet nga kjo botë ndonjë figurë e veçantë. E para herë që më jepet rasti të tregoj që nuk kam bërë pjesë në asnjë parti politike dhe se nuk kam qenë i përkëdheluri i asnjë pushteti. Kjo jo se unë nuk kam qenë një snob që doja të bëja të veçantin, por sepse nuk ishte e mundur të gjeja një lidhëse që ta mbante të bashkuar politikën me artin. Kush e ka bërë këtë, i ka mbetur lidhësja e këputur në dorë. Po, kushdo ka të drejtë të pyesë se çfarë kam qenë unë në fund të fundit? Nje hegelian i ngatërruar nga një mbivendosje darviniane? Darvini është brutal dhe nuk mund të shpjegojë butë dhe me delikatesë origjinën e atyre petaleve që vërtit nëpër duar. Është edhe më brutal kur shpjegon origjinën e njeriut, por nuk kam çfarë t'i bëj së vërtetës. Ndoshta nuk e di me saktësi se çfarë jam, por nëse dikush më perzien me social-demokratët nuk mund ta kundërshtoj me shumë forcë, por vetëm mund të them që nuk jam nga këta të sotmit, nuk ngjaj as me Shrederin që ka qenë i sukseseshëm dhe ndoshta kam një qasje vetëm me kohët më të mira të Vili Brandit. Nuk duhet që në asnjë mënyrë të lejoni që politika të më bëjë të vetin. Në të gjitha kohërat ajo e ka parë artin si dekor. Unë nuk dua të jem dekor. Vetëm në Greqinë e Lashtë ndoshta ka ndodhur e kundërta, sepse as Leonida i famshëm nuk kishte shans të rrinte mbi Eskilin. Kur do t'u dalë e nevojshme të më mbron, kujtoni si u përdor Migjeni dhe si u braktis Migjeni.

Nuk besoj që Bashkia të mendojë për homazhe dhe funeral publik. Nuk jam në marrëdhënie të mira me të që kur nuk pranova të bëj pjesë në bandën e qytetit. Ajo nuk ka si ta kuptojë që unë nuk jam për të ngritur moralin dhe entuziazmin e rrugës së qytetarëve, por për të akorduar ndjenjat e holla të shpirtit të tyre. Të mos shqetësohet, nuk dua funeral publik dhe për këtë më është mbushur mendja disa vite përpara, që në atë ditën që vdiq poeti F.R. Bëra të pamundurën

për t'i bërë një përcjellje publike atij, sepse as atë nuk e donin. E çova çështjen shumë lart dhe më në fund e arrita. F.R. që ishte një personazh kontravers, një njeri që kishte bërë çmos për t'i hipur me shkelma jetës së tij të vogël dhe talentit të tij të madh. Shkurt, ishte një poet. Fola aty dhe nuk besoj që të kem qenë ndonjëherë në jetën time më brilant se atë ditë. Fola me një dhimbje të madhe dhe me një zemërim të madh. Por kur mbarova dhe i hodha një sy asaj gjendjes së artit dhe të kulturës që ishin të pranishëm, m'u lidh në fyt një nyjë si një tumor. Dëshiroj të gabohem po aty, me ndonjë përjashtim të vogël, kjo vdekje nuk ishte tjetër, por një vdekje e radhës. Aty m'u kujtua Hygoi që bërtiste rrugëve të Parisit, ndërsa po vdiste Balzaku. A e dinte Franca që po vdiste njeriu më i madh i saj? Unë nuk dua një funeral publik për këto arsye. Nuk dua as një "vdekje jashtë radhe", sepse ne nuk e duam njëri-tjetrin.

Nuk dua të më përcjellin klerikë, sepse asnjëherë nuk kam dashur klerikë nëpër këmbë. Kjo jo për ndonjë diferencë me religjonet, por më shumë për një arsye sa të çuditshme, aq dhe pragmatiste: që një mendim qiellor nuk mund të mbrohet me një logjikë tokësore. Dje lexova një shkrim të Umberto Ekos, që sikur më erdhi si me porosi. Një shkrim i shkurtër, i ftohtë dhe racional. Aq racional sa mund të arrinte deri tek iracionalja. Merrej pak a shumë me atë që kam shkruar pak më lart dhe për ta mbështetur, kishte tërhequr pas vetes një qerre me filozofë ndër të cilët binte në sy Spinoza. Bëra shumë mirë që e lexova Umberto Ekon.

Nuk dua një varr të zakonshëm. Dua një cenotaf. Cenotaf me një pllakë pa emër dhe mbiemër në krye. Kjo është shumë intigruese, sepse njerëzit që janë përgjithësisht të prirur nga e keqja, do të mendojnë që aty brenda është kallur një monstër aq i përbindshëm, sa që familja nuk ka guxuar t'i vërë as emër. Kam shpresë që kjo do të më bëjë më të famshëm se do të nisin kërkimet pa fund për atë pllakë pa emër.

Dua një përcjellje me një varkë drejt detit, me varkë në flakë. E di, që nuk mund të arrij deri të ngushticat e Golf Strimit dhe nuk do të kem privilegjin e madh të më përshëndesin vikingët me shigjetat e nderzura, por prapë jam i kënaqur. Dikush mund të pyesë: Pse në det?", "Pse në ujë?" Eshtë gati si një kthim në identitet, sepse, andej ka nisur jeta. Duke u rikthyer, paguaj një borxh.

Kokëforti Akiv pa tjetër që do të japë një kafe në kujtimin tim atje te kafeneja "Venediku", në përvjetorët e mi. Në rastin e Dajës (një tjetër

---

pseudonim ky) duhet të shtojë edhe një fernet Branka. Kokëforti Aktiv më ka robëruar përgjithnjë vetëm me një buzëqeshje, të hollë, elegante, me një bonhomi universal.. Po Pacuku, që është një "hilexhi pa hile", që është edhe një proverb i gjallë lindor, sepse ka lexuar shumë Hafëzin edhe Rumiun, përpiqet të më zhgënjejë. Thotë që atë buzëqeshje Kokëforti Aktiv ua dhuron edhe të tjerëve. Nuk e besoj. Po të jetë e vërtetë, kjo do të jetë një katastrofë. Më në fund dëshirën time më të fundit, më të rëndësishmen dhe më kapitalen: Do t' u përgjërohem të gjithëve që të bëni të pamundurën dhe të mos më lini të vdes.

## GJERGJ FISHTA

### LAHUTA E MALESISË

*Poemë epiko-historike, përshtatur në prozë, me shkurtime, për nxënës,*

*nga Skifter Këlliçi*

Në këtë numër të revistës “Gegnia” po fillojmë botimin e veprës “Lahuta e Malcisë” të atë Gjergj Fishtës, të përshtatur në prozë nga shkrimtari dhe studiuesi Skifter Këlliçi. Tue e falenderue autorin e përshtatjes, çmojmë punën e tij të censhme në këtë përshtatje e cila mendojmë se ka me i shërbye mjaft receptimit të veprës ma lehtësisht prej nxanësve të shkollave por edhe prej lexuesve të vegjël në përgjithësi.

#### Kanga e parë

#### CUBAT<sup>1</sup>

Viti 1858...

Pesëqind vjet kishin kalue që kur atdheun tonë, të bukurën Shqipni, Turqia vazhdonte ta mbante të lidhun në vargonjtë e robnisë, të mjerë, të lame në gjak nga plagët e randa, të verbët, pa mundun kështu të shihte dritën e diellit, të lirisë, të uritun, qoftë dhe për një kafshatë buke. Pushtuesi turk e mbante atë të vuejtun, sa edhe nga dhëmbjet nuk e linte të derdhte dhe një pikë loti, aq sa për të do t'i vinte keq edhe miut në mur dhe gjarpnit nën gur.

Atdheu ynë ishte kështu si kau nën zgjedhë. Por jo për gjithnji. Sepse kishte ardhë dita që shqiptarët të kishin mbi vete vetëm Zotin dhe kurrkujt të mos u përkuleshin në trojet e veta.

Turqia tashma po ligështohet, forcat po i shterreshin dhe vise të Ballkanit kishin nisë me i dalë nga dora; nisën shqiptarët me mendue se si Shqipninë me e shkëputë nga zgjedha turke.

Të ishin të lirë, si në kohë të Gjergj Kastriotit, krejt më vete dhe nën varësinë e askujt, qoftë ky Sulltani i Turqisë, a knjazi Nikolla<sup>2</sup> i Malit të Zi, në krah të të cilit ishte si gjithnjë Rusia, kjo ishte dëshira e shqiptarëve. Se ky knjazi i egër dhe lakmitar, që nga pallati i tij në Cetinë ku kishte kryeqendrën, kishte nisë me topa e me ushtri



sulmin mbi Shqipninë, për me shtrua bjeshkë e lëndina, përgjatë lumit Drin dhe deri në kalanë e Rozafatit që ngrihej mbi Shkodër, të cilën do ta vinte nën këmbët e tij, edhe sikur gjaku të shkonte deri më gju.

E shihet turku se ç'po ndodhte e lotët i shkojshin faqeve, se vrullin e knjazit nuk mund ta përmbante, ngaqë Moskovi<sup>3</sup> po rrethonte Stambollin që ta shtinte në dorë.

Atëherë shqiptarët, lidhun në besë të Zotit, siç lidheshin të parët e tyre në kohë të Kastriotit, ndonëse me një kambë mbathë e tjetrën z bathë, edhe bagëtinë pa grazhd e pa vathë, një herë të ngranë dhe herë të pangranë, lanë grue, motër dhe nanë, me synin pishë e zemrën barot, si era me stuhi, e u vunë përballë forcave malazeze në buzë të lumit të Cemit.

Vihen përballë njeni-tjetrit shqiptarë e shkja<sup>4</sup>, përleshën, kapen fyt më fyt, ofshajnë nga dhimbjet e plagëve, bien shakull<sup>5</sup> për mbi dhe... Midis tyne edhe sokola mali, bij nanash të shkreta, që mbajnë lotët, sepse me gjokset dhe jetën e tyne ata arrijnë me thye sulmet e shkjaut.

Atëherë shqiptarët mblidhen në kuvend dhe një fjalë të madhe i çojnë sulltanit. Jo vetëm knjaz Nikollës nuk i japin pagë e të dhjeta<sup>5</sup>, por ata nuk ia japin as Sulltanit atje në Stamboll, se Shqipninë perendia nuk e kishte falë për të qenë robneshë, por me qenë e lirë dhe bijtë e saj bota do t'i quente djalë pas djali, deri sa jeta të mos shuhej, me emrin "shqiptar".

Turku i dëgjoi këto fjalë, u mbush tanë mëni dhe u lëshue mbi atdheun tonë që t'i përpinte shqiptarët. Por nuk ishte aspak e lehtë, sepse shqiptari gjallë s'përpihej dhe as shkulej, edhe kur e mësynte krajli<sup>6</sup> a sulltani.

Dhe kështu u kapërthyen turq e shqiptarë, tue lanë në fushën e betejës krena që këputeshin pa dhimbje nga luftëtarët e dy palëve.

Shqipnia po bahej kështu e pavarun. Por Shkjau dridhej nga frika se tashma tue u shkëputë përgjithnjë nga sulltani, ajo nuk do të binte më pas edhe në kthetrat e tij. Kështu mësyu kundër turkut dhe ashtu si derrat me çakej edhe ata u mbërthyen me njeni-tjetrin, u prenë, u çanë, u përcëlluen dhe u vranë nga zjarri i pushkëve dhe gjylet e topave.

Por knjaz Nikollës zemra i shkon nën thembër<sup>7</sup> dhe nuk gjen dert<sup>8</sup>, sepse ai kërkon me çdo kusht t'i mposhtë dhe t'i nënshtrojë shqiptarët, ta pushtojë tokën e tyne, atë tokë për të cilën vetëtonte

shekuj më parë shpata rrufe e Gjergj Kastriotit. Mirëpo shpejt ndien se shpirti i qetësohet dhe zemra i rreh prej gëzimit, sepse shpëtimi i vjen nga një mik i largët, por dhe shumë afërt. Është Moskovi.

...Në Petrograd<sup>9</sup> cari<sup>10</sup> po bante një be<sup>11</sup> të madhe për të cilën do të mbetej i habitun qoftë një plak, qoftë një kalama. Ai nuk do të kremtonte natë të madhe, as kumbarë<sup>12</sup> dhe kush nuk do të shkonte. Nuk do të bante as gosti dhe as dasmë. Nuk mjaftonte kjo, por s' do të vishej e as do të krihej dhe as në krye të kuvendit nuk do të dilte.

Por kjo do të ndodhte, vetëm kur ai të hynte në Stamboll e të vihej mbi sulltanin; të bahej kështu zot i tokës dhe i detit, t' i priste Evropës tregtinë, që as të shiste dhe as të blinte, që ajo të mbetej në kthetrat e tij të zhytuna në gjak, që ishin mësue të gërryejshnin gjithnjë në plaçkë të huej.

Mirëpo si skile e e vjetër, cari e dinte fort mirë se të arrijshe me u futë deri në Stamboll, nuk ishte e lehtë. Prandej nisi të thurte një plan se si së pari të lëshonte në shpinë të Turqësë shkjetë, pra malazestë, që kështu me sulme të paprituna dhe të mbrapshta t' i nxirrte shumë telashe.

Pastaj, ashtu si arusha del prej pusie<sup>13</sup>, ai do ta sulmonte befasisht Turqinë, do ta zhbinte e shkatërronte krejt, pa e vra mendjen, se me këtë veprim mbase do ta mbështillte tërë botën në zi<sup>14</sup>.

Pasi e pleqnoi këtë punë me vete, cari shkoi në dhomën e tij dhe nisi t' u shkruente miqve kah Serbia që të lidhshin besën që Shkja të ishte gjithë ajo hapësinë tokash nga lumi Budi, në Hungari, deri në Çanak Kala në Turqi. Veç kësaj, porositi që Sulltanin të mos ta lijsnin të qetë, por ta ngacmojshin për çdo ditë, për çdo shteg e për çdo kufi, herë me kërcënime dhe herë me pleqni<sup>15</sup>, që ta vijshin gjithnjë poshtë e ma poshtë vetes së tyre.

Mandej vazhdoi t' i shkruente knjaz Nikollës<sup>16</sup> me dredhi:

“Të përshëndes ty, që je knjaz Nikolla, se kam dëgjue se ke za të madh<sup>17</sup>, se je trim e gërxheli<sup>18</sup>, se je burrë e kuvendar<sup>19</sup>, se ta ka frikën anmiku. Por me sa duket kjo fjalë s' qenka asgja, sepse ti je rrasë<sup>20</sup> në Cetinë me një gjysmë opinge dhe je ba gazi i dheut<sup>21</sup>, tue mërzitë miq e kumbarë. Ndërsa turku përbri teje që e mban çallmën në vetull të synit<sup>22</sup>, me shallvare<sup>23</sup> derdhë bukur, rri e ban kokrrën e pallës<sup>24</sup>... Por thue ty të la kamba e dora dhe nuk po ndihesh për së gjalli?

Mos, bre burrë, a të ka hije që të rrish urtë, ti, cubi i Cetinës dhe ta kalosh motin në shtëpi, tue u ndeshë me furka<sup>25</sup> të grave? Po nuk ta mbush synin Shqipnia, me ato male të madhnueshme, me ato fusha

të blerueme?.. Me atë krah mos rri fjetun<sup>26</sup>, pse, pa luejtë kambë e dorë, nuk të ndihmon zot, as Shën Nikollë. Pra, ti tundu.. Sa për bukë e për fishekë<sup>27</sup>, më tako mue, sepse kam me të ndihmue. Veç kësaj vene kësulën në sy<sup>28</sup>, se, po të ngacmoi sulltani i Stambollit, nuk e le me të prekë as me pupël.

Pasi e shkroi këtë letër, pa humbë kohë, ia dorëzoi një kasneci<sup>29</sup>, që e futi atë në gji, u nis në udhë, la pas fusha e zaje<sup>30</sup>, kapërceu bjeshkë e male, shtegtoi për ujë<sup>31</sup>, deri sa një ditë me diell, arriti n' Cetinë, fill i vetëm, me këpucë të shqyeme dhe setër<sup>32</sup> të grisun dhe ia dha knjazit letrën në dorë. E mori knjazi atë letër që cari ia kishte çue dhe tri herë rresht e lexoi dhe tri ditë të tjera u vu në mendime të thella... Pastaj i çoi fjalë Vulo Radoviçit, që ishte kerserdari<sup>33</sup> i krahinës Vasoviçit, që të vinte sa ma parë në Cetinë, për ta takue atë, "godpodarin". Dhe Vuloja ashtu bani.

Ai ishte trim i çartun<sup>34</sup>, aq sa dhe toka e kishte randë ta mbante mbi vete, me sy që lëshojshin zjarr e shkëndija, me vetulla të trasha e mustaqe vesh më vesh e krye që arrinte deri te trau i shtëpisë. Dhe veshë e mbathë dhe armë shtrëngue në brez, kishte pamjen e një dragoi<sup>35</sup>. Ndaj dhe knjazi e donte fort dhe ia dëgjonte edhe fjalën.

Kështu pra Vuloja zbriti shpejt në Cetinë dhe u prit me nderime të një miku të vyem nga vetë knjazi. Ky së pari e qortoi se nuk ishte dukë prej kaq kohësh nga Cetina. Mandej e pyeti si po kalonte jetën. Dhe u habit kur mësoi prej tij se nga moti i keq toka ishte tha, kishte mbetë djerrë dhe kështu edhe buka atje po mungonte.

Mandej i dha zemër, por dhe i tha se nuk kishte ndodhë kurrë që cubi të mos gjente bukë, ashtu si skifteri të mos gjente gjah dhe të mos hante mish.

- Por t'mjafton t'i sulesh një katundi, - i tha, - e ke për të bâ prë lopë e qe. Kështu ke për të mbajtë tanë njerëzit e krahinës dhe jo ma gjindjen e shtëpisë.

Vuloja e dëgjoi knjazin me vëmendje dhe i gufoi zemra, kur ai vazhdoi me fjalët:

- Dëgjo, Vulo miku, mblidh nalt e poshtë disa cuba të idhtë si gjarpni ndër kaçuba dhe të lehtë si shpendët në fluturim dhe lëshoji andej nga Vranina, që të vrasin, që të presin, që të djegin gurë e dhe, tue grabitë e tue robitë<sup>36</sup>, në daç me natë, në daç me ditë. Se unë prandej të kam çue fjalë, që të vish këtu në Cetinë... Trunin një mendim po ma ngacmon: të kapërthehem prapë me turkun, prapë me të vritem, sepse ne, shkjatë, nuk mund të jemi në paqe me të.

Dhe kështu tue ligjërue knjazi vazhdoi ta mbulonte Vulon me qortime dhe pastaj i dha këshilla si të vepronte që Vraninën ta zhyste në gjak.

Pasi u morën vesh bukur fort me njëni-tjetrin, knjazi e mbajti mikun e vet për darkë. Mandej i dhuroi jo vetëm pare, por edhe një xheverdare.

- Këqyre këtë armë, Vulo, - i tha, - askush veç meje nuk e ka në Malin e Zi. Kondakun<sup>37</sup> e ka të lamë në argjend... Por edhe e varun në sergjen<sup>38</sup> dhe jo më në krah të një luftëtari e për më tepër në krah tëndin, ajo të kall datën.

Pas këtyne fjalëve, Vulo Radoviçi çue më kambë, u përshendet me gospodarin dhe u nis malit përpjetë në Vasoviç, tue përblue me mendje si ta shkretonte Vraninën, ashtu si knjazi i kishte lanë porosi.

## KANGA E DYTË

### OSO KUKA

Ndjehej i mjerë Avdi pasha, sundimtari turk i Shkodrës, sepse grueja nuk i kishte lindë djalë... Por u habit kur i thanë se edhe Shqipnia kishte mbetë vetëm me vajza! Mungojshin djemtë që t'u dilshin përpara cubave të Malit të Zi, të cilët ishin sulë në Vraninë, në atë tërthoren<sup>1</sup> e saj të zezë, ku ishin vra sa djem të rinj, ku kishin mbetë djerrë sa toka pjellore, ku kishin mbetë dhe vathët pa bagëti, të grabituna nga këta cuba që po digjshin kulla e stane dhe po thajshin kaq zemra nane.

Këto ishin bama të knjazit të Cetinës, që i dërgonte cubat e tij në Vraninë, që të vritshin e të pritshin, të rrafshojshin çdo gja sa as një djalë të mos lindte në votër<sup>2</sup>, që nanat të ofshajshin<sup>3</sup>, që motrat të qajshin, të mbeteshin pa vëllezën...

"-Si nuk paska qoftë dhe një djalë në Shqipëri, - rënkonte Avdi pasha, - një djalë trim, të cilit të mos i dhimbset jeta për atdhe!...

I dëgjoi Oso Kuka këto fjalë të pashës turçeli dhe kaq shumë u zemëruë, sa e çoi dorën në brez dhe u ba gati të ngrinte koburen dhe ta qëllonte. Por shpejt e mblodhi veten, nuk u ngut, por si trim as edhe nuk u tut<sup>4</sup>.

- Avdi pashë, - zuni me i thanë, - mos i përmend dy herë ato fjalë, sepse, për besë, të baj me të të qa e zeza nanë, sepse në Shqipni ka djem si zana<sup>5</sup>, që për trojet e veta nuk u dhimbset aspak jeta. Prandej, kur Shqipnia të jetë në rrezik, ata të parët do të dalin në

fushë të mejdanit<sup>5</sup>. Dhe atje, qofshin pa kësulë në kokë e pa opinga në këmbë, për kanun, për besë e fe, me armët që ua kanë lënë të parët, do të vihen përballë dushmanit<sup>6</sup>. Kurse ti, vjen këtu e na thue se në Shqipni nuk paska djem që për trojet e tyre nuk iu dhimbska jeta? Por po i lamë tash këto fjalë: Në Vraninë do të shkoj dhe cubat e knjazit do t'i ndal. Por më duhen dyzetë vetë, djem sypatrembun, që janë gati të vdesin, djem që mund të lindin veç në Shqipni. Atëherë të jap besën se Vranina do të bjerë gjallë në duert e malazezëve, veç kur ne të digjemi në flakë e barot.

Pasi dëgjoji këto fjalë, Avdi Pasha u çue më këmbë dhe pasi iu afrua Oso Kukës, i shtrëngoi dorën dhe i tha:

- Të lumtë ty, Oso Kuka, për fjalët që nxore nga goja, se burrë të tregon edhe pamja jote, tamam sokol mali. Zgjidhi ku të jenë djemtë ma të mirë dhe dil në ato vise të Vraninës, ku të zezat nana kanë varrosë djemtë dhe nusët janë shtrëngue të kthehen në gjini<sup>7</sup> tue të pritë si drita e diellit.

Pa kalue java, kur tashma agimi ka dalë në buzë malit të Cukalit, çeta e Osos nga qafa e Kalasë së Rozafatit merr rrugën nga Vranina. Çetë e vogël, por me djem të zgjedhun, jo pse ishin të pashëm, por kreshnikë për zemër dhe trimni. Ashtu si edhe vetë Osoja që u prin, që nuk e ka shokun as kur moti është i vranët, as kur kthjellohet, që kur kalon sokakut<sup>8</sup>, gjithkush e përshëndet me nderim.

Pushka i flakon<sup>9</sup> mbi krah si rrufe në natë të thellë dhe dy kobure i varen në brez. Kështu i armatosun, veshun e ngjeshun dhe me jelek prej ari mbërthye, me shtatin si div<sup>10</sup> dhe synin si shigjetë, Oso Kuka pash më pash<sup>11</sup> po i bie pazarit, me trimat e tij.

Fill pas tij vjen Soko Tona i Gurit të Lekës, i shpejtë si lumi i Valbonës, i përmendun edhe larg atyne maleve për mikpritje, trimni e besë të dhanë.

Pas i shkon një djalë i rrallë, Taro Pëllumbi; mandej bëjnë përpara dy djelmosha prej Zagore, Kacel Doda e Kemi Gila, të pashëm si karafila. Oso Kuka s' do ta kishte marrë kurrë me mend, se sa do të habiteshin dy vasha të reja, dy bija nanash të atyne mrizeve<sup>12</sup> dhe staneve, kur të mësojshin se ai kishte zgjedhë këta dy dhandurë të rinj për me luftue kundër cubave malazezë.

Mandej vjen një djalë tjetër, që ballin e ka si sini<sup>13</sup>, synin si duhi<sup>14</sup> dhe shpatullat si ari. Ky asht Çoku i Mark Kolë Dinit prej Kabashit të Dukagjinit, trim i çartun si zana<sup>15</sup>, rritun jetim, pa nanë e babë.

Pas këtij shihet çeta tjetër me disa të rinj, por edhe të tjerë ma të

vjetër, por të gjithë trima e bujarë. Veç në pamje e për hijeshi shquhet mbi ta Jup Qehaja, Galo Koqi... Mendej vazhdojnë rrugëtimin Vuksan Gjeli dhe Met Zeneli e ndër të gjithë si yll drite, dallohet Preng Markola prej Mirdite, lypë për pushkë e për pleqni<sup>16</sup> që nga Shkodra deri në Peshkopi.

Të tanë janë veshë, mbathë dhe armatosun, thue se po shkojnë krushq dhe njeri pas tjetrit po i bien Pazarit si ajo reja prej Tivarit<sup>17</sup> ngjitet lart, për të shpërthye ma vonë me rrufe atyre viseve.

Ata arrijnë mandej në bregun e Bunës<sup>18</sup>, futen dhe zanë vend në një lundër që kur veli ndehet<sup>19</sup>, rrëshqet dhe çan valët nëpër liqenin e Shkodrës drejt Vraninës, ku po ban nam Cetina<sup>20</sup>.

## KANGA E TRETË

### PREJA

Pse kjo qyqe, si asnjë herë tjetër asht tue vajtue atje në Vraninë, në atë të zezë krahinë që shtrihet në breg të liqenit të Shkodrës? Mos po qan, sepse i ka shkue jeta pa pasë e mjera as bir, as bijë? Jo, nuk po qan kjo qyqe për hallet e veta, por për një motër që ka mbetë edhe ajo si qyqe në votër, sepse është këputë kulmi i shtëpisë.

Po vajton për motrën e Avdi Hisës, të cilin pabesisht e kishte vra Vulo Radoviçi, i biri i shkinës, ky që po tmerronte banorët e saj, që nuk po linte as kalë të kalonte andej, që nuk po linte as çikë të fejohej, që po vriste djem të rinj dhe po i shtrëngonte nuset e tyne të ktheheshin të veja te prindërit. Po edhe nanat po i vishte në zi.

Me trembëdhjetë cuba të Cetinës Vuloja kishte mësy në mriz të Vraninës, ku po kullotshin dhen e dhi, të cilat donte me i grabitë. E kishte pikasë Avdiu dhe kishte lëshue piskamën<sup>7</sup>:

- Ndal, Vulo, mustaqegjati, nuk po ruej dhi e dhen për Karadak, por nuk largohem prej këndeje, pa e la mrizin në gjak.

Pastaj Avdia kishte nxjerrë breshanën nga brezi, që e kishte pasë si motër e nanë, dhe kishte dashtë ta qëllonte Vulon, por ajo i kishte shkrepë në dorë dhe kështu Vuloja, që kishte lindë për me vra, me pushkën e tij e kishte lënë trimin të vdekun. Jo vetëm kaq, por si cub që ishte, kundër zakonisht, i kishte zhveshë xhamadanin, i kishte marrë edhe pushkën, edhe taganin, që burrat me nder nuk e bajshin kurrë, kishte vu dhinë përpara dhe ishte zhdukë si hajdut arave.

Kur kishte pa Avdiun që ia kishin sjellë të shtrirë pa jetë në vig,

e motra kishte nisë me vajtue. E krahasonte të vëllanë me një lis me degë të prarueme, që Vuloja, ky përbindësh me tokë të zezë e kish martue dhe përsëriste fjalët e dhimbshme: "O vëlla, em vëlla!". Mandej vazhdonte të tregonte për një zog të zi që fluturonte nëpër Shqipni e këndonte se ka mbetë gjak pa u kthye.

U përhap ky vaj nga liqeni i Shkodrës e Vranina dhe e dëgjoi edhe Oso Kuka dhe u bani thirje shokëve:

- Të ngrihemi e të marrim gjakun e Avdiut, t'i kthejmë nderin Shqipërisë, të mos i mbajmë cubat me vjamë dhe të mos i lejmë çikat të qajnë.

Atëherë u çuen, djemt' e Oso Kukës, mbathë e z bathë, siç kishin qenë, rrokën armët dhe morën nga Vranina për me ngushillue motrën e Avdiut që vazhdonte ende të derdhte lotë për vëllanë e vdekun.

Secilit i lëngonte zemra, askush prej tyre nuk frikësohej dhe ashtu si stuhia që përshkon fushat kryq e tërthor, ashtu si rrufeja netëve mizore, si langoi që del me gjuejt dhe endet malit pa pushue, ashtu dhe djemtë e Osos ngasin që sa më parë të ndeshen me cubat e Vulos.

Kurrë nuk kishin kërcitë drunjtë e një pylli kur kishte marrë zjarr, ashtu siç kërciste Vranina, ndërsa sokolat e Oso Kukës ngitshin poshtë e përpyetë, thue se kambëve u kishin vu fletë. Kur qe, në breg të Moraçës u dëgjue krisma e pushkës së Preng Markolës nga Mirdita. Ishte i pari ai që i pikasi cubin Mirko që po humbte gjurmët.

- Ngadalë, mor zogu i shkinës, - vikati Prenga, - se nuk të le kush të grabitësh gjanë e Vraninës, edhe sikur të ishe vetë knjaz Nikolla.

Krisën kështu pushkët në log zanash, sa të dridhej fëmija në bark të nënës. I pari që mbeti i vramë ishte cubi Pavloviç, që po u grahte dhive të grabituna nëpër ara.

Kur pa Vuloja si e pësoi shoku i tij, për të cilin nuk ishte belegu, i braktisi dhitë dhe ia mbathi kambëve nga bregu.

- Bini o burra, - briti Osoja sa i mujt i zani dhe me djem u lëshue në shpinë kundër tyne si shigjetë.

Dhe ashtu si pulat fshihen në kaçuba kur u sulet skifteri, ashtu atbotë u fshehën edhe ata cuba, kush teposhtë, kush përpyetë. Por jo Vuloja, ai që ishte trim, sa t'i bajshe gjamën. Mirëpo sot nuk po i ecte e mbara, sepse Taro Pëllumbi i dha atij dhe një tjetri nganjë plumb në kokë dhe i vrau.

Po ku e kishte Osoja Kerni Gilën? Mos ndoshta se për të një zemër

vajze rrihte plot dashni dhe atij kështu po i dhimbsej jeta e po fshihej nëpër shkurre? Jo, nuk ishte fshehë aspak ai djalë, por në breg të Moraçës ishte ndeshë me Jovanin, një cub tjetër malazez.

Një çast Jovani kishte dashë të ikte. Por nuk kishte pasë forcë dhe cubat e tjerë që po vrapojshin për me shpëtue kokën, e kishin lanë prapa.

Atëherë nëpër breg të liqenit mbi të u derdh Kerni, me karajfile në dorë. Përpiqej të godiste anash vetëm për ta plagosë e zanë gjallë. Por nuk e kishte aspak të lehtë, sepse shkijau kishte tri zemra. Sapo pa Kernin, hodhi pushkën në një ferrë dhe nxori taganin me të cilin kishte vra sa e sa shqiptarë.

- Mos të të rrejë mendja, or trim i ri, - i tha Kernit, - se unë koris Malin e Zi tue ra në dorën tande! Por në qofsh i armëve si shqiptarët, nëse je sadopak bujar, nxirr dhe ti taganin. Dhe nëse asht e thanë, ma shkurto kryet në bejleg.

Kerni u ba gati shpejt dhe, pa e zgjatë, i briti:

- Jam shqiptar dhe si pushkën e gjatë, edhe taganin e kam zanat e nuk pres që cubi i Malit të të më mësojë besë dhe burmi. Por, meqë të asht mërztë jeta me cubni dhe punë të mbrapshta, ti tash ke mbarue.

Me të thanë lëto fjalë, uli pushkën për tokë, nxori taganin nga milli që nisi me flakërue nën rrezet e diellit dhe u vu përballë Jovanit. I kryqëzuen taganët që filluen të fringëllojshin, të shkrepshin shkëndija, kur ata përpiqeshin që kryet e shoqi-shoqit t'ia këputshin.

Djersë e gjak zuni t'u kullonte, por asnjëni nuk u ligështue. Ashtu si plagoset një ari, i goditun nga pushkë a hekur dhe jo vetëm nuk topitet, por vjen e nxihet dhe mësyn me furi e tërbim, ashtu dhe ata dy trima me duer të shpejta, si vetëtima në veprime, merrshin turr me fuqi të reja tue turfullue e kërcënue njëni-tjetrin dhe tue nxjerrë shkumbë e gjak nga goja.

Ndërkaq, aty ia behu Oso Kuka. Pas tij rob me dhi, të grabituna prej tyne dhe cubave të Vulos. Kernit i erdhi marre që deri atëherë nuk e kishte vra armikun, ndaj u mat ta godiste me aq furi, sa sikur tagani të kishte hasë në trupin e tjetrit, do ta kishte nda përgjysmë.

Por, befas Osoja, u vu midis tyre dhe u tha:

- Trima, mjaft paskeni luftue, por qenka thanë që njëni-tjetrin mos ta lini të vdekun. Pra, ti cub malazez, mprehi këmbët dhe dredho në shtëpi dhe i thuej nanës e nuses sate, në qoftë se i ke gjallë, se sot ke lindë për së dyti. Por thueji shokëve të tu që të mos i rrejë ai



cari juaj, se ai do të mundet me sundue mbi ne, veç kur në Shqipni të këtë vetëm çika. Ndoshta ne jemi të ndamë ndër vedi, por kur shkjaun të sulmojë vendin e të parëve tanë, shqiptarët, myslimanë e të krishtenë, merr vesh or djalë, kanë për t'u gjetë krejt në një fjalë.

Pas këtyne fjalëve, Jovani heshti dhe pasi luftëtarët shqiptarë i lidhën plagët, ai rroku pushkën e vet dhe u nis shpatit të malit për në Cetinë. Kurse Oso Kuka me trima mori rrugën për në Vraninë, atje ku Zana filloi me këndue:

Ku bie dielli e ku del hana,  
Oso Kukë nuk ban ma nana.

## KANGA E KATËRT

### VRANINA

Një lajm i tmerrshëm u përhap në Cetinë. Shqiptarët atje në Vraninë po bajshin kërde mbi shkjatë: luftojshin me ta, i zijshin, i vritshin, qofshin edhe cuba. Dhe kjo po ndodhte qyshse në krye të tyne ishte tashma Oso Kuka nga Shkodra, që trim si ai nuk kishte atyne anëve: Vetullat i kishte të zeza, ushtonte mali kur fliste, dridhej fusha kur vikaste dhe kur nxirte taganin e rreptë dhe e lëkundte nalt, rrufeja shkrepse kudo. Synin e kishte si të skifterit dhe kur matej me pushkën e tij, mund të vriste këdo, sado larg të ishte.

Burrë kaproç dhe trim i rrallë, sa thojshin se nana e kishte lindë me këmish, plumbi nuk ngulej në gjoksin e tij, as shpata nuk përkulej; dhe topi t'i binte, ai nuk shkulej nga vendi ku luftonte.

Pas fitoreve në Vraninë kundër malazezëve Oso Kuka paska thanë se shqiptarët, sado armiq t'u dalin përpara, nuk bien kurrë në dorë të Gospodarit.

Këto fjalë i shkuen në vesh knjaz Nikollës, që u zemëruë kaq shumë, sa menjëherë thirri në Cetinë tanë krenët e Malit të Zi, njeni si ari dhe tjetri si duhi, të gjithë trima sytrembun.

Si i pa të rreshtuem në një lëndinë, Knjazi ngërtheu vetullat dhe zuni t'u fliste:

- Oso Kuka me dyqind fatosë që i ka të zgjedhë në mal e në vërri, jo nga pamja, por nga trimnia, nga ata që pushkën e kanë nanë e babë, nuk po na le ta fusim në dorë Vraninën. Dhe paska thanë se shqiptarët do t'i dëbojnë malazeztë që guxojnë të vënë këmbë në trojet e tyre.

Pas këtyre fjalëve cubat e knjazit u panë sy më sy.

- Ju do të mësyni mbi Vraninë, - vazhdoi knjazi. - Vritni e pritni sa më shumë shqiptarë. Ta dini se ne na mbështet Moskovi i cili e ka pleqnue me turqit, që këta të na lenë të lirë të sulmojmë dhe të arrijmë deri në kalanë e Rozafatit në Shkodër dhe kështu të jemi dora-dorës me serbët vëllezën, që do të pushtojnë krahina të Shqipnisë së Veriut. Kurse krahina të tjera do t'i marrë bullgari dhe greku. Pra, mbasi ne, shkatë e Ballkanit, të kemi vu nën vete tanë këto toka të Turqisë, do të arrijmë të bashkohemi me vëllezërit tanë rusë në veri. Mirëpo, qëkur ky Oso Kuka na doli në Vraninë, nuk po di nga t'ia mbaj dhe kam frikë se nuk do të mund të pushtoj jo ma toka të tjera, siç i kam premtue carit, por as këto tokat shqiptare.

Kështu u tha Knjaz Nikolla krenëve të tij që mbetën të menduem. Por pas pak, njeni prej tyre, Mirkoja, nga më të mirët, u ngrit e tha: - Gospodar, ne fjalën e carit nuk mund ta lëmë në rrugë, edhe pse një trim shkodran ka dalë në Vraninë, në atë të zezë krahinë, në breg të liqenit të Shkodrës. Por ta zemë se këtë shkodran, që pushka e asnjërit prej nesh nuk po e rrëzon të vdekur në tokë, nuk po mund ta kapim as gjallë, as vdekun. Ne, malazetë, e dimë që në Shqipni ka djem si zana që kanë lindë me armë në dorë, të përmendun për besë dhe fe. Prandej, ky vend nuk bie kaq shpejt në kambët tona. Por mos kjo do të thotë se atë nuk mund ta pushtojmë? Jo, sa më shpejt t'i biem Vraninës! Unë po shkoj atje me shtatëqind vetë që s'e kanë për gja jetën. Mandej Gjukoviq Pera të vijë me katërqind pushkë të tjera. Kam besim se me këto ushtri kemi për ta marrë Vraninën; edhe sikur me tagan t'ia pres kokën Oso Kukës, kam për ta sjellë këtu në Cetinë të ngulun në një hu.

Atëherë knjazi u ngrit dhe u tha krenëve:

- Sokolat e mi, suluni me sa ma shumë ushtarë në Vraninë, pushtojeni dhe pritjani kokën Oso Kukës.

Rrëfen poeti:

Ti, moj Zanë, shihi ato kroje ku ujnat rrjedhin me curila, shihi bilbilat e pranverës, shih dhe flladin që sjell era, shih trëndafilët të mbuluem nga vesa që bie nga qielli, dhe më kallëzo, a të vjen keq që knjazi me krenët e vet vendosi me çue ushtri në Vraninë dhe me i shkurtue kokën Oso Kukës? Po më lëngon shpirti dhe zemra kur mendoj se ç'kob po i bie në kokë Shqipnisë së mjerë, ku kanë lindë burra si Gjergj Kastrioti, para të cilëve bota habitej, kurse shqiptarët si të hutuem rrinë me duer në ijë, thue se qielli ka vendosë që ata të

mbeten rob nën shkjaun dhe t'i nënshtrohen kështu knjazit.

Prandaj ju, krenë gjithandej në Shqipni, mbajeni mend se detyra juej asht që t'ua ndizni shqiptarëve dashuninë për vendin e tyre, që të luftojnë, ashtu siç po lufton dhe është gati të japë jetën Oso Kuka atje në Vraninë.

## KANGA E PESTË

### DEKA

Doli nga ujërat e Riekës hija e një të vdekuni, e ndezun në flakë, si të ishin flakë që nxjerr lugati, dhe tue ecë nëpër fusha dhe nëpër shpate malesh, nëpër kënetë dhe zallina, mori rrugën për në Vraninë. Më të mbërritë atje, bëri nga kulla e xhebehanes dhe i dha flakë barotit. Atëherë shpërtheu kulla, u drodh toka, ushtoi liqeni, lumi, mali... dhe Oso Kukës i doli gjumi.

Kishte parë një andërr, andërr të keqe, ndaj mezi nisi të kapërdinte bukën dhe mishin e dashit që po hante, ndaj u ngrit nga tryeza, lau duert dhe u mbështet pranë votrës, tue mendue dhe pi duhan.

Edhe djemtë, me të mbaruem së ngrani, nisën të kuvendojshin me njeni-tjetrin, a të luejshin cic-mic, të vajisshin pushkët, të mprihshin taganët dhe t'i vijshin fishekët në vezme. Kurse Soko Toma mbante ende në dorë kockën e shpatullës së dashit që kishte ngranë.

- Këqyre atë shpatull, - i tha Osoja, - se më duket se ajo diçka tregon.

Dhe Sokoja e ngriti atë, e pa në dritën e kandilit dhe iu përgjigj:

- Shpatulla tregon luftë, varre dhe tym e gjak nëpër oborre.

Pastaj u vranue në fytyrë dhe shtoi:

- Oso, më duket se shpejt do të kemi luftë...

- Merr atëherë, Kaçel, lahutën dhe na këndo një kangë shqiptare, - i tha Osoja një djali aty pranë, - se ne nuk mbajmë zi, ende pa qëllue mbi armikun.

Dhe Kaçeli ashtu bani:

Kishte dalë një arap prej detit, trim dhe belaxhi, dhe kishte urdhnue që nga çdo shtëpi t'i sillshin nga tri bukë pogaçe, nga shtatë enë më venë për me pi, nga një dash të pjekun në drekë dhe një sqap të rrjepun për darkë. Njëqind vetë kishte vra deri atëherë, njëqind shtëpia kishte djegë, kudo ku kishte shkelë kamba e tij. Me të arritë në Shqipni, i kishte dërgue atij trimit, Gjergj Elez Alia, një letër të vrazhdë, ku i shkruente: "Pasi të marrësh këtë letër, ti ke për të më

dalë në mejdan, sepse përndryshe unë do t'i djeg kullat e tua, toka e kullota do t'i shkel, bagëtinë do të ta mjel dhe gruen tande do ta marr rob".

E mori Gjergji këtë letër dhe u vranue fort kur e këndoi. Atëherë nisi të hante mish kau dhe të pinte venë trivjeçare. Kur u mbushën plot dy javë, provoi se sa i fuqishëm ishte ba. Kështu, mbërtheu me të dy duert një lis të madh që kishte në oborr, e shkuli me gjithë rrënjë dhe pastaj e nguli prapë aty ku ishte.

Atëherë veshi petkat ma të mira, ngjeshi në brez shpatën prej floriri, zgjodhi gjokun pullali dhe i tha së amës:

- Hallall ma bëj moj nanë, një amanet po të la: në qoftë se arapi do të më vrasë, ti për mue mos derdh lotë.

- Të ruejtë zoti, mor bir, - ia ktheu e ama, - se unë kurrë nuk do të të koris.

Atëherë Gjergji mori topuzin në dorë, i hipi gjokut në shpinë dhe u nis përgjatë shpatit të malit dhe, kur zbardhi dita, u ndodh para derës së arapit.

- Nadja e mirë, arap, - i tha, - nuk asht koha të rrish sot në votër, - por, ashtu siç më ke shkruar në letër, çohu dhe dil në fushë të mejdanit.

Kur e pa arapi i detit Gjergj Elez Alinë, ngjeshi edhe ai armët, e mbuloi trupin e kalit të tij me lëkura buejsh dhe doli në mejdan. U drodh gjoku i Gjergjit, kur pa kalin e arapit ashtu të zi dhe u zmbpraps.

- Mos u tut, - i dha zemër Gjergji gjokut, - se gjaja e coftë nuk mund të të bajë gjâ.

Befas arapi i zi iu turr Gjergjit dhe e qëlloi me topuz. Ky u mënjanue dhe topuzi i rrëshqiti mbi kokë.

Atëherë i briti:

- Ngadalë, o arap i zi, se këtu i thonë Gjergj Elez Ali!

E ngriti pastaj topuzin, shtjeu me tërë fuqitë mbi të dhe e la të vdekun në tokë. Mandej zbriti nga kali dhe i preu kokën...

...Kështu po këndonte Kaçeli me lahutë, ndërsa djemtë e dëgjonin të mahnitun nga trimëria e Gjergj Elez Alisë. Por jo Osoja. Ai e kishte mendjen tjetërkund. Ndaj i tha Met Zenelit, një djali aty pranë:

- Bashkë me Vuksanin, Sinanin dhe Kernin dilni roje në va, se tash është tue ra mesnata dhe shkjaun besë nuk ka.

Pasi ata dolën dhe morën nga vau, Oso Kuka dhe djemtë e tjerë ranë me fjetë. Por Oson nuk e zinte gjumi. As edhe një tjetër. Ky ishte Zeliq Gjuka. Ai as nuk flinte dhe as nuk kotej. Mandje tinëz, me një

strungë vu mbi kokë, la shtëpinë dhe mori nga vau.

Zeliq Gjuka ky zog shkine, edhe pse shqiptar nga Vranina, i gënjem nga florinjte e knjaz Nikollës, kishte tradhtue.

Tue ecë nëpër natë pa hanë, tutje vaut, u takue me Mirko malazezin, që me ushtrinë e tij të madhe kishte dyndë atyre anëve që prej aty të sulmomte Vraninën.

Kështu, të primë nga Zeliq tradhtari, shtatëqind ushtarët e Mirkos dhe katërqind pushkët e tjera të Gjokoviç Perës, nëpërmjet lumit të Riekës po u afrohesin me lundra brigjeve të Vraninës.

Rrëfen poeti:

Qani zana, në ato maja ku hani, në ato kroje ku pini, në ato hije ku vallëzoni, qani dhe lotët mos i pushoni, sepse tash në ato curra, kanë për të dhanë jetën djem që me aq kujdes i keni rritë, që armikut të mos i frikohen, edhe pse sot janë të rrethue nga shumë ushtri anmike. Thue ata mund të vdesin, sepse tashmë ato ushtri po i afrohen Vraninës dhe tradhtisht do ta pushtojnë? Po, por jo pa gjak! U ndezën flakë breshanat, kulluen gjak shpatat, kulluen gjak edhe zemrat e djemve shqiptarë, sepse tridhjetë prej tyre mbetën të vramë dhe dhjetë të tjerë të plagosun randë.

Po vallë Oso Kuka ishte?

Në xhebehane paska shkue, në atë kullë të barotit, se për së gjalli ai nuk bie kurrë në dorë të anmiqve, pa marrë hakun e djemve të vramë.

Kur panë malazeztë se pushka kishte pushue andej nga brigjet e liqenit dhe përreth s'po dëgjohej ma, u turrën nga xhebehania që të kapshin Oso Kukën.

Kështu, tue brohoritë për knjazin, njëqind vetë, ndër ushtarët ma të guximshëm, kërcyen në kulmin e pullazit të kullës, u ngjitën mbi frengjitë dhe nisën me shkatërrue muret e përgjakuna të saj.

- Ah, ngadalë, knjaz Nikollë, që të vraftë zoti! - u dëgjue një zë nga brenda kullës, - se këtu i thonë Oso baroti, dhe nuk ke pa shqiptar me sy që djeg veten edhe ty.

Atëherë i dha zjarr barotit.

Seç u drodh Vranina e shkretë, ç' u hodh kulla përpyetë dhe oshëtima e saj gjëmoi deri te Kalaja e Rozafatit!..

Tjegulla, gurë e trarë, hi, tym dhe gjymtyrë njerëzish fluturuen në ajër.

Vazhdon poeti:

Ejani, ejani, nana malazeze, mblidhni trupat e bijve tuej dhe mandej

mësojini fëmijët që të mos lakmojnë ma toka shqiptare, se shtrenjtë kanë për ta pague gjakun që Oso Kuka me djem të tij derdhi në ato fusha të Vraninës. Se pa u djegë në kullën e barotit, fisi i shqiptarit nuk do të bjerë kurrë në dorë të pushtuesve të huej.

## KANGA E GJASHTË

### DERVISH PASHA

Që nga ajo ditë kishin kalue plot njëzet vjet...Kishte ardhë viti 1878. Në Stamboll po binte mbramja dhe po mbulonte edhe pallatin e sulltanit, të rrethuem nga roja të shumtë.

Pa pritun, një shtegtar ia behu te portat e pallatit. Dukej se vinte nga vise shumë të largëta, sepse ishte i lagun, i mbuluem me djersë, i drangun, me tirqe shpërvjelë deri në gju dhe rripin shtrëngue në bel. Por ajo që habiti rojat, ishte se kërkoi të takonte vetë sulltanin!... Atëherë ata e pyetën se kush ishte.

- Kam qenë dikur me nam, kam pasë toka, bagëti, kam pasë shumë pasuni, - zuni të thoshte shtegtari i ngratë, - kurse sot gjithçka që kisha m'i rrëmbeu i hueji që më mban nën zgjedhë e kështu kam mbetë i përbuzun, i shtypun, si mishi për kërrabë, për t'u zie a për t'u pjekë. S'jam pra veç hije mbi dhe, hija e Shkodrës që më ka dërgue të takoj vetë sulltanin.

E dëgjuen rojat këtë shtegtar dhe ashtu siç ishte i lodhun dhe i këputun, tamam si hije, e përcollën para sulltanit.

Nisi e foli atëherë shtegtari:

- Sot, sulltan në Shqipni, nuk je ti, por ai knjaz Nikolla, që me cubat e tij nga Cetina ka pushtue jo vetëm Vraninën, por hovin kërkon me e ndalë në Shkodër. Dhe po të mos ishin trimat e Mirditës, ata cuba me kohë do të kishin hy atje. Kështu, o sulltan, ose hiq dorë nga Shqipnia, ose ndryshe shpejt dërigo ushtri që të zbrapsë malazezët pushtues.

E dëgjoi sulltani shtegtarin që si hije qëndronte para tij, keq u idhnue dhe çoi e thirri aty për aty Dervish pashën dhe i dha urdhën:

- Kështu si e ka nisë, ai knjaz Nikolla, Shkodrën do që ta bajë shkja, prandej merr pesëdhjetë tabore dhe dil në Mal të Zi për me i thye cubat e tij.

Pyet poeti:

Por njëmend, moj Shkodër, Dervish Pasha e ngriti tanë këtë ushtri

që të të dalë zot dhe të të këpusë prangat që prej s'dihet se kur Turqia në këmbë t'i ka vënë ty dhe atdheut? Jo, moj e shkretë, ai vjen për me të mbajtë gjithnjë rob, për me të ndrydhë nën thembër dhe shishin për me ta ngulë më thellë në zemër, edhe gjakun me ta pi, për me të lanë kalbun mbi tokë, ty dhe atdheun.

Pastaj i drejtohet atdheut:

Po djemtë, Shqipni, ti ku i ke djemtë, ku i ke? As sulltanit ata të mos i shtrohen, turq, serbë, a grekë, të mos quhen, a për pare e timare, për çifligje e beglleqe të mos shiten, që ti të mbetesh kështu grue horre dhe jo nanë e zonjë si në kohë të Kastriotit. Ku i ke pra djemtë, që të mos lenë Dervisha e Nikolla që të ta lajnë trupin me gjak dhe të të poshtënojnë si nanë pa djalë? S'janë të huejt që të shpëtojnë Shqipninë, por shqiptarët dhe kurrkush tjetër, se po qe se ti humb, për fajin e tyne kjo ka për të ndodhë.

Pastaj poeti vazhdon:

Pse po ndiej dhe andej nga Shkodra fort po dëgjohet lodra e trumpeta dhe po ushton Kalaja e Rozafatit? Sepse Dervish pasha ia behu në Shkodër, që me anadollakët e tij t'i vëjë flakë Cetinës dhe knjaz Nikollën ta zejë gjallë, ta lidhë dhe sulltanit në Stamboll t'ia dërgojë!

Mirëpo kjo nuk ishte kaq e lehtë, se ky knjaz kishte do trima të fortë që për të ishin gati të shkojshin në luftë, siç shkojnë krushqit në dasmë, edhe pse plumbat i presin në parzëm.

Atëherë Dervish pasha e ndau ushtrinë në tri çeta; njenen e lëshoi nga Podgorica, tjetrën nga Kernica dhe të tretën e mbajti pas vetes. Ndizet zharrë e vërri, kërcet pushka dhe havani, sa jehona përhapet anë e kand Ballkanit. Turqit rrethojnë Cetinën. Por malezezët lidhin besë që atë ta dorëzojnë dhe vetë të mos gjunjëzohen.

Kanë ngjeshë vezmet në brez, gati kanë taganat në millë dhe pushkët në krahë i mbajnë dhe përleshën me turqit.

Megjithatë, ushtritë e Dervish pashës shtyhen përpara; marrin Vraninën, ku vite të shkueme Oso Kuka i mbyllun në atë kullë, nuk u dorëzue, i dha flakën fuçive të barotit që shpërthyen në zjarr, shembën kullën dhe nëpër rrënojat e saj bashkë me djemtë u vranë edhe ushtarët e knjazit. Pastaj ushtritë e Dervish pashës pushtojnë dhe dy qytete të tjera, Zetën dhe Podgoricën dhe ndodhen kështu para Cetinës, aty ku e kishte çerdhen knjazi ...

Kërkon Dervish pasha ta shtijë pallatin e knjazit nëndë pash nën dhe!.. Por sa shumë ka shkrehë atje potera, sa shumë është ndezë lufta, sa shumë gjak asht derdhë, sa shumë ushtarë turq janë sharrue!...

Mësynte turku me fuqi, por edhe shkja mbahej trimnisht...Dhe kah u ndeshën aq furishëm, shpërthyen krismat e bubullimat, nisi pushka dhe nuk reshhte, filloi topi të gjëmonte, u ndërsynë turk e shkja me njëni-tjetrin tue u përta; njëni mësynte e tjetri shtynte, si dema ballë për ballë, kapërthye bërrylash, atje ku bajnë gjedhët mritz prej të nxehtit, atje ku toka asht zall dhe ku është djerrë, ndërsa pluhni i dendun ngrihej në ajrë.

Dhe ky dyluftim midis tyne vazhdonte. Dy herë turku e kapi për shpatullash, dy herë shkja e lëshoi ndër zaje, por kur së treti, turku mori ta kapte, për të dalë në majë të malit, nuk mundi. Atëherë ata nxorën taganat dhe si bisha tue uluritë, zunë të luftojshin. E hodhi turku shkjaun për tokë, por u drodh, nuk e vrau dhe kurrizin i ktheu.

Iu hodh atëherë shkjaun pas gjurmëve, vrap për vrap e ndoqi, dikë tue e therë e dikë tue e lanë të vdekun, e dërmoi dhe e shtyu deri në Rjekë, Vraninë, iu vu si shigjetë në shpinë dhe e dëboi edhe që andej.

Kur pa Dervish pasha se knjaz Nikolla ia shkatërroi ushtrinë, u zemëruë fort, përplasi këmbët i tërbuem dhe tjetër komandant zgjodhi, atë që më i miri ishte midis luftëtarëve të tij.

Pastaj e nxori ushtrinë e tij pas shpinës së cubave malazezë, që kështu t'ua priste rrugën atyne e t'i rrethonte. Por knjazi e kuptoi shpejt rrezikun dhe i trembun se mos kapej rob nga turqit, me çetat e veta mori malit të përpjetë.

Kështu Dervish pasha me vetulla të trasha ngërthye mbi ballë, u fut në Cetinë.

Por a do të qëndronte gjatë atje? Nuk dihej, sepse ndërkohë diçka po vlonte atje në Berlin.

## KANGA E SHTATË

### KUVENDI I BERLINIT

Ç'ishin ato bubullima që ndëgjoheshin andej nga Rumelia, nga Plevna dhe përhapeshin në tanë Bullgarinë? Ç'ishte ky gjënim topash, ç'ishte kjo gjamë, aq sa toka të dridhej nën kambë?

Ishin topat e Ruisë dhe havanat e Turqisë që shpërthejshin në fushat e betejave. Të dy si bisha kundër njëni-tjetrit. Turqit zmbraseshin dhe rusët mësyjshin, që të arrijshin kështu në portat e Stambollit, ta rrëzojshin sulltanin dhe perandorinë e tij të madhe.

U shqetësuen shumë kraljat e Evropës dhe u vunë midis këtyre



bishave. I shtrënguen ato ta ndalojshin luftën dhe të bajshin paqe. Ndaj u mblodhën në Berlin. Të bisedojshin që të shuheshin kështu meritë midis vendeve të tjera, të ngulshin gurë në kufij të rinj, që nga Ballkani e deri në Detin e Zi.

Por, a kishin besë e fe këta kraja, ma të fortët mbi dhe, me armët e mbërthyeme ende në brez? A kishin besë e fe për popujt e vegjël, a kishin besë edhe për fatin e Shqipnisë?

- Jo, për të tjerë kishin, por jo për Shqipninë...

Ndaj, kur ata ishin ulë në tryezë dhe të kërrusun mbi hartën e Evropës po bisedojshin me njeri-tjetrin se si do t'i ngulshin gurët edhe në kufijtë e Shqipërisë sonë me vendet që e rrethojshin, në sallë u fut knjaz Nikolla i Malit të Zi.

Të tanë kthyen kokën nga ky burrë i thinjun. Dhe kur e panë me dollomanë të lëshueme, strugën mbi krahë të vjetërueme, shallvaret të shqyeme mbi kupë të gjurit, ndjenë dhimbsuni. Por ndjenë edhe më shumë dhimbsuni, kur ai nisi t'u ankohej:

- Tokë buke ne nuk kemi, se bjeshkët dhe vërritë na janë tha e shkrumbue. Me shkëmbenj e rrasa të lëmueme asht i mbuluem i tanë vendi e kallëzat e grunit askund nuk t'i ze syni. Kështu cërnagorasit e mi nga halli lëshohen në tokat pjellore shqiptare, aq të begata, në daç me bjeshkë e vërri, me fusha për me kullotë bagëtia dhe bukë për me prodhue.

E dëgjuen të heshtun krajat e Evropës këtë knjaz që nuk pushonte të derdhte lotë. Aspak nuk e qortuen, ndonëse e dijshin se sa dame u kishte sjellë shqiptarëve me cubat e tij gjakatarë. Biseduen atëherë kokë më kokë edhe me sulltanin e Stambollit që rrinte i heshtun diku në tryezë dhe së bashku vunë dorë mbi letër që ta ndihmojshin këtë burrë dhe popullin e vet!... Kështu që këndeje e tutje Plava dhe Gucia, qytete krejt shqiptare, t'ia bajshin dhuratë atij. Por jo vetëm kaq: edhe Shkodra me gjithë malësinë përreth, deri në lumin Drin, t'i faleshin Malit të Zi.

T'i merrte knjaz Nikolla tërë këto toka pa shti asnjë pushkë? Dhuratë ma të madhe kurrë nuk kishte ëndërrue!...

Kur malazeztë morën vesh këtë lajm kaq të mirë nga Evropa dhe Stambolli, qenkan hedhë, paskan kërcyer dhe këngës ç'ia paskan nisë dhe kësulën mbi sy e paskan vu.

Të kishte shqiptari këndeje e tutje mbi kokë shkjaun? Atë që e kishte mësy, grabitë, vra, që ishte rrekë t'i futej në votër dhe të bahej zot i shtëpisë dhe tokës së tij? T'i hante ai bukë të bardhë e mish viçi në

sofër, të pinte ai verë prej poçi, sa gjaku t'i plaste në faqe? Kjo mund të ndodhte vetëm kur flakë të merrte rrokullia.

U kthye kështu knjaz Nikolla në Cetinë dhe shpejt i çoi fjalë mikut të vet, Pal Milanit, që, pa humbë kohë, të vinte e ta takonte. Dhe ai nuk vonoi dhe erdhi në pallat.

- Dëgjo, Pal, pesë tabore kam me t'i dhanë, pesë tabore me djem të rinj, djem nanash malazeze. Sulu me ta në Hot e Grudë, pastaj në Plavë edhe Guci që edhe ato krahina për një javë të m'i shtrosh, se krajlat e Evropës m'i kanë falë, që mbi to të shkel si të due. Mandej si ujku prej pusisë, sulu mbi ata trimat malësorë, qoftë me shpatë, qoftë me konop. Si të kesh shtrua kështu edhe Malësinë, rrugën hapun e kemi për me marrë Shkodrën, tue hedhë valle me lodër, pa na u futë ferrë në kambë.

E dëgjoi Mark Milani knjazin dhe i shpjegoi:

- Nuk shtrohet Malësia për një javë, dhe as me pushkë nuk merret Shqipëria. Ndaj veniu vesh fjalëve të mia, o knjaz, mos nguc grethat me krande, se vetes dam ke për t'i ba. Mos harro se as Zoti, as Kanuni nuk thotë që në vend të huaj të hysh përdhuni. Me më thanë, në zjarr të hidhem, a detit i bie anembanë, jam gati që tash, por të shkoj në Shqipëri, jo, nuk mundem.

U gajas knjazi dhe buza i shkoi vesh më vesh.

- Ç'burrë na qenke ti, Pal Milani, që këto fjalë nxore nga goja, sikur grue të ishe dhe prej tyne të trembeshe! Mirë do të ishte për ty që kamilaf në kokë të vijshe dhe deri në gju ta zgjasshe mjekrën. Ose ma mirë, shko në shtëpi dhe aty bashkë me shoqen tënde tjerr lesh në furkë dhe ngrohu në diell, se për luftë nuk qenke.

Si i tha plot mllef këto fjalë Pal Milanit, vazhdoi:

- Sa për luftë asht Mark Milani. Si luan asht ai trim, që ushtrisë ka për t'i pri, Plavë e Guci në dorë do të shtijë dhe pastaj në Shkodër do të futet ngadhnyes.

Rrëfen poeti:

Si shumë gjatë ke folë, knjaz Nikolla. Por mos e lësho vrapin më shumë se ç'e ke hapin. Ti lakmon që tokat shqiptare t'i bash të tuat, pa pyetë vetë shqiptarët? Po si të shkon mendja ty se ata do të t'i falin ato toka, pa zbrazë pushkë, mor Nikollë?! Mundet që njerëz të huej të ndodhen ngushtë, por, në qoftë se nuk u shkojnë shqiptarëve për mik dhe i prekin në erz, atëherë shqiptarët ngajnë si të kishin lindë, veshun me çelik dhe gjallë nuk u shtrohen atyne të huejve, edhe sikur vdekjen ta shohin me sy.

## KANGA E TETË

### ALI PASHË GUCIA

Dielli ende nuk kishte lindë, kur Ali pashë Gucia u zgjue, u vesh, i hipi gjokut dhe tek po largohej, u ndal te dera e shtëpisë dhe i thirri nanës së vet:

- Pa më dëgjo, moj loke, m' u ban nder miqve dhe shokëve dhe tanë atyre që më nderojnë; mos le të vobegtë të qajnë në derë, t' u bahesh si motër e vëlla dhe si nanë e babë, ashtu na kanë mësue prindët. Unë po nisem andej kah Peja, për me takue Haxhi Zekën. Por nuk di, nëse kam me të pa përsëri.

Mandej i tha së shoqes:

- Një amanet jam tue të lanë. Rritma djalin, djalë bujar, që të bahet burrë trim e armët nga dora të mos i lëshojë. Dhe, nëse malazetë do të sulen në Guci, baje zemrën gur dhe preja kryet në djep, që gjallë të mos ma lesh në duert e knjaz Nikollës. Ma mirë në vorr ta qash, se sa gjallë të jetë nën shkja.

Kështu tha Ali Pashë Gucia dhe mbi kalë si breshni me stuhi mori tërthores së malit.

Çka mendonte ai kah vrante ato vetulla të trasha dhe ata sy si shigjeta, tue shtegtue e tue lanë pas rrugë, kodra e fusha?

Dhe, ndërsa kali po vraponte porsi re, një lis të bukur ai pa përpara, një lis të bukur dhe plot hije, ndërsa përbri një gurrë gurgullonte plot ujë si flori. Nën atë hije Ali pasha e ndali gjokun dhe zbriti për me pushue .

Aty ai nisi të sodiste hijeshitë e viseve të Shqipnisë...Rreth e qark i dukej se shihte liqej, ara, lumej, male të madhnueshme, pyje të blerueme.

Atëherë sytë iu mbushën me lotë, kur mendoi se fati i atdheut tashma ishte në duert e hueja, se ma i keqi pushtues që e kishte shkelë, kurrë nuk e kishte lanë të ngrinte krye, që të shihte dritë me sy.

Dhe ndërsa rrinte kështu i mërzitun, pa pritun pa se përmes logut po vinte një vashë. Belin e kishte të shtrëguem me një rrip ari, flokët të hedhun pas shtatit, si ato rrezet e diellit që duken majë malit. Ishte e gjatë si breshana, tamam sikur të ishte zanë.

U trand gjoku kur e pa, lëvizti veshët, ngriti kryet dhe nuk ia ndau sytë, turfulloi disa herë dhe u zmbrops nëpër rudinën e gjelbër ku rrinte ndenjur Ali Pashë Gucia. E pa edhe ai vetë, u ngrit dhe nisi ta kundronte, pa dajtë se kjo qenie ishte njeri, apo hyjni.

Dhe pas pak, ndërsa po e këqyrte ashtu me habi, e pyeti se kush ishte:

- E ç'randësi ka kush jam, - iu përgjigj vajza, - por as pashkë dhe as bajram nuk kremtoj, dhe erdha të të them se ngushtë janë punët sot në Shqipni, se besa krejt po harrohet, se knjaz Nikolla si lugat ka dërgue sogjet shpat më shpat, që të arrijnë deri në Kalanë e Rozafatit, se në Berlin u nda pleqnia, që krahina të Shqipërisë t'i marrë Mali i Zi .

- Çfarë po thue? - zuni të gërthiste Aliu. - Knjaz Nikolla paska me pushtue malet tona dhe tokat deri në Drin dashka me i rrëmbye?

- Kështu në këmbë të shkjaout do të vuajë Shqipnia, - vazhdoi ajo, - se sot shqiptarët po rrehen me pare dhe timare, besë dhe fis po mohojnë, po harrojnë edhe atdheun dhe me armë po vrasin njeni - tjetrin. Marre e turp se po njollosin namin e të parëve! Jam unë, ora e Shqipërisë që i them këto fjalë, prandej shqiptarët do t'i nam, që të mos u zhbihet arave grami, që bagëtitë të ngordhin, që djalë të mos u lindë në votër, që të mos u rritet vëlla e motër dhe kështu të shuhet nën zgjedhë të huej, si shuhet kripa në ujë.

- Të lëshofsha mbi kokë bjeshkë e male, moj orë, - mori dhe i tha atëherë Aliu, - mos na nam më, se neve nama na ka ra, se ne besa na ka vra, derisa ka arritë që fisi i shqiptarit të dridhet para shkjaout. Të dridhet shqiptari para knjazit, që as sa luga në fytyrën e një bualli nuk çon kandar në këtë tokë! Por, në qoftë se shqiptari ka gjetë hije për të pushue, gurra për të marrë fresk dhe rudina për të vallëzue krah për krah me vajza të bukura, kur lulëzon e butë pranvera, më kallëzo si ta shpëtojmë të ngratën Shqipëri, se po të baj be, se djali për atë nuk po më dhimbset, se për të dhe jetën e fal.

Kur dëgjoi Ora e Shqipërisë se ç'i tha Ali pasha, u gëzue fort dhe nisi të ligjëronte:

- Çohu pra më këmbë, përderisa je gjallë, se koha nuk pret dhe knjazi me topa po na kërcënon, dil e tako Haxhi Zekën, grish Kosovën dhe krahina të tjera, lësho kushtrimin në gegë e toskë, që të mblidhen si kokrrat në shegë, që të lidhin besën midis tyre, që shkjaout të mos i nënshtroheni. Me ju do të jem edhe unë dhe, meqë ti bane be se jep jetën për Shqipninë, unë po të jap fuqi, që lisat t'i shkulësh, që tagani i armikut kurrë të mos ngulet në trupin tand, që plumbi i pushkës mos me të vra, që gjylja e topit mos me të ra.

Pas këtyre fjalëve të Orës së Shqipërisë, trimi u shtrëngue dhe e mbërtheu me duar lisin, si të ishte hu gardhi, dy tri herë e tundi, me

gjithë rrënjë nga toka e shkuli dhe përsëri e nguli aty ku ngrihej ma parë.

Pastaj u kthye për me dëgjue se çfarë do t'i thoshte Ora e Shqipërisë. Por u habit kur pa ajo ishte zhdukë si vesa mbi lule.

Vështroi rreth e qark nga zabeli, deri lart ku shihej bora që mbulonte majat e maleve, që të shquente se ku ishte zhdukë Ora. Por më kot, atë askund nuk e pa.

Kur gjoku nisi të hingëllinte dhe me thundër të godiste tokën, si ta lajmëronte se nuk ishte koha të priste, Ali pasha u përmend dhe kujtoi fjalët që i kishte thënë ora: se Shqipëria ndodhej në rrezik dhe kështu i kërceu gjokut mbi shpinë dhe bashkë me të u vërsul përpara, sa ishte vështirë të shihej dy herë me sy.

Të arrinte sa më parë në Pejë...

## KANGA E NANDTË

### LIDHJA E PRIZRENIT

Sapo arriti në Pejë, Ali Pashë Gucia, shumë i shqetësuem për këto të këqija që goditshin mbi Shqipërinë, lëshoi kushtrimin që të gjithë krenët e krahinave të atdheut tonë të mblidheshin sa ma parë në Prizren. Aty do të vendosshin me e shpëtue atë nga caponjtë e Malit të Zi, që me ushtri të armatosun edhe topa po dyndej drejt dy qyteteve shqiptare, Plavës dhe Gucisë.

Me të dëgjue këtë kushtrim, ashtu si yjet që shkrepin shpejt në qiell, ashtu u ngritën edhe burrat ma në za, nga të gjitha anët e Shqipërisë, të përmendun për urti e trimni dhe u mblodhën së bashku në Prizren.

Po përse atje në ato mrize dhe zaje po dëgjohej një piskamë? Ora e Shqipërisë paska qenë tue u la në një gurrë, paska dëgjue këtë lajm të gëzuem dhe menjëherë paska fluturue majë bjeshkës dhe paska takue Zanën.

Dhe që aty, të dyja, dora-dorës, zanë vend në një kodër dhe kuvendojnë me njena-tjetrën.

- Ti moj zanë, - nis e thotë Ora, - ke dëshirë me të tregue ndodhi trimërish dhe me njoftë vetë ata trima që për liri vringëllojnë shpatat si vetëtima, trandin botën si bubullima, që i bajnë copë e grimë armiq të Shqipërisë? A nuk i sheh atje në Prizren ata burra që janë

mbledhë dhe po bisedojnë në kuvend?

- Unë po i shoh, - përgjigjet zana,- por nuk i njoh se kush janë, por ndoshta akejtë na qenkan ngjallë, ata që patën pushtue Trojën dhe ai trimi në krye të kuvendit fort m'i ngjaka Agamemnonit. Kurse ai tjetri, pak ma tutje, me ata mustaqe të mëdha, që flitka sikur të ulurinte, mos është Diomedi?

- Akej, për besë ata nuk janë, - ia kthen Ora dhe qesh me vete për fjalët e Zanës, - por nuk janë as viganë e katallanë, po janë krenët e Shqipërisë, gegë e toskë të bashkuem, të cilët po vendosin që Evropës t'i çojnë letër, që mos ta copëtojë Shqipërinë e mjerë. Sa për atë trim që sheh në krye të vendit dhe që i ngjan Agamemnonit, ai nuk asht askush tjetër, veç Ali Pashë Gucia, të cilit për të drejtat e Shqipërisë nuk i dhimbset as nana, as djali. Kurse ai tjetri, me ato mustaqe të mëdha, nuk është Diomedi, por bajraktari i Shkrelit, Marash Vata, që ngjan si pirgu në ballë të kështjellës, që nuk e trand as topi. A e sheh atë burrë zeshkan, me fustan dhe me kollçikë dhe që flitka me fjalë kaq të matuna, sa me to edhe krajljat i mbërthen? Asht Abdyl Frashëri, që gjithkund ku e qiti shtegu, ia zbardhi faqen Shqipërisë. Pastaj vjen Preng Bibë Doda, që duket i ri, por i vjetër për pleqni.

Zana rrinte e dëgjonte çka i rrëfente Ora e Shqipërisë për ata burra të tjerë që po bisedojshin në atë kuvend. Pastaj ajo e pyeti me kureshtje:

- Po kush është ai flokëzi, me dy kobure në brez që festen ka vënë mënjanë në krye?

- Ai është Abdulla Dreni, ndër burrat më të gjallë në kuvend, kaq i dashun në Prizren, Gjakovë dhe tërë Kosovën, ai kurrë nuk ka lënë fjalë peng.

Ndërsa nalt në kodër ora dhe Zana po ligjërojshin, atje poshtë në Prizren Abdyl Frashëri e çelte kështu kuvendin:

Kur në kodra të Kapitolit ulkonja ende nuk kishte dalë për t'i dhanë sisë Romulit dhe kur Troja tashma ishte rrënue, andej larg kah Urali nëpër kreshta të nalta, sllavët endeshin si bisha mali, tue kërkue për molla të egra; kurse në viset e Ballkanit të parët tanë, pellazgët, kullotshin gjanë e gjallë dhe qetë i ngitshin nëpër ara dhe përgjatë shtegut të qytetnimit kishin shkue shumë përpara, që andej nga nisin ernat e ftohta të Veriut dhe deri në Vezuvin e mbuluem me shkurre, fis më të vjetër se se fisi i shqiptarit askund nuk kishte. Po në këto male e shkrepë tona Zeusi i stërviti njerëzit dhe me bekimin e Dodonës edhe i zbuti. Këtu orë e zana nisën vallen të kërcëjshin

dhe nëpër lëndina e livadhe të gjana Pegasi filloi të lodronte.

Ashtu si Leka me ushtritë e tij arriti deri në Indi, me rrufe në dorë dhe vetëtimë në sy, ashtu si Pirroja, që mprehu shpatën dhe doli deri në det si duhí, ashtu dhe shqiptari, kudo mori turr, lidhë fort me besë e fe dhe nuk u gjend kund mal e shkëmb që atij t'i ndalte hovin. Galë, romakë, dikur motit kishin kalue nëpër tokat tona e pastaj sllavë, por shqiptarët nuk iu përkulën dhe gjallë qafën nën zgjedhën e tyne nuk e vunë.

Rrinte Ora dhe Zana dhe dëgjojshin këto që rrefente Abdyl Frashëri në Kuvendin e Prizrenit, rrijshtin dhe dëgjojnin edhe ata burra rreth tij dhe mbusheshin me krenari.

Porsi ai tallazi i detit që dynd si mal i bardhë prej shkume tue lanë vdekje dhe tmerr mbas vetes dhe pastaj thyhet ndër shkëmbenj, - vazhdonte të thoshte Abdyl Frashëri, - ashtu forca e cilitdo anmiku që desh me i sjellë dam Shqipnisë, erdh dhe u thye në gjokset e bijve të tanë. Pati kujtue sulltan Murati se shqiptarët robë do t'i zinte dhe u sul me ushtri të madhe, me djem të regjun me gjak nëpër luftna, kur bota mbarë rrinte e heshtun nga frika dhe Evropa qante me lot. Por u gabuen, se Skënderbeu nxori pallën atje në Krujë, që vetëtoi nga rrezet e diellit dhe si breshën dhe stuhi u sulën shqiptarët mbi turqit mizorë.

Trandet toka, tymi çohet deri në re, bubullojnë male dhe gurishte dhe shtri në fushë të luftës, jeniçeri mbetet i ndrydhun nën kambën e shqiptarit. Jeniçeri e sheh, ndonëse vonë, se Shqipnia me dhunë nuk mposhtet dhe se e kanë gënjye ata që i kanë thënë se për atdhe shqiptari nuk e jep jetën.

U habitën Ora dhe zana, kur Abdyl Frashëri briti:

-Sot shtatë krajlrat e Evropës dhe sulltani të mbledhun atje në Berlin, kanë pleqnue ndërmjet tyre që Malësinë t'ia lëshojnë knjaz Nikollës, që të na ndajnë vëlla me vëlla dhe të na lejë rob nën shkja, që të ndezin zjarr në votrat tona, që të bajnë dru në zabelet tona, të luej shkja harushë me ne, thua se nuk ka shqiptarë mbi dhe.

Kush asht nip i Kastriotit që ka nder, dhe nuk përulet, dhe asht burrë si burrat, sot armët duhet të rrokë dhe të dalë në breg të Cemit, nga ku malazeztë po na kërcënojnë dhe t'i tregojmë kujtdo se Shqipnia nuk shtrohet pa gjak.

Kështu foli Abdyl Frashëri. U çue atëherë Mark Lula, i pari i Shalës, me sytë zjarr, sokol mali, i zoti i pushkës dhe i fjalës, dhe tha:

- Kam ra prë, kam bâ gjaqe, jetën e kam shkue si bishë mali, zbatun,

zhveshun edhe pa ngranë, por as sulltanit dhe as knjazit tungjatjeta nuk u kam thanë. Prandej, nëse shkja kërkon të na mësyjë dhe të dalë këndej nga viset tona, ka për t'u ndeshë me armët e mia, të Lekëve të Dukagjinit dhe ne me ndihmën e perendisë kemi për të thye pleqinën e Berlinit.

Ora e Shqipnisë dhe zana mbetën të prekuna nga këto fjalë të shqiptueme me kaq mllef dhe kaq çiltërsi.

- Por ne nuk duhet të luftojmë vetëm shkjatë, - vazhdoi Mark Lula, - sepse kemi brenda trojeve tona anadollakun, që kurrë të keqen nuk na e ka nda, që kurrë qafës nuk na e ka heqë lakun, që edhe zemrën na e ka tha, që na ka mbytë babë e nanë, që s'na ka lanë të rrisim djalë në vatër, na ka korrë grurin në arë, na ka marrë tokën e trashëgueme, na ka marrë qetë, ende tokën pa lërue, na ka marrë lopët me gjithë viça, na ka marrë delet me gjithë oqiça, na ka marrë dhen, na ka marrë dhi, na ka marrë vathë edhe mrize dhe na ka mbyllë gojën, që të mos flasim gjuhën tonë. Kështu si kraijat e Evropës, ashtu dhe sulltani e knjazi duen të na mbajnë rob nën veten e tyne. Ndaj ne të huejt zotë nuk i duem, sepse shqiptari asht zot në truëllin e vet.

- Të lumtë goja, o bajraktar, - i tha Ali pasha të parit të Shalës, - se ti lak s'i bake fjalës, se shqiptarët, turq e shkja, me sy nuk duen me i pa. Pra, o burra të marrim e të shkruëjmë një letër për shtatë kraijat që janë mbledhë në Berlin, ku t'u themi se pa u shterrë Drini e Shkumbini, edhe Buna pa u tha, na të gjallë nuk rrimë nën shkja.

Kështu foli Pasha i Gucisë, kështu dhe kreret e Shqipërisë nisën me shkruë letrën:

"Këtë tokë ku ne rrojmë, zoti vetë na e ka falë dhe as italianit nuk ia kemi marrë, as francezit s'ia kemi rrëmbye, as anglezit, as gjermanit, se më sllavit jo e jo, që veç dje ka ra në Ballkan dhe askush nuk e di se kur ka për ta këputë zverkun, si ai vrulli i karkalecit që sot është këtu e nesër nuk dihet se ku. Sa për sulltanin e Stambollit që thotë se knjaz Nikollës do me i falë Shkodrën dhe Malësinë, mund t'i thoni se Shqipnia nuk asht shportë fiqsh për me ua falë miqve peshqesh, por asht tokë e të parëve tanë, që e kanë la me gjak të turkut. Prandej nuk ka as sulltan, a knjaz në këtë botë që ta falë e ta shesë, deri sa të ketë një bir shqiptari mbi dhe.

Mbasi mbaruen së shkruëmi letrën e dërguen drejt e në Berlin, ku kraijat dhe sulltani kishin zanë të ndanin gjyq, në shekullin e ngratë, të mbuluem me gjak.



## KANGA E DHJETË

### MEHMET ALI PASHA

Kudo në Shqipni u përhap lajmi se sulltani kishte caktue në Kosovë një pashë të ri, Mehmet Aliun, dhe se ndodhej në konakun e Abdulla Drenit në Gjakovë, për t'u takue me krenët e Shqipnisë.

Kaluen tri ditë, kaluen dhe tri net dhe krenët shqiptarë, kush bej e kush agë, kush vojvodë dhe kush bajraktar, të primë nga Ali Pashë Gucia dhe Haxhi Zeka, shkuen me takue Mehmet pashën.

Pinë duhan dhe kafe, banë edhe biseda për rob dhe shtëpi, por nga e vona Mehmet pasha nisi me thanë:

- A e dini sa shumë ju do baba sulltani? Ju bën selam dhe thotë se ju ka në zemër, tamam si hajmali, se ju ruen si sytë e ballit, se ju ka si lulja në saksi...

E dëgjuen krenët shqiptarë pashën turk dhe e kuptuen se pas këtyne fjalëve të ambla, diçka fshihej.

- Por kanë ardhë kohë shumë të vështira, - vazhdoi pashai, - si për sulltanin, ashtu edhe për krajlat e Evropës.

U mendue një çast e pastaj vazhdoi:

- Kohë t'vështira kanë ardhë edhe për knjaz Nikollën, që ka mbetë i mjerë në ato shkrepë të Cetinës, sa që i dhimbset edhe gurit edhe drunit. Prandej krajlat e Evropës kanë pleqnue që t'i luten sulltanit dhe t'i dhurojë knjazit andej nga Shqipëria ndonjë grimë tokë djerrë, a ndonjë pëllëmbë toke buke, sepse, vallahi, ky knjaz ka ra ngushtë. Dhe kështu sulltani, që iu rritë jeta, ka vendosë t'i japë Malit të Zi, Hotin, Grudën dhe Plavën me gjithë Gucinë.

U ba një heshtje e shkurtën dhe pastaj Ali Pashë Gucia, tepër i zemëruem, nisi me folë:

- Për atë zot, sulltani ka gabue, se kjo asht punë që nuk bëhet kurrë. Po ç'qenka Shqipëria, vend i shkretë që u jepka si plaçkë dhe kujt, Malit të Zi? Prandaj, ti Pashë, ngarko rraquet dhe mbathja për në Stamboll. Sa për toka të Shqipnisë, në to shqiptari ka ngulë shpatën dhe ai knjaz Nikolla s'ka për ta shkulë kurrë.

Nuk mundi pashai turk të duronte këto fyerje, ndaj tanë mllef i tha Ali Gucisë:

- Ti qenkë arnaut i çmendun, për t'u varë në litar! Po nuk e di ti se po të mos ishte sulltani, dritë e diell s'kishte për të pasë në Shqipni? S'ka shqiptarë dhe as Shqipni, veç ka Allah, sulltan dhe Turqi.

Atëherë urdhnoi çaushtin që me zaptie hyni me vrull në dhomë dhe

mori e burgosi pabesisht Ali Gucinë dhe krenët e tjerë shqiptarë. U befasue Abdulla Dreni!.. Kurrë nuk e priste të ndodhhte kjo. Mehmet pasha kishte ardhë mik në shtëpi të tij, që kur errej dhe kur zbardhte dita, me dreka e darka, me të gjitha të mirat dhe tash po dënonte vëllezërit e tij shqiptarë. Pra, po mbante gjarpnin në gj.... Mirëpo, simbas kanunit, miku që të vjen në shtëpi, duhet të pritët si mik dhe të mos dorëzohet kurrë.

Por kudo u dha kushtimi, që u përhap nga Gjakova, në Qafë të Diellit, që nga Sharri në Buletin dhe nga çdo shtëpi u ngritën trima; plot të tjerë u turrën edhe nga Peja e Rugova, Gashi e Krasniqia. Dyndën mandej e Plava dhe Gucia dhe të tanë zbritën në Gjakovë.

I vuni re ata nga dritarja Mehmet pasha dhe pyeti Abdulla Drenin: - Ç'janë këta që shoh nëpër rrugë të Gjakovës? Mos janë krushq që kanë ardhë të marrin nuse, apo axhamij të sulltanit që shkojnë për t'u veshë nizamë?

- Nuk janë as krushq, as axhamij, - iu përgjigj Abdulla Dreni, - por djem shqiptarë, që kërkojnë të bisedojnë me ty për krenët tanë që erdhën këtu dhe më nuk u kthyen në shtëpitë e tyre.

U vrenjt pashai nga këto fjalë, se atij mendja nuk i kishte shkue kurrë që të ngriheshin shqiptarët e të vijshin për këtë punë me pushkë në Gjakovë. U tremb dhe atëherë dha urdhën që krenët të liroheshin sa ma parë nga burgu.

Dha ata, pa u takue aspak me të, u mblodhën në kuvend dhe një zani u thanë shqiptarëve:

- Sulltani për një rrotull gurabie na ka shitë te Mali i Zi!

- Shqipninë gjallë nuk e lëshojmë, - britën luftëtarët, - dhe në dorë të knjazit ne nuk bijmë. Kurse pashait këtu t'ia bajmë gjyqin, që të marrin vesh krajlrat e Evropës dhe sulltani se Shqipninë kush nuk mund ta prekë.

Të tanë ishin gati të suleshin nga konaku i Abdulla Drenit, që të kapshin pashain turk.

Atëherë u ngrit Haxhi Zeka dhe i qetësoi:

- Derë në za është shtëpia e Drenit, ku hanë bukë të varfën dhe të verbën. Kështu asht mirë që t'i çojmë lajm që pashën turk të na e dorëzojë gjallë.

E dëgjuen fjalën e tij trimat dhe u bindën. Dërguen kështu lajmësin, që trokiti në derë të Abdullait dhe i tha se përse kishin ardhë.

U mendue për disa çaste ai dhe e pastaj nisi me thanë:

- Baba mua më kam mësue që sa të jem gjallë, miqtë kurrë të mos

i lëshoj. Po të më lypni gjithçka që ai më ka lënë, unë që tash po jua jap. Po ju jap mal e vërri, tokën me gjithë shtëpi, vathën me bagëti, por erz, shpirt e mik nuk fal.

Me t'ua largue lajmësi, Abdulla Dreni u ngujue me pashën dhe ata që e shoqnojsnin në konakun e tij.

Mbetën të shtangun atje në kuvend. Shumë prej trimave bisedojshin me njeni-tjetrin se Abdulla Dreni duhej t'ua dorëzonte pashën e Sulltanit, se kanuni i maleve nuk e quante për mik hasmin e vendit. Të tjerë thojshin të kundërtën, pra se ai kishte të drejtë ta mbronte atë si mik.

Ndaj u ndez lufta midis shqiptarit që vriste shqiptarin, për një pashë që paska çue sulltani!... U ngatërruen kështu keq vëlla me vëlla, kur të gjithë duhej të luftojshin kundër turqve dhe malazezve!

Plot tri ditë dhe plot tri net krisi pushka nëpër rrugët e Gjakovës, derisa kulla u mor dhe pashai turk mbeti i vramë.

Atëherë u mblodhën të tanë aty në kuvend dhe i çuen fjalë sulltanit: - Pa dëgjo ti, more sulltan, çfarë po të thotë populli i Kosovës. Nëse një ditë do të vijë ndonjë pasha tjetër në Shqipëri, që t'ia dredhë lakun bakeqit, që shtegtari rrugës të shkojë pa frikë se e grabit dikush, që të ngrejë kisha e xhamia për besimtarët, le të vijë, se ende doret nuk të kemi dalë. Por, nëse e dërgon për ta nda Shqipninë dhe knjaz Nikollës t'ia japësh një pjesë dhuratë, ta dish se kemi për ta vra, pa thanë as edhe dy fjalë, siç vramë Mehmet pashën. "Miku s'vritet, - thotë kanuni, por ai nuk erdhi për mik dhe, meqë ty nuk kemi ku të të gjejmë, veqilët e tu do t'i zhdukim, nëse duan të na shesin tek të huejt".

Kur ka shkue fjala te krajlrat e Evropës se çfarë kanë ba shqiptarët në Gjakovë, ata kanë mbetë të habitun.

"Po ky komb vallë ç'qenka? Një grusht njerëzish të vobegtë, të cilëve as emnin nuk ua kemi dëgjue dhe që guxojnë të hedhin poshtë vendimin tonë dhe të sulltanit të Stambollit?!..."

*-vijon-*

**Gjergj Jozef KOLA**

## **MREKULLIA E HESHTUN E NANË TEREZËS**

*-Dramë-*

### PROLOG

Në vjetin 1979 Nanë Terezës i jepet çmimi Nobel për paqen. E tanë bota e civilizueme gëzohet për këtë grue të vogël te veprave të mëdha. Vetëm diktatura komuniste në Europen Juglindore i varë hundët deri në tokë.

Në Shqipninë që viente nën këtë diktaturë gjallojnë plot mundim e sakrificë, Nana e moshueme dhe e sëmurë randë si dhe Motra e Nanë Terezës. Ndërsa motra e madhe Gonxha i shërben pleqëve të sëmurë e të braktisun të tanë botës, motra e vogël Agetina ban te njëjten gja, tuj i sherbye një njeriu te vetem, nanës së saj. Reflektimi i këtij dimensionit të dashunise vetmohuese të dy motrave plotëson kuadrin e një shpirti të madh, siç asht ai i Nanë Terezës.

„Falë tejet, zemra e motrës, nuk kanë me m’qortue, se unë paskam ndihmue pleqtë e sëmurë dhe të braktisun të botës, porse jo nanën time të moshueme e të braktisun“, ithotë Nanë Tereza motrës së saj, Agetinës.

Familia mbetet për Nanë Terezen një parajsë e dytë, të cilën ajo e prek vetëm në lutjet e saja, pa të drejtën me e pa në këtë jetë. Ajo futet në skenë me këto katër rreshta që janë edhe emblema e dramës së panjoftun të jetës së saj.

*Në thellësinë e pafund të zemrës time dridhet e heshtun një andërr e pajetueme parajsën në qiell dhe familjen në tokë guxoj me i prekë vetëm përmes të lutjes.*

Ngushëllimi i vetëm qindron në atë që ajo mundet me i shkruar familjes së vet letra, porse mjerisht këto letra nuk mrrijnë kurrë, sepse

diktatura ka frikë dhe i merr këto letra si kërcënim për egzistencën e saj.

Drama prezanton raportin thellësisht të panjoftun të Nanë Terezës dhe familjes së saj në Tiranën e viteve 70. Fabula e saj nuk ka për qëllim dhanien e dimensionit historik të Nanë Terezës dhe aq ma pak dimensionin fetar të kësaj figure emblemë të dashunise njerzore të shekullit njizet. Këto dy dimensione janë dhanë nga qindra autorë. Kjo dramë shkon ma thellë, ajo prekë të përditshmen e ndalueme, të pajetueme të Nanë Terezës, dashuninë për familjen e saj.

N'krahnor te ksaj grueje te vogel e me nji korrace te hekurt, rritet nji lule e brishtë dashunijet, lule që askush deri më sot nuk ka guxue me e preke.

„ Dashunija e madhe e vërtetë asht forca e vetme e të krishteneve autentik“, asht kjo motoja e Nanë Terezës.

Atdheu i saj ndodhet në fundin e ferrit, aty ku familja e saj vuen etje dhe uri e megjithatë ajo e don atë ma fort se asnjherë.

„ Dashunia në nji shpirt te bukur, sa ma e pamujtun aq ma e fuqishme bahet“, i thotë njena motër, tjetrës.

Njikohësisht kjo dramë i shkon deri në qelizë aktualitetit të vendeve të Europës Lindore tuj marrë si shembull Shqipninë sot, tuj plotësue kështu nji nga dëshirat e përhershme të nji njeriut të jashtzakonshëm si Nanë Tereza: me jetue në çdo çast me pulsën e kohës edhe sot në shekullin e njizetenji.

Duhet nji dramë-mrekulli për me kallxue mrekulline e heshtun të Nanë Terezës.

## PERSONAZHET

NANË TEREZA

DRANDJA

AGETINA

GRUPI I MOTRAVE TE NANË TEREZES

(7 Persona engjaj të veshun me kostumin e Nanë Terezës e me krahë engjajsh.)

NEXHMIJA

SEKRETARI I LIDHJES

XHELATI

KRYEMINISTRI

GRUPI I SORRAVE

(5 Korba me krahë të zij dhe me një gjarpën në sqep.)

QIRAXHIJA

QIRAXHESHA

## AKTI I PARË

Një skenë tredimensionale. Dimensioni real mishënohet nga vorfnia absolute, dimensionin human kallxohet nga poezia dhe muzika, dimensionin hyjnor jepet nga lutja dhe hologrami i Nanë Terezës. Dy gra, nanë e bijë kanë rrethuar një shporet, i cili është përshatë si i tillë prej një fuqije naftet dhe po nxehen në ashklat e fundit, para se me ra në shtrat. Dhëtori është strukë mrenda dimnit dhe shpija përdhese gerset nën peshën e traut të hangun kohet. Mjerimi e ka mbuluar këto dhomë ndejt me mobilje të viteve 70. Grueja e moshueme kollitet fort disa herë, tuj nxjerrë në dukje moshën dhe sëmundjen e saj. E reja çohet e shkon te rafti. Një violoncel në dritare luan një muzikë të trishtë.

AGETINA

Nanë, po ta baj një çaj. Si po e do, çajë malit apo njat çajin kinez, të zi?

DRANDJA

*(Kollitet e çon krenë dhe e sheh pa ju përgjigjë e vazhdon e lot me zjermin e me prushin e fundit që ka mbetë.)*

AGETINA

Doktori tha mos me hanger shumë në darkë e me pi vetëm çaj se kjo

të ndihmon për zemër dhe mbi të gjitha flen rehat. Meqi ra fjala, a ke pa prep njat andrrën mramë.

DRANDJA

*(Nuk reagon aspak vetëm luen me prushin e mbetun e kollitet pa ndërpreme.)*

AGETINA

O Nana loke, a thue po na shkruen Gonxhja për Kshnella?

DRANDJA

*(Kthehet nga e bija dhe i buzëqeshë.)*

Sa ma gzon zemren moj Age, vetëm tuj ja permende emnin. Nganjisherë më duket se emni i saj asht ba si krahët e thatë të një fluturës e kam frikë me e shqiptue se më shkërmoqet në dorë.

AGETINA

*(Afrohet e bjen çajin dhefutë n`ibrikun e bakrit.)*

Vetë na ke mësue Loke, se sikur ti lutena Zojës Mari me tanë zemren, ajo kurrë nuk na thotë jo.

DRANDJA

Mos e fut Zotin në provë moj bijë se ta kthen provën ma të madhe se je vetë.....

*(Hesht dhe mbyllet në vedi...tash flet prep.)*

Megjithse me të thanë të drejtën një letër e Gonxhes kishte me kenë një dhuratë e madhe për mue dhe nuk i kisha kërkue të Lumit që lindë në kët dhetor kurgja tjetër: vetëm një letër prej vajzës time.

AGETINA

Për Lazrin gjen kohë Gonxhja e i shkruen tash e parë në Itali, ndërsa ne këtu në Tiranë, nëfund të botës, na ka harrue krejt.

DRANDJA

Pashë fenë Age, ça je tuj thanë? Ti kujton se puna e murgeshës asht e lehtë! Ato kanë rregulla të forta e ju duhet me ndejë tanë ditën e lume në kambë. Një zemër nane sheh ndryshe prej zemrave të tjera.

AGETINA

Loke, në kambë jena tuj ndej te tanë, përditë, derisa nuk kena forcë ma.

DRANDJA

Ala me dhemb zemra pse e lashë me ikë, porse i ishte mbushë mendja e ska tjetër.

*(Shtërngohen te dyja mbas shporetit tuj marrë zjermin e ashklave të fundit dhe sejcila mendon se një letër e Gonxhes kishte me ja ngrohë zemren ma fort se ky zjerm i ksaj nate dimnit.)*

AGETINA

*(Flet me vedi.)*

Ah peshë e randë e jetës! Me pasë njeriu një motër dhe mos me guxue me i shkruar një letër, mos me mujtë me jandi zanin te paktën. Sa kohë te vështira po na takojnë për hisë.

DRANDJA

Kurgja nuk ma ka vyshkë zemrën ma fort se mungesa eGonxhes. Të kisha edhe një herë të vetme me ja pa sytë e saj plot jetë e gjallni, mandej edhe me dekë ska gja.

*(Violonceli vazhdon me shpërnda muzikën e trishtë të stinës së akullit dhe Drandja merr mashën e shpërndan zjemrin mrenda stufës-fuqi. )*

DRANDJA

Age a e ke ble bukën sot?

AGETINA

Jo moj Loke, as sot jo!

DRANDJA

Po pse moj të pastë Lokja?

AGETINA

Se kur shkova unë kishte mbarue e shitësja më tha se tash duhet me u çue heret fort, në pesë të nadjes e me xanë rradhën...

DRANDJA

Po pse moj Age edhe për bukën duhet me xanë rradhën tash?

AGETINA

Ah moj Loke ti ke kohë që nuk del jashtë e nuk e din se në çfarë skamjet po jeton ky Kryeqytet. Në asnjë kryeqytet të botës, as në kohë luftet nuk asht racionue edhe ajri siç po ndodh këtu. Më duket se asht tuj ardhe dita e gjyqit të fundit.

DRANDJA

Falemnderës Zotit, se të paktën Lazri e Gonxhja e kanë një kashatë bukë dhe nuk vuejnë etje dhe uri.

AGETINA

E sikur të lexosh gazetata apo të ndish radion; tanë ditën ju kjajnë hallin vendeve të perëndimit që po shtypen e shfrytëzohen e lavdërojnë jetën tonë që shkon nga suksesi në sukses.

DRANDJA

Age rri urtë të pastë Lokja se këtu edhe birat e mureve e të tavanit kanë veshë.

AGETINA

Ah Loke, ça kanë me na ba ma shumë, të sëmura jena e ilaçe nuk ka, të urituna jena e dyqanet janë bosh. Nganjihere më duket se jam në teater dhe pres sa të mbarojne drama me dalë në jetën e vërtetë.



DRANDJA

Padyshim që e ka një jete tjetër Age, porse ajo është jeta ku ka me na u mbushë zemra plot. Tash shikjo moj bijë se mos gjindet kund ndonji gram miell e na ban ndojsend për darkë. Një supë me pak miell, ç'farëdo miellit, grunit apo kallamoqit kjoftë.

AGETINA

Po ku me e marrë moj Loke! Mielli ka mbarue ka herë e as në dyqane ska, mandej edhe me pasë miell s'ka voj, se edhe voji është ba një kile në muej, a të thashë dje?

DRANDJA

Po këto a kanë vendosë me na lanë me vdekë urrijet?

AGETINA

As që ju bahet vonë për ne.

DRANDJA

Mungesa e bukës edhe durohet, porse mungesa e ilaçeve jo. Si tha doktori e ka emnin kjo sëmundja ime?

AGETINA

"Reumathoide Arthritis" moj Loke. Në shqip i bjen të jetë: infeksion i lidhjes së kocave.

DRANDJA

Mirë pra ma bjer rruzaren se kështu e harroj darkën e ilaçet e merrem me lutje.

AGETINA

(*Shkon e ja merr të mshehun në një tullë të murit dhe ja bjen.*) A thue ke me m'falë një ditë Loke?

DRANDJA

Po përse moj Age, të pastë Lokja?

AGETINA

Sikur te ishte Lazri apo Gonxhja kishin me u kujdesë ma mirë për ty e unë as bukën e ilaçet nuk jam e zoja me ti ble.

DRANDJA

Jo moj bijë mos folë njashtu se gjithçka e ka një kuptim dhe është plani i Zotit që na me ndej bashkë për njena tjetrën. Lazri dhe Gonxhja të falenderojnë përditë në lutjet e tyne që je afër mejet e nuk më keni lanë krejt vetëm.

AGETINA

(*E perqafon fort Nanën e saj.*)

Më kallxo pra dicka prej Gonxhes kur ishim të vogla?

DRANDJA

Gonxhja e vogël ka pasë dy sy, si dy yje, që janë thellë në fund të botës dhe shndrijnë e tash sa ma shumë që kalon koha, aq ma mirë

e kuptoj shkëlqimin e këtyne dy syve.

AGETINA

Unë kam shkruar sot dicka për të, a po do me ta lexue?

DRANDJA

Po të pastë Lokja, nganjihere fjala ban mrekuilli e ta shuen mallin.

AGETINA

*(Hapë një fletore dhe lexon)*

Të kam mendue sot, preshëm siç mendon njeriu gjanat e bukuraqë janë lerg, mandej nisa tuj qeshë me vedi tinzash, siç ban pranvera kur fryn era e ja merr tana lulet e bardha qershijave dhe i ban shami lamtumiretnëpër asfaltin e hangun. Sot i kam fshi lotët e mallit me fytyrën tande që nuk e mbaj mend ma, Gonxhe, o motra e zemres time.

DRANDJA

Oh Gonxhe, o bija e mallit.

AGETINA

Sa vjet u banë Loke që nuk e ke pa?

DRANDJA

Mbi 40 vjet të pastë Lokja, mirë e ke thanë ti aty në letër: „me fshi lotët e mallit me fytyrën që nuk e mbaj mend ma“ ...Te paktën me ja ndi zanin një herë se mandej kisha me ja kujtue fytyrën e gjithcka. Gonxha ka pasë një za të amël e kur këndonte Ave Marinë mbushej tanë shpija e bukur në Shkup me zanin e saj.

AGETINA

Une kam shumë pak kujtime nga Shkupi Loke, vetëm se mbaj mend që kishim një aher të madh, të mbushun me ushqime e tana të mirat.

DRANDJA

Kopshti jonë ishte ma i bukuri në tanë Shkupin moj Age, prej tana luleve te stines kisht aty dhe Gonxhja e Lazri i dojshin fort lulet e shpisë tonë.

AGETINA

Ça na u desht me ardhë këndeje moj Loke....

DRANDJA

Babës tuej nuk i eci mirë tregtija, kur Shkupin ja hoqën Shqipnise dhe ja kaluen Maqedonisë e kështu na u desht me kërkue jetesën nëpër Shqipninë e Zogut që sapo kishte nisë me lulëzue. Porse edhe këtu erdhën komunistat dhe kqyre se ku kena përfundue...

*(Bjen dera)*

DRANDJA

Zoti e baftë mirë!

AGETINA

( *Shkon dhe e hapë derën. Nji çift rreth 60 vjeç hinë mrendë dhe flasin dialekt tiranet.* ) Urdhënoni mrendë. ATA TE DY Mirëmroma! DRANDJA Mirmrama dhe mirë se keni ardhë.

ATA TE DY

Mirëmroma None! DRANDJA

Age a ju ke dhanë lekët e qirasë moj bijë?

AGETINA

Jo moj Nanë se sot ka kenë mbyllë banka e ti e merr nesër pensionin.

DRANDJA

( *i drejtohet çiftit* )

Ju jep Lokja lekët juve, se edhe juve po ju duhen diçka meqi keni ardhë dy ditë para. Në baule kam lekët e dekës e po ju jap se i zëvendësoj me pension mandej.

QIRAXHIU

Jo moj none, nuk kom ardhë për paratë...

QIRAXHESHA

Thame të ulemi një herë se na vetëm kalimthi në oborr shihemi e asnjihere nuk gjetëm kohë për njeri tjetrin.

DRANDJA

Ju lumshin kambët e paçi faqen e bardhë se na kena tash 10 vjet këtu në Tiranë e kërkush nuk na hin e del, se nuk njohim kend.

QIRAXHESHA

Kom sjelle nji tespixhe e kom bo vete e thashë të ju ëmbëlsoj në kët natë të ftoftë.

AGETINA

Ju rritë ndera! Urdhnonie uluni.

ATA TE DY

Përdridhen si dy njerëz që e kanë marrë vesht lajmin porse bajnë sikur nuk dijnë gja dhe presin më ë marrë vesht prej tyne.

QIRAXHESHA

Faleminderit po nuk po dona me ju shqetesue në nji ditë si kjo, moj none.

QIRAXHIU

Ditë i thonçin se tashmo osht natë!

DRANDJA

Age, afroju nga nji çaj moj bijë.

AGETINA

Po nji çaj, me plot dishirë porse ne na ka mbetë vetëm çaj kineze, e zezë.

QIRAXHESHA

Kemi sjellë neve një shishe me verë të kuqe, se helbete mi motra, janë festa e njeriu duhet me festue me pak pije të mirë.

QIRAXHIU

Në fakt e kemi ruejte tash sa kohë në trapazan e sot i thoshë plakës time, mij grue pa çohu e na merr shishen se sot osht një dite e veçante.

QIRAXHESHA

Hë pra mi burrë dhe kur osht një dite e veçantë, njeriu duhet ta festojë si ditë të veçantë.

*(Ulen perreth tryezës dhe ndërsa Agetina bjen çajin, Drandja ndan nga një kallep amelcinë dhe ata hanë tuj pa njëni tjetrin në heshtje.)*

QIRAXHESHA

Agetina unë të shoh nganjëherë kur del jashtë dhe ulesh ke pema e qershisë e aty shkruan në fletoren tande.

AGETINA

Ju jam mirnjohëse fort që na lejoni me dalë e me marrë nganji rreze diellit në oborrin tuej, se këtu në bodrumin tonë rradhë hyn nga një rreze vogël...

QIRAXHESHA

Po e vërtetë moj motra...këtu osht ftoftë megjithse jemi mundue me ja mbyllë mirë birat...

QIRAXHIU

Ne kemi ble një shporet të ri dhe nëse keni dëshirë do ju a falim juve të vjetrin, osht shumë i mirë me pllaka e emalimit, të bardha?

DRANDJA

Ju rritë ndera o njerëz të mirë se mjaft mirë po bani. Ky shporeti jonë kur fryn erë e futë tanë tymin mrendë.

AGETINA

Kena ba një lutje në lagje për me marrë një autorizim për shporet te ri, porse derimëtash ala s'kena marrë përgjigje.

QIRAXHESHA

Te kom sjellë edhe një fletore të bukur njoshtu me vijë të kuqe ku mund të shkruash dhe për kohën që jetoni këtu tek ne.

AGETINA

Ju falem Nderes me gjithë zemër, në fakt unë nuk shkruiej kushedise ça ...

DRANDJA

Ju baftë shndet se paska kene mjaft e mirë kjo amelcinë...

*(Heshtja e mbulon skenën dhe ata hanë e pijnë çaj nën tingujt e trishtë të violonçelit. Nanë e bijë nuk e dijnë qëllimin e ardhjes e as nuk dojnë me e dijtë, se ju mjafton kjo amelcinë që nuk e kane hangër me kohë. Ndërsa qiraxhijtë nuk dojnë me dalë*

*krejt artificialë dhe interesaxhi ma shumë se ç`janë.)*

QIRAXHESHA

Loke si e ke emnin e plotë?

DRANDJA

Drande më thërrasin e ky asht shkurtim i fjales Drandofile.

QIRAXHIU

Po fëmija e tjerë si e kanë emnin?

DRANDJA

Kam edhe një djalë e një vajze tjetër. Djali quhet Lazër e jeton në Itali.

AGETINA

Ndërsa motra quhet GONXHE, asht murgeshë. Në fillim ka qenë në Irlandë, mandej ka përfundue në Bombei, në Indi.

QIRAXHESHA

Edhe unë kam dy vajza e një e kam të martueme lerg në Jug te vendit, në Sarandë e me merr fort malli për të. Na kallxoni ndonji gja për vajzën e madhe, Gonxhen pra.

AGETINA

Unë kam shkruë një herë një poezi dhe ja kam nisë motrës së madhe sepse edhe ajo shkruen poezi. Nana Loke quhet Drandofile, ndërsa vajzës së madhe i ka vu emnin Gonxhe. Rradhë gjindet një metafore kaq e amël në jetë se sa kjo e Gonxhes së Drandofiles. Duket se jena një familje poetësh se e kena poezinë në genet tona.

*(Lexon)*

Vajza e Drandofiles

E thirrun Gonxhe

Një motër e vogël

E dashunisë së madhe.

QIRAXHESHA

Ah sa bukur, plot me lule kjo vjershë për motrën.

QIRAXHIU

Si quhej motra, Gonxhe e Drandofiles? Shumë bukur, shumë.

Gëzohem që e ndani me neve këtë ditë.

QIRAXHESHA

Tash uroj të shkruani edhe diçka për ne që kaluam këtë natë të veçante me ju.

CIFTI COHET PËR ME IKE.

AGETINA

Po shkoni? Kaq shpejt?

QIRAXHESHA

Ju faleminderit për këtë mromje kaq të ngrohtë që na falet, familja Bojaxhiu.

DRANDJA

Na ju falena Nderës e jena plot mirnjohje për këtë vizitë të përzemërt. Më duket sikur ju ka prue Gonxhja ime sonte!

QIRAXHIU

Po ne njerëz jemi e duhet ti ndajmë gëzimin dhe hidhërimin me njeni tjetrin moj none.

AGETINA

Paçi faqen e bardhë gjithmonë.

*(I përcjell. Kthehet nga e ama.)*

Loke a po din me thanë çka ishte kjo vizitë?

DRANDJA

Unë e kam pak a shumë një ide.

AGETINA

Ndoshta kanë dashtë me e dijtë se çka shkruiej unë, në fletore te oborri kur del dielli? Po unë as që po shqetësohem se fundja poezitë këtu janë e mund ti lexojnë kushdo.

DRANDJA

Të pastë Lokja ty, u bane pesëdhjetë vjeçe, dhe ke mbete si njiçet.

Gjatë tanë kohës kam pasë përshtypjen se i ka pru Gonxhja.

AGETINA

Po cila Gonxhe moj Loke, Gonxhja as nuk i njeh e nuk e din kush janë?

DRANDJA

Rrugët e Zotit janë të pafundme e të pakuptueshme për ne moj Age.

AGETINA

Jena tash 10 vjet këtu e as në oborr nuk na përshtëndesin, vetëm vijnë me marrë qiranë një herë në muej te dera e tash papritmas tanë kjo mirësjellje?

DRANDJA

Merri dhurata e jetës me mirnjohje moj të pastë Lokja, njashtu si të vijnë...

*(Heshtje dhe violonçeli po luen ma me gjallëni.)*

Tash na i bjer shtretin afër stufës se sonte asht ftoftë i madh e po flejmë këtu afër.

AGETINA

Mirë moj Loke, kush ta prishë ty, unë veç ty të kam në këtë botë e kërkend tjetër. A ta mbushi një gotë venë?

DRANDJA

Po besa nuk po thue keq se vena, gjaku i Krishtit asht e po na e nxen zemren sonte.

AGETINA

Po më duket si festë sot Loke e kjo lidhet ma fort me venën, të cilën vetëm për vitinri e nxjerrin në shitje.

*(Shkon e afron dy shtretnin afër stufës dhe rrinë të dyja mbi to, ndërsa violonceli luen një muzike të trishtë ku ndihet era e ftoftë që hin prej dritareve të pa mbylluna mirë. Ato pijnë gotat e venës në heshtje ndërsa Agetina hapë Poemen e Ndre Mjedës dhe lexon.)*

AGETINA

“Molla t’kputuna një deget Dy qershia lidhë n’një rrfanë.

Ku fillojnë kufijt e gegët

Rrin një çike me një nanë”

*( Ata te dyja shihen në sy me njena tjetrën dhe qeshin, si dy krijesa që nuk kanë askënd në botë përveç njena tjetrës.Heshtje, ajo lexon në za, shfleton....) Se n`balkue maruen lulet*

Shpija asht shurdh e vendi asht tytë Jo me Loken një e dytë Në këtë vend ma nuk ugjet.

*( Shtrihet e flen.)*

DRANDJA

*( Merr rruzaren dhe lutet ngadalë.)*

Të falem Mari, hirplote, Zoti asht me ty, ti je e bekueme ndër tana zojat dhe i bekuem asht fruti i barkut tand, Jesus...

*(Shtrihet edhe ajo në shtratin përkatës,ndërsa në skene hyn Nane Tereza. Te tri figurat ndricohen prej nelt, ndersa perreth asht krejt terr në skenë. Nanë Tereza hyn në skenë gjithmonë prej kësaj drite lutjet si hologram.)*

NANE TEREZA

Në thellësinë e pafund të zemrës time dridhet e heshtun një andërr e pajetueme parajsën në qiell dhe familjen në tokë guxoj me i prekë vetëm përmes lutjes.

*(Ajo shkon e sillet sa tek e ama njashtu edhe tek e motra që po flejnë të mbërthyeme mirë.)*

Loke e dashtun, unë të mbaj në zemren time. Sa letrat me fjalë dashuniet e sa ilaçet plot me shpresë ti kam nisë. Unë e di se asnjena dhe as tjetra nuk e zëvendsojnë mungesen time, porse unë besoj se dashunia përsa gjallon, ka krahë dhe e gjen rrugën.

*(I drejtohet të motrës.)*

Të falem Age, zemra e motrës, fale tejet nuk kanë me m’qortue, se

unë paskam ndihmue pleqtë e sëmurë dhe të braktisun të botës, porse jo nanën time të moshueme e të braktisun“. (Ju drejtohet te dyjave) Letrat e mija janë provë dashuniet se nuk ju kam harrue asnjherë. Dashunija e madhe, e vërtetë, e gjallë asht forca e vetme dhe sheji dallues i të krishtenit autentik.

*(Nji kangtare e veshun si engjull në bardh-blunë e Nanë Terezës futet në skenë dhe këndon AVE MARIA të Shubert.)*

## AKTI I DYTE

Katër blloqe ma ndej, në një zyrë, për gjatë tanë ditës së akullt një oficer i sigurimit të shtetit komunist ka pasë në dorë letrën, që një murgeshë e huej, një fare “Mother Theresa” i ka dërgue një familjes në Tiranë dhe ai ka pa me kujdes se mos në ato rreshta mshehen kode të caktueme për përmbyshjen e pushtetit popullor.

### OFICERI

*(Këndon refrenin e një kange lufte dhe përsërit vetëm një fjalë)*

Hakmarrje, hakmarrje, hakmarre, hakmarrje...

Zyrë në ministri me portrete tipike për kohën e diktaturës komuniste. Një overhead projekton në mure një letër të nënshkrueme: Mother Theresa. Oficeri i sigurimit sillet rreth saj mendueshëm. Ai heq dorezat dhe e merr letrën në dorë. Një shkëndijë eletrike e përshkon. Ai e vendos letrën mbi tavoline, merr një letër e lapës dhe shkruen.

Bjen

Zilja.

### OFICIERI

Ministria e mrendshme, zyra e postës sekrete, shoku Xhelat, me pseudonimin e luftes TRIMOSHIju flet....

*(Ndigjon në heshtje...)*

Po shoku ministër, si urdhëroni shoku ministër. Patjetër shoku ministër. Letrën e kam kontrolluar disa herë rresht, porse nuk kam gjetur asgjë subversive. Po e kuptoj se armiqtë e popullit nuk flejnë. Udheheqësi yne ka thënë: Uji fle, armiku nuk fle.

*( Ullë telefonin dhe i sillet perreth tryezës ku asht letra. Në mes të nëpunësit dhe letrës së Nanë Terezës zhvillohet një luftë e heshtun, ku paranoja e tij përballë fuqisë së saj krijonjë përplasje të jashtzakonshme.)*

### OFICIERI

Çfarë të ketë vallë kjo letër? Mos ndoshta kapitalistët dhe revizionistët të kenë arritë aq lart në teknologji sa të kenë prodhuar një letër ku të jetë fshehur një bombë? E sikur të jetë bombë atomike, ku do të



fshihem unë para ministrit? Nuk është një e tillë? Po atëhere përse therret ministri i mrendshëm, dora vetë?

*(I afrohet letrës dhe ndriçon në mure fjalët e saj, porse tanë frikë me e prekë se mos pëson prep atë shkëndijen që e detyron me shkruet.)*

ZANI I NANE TEREZES

“Unë popullin shqiptar e kam gjithnji në zemrën time dhe lutem për të...”

XHELATI

*(Mbyllë veshët)*

Pusho ore ti kuçkë, në të zënça me dorë...nuk na duhen lutjet neve. (Bjen zilja e telefonit)

Ministria e mrendshme, zyra e postës sekrete, shoku Xhelat, me pseudonimin eluftës TRIMOSHI, ju flet.... *(Ai merr qëndrim gatitu.)*

Shoku kryeministër, unë jam gati të qëndroj ditë e netë pa gjumë e nëse edhe një gjurmë e vetme subversive të jetë fshehur në kët letër, unë do ja nxjerrë përjashta, si të ishin zorrë pule. Padyshim që ju do te jeni i pari, që do e merrni vesht lajmin.

*(Dëgjon zanin që i flet pa ba zhurmë dhe qëndron gatitu.)*

Sytë, veshët, hundët e të gjitha çfarë kam do i mbaj hapur, simbas porosisë së udhëheqesit tonë, uji fle porse armiku nuk fle.

*(Ai ulë receptorin dhe vazhdon me u sjellë përreth tryezës.)*

Kush është ore kjo Mother Theresa ( *shqipton si e lexon*)...Gonxhe Bojaxhiu shkruhet këtu ne fund. Si mund të ketë njeriu dy emra? Në zarf ka vendosur emrin e Mother Theresa e në fund të letrës emrin Gonxhe Bojaxhiu. Përse vallë kjo taktike e re armiqësore? Si mund të ketë njeri dy emra apo ky është një mesazh i fshehtë që mund ta deshifrojnë vetëm armiqtë e brëndëshëm?

ZANI I NANE TEREZES

Gjithnji në lutjet e mija e kam afrue edhe pëshpërimën e zemrës për popullin shqiptar, sepse prej gjakut jam shqiptare... OFICIERI

*(Mbyllë veshët)*

Ah belá, ç më gjeti mua! Ty ore Gonxhe Bojaxhiu ta tregoj unë...

*(Këndon refrenin hakmarrje, mandej reciton.)*

Në të zënça në dorë,do të të bëj krejt me BOJE,me bojë ore bojaxheshëdo të të bëjë kuqaleshë....

Do na kujtosh ti neve gjakun tonë shqipëtar! Një murgeshë nuk ka gjak, lerë më shqipëtarë!

*(Hapet dera dhe në dhomë futet Nexhmija bashkë me një person tjetër pa identitet të përcaktuem, që mbahet sisekretar i lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve. Bashkë me to hyjnë edhe 5 Korba të zi që mbajnë nga një gjarpën në gojë. Ata shkojnë në*

*sfond dhe krijojnë një hark çerek hane.)*

5 KORBAT:

Saherë kqyrem në pasqyrë Më rrjedh gjaku në fytyrë.

OFICIERI

Shoqja Nexhmije po ky është një nder i madh për mua dhe për gjithë ministrinë tonë të mrendshme.

NEXHMIJA

*( Krejt akull.)*

Ku është ajo letra e asaj murgeshës? OFICIERI

Cilës murgeshë, shoqja Nexhmije.

NEXHMIJA

E asaj murgeshës së krishterë, Gonxhe Bojaxhiut. OFICIERI

Këtu nuk ka asnjë Gonxhe, lerë më të Bojaxhiut?

SEKRETARI

Me se po merreni pra?

OFICIERI

Aktualisht po gjurmoj në letrën e njëanglezeje me emrin Mother Theresa.

SEKRETARI

Po kjo është ore ti, Mother Teresa dhe Gonxhe Bojaxhiu janë një.

OFICIERI

Unë isha çoban kur partia më bëri partizan dhe dëgjoja anglezet se si na shanin e na kërcënonin në gjuhën e tyre e megjithëse nuk e dija asnjë fjalë anglisht unë e kuptoja se donin të na minonin luftën tonë heroike nacional-çlirimtare.

NEXHMIJA

Ore ti do na e tregosh letrën?

OFICIERI

Kjo këtu është shoqja Nexhmije, porse unë nuk kam gjetur asgjë subversive, pervec budallaliqeve të tilla si „ unë lutem për gjakun e shqipëtarve“ apo Zoti nuk e ka harruar Shqipërinë...Këto janë njerëz të sëmurë, shoqja Nexhmije, kujtojnë me të vërtete se ka Zot. Kur nuk e zbuloi Partia dhe shoku Enver me gjithë atë shkollë e dije, Perëndine si do e zbuloj një murgeshë që rri gjithë ditën duke u lutur?

NEXHMIJA

Pa hidhu pak tutje! Di të lexosh e të shkruash ti? OFICIERI

Si urdhëroni shoqja Nexhmije. Partia na i mësoi të gjitha.

NEXHMIJA

*(I drejtohet personazhit që rri mbas saj.)*

Pa thuji pak ti shoku sekretar i lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve si qëndron kjo puna e leximit dhe shkrimit.

SEKRETARI I LIDHJES:

Analfabetizmi i një njeriu nuk matet nga leximi apo shkrimi i një teksti, porse nga ajo se sa e kuptojme ne një tekst të tillë. Nëse e lexon tekstin dhe e shkruan atë, je analfabet, nëse e lexon, shkruan dhe e kupton atë, atëhere nuk je analfabet. Ndryshimi është thelbësor.

NEXHMIJA

E kupton tani? OFICIERI

Jo, shoqja Nexhmije.

NEXHMIJA

E dija mirë se nuk mund ta kuptosh, largohu tani mënjëane dhe mos më thirrë në emër, une jam kryetarja e Frontit dhe drejtoreshë e institutit, nuk të mjafton?

OFICIERI NDERON ME GRUSHT DHE DEL MENJEANE

Si urdhëroni shoqja kryetare, shoqja drejtoreshë, shoqja N....

NEXHMIJA I BAN ME SHENJE SEKRETARIT TE LIDHJES

Hidhja një sy ti se mund të jetë i fshehur në mes të rreshtave mesazhi.

Fundja pse pikërisht në këto ditë duhej të vinte një letër e tillë?

SEKRETARI PASTRON GJYSLYKET DHE PERIQET ME LEXUE ZANI I NANE TEREZES

„E dashtuna Nanaloke, e dashtuna Age. Sytë e mijë nuk mund ta kallxojnë se sa loti i mallit ka rrjedh prej tyne, për me ardhë deri te ju“...

*(Ndalon leximin dhe fshin gjyslykët xhamëtrashë.)*

E kam thënë unë ore, gegërishtja ska qenë asnjherë e ndaluar siç pretentojnë armiqtë tanë jashtë vendit.

NEXHMIJA

Sheh gjë ti apo jo? Ka ndonjë mesazh të fshehtë që duhet ta kuptojmë, ndonjë deshifrim metaforik?

SEKRETARI I LIDHJES

Jo asgjë derimëtash, duhet te qëmtojmë në lidhjet e personit në fjalë me mërgaten e qyqeve andej në perëndim...Kjo letër vjen pikërisht në një kohë me botimin e një shkrimtari reaksionarë në Romë, Ernest Koliqi, ku ai shkruan sesi vjen në vendin tonë, mbas rrëzimit të diktaturës së proletariatit.

NEXHMIJA

Shihet gjë nga kjo lidhje këtu se unë nuk e kapë dot lidhjen e këtyre dy armiqve, ksaj murgeshës dhe atij shkrimtarit dekadent?

SEKRETARI

I jati i ksaj Bojaxhiut ishte me origjinë nga Shkodra dhe andej kanë dalë të gjithë poetët reaksionar të vendit tonë.

OFICIERI

*( Kërcën nga qoshja dhe nxjerr letrën.)*

Shkodra, Shkodra, ah Shkodra!

NEXHMIJA

Po ti ç'pate ore që hidhesh kështu?

OFICIERI

Unë kam guxuar ta prekë letrën me dorë shoqja kryetare, gjithnji e kam bërë me dorashka, ndërsa ksaj rradhë doja ta ndjeja më mirë dhe e mora në duar.

NEXHMIJA

Folë ore çdo të thuash se nuk kemi ngenë të merremi me ty.

OFICIERI

Sapo e preka, e shtërngova lehtë, nga takimi pati një shkarkim elektrik dhe më detyroi të shkruaja këto rreshta:

## ZANI I NANE TEREZES

### PORTRETI I SE KEQES

*Fytyra jote mban maskën e krimit se ti nuk ke qeshë kurrë në jetë*  
e unë isha fëmijë kur ti kaloje rrugëve të Shkodrës dhe nanat fshiheshin nëpër strehet e fatit e pëshpëritnin tanë tmerr në sy:

“Ky asht vdekja” dhe ajo mbante emnin tand se nuk ishte shyqyr me të ndeshe ty, Xhelat ishte fatkeqsia e jetës dhe krimi mbante rranjë të thella, qëkur 14 vjeç ushtar - fëmijëu mësove me vra të fajshëm e të pafajshëm. Kështu e vrave në tortura edhe martirin e Beltojës, e në fund e gozhdove në derë të birucës dhe i the:

“Ringjallu tash nëse mundesh”!

Jashtë nanat u drodhën deri në loçkë të zemrës, se ishte një fatkeqsi e madhe për një qytet, me të lindë ty dhe aspak shyqyr, o Xhelat.

E tash fëmija e shqiptarëve struken në barkun e nanave se kanë frikë me dalë në dritë...

SEKRETARI

Me të vërtete e kryqëzove atë, poetin nga Shkodra?

OFICIERI

Sa herë që hyja ne qeli dhe e rrihja mirë e mirë, ashtu sic na mëson Partia të bëjmë me armiqtë, ai i gjakosun më thoshte se nuk më ka frikë se ai është poet dhe poetët ringjallen edhe nëse i vret. Unë i thashë se nëse ka një njeri që do rilindë ky është shoku Enver.

NEXHMIJA

Shoku Enver do rilindë? Po ai gjallë është, përse i duhet rilindja?

OFICIERI

Ai, poeti i lidhur me tha se vetëm poetët ringjallen e shoku Enver jo, sepse ai nuk është poet. Atëhere e kaloi kufinin.

NEXHMIJA

Kështu të tha?

OFICIERI

Ne në ministrinë tonë kemi një parim të lartë: Gjatë torturave ti mund të flasësh keq kundër kujt të duash, mund te fyesh marksin dhe leninin, ama shokun enver jo, se ky është dënimi yt me vdekje.

NEXHMIJA

Dhe mirë jau bëni, se shoku enver nuk preket.

SEKRETARI

Atëhere çfarë bëre ti?

OFICIERI

E mbërtheva ashtu siç ishte me zhele të përgjakura, e tërhoqa zvarrë dhe ndërsa recitonte poezi mbi vëllazërimin e mbi gjakun e shqiptarit e mbështeta në derën e drujtë të qelisë. Mora gozhdat dhe një çekan të madh dhe e gozhdova për derë. Ndërsa i rridhte gjaku gjithandej i thosha: Hë ringjallu tani, se ju poetet ringjalleni.

SEKRETARI

Po ai ç` të thoshte?

OFICIERI

Jemi vëllezër, më thoshte, jemi shqipëtar. Ik ore, unë nuk bëhem kurrë vëlla me ju reaksionarët.

NEXHMIJA

E shau ai me të vërtetë shokun enver? OFICIERI

Po, tha se shoku enver nuk do ringjallet kurrë.

NEXHMIJA

Mirë ja bëre qenit, shoku enver është perëndia jonë.

OFICIERI

Shoqja kryetare, shkova nesër në mëngjez të shihja nëse ishte ringjallur dhe e gjeta të mbytur në gjak. E mora prej aty dhe e

ngarkova në karrocën e plehut, pastaj e hodha në oborrin e degës së mrendshme...

SEKRETARI

Po çfarë u bë me të pastaj?

OFICIERI

Kufomën e nisëm për Tiranë në fakultetin e mjeksisë për studentet. Uroj të mos u jetë ringjallur atyre si lugat dhe i ka trembur... hahahahahahaha.

(Qeshë vetë si xhelat i llahtarshëm dhe të tjerët me të.)

NANE TEREZA SI HOLOGRAM

Unë popullin shqiptar e kam në zemren time dhe dy zemrat tona rrahin njëherësh me njena tjetrën.

OFICIERI

Shoqja kryetare e frontit, unë shpesh herë kam parë në ëndërr sikur i gjithë qyteti i Shkodres u ngrit dhe doli në shesh e kërkoi të rrëzonte shokun stalin.

NEXHMIJA

Shokun stalin apo shokun enver? OFICIERI

Shokun stalin, sepse ai ishte midis qytetit me mustakë prej burrash.

SEKRETARI

Shpesh herë e kam pyetë veten se si është e mundur të mos ngrihen ata njerëz në këmbë. Ne ju vramë intelektualët, ju shkatruam kishat gotike dhe katedralet, ju mbytëm me duart tona artistët që kishin mbaruar në perëndim, ndërsa ata vetëm heshtën. OFICIERI

Pse çfarë duhet të bënin ata?

SEKRETARI

Të ngriheshin, të dilnin në shesh e të jetonin të lirë apo të vdisnin njëherësh. I poshtëruam deri ku nuk bën dhe ata nuk bënë zë....

NEXHMIJA

Ta kishin provuar njëherë të ngriheshin. enveri dhe unë këtë kemi pritur, të guxojë të ngrihet një qytet një herë dhe t'ja shkullim dhëmbët një nga një. Kush vjen në pushtet me dhunë ai nuk heqën kurrë dorë nga dhuna. Diktatura e proletariatit vjen nga dhuna dhe mbahet me dhunë.

NANE TEREZA

Unë popullin shqiptar e kam në zemren time dhe lutem për të. Shqiponja kur e merr rrugën e kthimit në fole i rreh zemra ma fort se kurrë, sepse kjo ja shkurton largësinë në kohë dhe hapsinë.

NEXHMIJA

Pra kjo letra paska aftësi të jashtzakonshme?

SEKRETARI

Me sa duket një kontakt me të imponon të shohësh, e të shkruash një ngjarje ku ruhet thelbi i jetës tënde...

NEXHMIJA

Atëhere jam shumë e interesuar të dij se çfarë do të thotë për juve shoku Sekretar... SEKRETARI

(I nxanë ngushtë.)

Shoqja Nexhmije, shumë kam arritë në krijimtarinë dhe karrieren time jua detyroj juve, porse unë jam këtu vetëm një dëshmitar i fantazisë së kohës dhe jo person real siç jeni ju të dy...

NEXHMIJA

*(I jep urdhën me dorë. Ai shkon dhe merr letren në duer dhe një shkarkim elektrik e ndjek. Ulet e shkruen)*

SEKRETARI

Parti e dashur të vegjël jemi

Por ty në zemër gjithnji të kemi Se ti na rritë e na edukon

Dhe pa u lodhur për ne punon...

NEXHMIJA

Hahahahaa, ja hodhe dhe kësaj rradhe, si gjithnji. Porse një gjë dije ama: Unë jam si virusi bazë, një herë Nexhmije, gjithmonë Nexhmije do të mbes, ndërsa ti do modifikohesh, do marrësh një natyre tjetër edhe me të rrezikshme se unë.

SEKRETARI

Të jap fjalën shoqja kryetare se unë i tillë do të mbes gjith jetën time: besnik i partisë, megjithse unë mbes aktualisht në kët skenë vetëm një produkt i fantazisë se sa i realitetit.

NEXHMIJA

Tani po provoj unë ta marr letrën në dorë. Do keni guximin të ndajmë bashkë sekretin e jetës time?

*(Oficieri mbyll veshet me dorë tanë frikë dhe shkon në një qoshe, ndërsa Sekretari merr gjyslykët dhe vazhdon me i pastrue me një shami të kuqe.)*

ZANI I NANE TEREZES

Shqipnia asht dashunia ime e madhe që më ndjek gjithandej në rrugët e botës...

KORBAT

Sa herë kqyrem në pasqyrë, Më rrjedh gjaku në fytyrë.

NEXHMIJA

*(Merr letrën në dorë dhe shihet shkarkimi elektrik. Ajo ulet e shkruen. Tash e lexon.)*

Unë isha e fejuar me dashurinë time të parë  
 Qemalin, me syze të trasha dhe zemer poeti  
 Atë natë maji njoha Enverin dhe në bodrumin e shtëpisë  
 U mbarsëm si lepuj pa u ndalë, deri në mëngjez  
 Dhe të nesërmen e vramë Qemalin dhe themeluam partine tonë.  
 Pelenat e saj ja hodhëm Shqipërisë në grykë si litar trekëndëshi për  
 50 vjet me rradhë ndërsa nënat shqiptare thërrisin:

ZANI I NANE TEREZES

Ça ke ba ti atdheu jonë që mallkimi njitet kaq shpejt në ty?

NEXHMIJA

Shoku sekretar, Qemali të ngjante ty, kishte trup të shkurtë, ishte  
 inteligjent, poet dhe mbante syze të trasha.

SEKRETARI

Eshtë kjo arësyeja që më ke mbajtur afër gjithnjë edhe atëhere kur  
 korbat e zinj turreshin mbi mua dhe poezitë e mija që sadopak nuk  
 i përshtateshin frymës së kohës?

KORBAT

Sa herë kqyrem në pasqyrë, më rrjedh gjaku në fytyrë.

NEXHMIJA

Kam dashur të kem gjithnji si MASKOTIN tim... SEKRETARI

Nuk ta plotëson Enveri jetën seksuale, shoqja Nexhmije?

NEXHMIJA

Enveri ka probleme me potencën dhe kur është në formë dhe  
 shëndoshë atëhere shkon nëpër qytete dhe e jeton me gratë dhe djemt  
 e rinj seksualitetin e vet. Unë jam vetëm nëna e fëmijeve të tijë, asgjë më  
 shumë. Mbas kaq vitesh martesë ne jemi kthyer shokë ideali.

SEKRETARI

Shoqja Nexhmije a e kupton se çfarë po ndodhë? Kjo murgesha  
 leckamane, siç e ka quajtur shoku enver, po na provokon të gjithëve.

NEXHMIJA

Po e shoh mirë se mua nuk më shpëton asgjë. Kjo leter ka fuqi të  
 jashtzakonshme e na detyron me folë atë që kemi thellë nesh, që  
 asht thelbi jonë: të vërtetën.

SEKRETARI

Ti ore shoku Oficier...

OFICIERI

Po Xhelat quhem, në kohën e luftës mbaja pseudonimin TRIMI...

SEKRETARI

Ka letra të tjera si këto?



OFICIERI

Si të tjera? Duhet të ketë dhe të tjera?

NEXHMIJA

Ka shkruar kjo murgesha Mother Teresa letra të tjera familjes gjatë këtyre viteve?

OFICIERI

(*Shkon e hapë një bllok të madh.*)

Familia Bojaxhiu në Tiranë ka marre letra nga një farë Lazër Bojaxhiu nga Italia, ndërsa nga Gonxhe Bojaxhiu asnji, nga Mother Theresa ka marrë një në vitin 1950...)

SEKRETARI

Kjo është letra. Një letër të tillë duhet ta kemi ne në dorë, para të tjerëve, Mehmetit, Haxhiut apo Ramizit me shokë.

NEXHMIJA

Po duhet ta gjejmë atë letër patjetër, me këtë e kemi të ardhmen e siguruar çfarëdo surprise të sjelli ajo. Këtë këtu ta fshehim mirë.

HYN KRYEMINISTRI SHEHU

Po juç`bëni këtu?

NEXHMIJA

Nuk i jap kujt llogari.

SHEHU

Ku është ajo letra e nobelistes?

NEXHMIJA

Cila letër?

SHEHU:

Letra e nobelistës së këtyre ditëve.

SEKRETARI

Këtu s`ka letër?

SHEHU

Mbylle ti se s`të pyeti njeri.

XHELATI

Këtu është letra.

(Kallxon me dorë.)

SHEHU

Rrofsh ti shoku TRIMI!

(*Ai shkon dhe e merr në dorë letrën dhe lexon.*)

NANE TEREZA

Unë popullin shqiptar e kam në zemrën time dhe lutem për të.

SHEHU

(*Shkruen në një letër mbi tryezë dhe lexon.*)

Mbaj mend në Spanjëne viteve 30 kur dogjëm të gjalla murgeshat në një manastir. Ata hidheshin në mes të flakëve, ndërsa ne qeshnim sa mundeshim përjashta dhe thërrisnim: Ku e keni Jezusin të ju shpëtoje! Që atëhere njoha në vetvete nuhatjen për gjak të jeniqerit që kisha trashëguar. Edhe kur vrava në jug të vendit ata dyzet ballistat me dorën time, nuk kisha të ngopur...

NEXHMIJA

(E ndërpret.)

Ballistë kemi vrarë të gjithë gjatë luftës, se na e kërkonin shokët e internacionales komuniste.

KORBAT

Sa herë shihem në pasqyrëMë rrjedh gjaku në fytyrë.

SHEHU

Në vitin 1966 kur hodha në erë katerdralen gotike te Danjës ku kishte vënë kurorë Skenderbeu me Donikën e ndjeva se diçka u plotësua thellë në vetëdijen time. Për herë të parë u ndjeva një njeri i plotësuar...

SEKRETARI

Shoku kryeministër, ndoshta do ishte e mirë që disa trashëgimni kulturore të ishin ruajtur se do i shërbenin brezave.

SHEHU

Rri ore ti se nuk di çfarë është drejtimi i një shteti. Ne shqiptarët kemi trashëguar „hajmlinë e pashallarëve“ dhe këtë ti nuk ke shkruar në librat e tua. Të drejtosh në Shqipëri ke vetëm një shanc: Të bëhesh pashallar i paprekshëm, t'ju afrosh njerzve tharkun e dembelizmit e vetë të jesh padishah. Enveri dhe unë e kemi kapur këtë që në vitin 1944 prandaj do sundojmë këtu sa të jemi gjallë: Demokracia borgjeze tek ne nuk do e ketë kurrë asnjë mundësi të triumfojë.

NEXHMIJA

Dhe mbi të gjitha ta mbash mirë me të huajt, se përndryshe të fluturon koka si Ali pashës në Janinë. Ai humbi kokën dhe ne humbëm Janinën.

SHEHU

Tashma te huajt janë bërë të gjithë armiqtë tonë dhe ne duhet të shtërngojmë fort rradhët me njeri tjetrin shoqja Nexhmije. Shoku Enver dhe unë jemi dy pashallarët e vetëm që projektojmë feudalizmin komunist. Letrën do e mbaj unë...

NEXHMIJA

Letra do jetë pronë e familjes Hoxha se ne jemi pashallarët par

excellence... SHEHU

Jo do e mbajnë ne familja Shehu, se ne jemi ruejtës më të mirë të pasunisë kombëtare...

*( Të dy përplasen me njëri tjetrin në skenë dhe ndërkohë letra bahet flakë dhe fluturon. Në skenë Hyn një engjull me veshjen e Nanë Terezes dhe e merr letrën si shpate e ju sillet përreth nën motivin e „valles se shqipeve“).*

OFICIERI

E kam parë sa herë në ëndërr këtë skenë, se si një engjëll me shpatën flakë vinte, ma priste kokën, ma hidhte nëpër shkëmbij dhe ëngjëj të bardhë me silleshin përreth dhe thërrisnin:

NANE TEREZA

Ti nuk ke me uringjallë kurrë! Ju nuk keni me u ringjallë kurrë, kurrë, kurrën e kurrës...

-vijon-

**Primo SHLLAKU**

**DIASPORA SHQIPTARE**  
**– KJO JETIME ME PRINDË GJALLË**

*Refleksione mbi librin Shqiptarë në liri - Diaspora shqiptare në Amerikë, autore Eleni Karamitri*

**Ramja e tabuve**

Me ramjen e sistemit tek na, pjesa ma e madhe e tabuve shpërtheu e u derdh në sheshin Skënderbej si provë se bota shqiptare do të njisohej tashma dhe se dukunitë e izolimit do t'i përkisnin të kaluemes dhe vetëm të kaluemes. Do të ishte krejt e vështirë me thanë sesa vëllim kishte pjesa e hapët dhe sa vëllim kishte pjesa e ndalueme. Kjo, mbase, do të shihet mbasi tabutë e shpalluna gjatë stinës së eksperimentit tek na, do t'i kenë ba të korrat e tyne dhe krahasimet do të jenë të mundshme. Sidoqoftë, na rezulton se na e njëfnim veten pak, madje, na e kishim të ndalueme me e njoftë veten dhe portreti ynë, me gjithë zellin e madh të mendjeve e vullneteve të lira, ishte një skicë e papërfundueme.

Besoj se as në botën antike, atëherë kur transporti fizik bahej me mjete të natyrës, qendrat e qytetnimit nuk ishin kaq larg dhe kaq të pakomunikueshme njena me tjetrën sa botët – ose ma mirë të themi – ciflat e botës shqiptare të hallakatuna në katër anë me një bërthamë në mes, e cila – paradoks i paradokseve – në vend që t'i thithte dhe mblidhte, i shqelmonte dhe i izolonte.

Na ktej ishim krejt në errësinë informacioni. Dinim se kishim ca shqiptarë ose ish-shqiptarë, për të cilën merrnim vesht se janë diku vetëm përmes remitancave që vazhdonin ende t'u vinin familjarëve dhe përmes ndonjë goditje të policisë politike të regjimit që arrestonte me preferencë individë me njerëz të arratisun, por edhe me njerëz me banim jashtë qysh para Luftës së Dytë Botnore. Dinim se atje jetonte një Fan Nol, fort i nderuem dhe i studiuem ndër ne, që delte kudo si anmik i mbretit Zog (pikë kyçe kjo për liçencimin e pranisë së tij si faktor i mbrendshëm kulture), dinim se ai Fan Nol, kishte përshndetë “gubernën e E. Hoxhës” si legjitime, dinim se

ishite përkthyes i madh e i pakapërcyeshëm, superlativ që regjimi e ruante vetëm për autoportretizim, dinim se kishte shkruar tri poezi të mrekullueshme me sfond politik, dinim se qeveria shqiptare e luste të kthehej për t'i dhanë – thuhej – postin honorifik të kretarit të Kuvendit Popullor, por që ai na e refuzonte për shkak të moshës dhe të koleksionit të smundjeve që kishte. Mbas katër vjetësh të vdekjes së tij, morëm përsëri vesht se qeveria shqiptare priste vdekjen e tij që të zhvillonte pogromin e saj mbi institucionet shqiptare të kultit, me të cilin, edhe pse me bindje shumë të shkira fetare, imzot Noli nuk do ta kishte përshndetur në asnjë rrethanë. Pra, na të interesuemit për zhvillimet ma të gjana të kulturës dhe dritës shqiptare, jetonim në njilloj jermi kulturor, gjithsesi dëshprues, sepse informacioni vinte i vagullt dhe gjysmak, i mbështjellë me mister dhe i përpunuem jashtë kufinit të së vërtetës.

Disa shkodranë e dinin se Sami Rrepishti dhe Arshi Pipa ishin diku në Prendim, se ishin njerëz të zotë, se ia kishin “lagë letrat sistemit”, por se ç’kampionë ishin, se mese merreshin, pse ishin të denjë për t’u përmendë, askush nuk fliste, askush nuk dinte. Ata që sot thonë se e dinin qysh atëherë, nuk kanë punë me këtë konstatim timin, sepse dija merr vlerë kur ndahet progresivisht përgjysëm e kshtu deri në infinit.

Sa i përket Martin Camajt që banonte edhe ma afër e që, gjithsesi me veprën e tij voluminoze, me drejtimet e interesit të tij letrar e gjuhësor, ushtronte njilloj trysnie të dukshme e trimoshe mbi establishmentin zyrtar kulturor mbrenda Shqipnisë skajshëm të vetmueme, asnjë informacion, absolutisht heshtje e thellë, ajo heshtje që duhet të ketë virtualisht mosqenia. Pra në Tiranën tonë, atëherë të kuqe, kishte njerëz që kishin marrë përsipër, duke qenë vetë vdekatarë, të shpërndanin sipas interesave të një shteti njëpërdorimësh, qenien dhe mosqenien tek të njajtit vdekatarë sikurse ata vetë. Feja e trashendencës ishte zevendësue me fenë e egocentrizmit. Bariu literal i zu vendin bariut metaforik....*blegërimë operistike!*

Dhe në anën tjetër të botës, burra të mirë e të selitun, burra me mend e me moral kombtar, vazhdonin punën e tyne kërkimore, shkencore, letrare, politike e gazetareske për atdheun primar pa asnjë mirënjoftje nga ai atdhe. Me siguri që në Amerikë e kudo që inteligenca shqiptare kërkonte lidhjet e saj të ligjshme me shpirtin e përjetshëm të kombit, e kishin kapë vlerën profetike të vargjeve të Nolit se *mbas dimrit vjen njëverë / e do kthehemi njëherë.../*

Ndërsa na ktej kishim humbë çdo shpresë, në Amerikë kryekreje por edhe në qendra të tjera të diasporës, festoheshin vit mbas viti përvjetorët e Pavarësisë, mblihdeshin në festa, festonin së bashku, festonin ditëlidhje personash e gazetash dhe shpirti i komunitetit shqiptar mbahej i gjallë me gjithë trysninë e madhe që bante prania e kulturës vendase mbi të gjitha kulturat kombtare atje, të marra si minoritete.

Por nuk duhet harrue se, edhe vetë anëtarët e diasporës e ndjenin shtetin shqiptar si diçka të huejtun, megjithë temenatë që ai u bënte përmes shërbimeve diplomatike. Shteti shqiptar i diktaturës e kishte shumë frikë diasporën. Duke qenë se komunitetet shqiptare me banim në Prendim gjendeshin fare pranë qendrave të mëdha të politikës botnore, shteti shqiptar sillej kujdesshëm me ta dhe “ua krefte bishtin”. Por me mënyrat ma të sofistikueme kontrollonte zhvillimet brenda saj dhe ma vonë doli se çfarë grindjesh e përçamjes kishte futë mes tyre. Por shqiptarët, naivë dhe shpesh gogësitës nga mirëqenia e vendit pritës, nuk denonconin intrigat dhe autorët, nga turpi se mos ulnin bashkatdhetarët dhe Shqipninë si atdhe.

Me ramjen e Murit të Berlinit, procesi i desintegritit të Lindjes komuniste, në të cilën na e dinim se nuk banim ma pjesë, u ba rrokullisës. Tek na erdhi ma parë rropama, mandej rrëzimi. Por edhe rrëzimi që erdhi, tabutë na i la të ngrehun, si elemente të një gardhi tjetër, që duhej shembë jo ma me entuziazëm, por me sistem dhe përpjekje ardhmënore.

Dallëndyshja e parë fluturon mbi diasporë. Ramja e sistemit tek na erdhi së jashtmi dhe mendimi zyrtar i të gjitha fushave u zu gafil. Ende në qeverisje ishin të njajtit emna, në katedra dhe akademi të njajtat fizionomi, ende në shkrimet dhe studimet që u shterren dhe u rrëgjuen e njajta terminologji, i njajti kandvështrim, të njajtat interesa etnocentriste, e njajta prirje inventarizuese e mbushun gjithkund me frikën e nxjerrjes së përfundimeve organike.

Bota akademike shqiptare që i kishte mplakë epigonët e vet me një meny monotone “gjellësh”, po përpëlitej me gjetë formulën e re të “përshtatjes”, pa i shkue fare ndër mend se kishte edhe dorëheqje, edhe autokritikë, edhe ndjesë publike për faktin se kishte heshtë, se kishte falsifikue dhe se kishte vu interesin e ngushtë vetiak mbi ndërshmëninë intelektuale dhe, siç doli ma vonë, në autokritikat e tyre të vonueme, “pas kaosit”, ata shpallën se kishin mendue që “do të vinin të tjerët për t’i ndreqë ato që ata nuk kishin mundë me ndreqë”.

Në mesin e shkencëtarëve të rij e ma pak të rij, ideja e kthimit të fletës dhe e përqsasjeve të reja u ba moto e ditës. Tabutë e ngrituna me kujdes për gati një gjysëm shekulli kishin "material", sepse në vetvete përbanin fusha të virgjëna, e kishin të sigurtë zbulimin dhe, gjithsesi, ishin objekte ma tërheqëse se temat e rimblaçitura, me të cilat ushqehej skorbutikisht jeta jonë studimore.

Megjithatë ka diçka edhe heroike në preferencën e disave për t'u përballue me tabutë. Sadoqë brezi i vjetër i studiuesve që mbas viteve '90 mbante frenat e katedrave dhe bante politikat e gradimeve shkencore, na shfaqet i shpenguem dhe bekues në zgjedhjen e temave deri atëherë tabu, realiteti ka ma shumë elemente ngurrimi dhe mëdyshje sesa thuhet.

*Studiuesja Eleni Karamitri ishte ndër të parët që i hodhi preferencat e saj tek zonat "me hije" të studimeve shqiptare. Atë e ngacmonte diaspora, kjo botë e hapërderdhun në katër anët e globit, e cila, që në mesjetën e vonë, ka qenë vërtetimi i pamundësisë së botës shqiptare për të krijuar një shtet të stabilizuem me një ekonomi po të tillë.*

Harta e diasporës shqiptare nuk ndrit e tana njilloj, nëse me ndritje do të kuptonim intensitetin e veprimtarive të saj shkencore, kulturore dhe komemorative. Ndriçimi i saj i madh u vu re në fillimet e shek. XIX, kur stina e romantizmit i përflaku tokat e Italisë së Jugut dhe asaj ishullore. De Rada e Gavril Dara, Kamarda dhe Skiroi zunë fill letërsinë e madhe shqipe të shqiptarizmit, i marrë ky si koncept gjithëpërfshimës për atdheun amë dhe të gjithë hartën e diasporës së bashku. Për të gjithë ata që e dinë sesa me ngut po prishej shekulli me zakonet dhe prirjet e tij, ajo kohë do të mbetet padyshim si koha e artë e shqiptarizmit, kur diaspora merrte përsipër zgjimin e atdheut e të vetdijes kombtare pa pretendue që të kthehej kurr ma atje.

*Autorja e këtij libri si edhe e disa shkrimeve e botimeve të tjera me temë diasporën, Prof. Dr. Eleni Karamitri, e kishte intuitën sesa material studimi dhe se ç'fushë e virgjën ishte diaspora, sidomos ajo e Amerikës, e cila mbetej elementi ma i ri dhe ma i gjallë i gjithë diasporës historike, për shkakun se Amerika ishte kthye në Tokën e Premtueme për të gjithë të vorfnit e botës, që atdheu i tyre nuk i mbante dot.*

*Autorja na thotë se diaspora amerikane ishte shumë interesante edhe për faktin se ajo përbahej nga elemente të larmishëm në pikëpamje të prejardhjes. Baza e ksajdiaspore përbahej nga pinjoj të familjeve të emigracionit ekonomik. Ktu kamparasysh shembulltarisht*

studiuesin, përkthyesin, shkrimtarin dhe aktivistin Peter Prifti, si dhe Stavre Frashërin, Xhevat Kallajxhiun etj. Kemi pastaj edhe emigrantët e luksit, siç kam dëshirë të quej imzot Fan Nolin dhe mik-anmikun e tij, Faik Konicën, që edeshën Amerikën për mitin e saj në ngritje dhe mirëqenien e luksin e lehtë që ofronte. Por në Amerikë kishin shkue edhe emigrantët politikë, të pakënaqunit me shtetinkomunist që ishte vendosë ndër ne më 1945. Këta emigrantë aspak emigrantë, por të ikun prej atdheut nga alternativa e mprehtë “o jetë, o vdekje”, ndër të cilët do të përmendja Sami Rrepishtin, Arshi Pipën, Gjon Sinishtën etj., i kanë ba trysni shtetit dhe kulturës socialiste të atdheut të tyne. Në fakt ata nuk donin të qëndronin jashtë, ata prisnin si e si të hapej diku një spirale që ata të mund të vizitonin të paktën atdheun e tyne e le të mos baheshin të njoftuna shkrimet. Por atdheu ishte shumë serioz dhe e kishte humbë buzëqeshjen pritëse për bijtë e vet. Ata gati sa nuk vdiqën pa ukthye në atdhe, si Martin Camaj, vepra e të cilit asht një aht i pafund lutje të heshtun përta pa edhe një herë shpinë e vet e vorret e prindëve. Por jo! Atdheu nuk i dontefëmijët e tij edhe kur kta ishin ba të hajrit, poetë, gjuhëtarë, politologë e kulturologë. Atdheu nuk buzëqeshte më, se “kishte mejtime të tjera”, do të thoshte Çajupisarkastik.

*Asht vërtet ngazëllyese kur shef autorë si E. Karamitri që me një entuziazëm shkencor sjellin në Shqipni autorë të panjofun e me kontribute si Peter Prifti. Ajo i ka ba zgjedhjet e saj qysh herët në fillimin e viteve '90 dhe “fluturimin” e saj mbi “territoret” e diasporës i ka ba që më 1996 me librin e saj të parë, monografinë për dijetarin shqiptaro-amerikan Peter R. Prifti, i cili asht një përmirësim dhe pasunim i tezës së saj të doktoraturës **Kontributi shkencor dhe pedagogjik në veprat e profesor Peter Priftit.***

Libri në krye të së cilës destinohet ky shkrim si parathanie, mban si titull **Shqiptarë në liri. Diaspora shqiptarë në Amerikë - Studime letrare, dëshmi, bibliografi.** (2017, 234 fq). Si libri i tretë i autores me këtë tematikë, po na vërtetohet se ajo po këmbëngul në eksplorimin edhe ma të thellë të diasporës, përkatësisht asaj të SHBA.

***Përpyekja e saj flet ma shumë se roli i sipërmarrun i inventarizuesit të një materiali që pret të evidentohet, të përfshihet dhe të bahet pjesë e studimeve ma integrale të letrave shqipe në shek. XX.***

Megjithse e quan pak a shumë të shterruem interesin e tij për Peter Priftin, libri që kemi në dorë, i paguen një tribut të fundëm këtij personaliteti të botës diasporake amerikane, që me kaq përkushtim dhe dizinteres vetjak u muer, simbas mënyrës së tij, me plotësimin



për letërsi të nevojave të komunitetit shqiptar të Bostonit e ma gjanë. Mos të harrojmë edhe një fakt tjetër shumë të rëndësishëm se aktivistët kulturorë shqiptaro-amerikanë, edhe pse ndodheshin në një vend demokratik dhe të lirë si Amerika, nuk mund të propagandonin e të përhapnin letërsinë zyrtare që zhvillohej bashkëkohësisht në atdheun e tyre amë. Letërsia zyrtare shqiptare, e ashtuquejtuna e realizmit socialist, ishte e ndotun ideologjikisht dhe për këtë shteti amerikan kishte ndjeshmëni të hatashme. Mbas 1947 kur Broëder-i e shkriu partinë komuniste amerikane, shteti amerikan krijoi shërbime të veçanta për zbulimin dhe hetimin e çdo veprimtarie komuniste dhe historia e këtij shteti nuk asht nga ma demokratiket kur bahet fjalë për propagandën komuniste. Kështu që, po të shofim me kujdes edhe tekstet për të cilat kujdesej elita kulturore shqiptaro-amerikane janë paksa të kapërcyer dhe anakronikë. Mesa duket, interesat letrare nuk duhet të kapërcenin kufijtë e tematikës shtetformuese dhe independentiste shqiptare. Por edhe nëse duhet të bahej ndonjë përjashtim, ai përjashtim pajtohej vetëm me letërsi dokumentare dhe udhtimesh siç asht rasti i librit *Përmes Mirditës në dimër*, përkthimi i të cilit na duket sikur duhet të promovonte një paketë turistike, që mund të konsumohej vetëm me imagjinatë, në kushtet kur objekti i këtij libri ndodhej mbrenda një izolimi total.

Pra, mund të themi se gama letrare e përpunueme për nevojat shpirtnore të komunitetit të diasporës asht shumë e vorfën dhe zgjon ndjenja gjeografikisht të kufizueme deri në të ndalueme. Ngandonjihërë na dukej se misioni i ktyne njerzve vullnetmirë e shtynte lexuesin e vet nëmos tek e pamunduna, tek e ndaluemja po se po. Me një fjalë, mendojmë se vepra në shqip me rezonancë ma të gjanë njerzore dhe shpirtnore, do të kryenin një rol të shumfishtë dhe do të edukonin edhe atdhedashuni.

Por Peter Prifti me shokë e nuhasnin indoktrinimin e produktit aktual shqiptar të asaj kohe dhe u shmangeshin teksteve që mbanin erë propagandë. Se përse kta personalitete dhe njerz të shkolluar e të selitur me lirinë e mendimit nuk mbajtën një qëndrim kritik ndaj produktit të atëhershëm letrar në Shqipni, të hapnin polemika në gazetata e shumta që kishin dhe të pasunonin rubrikat me tema tërhjekëse letrare, mbetet ende një enigmë. Frika nga censura e shtetit amerikan dhe ideja për të mos e goditë shtetin amë, ndoshta kanë ba që këta intelektualë të pajisun me dije solide, të detyroheshin të ecnin në tel, si disa mjeshtra cirku.

*Autorja Eleni Karamitri ka sjellë një risi të pëlqyeshme në këtë libër të saj, sepse ka tentue një paraqitje, qoftë edhe skematike, të autorëve shqiptarë të diasporës në çift. Libri trajton Nolin dhe Konicën në çift, po ashtu Arshi Pipën dhe Peter Priftin. Autorja ka shpikur një strukturë dialogjike të paraqitjes së këtyne çifteve të ndritshme të mendjes shqiptare, që punonte jashtë atdheut. Ksisoj paraqitja duale e autorëve, sa me kritere kronologjike aq edhe me kritere tematike, ka shmangë renditjen vertikale të meritave dhe ka promovue paraqitjen transversale, e cila asht edhe komparative, edhe historike.*

Paraqitja e Nolit dhe e Konicës si një pendë qe që lërojnë arat e letrave shqipe, ka ma shum relief dhe prodhon ma shum energji sugjestionuese. Veç e veç ata rezultojnë ma pak miq se e kundërta. Struktura duale e ban ma të mundshëm pajtimin moral që shpesh nuk shkon paralelisht me atë intelektual dhe personal. Kurse strukturimi dyshes Pipa-Prifti mbahet vetëm në ganxhën kronologjike. Çdo simetri humbet po të kihet parasysh agresiviteti konstant i Pipës ndaj metamorfozës diktatoriale të punëve në Shqipni. Pipa na duket se, me kritikën e tij, pak gjana i la në kambë atij sistemi. I përqsasur me Peter Priftin nga kjo pikëpamje na duket ma tepër çeshtje forme dhe konsequencë strukturore. Për historinë e diasporave tona që ndezen e fiken, sot mund të ketë fillue një histori e re, ajo e pasjes së një qendre që askush nuk e pengon me qenë edhe gjeometrikisht qendra e periferive kulturore që ato përbajnë. Por asht tepër herët me thanë sesi do të zhvillohen punët. Me si kanë ndodhë punët deri tash, pesimizmi ka qenë shoku ma i sigurtë.

## ORTOGRAFIJA E GJUHËS SHQIPE (1964)\*)

*-vijon nga numri i kaluar-*

### IV. FJALËT E PËRBAME

1. Fjalët e përbame e të përngjituna në përgjithsi, gjithashtu edhe fjalët e formueme me parashtesa - shkruhen pa vijë në mes:

a) fjalët e formueme prej dy emnash ose prej një emni dhe pjesorje e mbiemni; p.sh.: aktlindje, armëpushim, datëlindje, damshpërblim, juglindje, pikënisje, pikëpamje, postëtelegraf, udhëheqje, urdhën, ngarkim, vendbanim, vendlindje, marrëveshje, udhëheqës, zadhanës, buzëqeshun, dorështrënguem, fatpadalë, dorëcung, dritëshkurtë, fuqiplotë, hirplotë, pesëvjeçar, qindvjeçar, qindvjetor, vullnetmirë, kryegja, kryegjysh, kryeshtruet, kryefjalë, kryefill, kryelanë, pikësosje.

b) fjalët e formueme prej një ndajfoljeje a parafjale dhe një emni, mbiemniafoljeje, sidheato të formueme me parashtesa: bashkëshort, bashkqytetar, bashkëpunim, bashkëveprim, antiimperialist, antifetar, kundërvajtës, kundërvajtje, kundërrevolucion, mbikqyrje, mbikqyr, mbivlerë, kundërvlerë, i maparshëm, i matejshëm, mosdije, mosinteresim, mospërfillje, mosrealizim, i pafat, mospasje, nënkryetar, nëndrejtor, nënshkrim, nënkolonel, padije, pafajni, pafajsi, mbrapavijë, i mbrapambetun, shumfish, jozyrtar, joreal, jokalimtare etj.

c) fjalët e formueme prej një emni dhe fjalëvet gjysmë, krye, vetë; p.sh.: gjysmëhanë, gjysmërreth, gjysmëkoloni, gjysmëproletar, kryetrim, kryekomandant, kryeartikull; vetëqeverisje, vetvendosje.

d) fjalët e hueja të përbame monarkofashist, procesverbal, socialdemokrat etj.

2. Dotëshkruhen me vizë emnate përbamë me lidhje bashkërenditëse, pjesët e të cilëvet janë të barabarta e shumherë ndërmjet tyre vihet lidhza dhe; p.sh.: ekonomiko-shoqnor, greko-romak, marksizëm-leninizëm, marksist-leninist; në këtë mënyrë do të shkruhen

\*) Enti për botimin e teksteve i Republikës Socialiste të Serbisë, Beograd 1964.

edhe këto fjalë: gjeneral-major, kalë-fuqi, nacional-çlirimtar (dhe nacionalçlirimtar), lidhjet trako-shqiptare, iliro-shqiptare.

3. Shkruhen me vizë në mes fjalët e formueme prej një emni dhe emnavet zavendës e ndihmës: zavendës-drejtori, zavendës-kryetari, zavendës-ministri, ndihmës-mjeku. Këto fjalë do të shkruhen në këtë mënyrë edhe atëherë kur jipen me shkurtime, zv-drejtori, zv-mjeku, zv-ministri.

4. Shkruhen me vizë pse pa te në mes fjalët e formueme prej një emni dhe fjalzës ish: ish-drejtor ose ish drejtor, ish-ministër ose ish ministër etj.

## V. PËREMNAS

### 1. PËREMNAS VETORË

Trajta e emnoses shumë të vetës së parë të përemnit vetor është na e ne; p.sh.: na (ne) punojmë na (ne) shkruajmë. Trajta neve përdoret për rasën dhanore: p.sh.: neve na shkruen, po na thonë neve, dhe na si trajtë e shkurtë e kësaj rase (na foli) dhe rasës kallxore (na përshëndeti). Në vetën e dytë të shumsit do të përdoret ju për emnoren, juve, si trajtë e plotë e dhanores dhe ju si trajtë e shkurtë e dhanores dhe e kallxores, ju punoni, juve jua thanë, ju dërgova një letër, po ju la. Trajta u do të përdoret për dhanoren e shumsit të vetës së tretë: u foli, u thashë.

2. Trajatat e vetës së tretë do të shkruhen kështu: ai, ajo, atij, asaj, ate, asi, aso, ata, ato, atyne, asish, asosh.

3. Dhanorja e përemnavet vetorë më, të bashkë me trajtën e shkurtë të përemnit të vetës së tretë të njëjtit në rasën kallxore do të shkruhen me trajtë të ngjitur ma (më + e) dhe ta (të + e) për arsye se ë-ja me e-në e kallxores u shkrinë në një tingull të vetëm tue dhanë një a e me at rasë nuk u zhduk kurrfarë zanorje që të përlijet apostrofi.

Trajta e përemnit vetor që vjen nga kontraksioni i trajtave të shkurta i dhe e ose i dhe i do të shkruhet ia a ja; p.sh.: ia dha librin (librat) a ja dha librin (librat).

4. Trajatat përemnore proklitike i dhe pjesëza u e formës pësore do të shkruhen bashkë: nuk u ngjiti; nuk iu bashkue etj.

5. Trajta e dhanores shumë të vetës së parë na do të shkruhet e ndame nga trajta proklitike e kallxores së vetës së tretë: na e dha, na e mori; trajtat e dhanores shumë të vetës së dytë ju dhe të vetës së tretë u bashkohen me kallxoren e në jua (ju + e) dhe ua (u + e): jua kam thanë, ua kam dhanë librin. Trajatat e dhanores më, të, kur

bashkohen me trajtën e kallxores së vetës së tretë shumë, i, si edhe me u-në e pësorës, do të shkruhen të ndame me apostrof: m' i dha librat, t' i dha librat; m' u muer goja, t' u dha e drejta etj. Do të shkruhet me ë përemni vetë, kurse pa ë përemni pronor (i, e vet).

## 2. PËREMNNAT DËFTORË

Përemnat dëftorë në njajës e në shumë do të shkruhen në kët mënyrë; ky, këtij, këte, kësi, këta, këtyne, kësish, kjo, kësaj, këte, këto, këtyne, kësosh, ai, atij, ate, asi, ata, atyne, asish, asaj, ato, atyne, asosh. Kur përdoren si mbiemna akuzativi njajës do të shkruhet pa -ë: kët njeri, kët vajzë, at kalë, at dritare etj.

## 3. PËREMNNAT PRONORË

Përemnat pronorë kur gjinden bashkë me ndonji emën mirren si mbiemna dhe shkruhen pa nyjë, si:

- djali im, djalit tim, djalin tim, (edhe tem);
- djemt e mij (e mi), djemvet të mij (të mi);
- djali yt, djalit tand, djalin tand, djemt e tu; djali i tij, djalit të tij, djalin e tij, djemt e tij, djemve të tij;
- djali i saj, djalit të saj, djalin e saj, djemt e saj, djemvet të saj;
- djali ynë, djalit tonë, djalin tonë, djemt tanë, djemvet tanë;
- djali i tyne, djalit të tyne;
- vajza ime, vajzës sime, vajzën time (edhe teme), vajzat e mija (e mia), vajzavet të mija (të mia);
- vajza jote, vajzës sate, vajzën tande, vajzat e tua, vajzavet të tua;
- vajza e tij, vajzës së tij, vajzën e tij, vajzat e tij (e tija), vajzave të tij (të tija);
- vajza e saj, vajzës së saj, vajzën e saj, vajzat e saj (e saja), vajzave të saj (të saja);
- vajza jonë, vajzës sonë, vajzën tonë, vajzat tona, vajzavet tona;
- vajza juej, vajzës suej, vajzën tuej, vajzat tueja, vajzavet tueja;
- vajza e tyne, vajzës së tyne, vajzën e tyne, vajzat e tyne, etj.

Si përemna pronorë do të përdoren me këto trajta:

- i imi, timit, timin (edhe temin), të mijt (të mitë), të mijvet (të mivet), së a të mijsh (të mish);
- e imja, simes, timen (edhe temen), të mijat (të miat), të mijavet (të miavet), së a të mijash (të miash);
- i yti, tandit, tandin, të tutë, të tuvet, së a të tush;
- e jotja, sates, tanden, të tuat, të tuavet, së tuash;

- i yni, tonit, tonin, tanët, tanëvet, tanësh;
- e jona, sonën, tonën, tonat, tonavet, tonash;
- jueji, tuejit, tuejin, tuejt, tuejvet, tuejsh, suej;
- i tiji, të tijit, të tijin, të tijt (të titë), të tijvet (të tivet);
- e tija, së tijës, të tijën, të tijat (të tiat), të tijavet, (të tiavet), të a së tijash (tiash);
- i saji, të sajit, të sajin, të sajët, të sajëvet;
- e saja, të sajës, të sajën, të sajat, të sajavet;
- i tyni, të tynit, të tynin, të tynet, të tynëvet, së a të tynesh;
- e tynja, të a tynës, të tynën, të tynet, të tynëvet, të a së tynesh.

#### 4. PËREMNAS LIDHORE

Trajtat e përemnavet lidhor janë këto: i cili, të cilit, të cilin, të cilët, të cilëvet, së cilësh; e cila, së cilës, të cilën, të cilat, të a së cilavet, së cilash, që, kush, kujt, ke.

#### 5. PËREMNAS PYETËS

Përemnat pyetës shkruhen kështu:

- Kush? kujt? ke? ç' ? çka?

Duhet dallue ç' do (kur kemi përemnin pyetës ç' dhe foljen do) nga çdo (përemnën e mbiemën i pakufishëm), me një fjalë: ç' do ti këtu?, çdo njeri.

#### 6. PËREMNAS DHE MBIEMNAS E PAKUFISHËM

Përemnat dhe mbiemnat e pakufishëm do të shkruhen me këto trajta: çdo, kushdo, asgja, asnjëri, ndonjë, ca, disa, kaq, secili, secila, secilado, gjithsecili, gjithsecila, diçka, gjithçka, gjithsejt, gjithqysh, akëcili, akëcila, kush, askush, pakkush, shumkush, kurrkush, kurrfarë, kurrëgj, rrallëkush, gjithkush, tjetër, tjetri, tjetrit, të tjerë, tjetra, tjetrës, tjetrën, të tjera, njëri tjetrin, i gjithë, të gjithë, të gjithëve, të gjitha, të gjithave, i tanë, të tanë, të tana.

Fjalët i gjithë, i tanë përdoren me një, kur janë përemna: E dinë të gjithë, Erdhën të tanë. Kur janë mbiemna, ma të shumtën, s' marrin një e s' lakohen: gjithë fshati, në gjithë fshatin, gjithë njerzit, gjithë fletoret, gjithë bota, tanë bota. Gjithë mund të përdorët edhe me një, tue u lakue e tue iu përshtatë në gjini emnit që ka pranë: i gjithë fshati, të gjithë njerzit, të gjitha fletoret, fletët e të gjitha lulevet.

#### VI. FOLJET

Disa vërejtje të përgjithshme

1. Në gjuhën shqipe kemi një numër foljesh, tema e të cilave mbaron

me bashkëtingëllore të langëta: l, ll, r, rr, okluzive qiellzore: k, g dhe frikativen ndërthambore dh që në trung - fill para tyne - kanë diftongun ie, i cili shumkund shqiptohet je. Këto folje do të shkruhen me je në të gjitha vetat e së tashmes së dëftores e të lidhores, me përjashtim të vetës së dytë të shumsit, si edhe në mënyrëndëshriore e pjesore; p.sh.: vjel, mjel; ndjell, mbjell, sjell, vjell, pjell, mbështjell, përcjell; nxjerr, çjerr, bjerr, vjerr, tjerr; djeg; pjek, ndjek; rrjedh, vjedh, hjedh, etj.

2. Si gjedhe për këto folje, po japim vetë zgjedhimin e njanës ndër to në disa kohë të thjeshta:

- E tash.dëft.vep.: mjel, mjel, mjel, mjelim, mielni, mjelin.
- E pak.dëft.vep.: milsha, milshe, milte, milshim, milshit, milshin
- E kr.thj.dëft.vep.: mola, mole, muel, a moli, muelëm a molëm, muelët a molët, muelën a molën.
- E pakr. lidh. vepr.: të milsha, të milshe, të milte, të milshim, të milshit, të milshin.

3. Disa folje tjera, që, simbas vendit, shqiptohen me ie ose je do të shqiptohen e shkruhen me ie: ziej, përziej, ndiej. N' aorist dhe në mënyrën dëshirore shkruhen me je: zejva, përzejva, ndjeva; zjefsha, përzejfsha, ndjefsha.

4. Foljet bie, shtie, do të shkruhen me i në prezent ndërsa n' imprefekt do të shkruhen me j, p.sh. bijsha, shtijsha. N' urdhnoren këto folje shkruhen kështu: bjer, bjerni, shtjer.

5. Foljet me marrë, me nxjerrë e tjera, shkruhen me rr në prezent, n' imprefekt dhe në particip: marr, marrim, mirrni (merrni), marrin; nxjerr, nxjerrim, nxirrni, nxjerrin; mirrsha, nxirrsha etj. Por në të kryemen e thjeshtë do të shkruhen me r: mora, more, muer, a mori, muerëm a morëm; nxora, nxore, nxuer a nxori, nxuerëm a nxorëm etj.

*-vijon-*

